



ISSN 2410-762X

# PERLA

REVISTË SHKENCORE - KULTURORE 2016/1

## TRAJTON

- LIDHJET KULTURORE SHQIPTARO - IRANIANE
- ALBANOLOGJI
- IRANOLOGJI
- PËRKUJTIME
- PASQYRA E LIBRAVE
- KRONIKA KULTURORE
- NEKROLOGJI

# PERLA

Revistë shkencore - kulturore tremujore

Viti XXI 2016 Nr. 1(74)

## Pasqyra e lëndës

### LIDHJET KULTURORE

<i>Abdulla Rexhepi</i>	Qasjet kritike të Sami Frashërit ndaj poezisë perse .....	5
------------------------	---	---

### ALBANOLOGJI

<i>Henri Boissin</i>	Rreth trajtës së shquar dhe të pashquar të emrit në gjuhën shqipe .....	17
<i>Shpëtim Çuçka</i>	Stefan Prifti dhe përkthimi i veprës së Barletit "Mbi jetën dhe veprat e Skënderbeut" .....	29
<i>Doriana Tuxhari</i>	Vëzhgime për terminologjinë e veshmbathjeve dhe të kozmetikës në gjuhën shqipe të sotme ...	32
<i>Jonida Xhyra-Entorf</i>	Semantika e përkryerjes (Sprovë për një interpretim të figurës së Serafina Topisë) .....	47
<i>Vasil Kristo</i>	Edukimi kombëtar gjeografik nëpërmjet teksteve shkollore (1912–1939) .....	55
<i>Merita Koka-Karaguni</i>	Migrimi dhe tiparet e tij në qytetin e Tiranës (1945-2002) .....	64

### IRANOLOGJI

<i>M. Xh. Jahaki</i>	Kulmi dhe ekuilibri në letërsinë perse .....	73
<i>Ahmed Tamimdari</i>	Stilet e prozës persiane .....	82
<i>Akiro Matsumoto</i>	Mbi filozofinë gjuhësore të Rumiut .....	92
<i>Suela Xhyheri</i>	Historia e panjohur e Letrës së Profetit Muhamed drejtuar mbretit të Persisë Khusraw II .....	104

## **PËRKUJTIME**

Stefan Prifti, profesori, filologu dhe përkthyesi i shquar (1910-1975) ( <i>Remzi Përnaska - Tefë Topalli</i> ) .....	119
--	-----

## **PASQYRA E LIBRAVE**

Aktet e Kongresit Ndërkombëtar të Arkeologjisë Shqiptare ( <i>Luan Përzhita</i> ) .....	125
Pesëdhjetë vjet publikime arkivistike në Kosovë ( <i>Sadik Mehmeti - Nuridin Ahmeti</i> ) .....	133
" <i>Godishen zbornik (Vjetar)</i> " i Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Shkupit ( <i>Valentina Nestor - Emil Lafe</i> ) .....	138

## **KRONIKA KULTURORE**

Konferenca shkencore "Fjalorët latinisht – shqip dhe latinishtja në shkollat shqiptare" ( <i>Kujtim Kapllani</i> ) .....	143
Java e Kulturës Iraniane në Shqipëri ( <i>Elton Lila</i> ) .....	146

## **NEKROLOGJI**

Kristo Frashëri (1920-2016) ( <i>Emil Lafe - Kastriot Bezati</i> ) .....	151
<i>Pasqyra e lëndës (persisht)</i> .....	155



# **LIDHJET KULTURORE SHQIPTARO-IRANIANE**



**Abdulla REXHEPI**

## **QASJET KRITIKE TË SAMI FRASHËRIT NDAJ POEZISË PERSE**

### **Përmbledhje**

Sami Frashëri ashtu siç kërkonte reformimin e shumë aspekteve jetësore – që nga kultura e deri te ekonomia – të Perandorisë Osmane, po ashtu kishte paraqitur mendime kritike për letërsinë në përgjithësi dhe për poezinë në veçanti. Në shkrimet e tij hasim vlerësime dhe kritika të qëndrueshme për poezinë perse, megjithëse kishte një admirim të veçantë për atë letërsi. Ai e çmonte tepër poezinë perse dhe thoshte se vetëm ajo e çlodhte dhe e qetësonte pas punëve të vështira. Është interesant fakti se Sami Frashëri në veprimtarinë e tij letrare ka qenë i ndikuar nga libri “Shahname” i Ferdusit, një përzgjedhje të të cilit nën titullin “Zubdei Shahname” e përkthen në gjuhën turke. Në dramën e tij “Gave”, autori trajton – gjithnjë sipas aktualitetit në të cilin ka jetuar – tregimin “Kaveh Ahenger” të Ferdusit në “Shahname”. Edhe emri i dramës tjetër të tij Suhrâb” ose “Ferzendkuş”, e cila ende nuk është publikuar, na bënë të kuptojmë se Samiu është i ndikuar nga tregimi i Rustemit dhe Sohrabit në “Shahnamenë” e Ferdusit. Nga këto fakte shohim se Samiu më shumë ka qenë i mishëruar me poezinë epike iraniane sesa me poezinë lirike të kësaj letërsie. Edhe gjatë trajtesave për poezinë dhe poetët iranianë, ai mbi të gjithë vendon Ferdusin dhe thotë se ai është mjeshtri dhe babai i poetëve iranianë. Edhe në “Kamusu’l Alam”, Samiu sjell të dhëna të rëndësishme për jetën dhe veprën e shumë poetëve iranianë.

Si një shkencëtar e kritik që ishte, nuk mund të mos shprehte edhe vlerësimet e tij kritike kundrejt kësaj poezie. E meta e parë e poezisë perse, sipas Samiut, është *Dashuria*, e cila nuk u drejtohet grave dhe nuk

---

Abdulla Rexhepi, drejtor i Institutit të Shkencave Humane “Ibn Sina” dhe doktor në letërsinë perse.

flet për to sipas rregullave të natyrshme dhe njerëzore, por gjendet në një veprim jo të zakonshëm. Një gjë të tillë e kanë vërejtur edhe kritikët e mëvonshëm iranianë të letërsisë që kanë thënë se e Dashura e secilit poet iranian është e njëjtë, ka tipare e karakteristika të njëjta. Dhe e meta e dytë që e vë në pah Samiu, është përdorimi i disa stereotipave si trëndafili, bilbili, vera, mejhane, etj., të cilët sipas tij, janë të panevojshme dhe të tepruar, që ndikojnë në zbehjen e kuptimit të poezisë.

## Hyrje

Sami Frashëri jetoi në një kohë kur Perandoria Osmane kishte filluar të shpërbehej, kurse intelektualët e pushtetarët e saj bënë të gjitha përpjekjet të kapnin hapin e zhvillimit modern të kohës, nga i cili ishin shumë larg, sidomos në rrafshin kulturor-shkencor. Zhvilloheshin debate të shumta për tema të ndryshme kulturore, ku merrnin pjesë intelektualë tradicionalë dhe modernë. Në fakt, polemikat zhvilloheshin midis traditës dhe modernes ose në mes botëkuptimit klasik islam dhe botëkuptimit modern perëndimor. Midis këtyre polemikave kulturore zë vend edhe letërsia, më saktësisht poezia. Disa nga intelektualët e asaj kohe<sup>1</sup>, mbronin poetikën klasike-tradicionale. Këta kërkonin që poezia të ketë rimën dhe metrin e së kaluarës dhe ishin kundër poezisë moderne, e cila, duke mënjanuar formën, më tepër fokusohet në mesazhin përmbajtjesor të saj. Përballë këtij qëndrimi mbi poezinë, u rreshtuan intelektualët modernistë<sup>2</sup>, të cilët kërkonin braktisjen e konceptit klasik për poezinë dhe kthimin kah poezia moderne. Sami Frashëri jetonte dhe vepronte në një mjedis të tillë polemikash dhe si një intelektual i shkallës më të lartë në Perandori, doemos do të bëhej pjesë e këtyre debateve intelektuale. Ai në disa shkrime ka reflektuar për gjuhën dhe letërsinë në përgjithësi. Shumë mendime të tij të para 120–130 vjetëve për gjuhën e letërsinë mbeten relevante edhe në debatet e sotme të gjuhësisë dhe

<sup>1</sup> Poetikën klasike e mbështetnin Eihaxh (haxhi) Ibrahim Efendiu dhe artistët përreth tij, si: Shejh Vafî, Halil Edîp, Faik Esat (Andelîb), Mystexhâbilizâde Îsmet, Mehmet Xhelâl, Ahmet Rasim dhe Sâmih Rifat, të cilët drejtonin kritika të ashpra kundrejt modernistëve. Shkrimet e tyre i botonin në gazetatat dhe revistat si: "Hazine-i Fünûn", "Resimli Gazete", "Musavver Malûmat", "Musavver Fen ve Edeb".

<sup>2</sup> Gardianët e poetikës së re, qëndrimet e tyre i mbronin në revistën Servet-i Fünûn, me mbështetjen e Rexhâizâde Mahmut Ekremi. Pjesëtarët e kësaj shkolle që në fëmijëri kishin mësuar gjuhët e huaja perëndimore, veçanërisht atë frënge dhe ishin brumosur me kënaqësitë dhe bukuritë e letërsisë perëndimore. Vlen të theksohet se edhe në Stamboll, këta përruronin një mënyrë jetese perëndimore. Ndërsa aktivitetet dhe shkrimet letrare i realizonin nën mbikëqyrjen e Tevfik Fikretit. Si rezultat i polemikave mes Rexhâizâdes ile Naxhiut, lindi letërsia moderne e ashtuquajtur Letërsia e Serveti Funinit.

kritikës letrare. Qëndrimet për poezinë, Samiu më së qarti i shprehu në gazetën “Hafta”, megjithëse këtu paraqitet vetëm si një mendimtar që ofron mendime rreth mënyrës se si duhet të jetë letërsia, e jo si një kritik letrar që merret posaçërisht me kritikën e një zhanri apo vepre të caktuar letrare. Duke pasur parasysh formimin intelektual të Samiut, i cili ishte formim sa oriental aq dhe oksidental, u rreshtua në anën e atyre që kërkonin konceptime moderne për poezinë dhe kështu doli kundër imitimit të poetëve klasikë, të cilët më shumë ishin të përkushtuar te rima dhe metri sesa në kuptimin e poezisë. “T’i thuash poezi fjalës së përshtatur dhe të rimuar, domethënë të ulësh shumë poshtë vlerën e poezisë dhe të poetëve. Shumë fjalë të shkruara me metër dhe me rimë janë shumë larg për ta arritur epitelin poezi, dhe shumë fjalë pa metër e pa rimë, me të drejtë, janë të denja për epitelin poezi”<sup>3</sup>.

Sami Frashëri gjithashtu ishte kritik i poezisë klasike turke, për krijesit e së cilës thoshte se nuk kanë arritur të shpëtojnë nga ndikimi i poezisë persiane. Sipas tij, për shkak se poetët turq kanë qenë nxënës të poetëve iranianë, është e natyrshme që të metat e mangësitë e poetëve iranianë, të gjendeshin edhe te këta. “Por ashtu siç kemi theksuar se në zhanrin e poezive narrative e historike nuk mund të qortohen poetët iranianë, të njëjtën do të themi edhe poetët e lashtë turq, ndërsa veprat e tyre në këtë zhanër meritojnë të vlerësohen e të lavdërohen. Për këtë arsye mund të thuhet se sado që në gazeliatet dhe në Divanet e Ali Shir Nevait, pavarësisht nga shumë gjurmë të shkathtësisë e të elokuencës, është e natyrshme të gjejmë mangësitë që vërehen te gazeliatet persiane, përmbledhjet poetike të poetit të përmendur, si “Ferhad ve Shirin” dhe “Lejla ve Mexhnun”, janë të denja që nga çdo aspekt të mirëpritën dhe të lavdërohen. Që nga ajo kohë kanë dalë edhe shumë poetë që kanë lënë vepra të çmueshme në gjuhën turke lindore, dhe është e natyrshme që brenda veprave të tyre do të gjenden shumë poezi që do të mund të dalloheshin”<sup>4</sup>.

Në parathënien e librit “Hurdeçin”<sup>5</sup>, në të cilin Samiu kishte zgjedhur vargje nga disa poetë persianë dhe kishte përkthyer e

---

<sup>3</sup> Şemseddin Sami, “Şiirin Mahiyet ve Hakikati”, Hafta, 29 Ramazan 1298, c. I, sy. 2 fq. 26 (Përktheu nga origjinali prof. dr. Abdullah Hamiti, dorëshkrim).

<sup>4</sup> Şemseddin Sami, “Şarkta Şiir ve Şuara 3”, Hafta, c. I, sy. 6, 27 Şevval 1298, fq. 88.

<sup>5</sup> Gazmend Shpuza në librin “Bota iraniene në veprën e Sami Frashërit” gabon kur thotë se libri ‘Hurdeçin’ i Samiut është përkthim i librit ‘Hurdefurush’ i autorit Muallim Naxhi, të cilin gjithashtu (duke cituar Sami Frashërin) gabimisht e paraqet si poet persian, kur ai është poet turk, bashkëkohës i Samiut (shih: f. 128). Vepra Hurdeçin, siç thotë dhe Samiu në hyrjen e saj, është përmbledhje e disa vargjeve të poetëve persianë, poezitë e të cilëve i përkthen dhe i komenton në gjuhën turke. Sami Frashëri askund nuk thotë se e ka përkthyer librin ‘Hurdefurush’ të Muallim



komentuar vargjet e tyre, thotë se nuk ndien kënaqësi kur lexon poezinë klasike turke. “Eleganca dhe mjeshtëria e poetëve persianë nuk shihet te poetët klasikë turq, ose së paku mua më duket ashtu... Kjo është diçka e natyrshme, e paimponuar, ja që më shumë po e ndiej poezinë perse<sup>6</sup>. Po në këtë parathënie ai shpreh përkrahjen e tij për poezinë dhe poetët e rinj turq dhe thekson se ka disa vite që kanë filluar të dalin në skenë poetë që premtojnë suksese të mëdha në këtë drejtim.

### **Poezia perse në këndvështrimin e Sami Frashërit**

Sami Frashëri është i mendimit se letërsia e Iranit ka një të kaluar më shumë se 10–11 shekuj. Edhe pse – sipas tij – feja islame lindi të arabët dhe arabët janë ata që identifikohen me Islamin, megjithatë letërsia perse duhet llogaritur si letërsi islame. Ndër shkaqet kryesore të këtij pretendimi është alfabeti, ngase arabët edhe pas ardhjes së Islamit, kishin ruajtur shkrimin e tyre dhe në këtë mënyrë kishin ruajtur edhe letërsinë paraislame. Por një gjë e tillë nuk vlen dhe për iranianët, ngase ata me të hyrë në Islam, patën braktisur shkrimin e tyre dhe kishin pranuar alfabetin e gjuhës arabe dhe kështu kishin harruar edhe letërsinë e lashtë të tyre<sup>7</sup>. Padyshim se Samiu këto përfundime i mbështeste në rezultatet e studimeve për letërsinë perse që ishin bërë deri në kohën e tij, sepse studiuesit e mëvonshëm kanë zbuluar dorëshkrime dhe tekste nga letërsia perse e paraislamit, ku ndër to mund të përmendim epikat mitologjike si *Mehrisht*, *Zamjadisht* në gjuhën avesta, *Ajatlar Zeriran* dhe *Karname-i Ordshir* në gjuhën pehlavite, pjesa e parë e “Shahnamesë” së Ferdusit, “Gorshasbnameja” e Esedi Tusiut dhe “Shahnametë” e Muejjed Belhiut dhe Ebu Mansurit<sup>8</sup>.

Si njohës i shkëlqyeshëm i botëkuptimeve dhe filozofive lindore e perëndimore, Samiu poezinë perse e radhitë në mesin e poezive indoeuropiane dhe bënë dallimin e saj nga poezia arabe, edhe pse nuk qe krejt e pandikuar prej saj. “Poetët iranianë nuk imituan fare poetë arabë, por ndoqën një rrugë të veçantë, dhe është një gjë e çuditshme që mos të gjendet asnjë ngjashmëri midis poezisë arabe dhe poezisë persiane. Nga

---

Naxhiut, por që atë libër e ka marrë si mostër për librin e tij ‘Hurdeçin’. Gjithashtu duhet thënë se G. Shpuza bënë edhe një gabim tepër të madh kur fjalën ‘nuresidegan’ (fjalë perse me kuptimin ‘të rinj’, ‘të porsaardhur’) e përkthen si emër të përveçëm Nusidgjan, të cilin e prezanton si poet turk. Samiu në hyrje të veprës ‘Hurdeçin’ flet për poezinë dhe poetët e rinj turq, për të cilët ofron përkrahje, dhe diku përdor për ta dhe fjalën perse ‘nuresidegan’ në kuptimin ‘poetët e rinj’. Prandaj dhe kjo fjalë nuk ka të bëjë fare me ndonjë emër poeti të kohës së Samiut.

<sup>6</sup> Şemseddin Sami, Hurdeçin, Mihran Matbaası, İstanbul, 1885. fq. 6.

<sup>7</sup> Şemseddin Sami, “Şarkta Şiir ve Şuara 2”, Hafta, c. I, sy. 6, 27 Şevval 1298, fq. 86.

<sup>8</sup> Ahmed Tamimdari, “Historia e letërsisë perse”, ... f. 175.

një anë, kjo kundërvënie, dhe, nga ana tjetër, ngjashmëria e poezisë persiane me poezinë indiane e greke dhe me poezitë e gjuhëve të tjera ariane, shtrojnë mundësinë që poetët e mëparshëm t'u jenë nënshtruar veprave poetike të Iranit të krijuara para Islamit. Sepse, sado që sot nuk ka një vepër nga poezia dhe letërsia paraislame e Iranit, është e mundur që në kohën e poetëve Dekiki dhe Firdeusi të ketë pasur disa kujtime nga poezitë e vjetra, qoftë të mbajtura mend nga populli. Ashtu siç kanë arritur te poetët e Iranit islamik shumë aspekte të historisë së vjetër të Iranit, po ashtu edhe disa vepra të poetëve të kohërave të Dara-s dhe të Nevshirvan-it duhet të kenë arritur te veshët e këtyre poetëve<sup>9</sup>.

Në disa vepra të Samiut hasim admirim të madh për poezinë klasike perse, veçanërisht për epikën perse. Për të poezia perse ishte çlodhje nga punët e rënda si hekuri. “Nga e kaluara e kam bërë shprehi që, kur lodhem nga punët e detyrueshme. – të ftohta dhe të forta si hekuri, – prehjen dhe qetësinë shpirtërore e kërkoj në poezinë perse. Pse e parapëlqej poezinë perse? Mund të thoni se a nuk mund të përjetohet butësia dhe eleganca e poezisë perse edhe në kohën kur lexon veprat e poetëve klasikë turq – të akuzuar si imitues të poetëve persianë – apo te veprat e poetëve tanë të rinj, të cilët kanë filluar të shkruajnë gjatë këtyre 5–6 viteve të fundit, madje kanë shkruar dhe vepra mjaft të bukura? Nuk kam asnjë fjalë për këta poetë të rinj, sidomos unë jam prej të parëve që kam shprehur përkrahjen time ndaj kësaj tradite moderne të poezisë. Megjithëse kjo poezi ende është shumë e kufizuar. Ndërsa eleganca dhe mjeshtëria e poetëve persianë nuk shihet te poetët klasik turq, ose së paku mua më duket ashtu... Kjo është diçka e natyrshme, e paimponuar, ja që më shumë po e ndiej poezinë perse. Nëse na lejohet ta përshtatim një thënie të Napoleon Bonapartit për ndarjen e gjuhëve evropiane dhe nëse ne atë e përdorim për gjuhët e Azisë, atëherë mund të thuhet se “Gjuha perse është e krijuar për poezinë, ndërsa poezia për gjuhën perse”<sup>10</sup>. Ai te poezia perse gjen mësim për moralin dhe filozofinë, dy rrafshe këto shumë të rëndësishme për jetën e njeriut.

Si mendimtar serioz që ishte, Sami Frashëri nuk mund të mos shprehte dhe kritikën e tij për poezinë perse dhe të nxirrte të pah të metat që mendonte se kishte kjo poezi. Në vijimin e dytë të shkrimit të tij me titull “Poezia dhe poetët në Lindje”, ku flet për poezinë perse, shpreh qëndrimin e tij kritik për dy aspekte të kësaj poezie.

Sipas tij, e meta e parë e poezisë perse është në atë se dashuria, e cila nuk u drejtohet grave dhe nuk flet për to – sipas rregullave të natyrshme dhe njerëzore, – por gjendet në një veprim jo të zakonshëm.

---

<sup>9</sup>Şemseddin Sami, “Şarkta Şiir ve Şuara 2”, Hafta, c. I, sy. 6, 27 Şevval 1298, fq. 86–87.

<sup>10</sup>Şemseddin Sami, Hurdeçin, fq. 2.

Sado që në “gazelet” e poetëve iranianë fjalët e përmendura “dilber” dhe “xhanan” (e dashur – shpirt) kryesisht kanë të bëjnë me dashurinë e një personi të imagjinuar, edhe në rast se ekziston ai person, s’ka dyshim se do të jetë i dashuri i një lloji të dashurisë që e kanë ekspozuar Platoni dhe filozofët e tjerë grekë e që te lindorët pa sukses është e njohur me emrin “dashuri e vërtetë (reale)”<sup>11</sup>.

Meqë Samiu në këtë pikë nuk specifikon poetin apo ndonjë krijimtari të caktuar poetike perse, atëherë na jep të drejtën të mendojmë se ai një qëndrim të tillë e ka për të gjithë poetët persë, gjë që është e paqëndrueshme. Një kritikë e tillë mund t’i drejtohet me shumë të drejtë poetëve – që nuk janë pak në numër – të cilët nuk arritën të shpëtojnë nga ndikimi i poetëve të mëdhenj persë, siç ishin Ferdusi, Senai, Attari, Mevlana, Hafizi, Sadiu. Tani në vazhdim të shohim se prej nga buron kjo qasje e Samiut për poezinë.

Ekziston dallim i madh në këndvështrimet ontologjike dhe epistemologjike midis mendimtarëve klasikë të Lindjes dhe atyre modernë të pas Renesancës, – këtyre të fundit u takon dhe Samiu. Natyrisht, këtë kritikë që ai u drejton poezive klasike perse e turke, e bazon në konceptimet moderniste për universin dhe ekzistencën. Botëkuptimet e reja filozofike në Perëndim ndikuan në ndryshimin e qasjeve ndaj të gjitha rrafshëve jetësore, duke përfshirë këtu edhe poezinë. Arti, ku bënë pjesë edhe poezia në lashtësi, p.sh. te Platoni dhe te Aristoteli, ishte *Mimesis*. Mimesis-i ka kuptimin e zbuluesit apo personit që nxjerr në pah *Physis*-in, e cila nënkupton gjithësinë, e jo përshkrim i natyrës siç kuptohet zakonisht. Sipas këtij vështrimi, artisti është vetëm një zbulues, por jo edhe krijues, ku midis tyre kemi një dallim të madh. Poezia klasike reflekton formën e një shembulli të një akti, kurse pasiviteti që zë vend në brendësinë e poetit në asnjë mënyrë nuk u nënshtrohet realiteteve që ekzistojnë jashtë tij. Andaj dhe poezia klasike perse – ashtu si poezia arabe dhe ajo turke e divanit – përbehet nga koncepte subjektive dhe universale, nga stereotipat letrarë apriori dhe në forma të caktuara e të kufizuara. Në një poezi të tillë nuk mund të ekzistojë koha historike dhe kalendarike e për këtë dhe funksionaliteti i saj është çdokohshëm dhe për çdo mendësi. Poezia klasike perse nuk reflektonte jetën e vërtetë të njeriut, por më tepër ishte rezultat i transformimit të jetës në kujtesë dhe për këtë kjo poezi s’kishte nevojë për fjalë të vërteta.

Samiu bënë dallim e subjektit me objektin dhe në këtë mënyrë kërkon përshkrimin e saktë të objektit, në këtë rast të gruas të cilës i këndon poeti. Ndërsa në poetikën klasike që nga Platoni, Plotini, etj., të

<sup>11</sup> Şemseddin Sami, “Şarkta Şiir ve Şuara 2”, Hafta, c. I, sy. 6, 27 Şevval 1298, fq. 87–88.

cilën e trashëguan edhe poetët persianë, subjekti dhe objekti në mendimin e poetit janë të pandarë dhe kjo është arsyeja se pse karakteristikat dhe epitetet e figurave poetike përafërsisht janë të njëjta. Duhet theksuar se objektcentrizmi në filozofi dhe më pas në të gjitha fushat e tjera jetësore lindi me Dekartin (1596–1650) dhe më pas u trajtësua nga Kanti (1724–1804), të cilin më pas e shohim në ontologjinë dhe epistemologjinë moderniste, së cilës i takon dhe Sami Frashëri. Kanti mendon se e bukura është akt i vlefshëm që njeriut i dhuron kënaqësi, dhe sipas kësaj d.m.th. akt relativ që mund të ndryshojë nga një njeri te në tjetër<sup>12</sup>. Ndërsa në botën islame, e bukura ka karakter ontologjik/ekzistencial (genisize). Pra, sipas kësaj premise, vetë Qenia është e bukur (art) dhe të folurit për te është sikur të flasësh për vetë Qenien. Qeniet janë të bukura dhe kjo e fundit nuk është subjektive. Kështu dhe njeriu nuk është objekt i realizimit estetik dhe e bukura ka realizim të jashtëm<sup>13</sup>.

Thënë shkurt, të përqendrohesh te subjekti do të thotë që fenomenet, botën përreth, madje edhe Zotin ta konceptosh prej prizmit të njeriut, pra këto gjëra t'i kuptosh aq sa ke kapacitet dhe interes si njeri, e jo t'i perceptosh ashtu siç janë. Prandaj çdo gjë kuptohet sipas interesit njerëzor, edhe arti krijohet dhe pëlqehet sipas shijeve të vetë njeriut. Pra dallimi midis qasjes moderniste dhe jomoderniste qëndron në këtë se modernistët të ndikuar prej Kantit, janë antropocentrikë, pra çdo gjë e vështrojnë nga spektri njerëzor, ndërsa jomodernistët janë trashëndentalë, apo Zotcentrikë. Nëse këtë qasje e bartim në poezi dhe në përgjithësi në art, atëherë themi se sipas modernistëve arti apo poezia është krijim që ndjell shijen ose kënaqësinë e njeriut, kurse për botën jomoderniste, sidomos për botën klasike islame, poezia ose arti janë vetëm mjete për zbulimin apo nxjerrjen në pah të bukurisë hyjnore. Kjo vlen sidomos për letërsinë e tesavufit, e cila ndoshta është letërsia më origjinale dhe më universale se lirika dhe epika e botës islame. Për poetët si Mevlana, poezia nuk është krijim për të kënaqur shijet e njeriut, por është një mjet për të shfaqur bukuritë e fshehta të Krijuesit. Për poetët si ai, poezia në fakt nuk është profesion, dhe kjo është arsyeja pse në shumë raste Mevlana distancohet nga poezia dhe atë e konsideron të pavlefshme. Sipas tij, arti i vërtetë reflektohet nëpërmjet një shpirti që është pastruar nga çdo e keqe dhe lakmi, sidomos nga lakmia për të qenë artist. Vetëm një shpirt i tillë mund të reflektojë bukurinë e botës së dukshme dhe të padukshme. Për këtë edhe mendoj se Sami Frashëri kur kritikon letërsinë turke të Divanit, letërsinë perse apo letërsinë klasike në përgjithësi, është nën ndikimin e filozofisë moderniste, pra nuk merr fare

<sup>12</sup> Immanuel Kant, *Kritika e gjykimit*. “Plejad”. Tiranë 2002, fq. 42.

<sup>13</sup> Shahram Pazouki, *Felsefe ve Hikmet*. Teheran, 1388. fq. 24.

parasysh botëkuptimin që kishin të vjetrit (por edhe shumica e myslimanëve sot) ndaj fenomeneve, metafizikës dhe Zotit në përgjithësi.

Një qasje e tillë për letërsinë, sidomos për poezinë, e cila kishte një traditë të gjatë dhe shumë të pasur në botën islame, ndikoi tek intelektualët e Lindjes, të cilët kërkonin reforma në të gjitha sferat jetësore në shoqëritë e tyre. Si në botën arabe, në Iran, ashtu edhe në Turqi u zhvilluan debate mjaft interesante dhe të dobishme pro dhe kundër poezisë klasike dhe moderne; nga këto debate ishte ndikuar edhe Sami Frashëri. Kritika më e madhe që i bënin poezisë klasike kritikët e saj, ishte se ajo nuk përshkruante realisht objektet apo fenomenet për të cilat fliste poeti. Prandaj dhe Samiu kërkon që fenomenet dhe realitetet që përshkruan poeti, të jenë objektive ashtu siç i sheh ai vetë. Ai shkruan: “Kur duam të bëjmë përkufizimin e drejtë për poezinë, duhet t’i lëmë anash lidhjet si rima e metrika, por të kujdesemi për karakteristikat e saj të vërteta dhe shpirtërore. Prandaj, mund të themi se: ashtu sikundër piktori i vizaton dhe vë në dukje trupat dhe pamjet e natyrës, edhe poeti i përshkruan me fjalë mendimet dhe ndjenjat njerëzore, si dhe situatat dhe ngjarjet e ndryshme”<sup>14</sup>. Pra edhe Samiu, si kritikët tjerë të poezisë klasike, mendon se nëpërmjet përshkrimit, lexuesi merr nën kontroll skenat reale që përshkruhen në poezi dhe, duke i bashkënduar ato, arrin të krijojë një imazh të vërtetë për mesazhet që dëshiron t’i transmetojë poeti. Sepse, sipas tyre, në qoftë se lexuesi fokusohet vetëm te rima dhe metri, nuk mund të kapë si duhet mesazhet e poetit. Sami Frashëri shkruan se rima te poetët e vjetër ka qenë krejtësisht e panjohur. Kjo është zbuluar nga poetët arabë dhe nga ata është bartur te poetët persianë e turq, dhe është kaluar në Evropë në mesjetë së bashku me veprat e qytetërimit islam. Sot shumica në poezi i kushtojnë rëndësi rimës dhe rima po konsiderohet një nga kushtet e domosdoshme të poezisë. Edhe në metër janë dy rrugë. Disa nga poetët kanë kujdes që metri silabik në vargje të jetë numerikisht i barabartë, dhe disa nuk e shikojnë numrin, rrokjet e gjata i zëvendësojnë me dy të shkurtra, por vetëm kujdesen që vargjet të kenë një zgjatje zëri<sup>15</sup>. Për këtë dhe në hyrjen e veprës “Hurdeçin” Samiu shprehet se përkrah poezinë e re moderne turke dhe thotë se ajo ka vlera të larta, megjithëse, sipas tij, kjo poezi ende është shumë e kufizuar. Por ai nuk ka të njëjtin mendim edhe për poezinë klasike turke.

Ndërsa, kritika e dytë e Sami Frashërit për poezinë perse ka të bëjë me këngët lirike persiane, që janë të kufizuara në përdorimin e disa

<sup>14</sup>Şemseddin Sami, “Şiirin Mahiyet ve Hakikati”, Hafta, 29 Ramazan 1298, c. I, sy. 2, fq. 28.

<sup>15</sup>Şemseddin Sami, “Şarkta Şiir ve Şuara 2”, Hafta, c. I, sy. 6, 27 Şevval 1298, fq. 87–88.

fjalëve si: *trëndafil, bilbil, selvi (qiparis), bistekët e së dashurës, verë, mejhane, mejhanexhi*, dhe me kujdesin e tepruar që u kanë kushtuar disa krahasimeve jo të zakonshme, deri në atë masë, sa të dalin jashtë së zakonshmes. Paaftësia dhe pamundësia e poetëve elokuentë iranianë që t'i numërojnë këto situata të pamundura i ka privuar veprat e tyre poetike nga shija dhe bukuria që kanë pasur për qëllim. Sado që brenda një gazeli persian që ka të bëjë me dashurinë, mund të gjesh një varg apo një bejt, i cili mund të pëlqehet nga çdo aspekt, brenda një divani (përmbledhjeje) të këtillë rrallë gjendet një gazel i zhveshur nga të metat që përmendëm lart<sup>16</sup>. Si shumë kritikë të tjerë të poezisë klasike lindore, edhe Samiu kritikon stilitë e tepërta, formalizmin, metaforat e përsëritura, shprehjet figurative dhe alegorike, etj. të poezisë, për të cilat mendonin se elementet e këtilla letrare shkaktonin ngufatjen e objektivitetit të poezisë.

Por kritika letrare e dekadave të fundit ka konstatuar se këto shprehje figurative duhet t'i kuptojmë si arketipa letrarë më të gjerë e më të thellë e jo vetëm si stereotipa me kuptime shumë të ngushta, ashtu siç duken në vështrim të parë. Arketipat janë personalitete ose struktura ezoterike që nëpërmjet simboleve shpërfaqin elementet dhe konceptet e një kulture të caktuar. Prandaj dhe kjo simbolikë duhet kuptuar brenda kornizës ontologjike dhe epistemologjike të misticizmit islam, veçanërisht të misticizmit me elemente të lashta iraniane. Simbolika e letërsisë klasike perse, sidomos ajo e poezisë së tesavufit është shumë më e thellë dhe tejkalon përkufizimet racionale. Për shembull, fjalën *mejhane* në letërsi, sidomos në letërsinë mistike, duhet ta marrim si një vendqëndrim të mistikut, qoftë ajo xhami apo teqe, ku ai i çliruar nga çdo djallëzi e kompleks, pra si një i dehur, nxjerr nga shpirti e mendja fjalët dhe lutjet më të bukura për të Dashurin e tij, madje në disa raste kjo dehje shkon deri në Enel Hak (tretje në Zotin).

## Përfundim


Sami Frashëri me gjithë admirimin për poezinë perse dhe kënaqësinë që ndjeu me këtë letërsi, nuk ngurroi të drejtonte edhe kritika drejt saj dhe kishte arritur të identifikonte –sipas tij – dy të meta themelore të poezisë perse. E meta e parë është *dashuria*, e cila nuk u drejtohet grave dhe nuk flet për to sipas rregullave të natyrshme dhe njerëzore, por gjendet në një veprim jo të zakonshëm. Një gjë të tillë e kanë hasur edhe kritikët e mëvonshëm iranianë të letërsisë, për të cilin kanë thënë se e Dashura e secilit poet iranian është e njëjtë, ka

<sup>16</sup>Şemseddin Sami, “Şarkta Şiir ve Şuara 2”, Hafta, c. II, sy. 6, 27 Şevval 1298, fq. 88.

tipare e karakteristika të njëjta. Dhe e meta e dytë që vë në pah Samiu është përdorimi i disa stereotipave, si trëndafili, bilbili, vera, mejhane, etj., të cilët sipas tij, janë të panevojshëm dhe të tepruara, çka ndikon në zbehjen e përmbajtjes. Por duhet theksuar se rezultatet e mëvonshme të kritikës dhe studimeve letrare dëshmojnë se jo të gjitha këto kritika janë të qëndrueshme, por megjithatë ne duhet t'i kuptojmë ato sipas rrethanave dhe realiteteve kohore dhe hapësinore ku jetoi Samiu.

## Literatura

1. Ahmed Tamimdari. *Historia e letërsisë perse*, përktheu: Abdullah Rexhepi, Fondacioni Saadi Shirazi, Tiranë (bot. i dytë), 2011
2. Gazmend Shpuza. *Bota iraniane në veprën e Sami Frashërit*, Onufri, Tiranë, 2004.
3. Immanuel Kant. *Kritika e Gjykimit*, Plejad. Tiranë, 2002.
4. Shahram Pazouki. *Felsefe ve Hikmet*. Teheran, 1388.
5. Şemseddin Sami. *Şiirin Mahiyet ve Hakikati*, Hafta, 29 Ramazan, Istanbul 1298.
6. Şemseddin Sami. *Şarkta Şiir ve Şuara 1,2,3*, Hafta, Şevval, Istanbul 1298.
7. Şemseddin Sami. *Hurdeçin*, Mihran Matbaası, Istanbul, 1885.



# **ALBANOLOGJI**





Henri BOISSIN

## RRETH TRAJTËS SË SHQUAR DHE TË PASHQUAR TË EMRIT NË GJUHËN SHQIPE

Shqipja, ashtu si bullgarishtja dhe maqedonishtja, për të përmendur këtu vetëm gjuhë ballkanike, e shënon shquarsinë e emrave me anë të një nyje të prapavendosur, format e së cilës në emërore njëjës, gjinia mashkullore, janë: *-i* (*-u* pas grykoreve dhe zanores, përveç përjashtimeve), gjinia femërore: *-a* (*-ja* në disa raste pas zanores), në gjininë asnjane: *-t* (në raste kur kjo gjini s'është zhdukur ende) dhe: *-t* në numrin shumës në të tria gjinitë. Kjo nyjë lakohet dhe merr mbaresa të veçanta sipas rasave.

Kemi të bëjmë me një sistem koherent të përsosur dhe që funksionon normalisht në dukje: *një burrë i math*<sup>1</sup> “un grand homme”, *një grua punëtore* “une femme travailleuse”, *mish të lirë* “de la viande bon marché”, që u kundërvihen formave të shquara: *burri i math* “le grand homme”, *gruaja punëtore* “la femme travailleuse” *misht e lirë* “la viande bon marché”<sup>2</sup>.

---

<sup>1</sup> Shembujt e sjellë në këtë artikull nga H. Boissin i kemi lënë sipas origjinalit, pa i kthyer në normën e sotme letrare. (Shënim i përkthyesit).

<sup>2</sup> Do të vëmë re që në grupin emër + mbiemër që përmban të ashtuquajturën nyjë lidhëse, shquarsia vihet re në emërore asnjane, jo vetëm nga prania e nyjës së prapavendosur, por edhe nga trajta e veçantë e nyjës lidhëse: e pashquar mish të lirë, e

---

Henri Boissin (Anri Buasën, 1910–1975), albanolog i shquar francez, që themeloi dhe drejtoi mësimin e gjuhës shqipe në Institutin e Gjuhëve dhe Qytetërimeve Orientale në Paris (1949–1968). Autor i një vargu artikujsh për gjuhën shqipe, ndër të cilët edhe artikulli i mësipërm, që ka vlerë jo vetëm për historinë e studimeve për kategorinë e shquarsisë në gjuhën shqipe, por edhe për vëzhgimet e mprehta, krahasimet e brendshme (ndërmjet gegërishtes e toskërishtes) dhe të jashtme (me gjuhët fqinje të Ballkanit e me gjuhë të tjera) dhe hap shtigje për hulumtime të mëtejshme. Vepra kryesore albanologjike e H. Boissin-it është Grammaire de l'albanais moderne. Paris, 1975, 341 f. Ky shkrim botohet në përkujtim të 40-vjetorit të ndarjes së tij nga jeta..

Ç'është e vërteta, në vija të përgjithshme, gjendja faktike në gjuhën letrare normale, kryesisht në atë të dialektit të jugut, në toskërishte, është e mirë; nga ana tjetër, nuk mund të themi të njëjtën gjë për gjuhën me karakter më popullor dhe të ndarë në shumë të folme, të dialektit të veriut, të gegërishtes.

Rendi i bukur i paradigmave gramatikore duket sikur priset nga gjithë ajo seri faktesh që ne do të shqyrtojmë njërin pas tjetrit sipas ndarjes së tyre dialektore.

## I. Raste të veçanta në gegërishte

1. Ndërsa në toskërishte, ashtu si në shumicën e gjuhëve indoeuropiane, mbiemri dëftor<sup>3</sup> ndiqet nga një emër në trajtë të pashquar, gegërishtja, në këtë rast, mund të përdorë një të shquar. Këtë përdorim, pa qenë krejt absolut, e ndeshim shpesh pas fjalëve *ai, ajo* (që shërbejnë edhe si përemra vetorë): *ai njeriu* “cet homme”, *asaj goces* “de cette jeune fille” (shembuj të cituar nga Weigand-i, *Albanische Grammatik*, f. 66). – Le të marrim rastësisht disa shembuj të tjerë nga tekste të ndryshëm: *jam i sigurt se malësorët qi e përsjellin at Shkodranin...* “je suis sûr que les Montagnards qui accompagnent ce Scutariote...” (Koliqi, *Miku*); *shko n'at shkollën ku jam mësue* “va dans cette école où j'ai étudié”, dhe disa rreshta më tej: *shko n'at kishë* (e pashquar) *ku i kam urue...* “va dans cette église où j'ai prié...” (Filip Shiroka, *Shko dallnyshë*), etj. – Pas dëftorit të afërsisë *ky*, femërore *kjo*, mund gjithashtu të hasim, ndonëse më rrallë, trajta të shquara: *në këtë Svicërën e Ballkanit: dans cette Suisse des Balkans*” (Anton Harapi, *Korçë e Shkodër*), *kjo çobanka po na bredh shkëmb mbi shkëmb* “cette bergère saute de rocher en rocher” (Nexhat Hakiu, titull poezie).

Një rast i veçantë formohet nëpërmjet grupit të përbërë mbiemër dëftor + numëror + emër. Në këtë rast mund të ndeshim trajtën e shquar të emrit në të dy dialektet, kështu në gegërishte: *ndershej ktyne dy krahinavet* “entre ces deux régions” (Anton Harapi, *Korçë e Shkodër*), në toskërishte: *këto të dy tepsitë e ergjentta* “ceux deux

---

shquar misht e lirë; e njëjta dukuri ndodh edhe në kallëzore, për të tria gjinitë: një burrë *të madh* ~ *burrin e madh*; një grua *të madhe* “une grande femme” ~ *gruan e madhe*; misht *të lirë* ~ *misht e lirë*; dhe në gjinore-dhanore femërore: një gruaje *të madhe* ~ *gruas së madhe*.

<sup>3</sup> Kemi ruajtur terminologjinë gramatikore të frëngjishtes, që përdor autori, sipas së cilës dallohen mbiemrat dëftorë e pronorë (*ky libër, kjo fletore, libri im, fletoret e mia*) nga përemrat dëftorë e pronorë (*ky është libër, ç'është kjo? imja është supa? të gjitha janë tonat* etj.). Ky dallim është bërë dikur edhe në gramatikat e shqipës: *cili libër është yti?* (përemër pronor), *libri yt* (mbiemër pronor).

plats d'argent” (Lumo Skendo, *Ay mal*). – Më poshtë do të shikojmë trajtimin e ndryshëm të numërorit në gegërishte, e cila i plotëson nevojat e saj nëpërmjet trajtës së shquar të emrit, dhe në toskërishte, e cila i shton në raste të tilla edhe një lidhëse të lakimit të shquar të numërorëve.

Gjithashtu, në raste të tilla mund të përdoret ndonjëherë trajta e shquar pas *disa*, ca “quelques”: *me ndihmën e disa Shqiptarëve* “avec l'aide de quelques Albanais”.

Edhe pse këto ndërtime nuk kanë asgjë të përcaktuar me rreptësi, ato prapëseprapë karakterizohen nga një pasiguri, e cila turbullon ndjenjën e kundërvënies së qartë midis së pashquarës dhe të shquarës.

Disa herë kemi krahasuar ndërtimet greke *Αυτός ο άνθρωπος* “Ky burrë”, *τούτο το κορίτσι* “kjo vajzë” dhe maqedone *toj mužot* “ky burrë” (Sandfeld, *Linguistique balkanique*, ff. 122 et 178 shënim.).

– Ne do të shtojmë që është ndërtimi i zakonshëm i sllavishtes së vjetër: *mésto se mačūnoe* “ky vend mundimesh”, ku fjala *mačūnoe* është trajtë e shquar (Vaillant, *Manuel du vieux-slave*, I, f. 16.)

2.Një përdorim më i papritur është ai i trajtës së shquar që ndeshet nganjëherë pas *nji*, në frëngjishte “*un*”, kështu: *Nji lules së veshkun* “A une fleur fanée” (titull i një poezie të Filip Shirokës); *nuk i lënte dalë nji i riut* “il ne restait pas en arrière d'un jeune” (Koliqi, *Miku*), etj.

Është një rast i ndryshëm nga ai që vihet re pas thyesave po në toskërishte, shembuj (të nxjerrë nga Fjalori i Leotti-t): *harxhova një të njëzettën e të hollave* “j'ai dépensé un dixième<sup>4</sup> de l'argent”, *në një të katërtën e orës* “en un quart d'heure”. Në gegërishte thyesat vendosen në trajtën e shquar pas numërorit 1 (nji): *nji e dytë*<sup>5</sup> “1/2”, *nji e treta* “1/3”, *nji e katra* “1/4”. – Mund t'i krahasojmë me mënyrat e të shprehurit në greqishte *Ἐόδεψα το ένα τέταρτο ἀπ'τα λεφτά στο Παρίσι και τα άλλα στην Αθήνα* “harxhova çerekun e parave në Paris dhe pjesën e mbetur në Athinë”, etj.

3.Dallimi midis krahasores dhe sipërores shënohet nëpërmjet kundërvënies të së pashquarës me të shquarën, sipërore (relative), në fakt, teorikisht, është vetëm trajta e shquar e krahasores, *kjo odë asht ma e pastër* (e pashquar, pra krahasore) *se të tjerat* “cette chambre est plus propre que les autres”, ndërsa *kjo odë asht ma e pastra* (këtu kemi të shquarën, pra sipëroren) *nga të gjitha* “cette

<sup>4</sup> Në fakt: Një të njëzettën = un vingtième. (Shënim i përkthyesit)

<sup>5</sup> Kështu në origjinal, por pritej *nji e dyta* (Shënim i përkthyesit)

chambre est la plus propre de toutes”. – Në fakt, ne mund të gjejmë trajta të shquara të cilat kanë qartësisht kuptimin e krahasores: *mê i zoti se tjerët* “plus capable que les autres” (Çekrezi).

Ne do të vëmë re se, ndërkohë që gjuhët sllave moderne ka një kundërvënie të qartë ndërmjet krahasores dhe sipërores, sllavishtja e vjetër njihet, po ashtu, një përdorim mjaft të lëkundshëm në këtë lëmë. Sipërorja relative shprehet normalisht me krahasoren: *visěchŭ mŭn’ii* “më i vogli nga të gjithë” (Vaillant, *vep. e cit. f.* 134). – Ndërkohë që në greqishten e vjetër krahasorja dhe sipërorja kishin mbaresa të dallueshme (-τέρος, -ίων, për krahasoren, -άτος, -ιστος, për sipëroren), greqishtja moderne e ka rrafshuar këtë dallim dhe është thjesht prania ose mungesa e nyjës, e cila tregon nëse kjo apo ajo trajtë është një krahasore apo një sipërore (p.sh. Πιο καλός, καλύτερος, πιο καλύτερος, janë krahasore “më i bukur” dhe Ο πιο καλός, ο καλύτερος, ο πιο καλύτερος, janë sipërore “më i bukur”). Rumanishtja gjithashtu kundërvë: *mai bogat* “më i pasur” me *cel* (nyjë) *mai bogat* “më i pasuri”.

## II. Raste të veçanta në toskërishte

Këto raste janë të pakta dhe vetëm i pari është vërtet i qartë.

1. Në toskërishte, kundërvënira formale e të shquarës me të pashquarën është zhdukur krejt në gjuhën popullore në gjinore-dhanore shumë. Ne kemi mundur të hulumtojmë seri të tëra gazetash të kohëve të fundit pa gjetur qoftë edhe një formë të vetme. Ndërkohë që revista shkencore e Institutit të Shkencave quhet zyrtarisht “Buletini i Institutit të Shkencave” (trajta e shquar), shpalljet e shumta dhe urimet politike të dërguara nga funksionarë të këtij institucioni gjithnjë kanë qenë nënshkruar kështu: *Nënpunësit e Institutit të Shkencave* (e pashquar). Prej këndej buron një çekuilibër midis gjinore njëjës (trajtë e shquar për nga kuptimi dhe nga forma) dhe gjinore shumë (e shquar për nga kuptimi, por e pashquar për nga forma), *plani i muajve* (e pashquar) *Korrik e Gusht* “le plan des mois de juillet et d’août”, për shembull i kundërvihet për nga forma *plani i muajit* (trajtë e shquar) *Gusht* “le plan du mois d’ août”. Këtu nuk bëhet fjalë për mënyrë të shprehuri, e cila ngjitet deri në zanafillë, për një zvogëlim të thjeshtë të dyfishtë (përpara nyjës të që i paraprin një mbiemri ose një emri në gjinore): *malevet të larta*: “des hautes montagnes” ose *malevet të Shqipërisë* “des montagnes d’ Albanie” shqiptuar *malevetë larta*, *Shqipërisë* (ndodh dukuria e haplologjisë dhe më vonë në mënyrë të ndarë *maleve të larta*, *Shqipërisë*, por për një kalim në kategorinë e së pashquarës, meqenëse e njëjta

dukuri do të mund të na jepte në gjinore-dhanore njëjës mashkullore: *malit të lartë* “de la haute montagne”, *malit të Tomorrit* “de la montagne du Tomorri”, dhe femërore: *shtëpis së bardhë* “de la maison blanche”, *shtëpis së mikut* “de la maison de l’ami” dhe se për këto dy raste, ne nuk hasim asnjëherë forma të thjeshtuara si *mali të lartë*, *mali të Tomorrit*, *shtëpi së bardhë*, *shtëpi së mikut*.

2. Në disa të folme toske, kryesisht në atë korçare, nyja lidhëse që ndjek një emër në femëroren e shquar në gjinore-dhanore ka formën *të* në vend të *së* (shembuj të nxjerrë nga “Lulja e Kujtimit” e Foqion Postolit): *hapi portën e shtëpisë të Z. Kristo* “il ouvrit la porte de la maison de M. Kristo”, *në xhepin e palltos të Dhimitrit* “dans la poche du paletot de Dhimitër”. – Le të shënojmë edhe: *mënyra e radhosjes të fjalëve në vargje* “la manière d’aligner des mots en vers (Mitrush Kuteli, nga Pogradeci, qytet i vogël i krahinës së Korçës). Prej këtyre shembujve konstatohet luhatjen që ekziston në gjinore-dhanore shumë tek emrat në formën e njëjës lidhëse që mund të jetë *të* ose *së*, si për shembull: *resultati i së dhënave gjeografike* “le résultat des données géographiques” (Eqerem Çabej, *Për gjenezën e literaturës shqipe*), por *e kremta e të pambrujvet* “la fête religieuse des azymes”. Toskërishtja përdor gjithashtu në gjinore-dhanore njëjës formën *së* (gegërishtja ngurron në këtë rast midis *të-së* (me të shpeshtë) dhe *së-së*) *drithma e së përtejmes* “la peur de l’au-delà”, *thellësit e së panjohurës* “les abîmes de l’inconnu”. Nëse në shembujt e parë mund të themi se bëhet fjalë për një ndikim të mashkullores, grupi i dytë i shembujve duket se tregon më fort që kemi të bëjmë me një pasiguri midis së shquarës dhe të pashquarës.

### III. Raste të përbashkëta në gegërishte dhe në toskërishte

1. Shqipja (gegërishtja dhe toskërishtja), ndryshe nga ç’ndodh në shumë gjuhë të tjera indoeuropiane, mund të përdorë për thirroren, kur bëhet fjalë për një grup të përbërë (emër + mbiemër cilësor, emër + mbiemër pronor, emër + emër në gjinore) trajtën e shquar të emrit, për shembull, gegërisht: *luleja e bukur, kputë kush te ka?* “belle fleur, qui t’a brisée?” (Filip Shiroka), *moj Shqypni, e mjera Shqypni* “ô Albanie, pauvre Albanie”, *o i biri i Adamit* “ô fils d’Adam” (Gjergj Fishta), etj.; toskërisht: *o mëma jime, e bukura Arbëri* “ô ma mère, belle Albanie” (Zef Skiro), *o foshnjëzat e uruar* “ô petits enfants bénis” (Naim Frashëri); toskërisht e Italisë: *zonja e ime* “ma reine”, po në rreshtin e mëposhtëm: *zonjë* (e pashquar) “reine” (Anton Argondizza, *Pa mëmë*).

Për analogji të këtyre shprehjeve mund të shikojmë edhe ndërtime bullgare të tipit *dragi prijatelju* “i dashur mik”, ku mbiemri merr formën e ashtuquajtur “të gjatë”, e cila vjen nga trajta e shquar e sllavishtes së vjetër *moeto pārvo libe* “dashuria ime e parë”, me një mbiemër pronor normalisht të shquar; e njëjta dukuri ndodh edhe në serbokroatishte, ku “(o) *fajkua i bardhë*” thuhet “*beli* (trajtë e shquar) *sokole*”, dhe jo \**beo* (e pashquar) *sokole*”. Po kështu, edhe në sllavishten e vjetër zakonisht përdoret trajta e shquar (Vaillant, *po aty*, f. 120). Ndër gjuhët e tjera ballkanike, rumanishtja, e cila, si të thuash, është shumë e ndikuar nga gjuhët perëndimore, në mënyrë të veçantë nga frëngjishtja, paraqet gjurmë të një përdorimi analog përpara një mbiemri pronor ose një emri në gjinore: *fătul meo* “djali im”, *kopiii mei* “fëmijët e mi”, *omul lui Dumnezeu* “njeri i Perëndisë” (Candrea-Hecht, *Grammaire roumaine*, f. 50) – Po kështu, veç këtyre do të vëmë re që në shumës forma e thirrores përkon me formën e rasës së zhdrejtë të *nyjzuar* të emrave. – Pak rëndësi ka këtu që bëhet fjalë, sipas shprehjes së z. Puşçariu, për një rast të metanalizës (Sandfeld, *Linguistique balcanique*, f. 148), për një fjali si: *vă spun vouă domnilor* “Jua them juve zotërinjve”, e cila më poshtë analizohet: *vă spun vouă, domnilor* “Jua them juve, zotërinj”, sepse vetë mënyra se si është ndërtuar kjo fjali tregon se ajo është në përputhje me natyrën dhe frymën e gjuhës. – Së fundi, greqishtja bizantine ka njohur (madje edhe greqishtja moderne njëj ende raste sidomos në shprehjet e ngurosura) ndërtime të tilla si: Δόξα ο Θεός σοι ο Θεός “lavdi ty, o Zot”, tek e cila o Θεός emërore e shquar, ka vlerën e një thirroreje, ashtu si në greqishten biblike Κύριε ο Θεός μου “Zot, o Perëndia ime”.

2. Kur një emër shoqërohet nga një mbiemër pronor, ky emër merr trajtën e shquar dhe ndiqet nga mbiemri pronor (i cili përmban për të gjitha vetat nyjën e quajtur “lidhëse” shembuj: *ma, ta notre, votre maison, sa maison (à lui), sa maison (à elle)*, të cilët do të mund të përktheheshin në shqipe me: *shtëpia (e) ime, e jote, e jonë, e juaj, e tij, e saj*, por në kallëzore, ndërsa për vetën e tretë ndeshim formën e nyjës lidhëse të pritur pas emrit të shquar, pra të *e-së*: *shtëpin e tij, shtëpin e saj* (si *shtëpin e madhe* “la grande maison”, çka nuk është e njëjta gjë për dy vetat e para, ku nyja lidhëse merr formën që haset pas një emri të pashquar: *shtëpin t’ime, shtëpin t’ënde, shtëpin t’onë, shtëpin t’uaj* (si tek një shtëpi të madhe “une grande maison”). Në shumës vihet re e njëjta kundërvënie, por më pak e zgjeruar, trajta “e pashquar” e nyjës lidhëse që nuk takohet përveç se në rastet kur pronari është në numrin shumës: *shtëpit*

*t'ona* “nos maisons”, shtëpit *t'uaja* “vos maisons”, i kundërvihet kështu jo vetëm shtëpit *e tyne* “leurs maisons”, por edhe shtëpitë *e mija* “mes maisons”, shtëpit *e tu(j)a* “tes maisons”, shtëpit *e tij* “ses maisons” (à lui), shtëpit *e saj* “ses maisons (à elle). – Në fakt, gjithçka zhvillohet sikur ndarja e *e-së* dhe e *të-së* të bëhej sipas parimit të mëposhtëm: *e* përpara një mbiemri pronor që nis me bashkëtingëllore, *të* përpara një mbiemri pronor që nis me zanore. – Sido që të jetë puna, dallimi midis i shquar nga i pashquar nuk ka këtu asnjë bazë logjike (ndryshe nga ç'ndodh në grupin emër + mbiemër cilësor që përmban një një lidhëse) dhe duket sikur mbështetet në një dallim thjesht formal. – Le të shtojmë gjithashtu se nëse shembujt i zgjodhëm të tillë që të kenë një emër në femërore, i njëjti dallim është edhe për mashkulloren. Për sa u përket rasave të zhdrejta, atë çka thamë lidhur me zhdukjen e trajtës së shquar në gjinore – dhanore, ajo gjen zbatim edhe këtu.

3. Për sa u përket parafjalëve që kërkojnë kallëzoren, teorikisht ka një kundërvënie midis trajtës së pashquar dhe asaj të shquar; parafjala duke u ndjekur nga trajta e pashquar kur emri është i veçuar, dhe nga trajta e shquar kur ai ndiqet nga një mbiemër pronor ose cilësor apo nga një emër në gjinore: *në shtëpi* “dans la maison” i kundërvihet formës *në shtëpinë e tij* “dans sa maison (à lui)” (shih çka u tha në paragrafin e mësipërm), *në shtëpin e madhe* “dans la grande maison”, *në shtëpinë e mikut* “dans la maison de l'ami”. – Ç'është e vërteta, janë formuar një numër i madh shprehjesh të ngurosura me trajtë të pashquar që qëndrojnë (nën ndikimin e lokucioneve të tipit *për shkak të (shiut)* “à cause (de la pluie), *me anë (të postës)*, “au moyen (de la poste), *nëpër mjet të* “au moyen de”, etj.) ndërkohë që vetë shprehja nuk është më e veçuar: veçanërisht është rasti kur këto shprehje ndiqen nga një emër në gjinore, për shembull: *në mes* (në gegërishte gjithashtu *për mjedis*) “au milieu”, *në rranxë* “au pied”, *përmbi sipërfaqe* “au-dessus de la surface”, *në shtëpi* “à la maison”, *në dritë* “à la lumière”, *në krye* “au bout”, etj., të cilave mund t'u shtohen: *në mes (për mjedis) të qytetit* “au milieu de la ville”, *në rranxë të malit* “au pied de la montagne”, *përmbi sipërfaqe të detit* “au dessus de la surface (du niveau) de la mer”, *në shtëpi të mikut* “dans la maison de l'ami”, *në dritë të hënës* “à la lumière de la lune, au clair de la lune”, *në krye të pesë vjetëve* “au bout de cinq ans”, trajta e shquar normale gjendet e ruajtur në grupin emër + mbiemër (cilësor ose pronor). – Për ta përmbledhur, në të dy dialektet vëmë re një luhatje të madhe; në të njëjtin tekst (te *Miku* i Koliqit), ne gjejmë dy rreshta larg njëri-tjetrit: *n'odën e miqvet* (trajtë e shquar) dhe *n'odë të*



*miqvet* (trajtë e pashquar) “dans le salon” ose fjalë për fjalë “dans la pièce des hôtes”.

Rumanishtja, e cila njih një përdorim analog, ia ka dalë më mirë të ngulisë përdorimet dhe kundërvë *pe masă* (e pashquar) “mbi tryezë” me *pe masa* (e shquar) *rotundă* (mbi tryezën rrumbullake”, *pe masa mia* “mbi tryezën time”, *pe masa vecinului* “mbi tryezën e komshiut”.

Nga ana tjetër, në sllavishten e vjetër, në togfjalëshat që përmbajnë një emër + një mbiemër, dhe pas disa mbiemrave të emëruar, trajta e pashquar ishte ngulitur në disa shprehje (Vaillant, *po aty*, f. 166).

4. Në gjinoren shumë të emrat e përveçëm që varen nga një emër i parë, ndeshim në të shumtën e rasteve trajtën e pashquar. “*Shtegu i Barijve*” “Le Chemin des Bergers”(emërtim vendi), *të ngushtat e Dardaneleve* “les détroits des Dardanelles”, *shtetet e Ballkanëve* “les États des Balkans”, *mbreti i Shqiptarve* “le roi des Albanais”, *kështjelli i Dukagjinve* “le château des Dukagjin”. Ky ndërtim shtrihet në gegërishte për disa mbiemra të emëruar: *gjuha e të parve* “la langue des ancêtres” (*gjuha e të parvet* do të shprehej më saktë në frëngjishte “la langue des premiers, des notables”), *përpara të mëdhejve* “devant les grands” etj.
5. Ne do të shënojmë që emrat, të cilët tregojnë individualitete qartësisht të karakterizuara, si emra qytetesh, vendesh, njerëzish, dhe, në një shkallë më të ulët, emrat e muajve, kanë pothuajse gjithnjë lakim të shquar. Megjithatë, në thirrore dhe në rrjedhore, pas disa parafjalëve, në titujt, në shprehje të ngurosura, gjejmë edhe trajta të pashquara: për shembull: *o Tiranë* “ô Tirana”, *në Korçë* “à Korça”, *Korçë e Shkodër* (titulli i një artikulli të Anton Harapit). Po kështu, le të shënojmë kalimthi disa emra lulesh, frutash, apo kandrash të nxjerra nga emra shenjtësh: *lule shën Mitri* “amarante” (fjalë për fjalë “fleur de saint Démètre”, *lule shën Gjergji*, emër tjetër lulesh (fjalë për fjalë “fleur de saint Georges”), *lule shën Gjini* “lamier pourpre” (fjalë për fjalë “fleur de saint Jean”), le të shtojmë gjithashtu për kërshtëri: *kumbulla shinjine* (edhe shinjinje) “lloj kumbulle” (fjalë për fjalë “prune de saint Jean”), ku Shinjin (variant dialektor i Shën Jinit, shën Gjinit), nuk ka qenë kuptuar më si shenjues “shën Gjini”, por është shformuar dhe është kthyer në një mbiemër të thjeshtë pa vlerë tjetër të qartë, përveç se asaj për të emërtuar një varietet kumbulle. Duket se të gjitha këto format me -i, nëse do t’u përmbaheshim rregullave të gramatikës tradicionale, duhej të ishin në rrjedhore; megjithatë, është më e hijshme për nga kuptimi që atje të ketë gjinore të

pashquara pa një lidhëse; disa shprehje të tjera që përmbajnë gjinoren e shquar, e shfaqin një lidhëse, si: *bukë e shën Vasilit* “pain (galette) de saint Basile”, *pulë e shën Maris* “coccinelle” (fjalë për fjalë poule de sainte Marie). Trajta e pashquar ndeshet gjithashtu në raste shumë të rralla, kur emri i përveçëm paraprihet nga një mbiemër në trajtën e shquar: *I shkreti Lekë* (emër i pashquar) “le pauvre Alexandre” (çka i kundërvihet për shembull: *Leka* (trajta e shquar) *është një burrë i mirë* “Alexandre est un homme bon.”)

6. Ka gjithashtu një kundërvënie të pastër cilësore midis shquarsisë dhe pashquarsisë, ku shquarsia shënon thjesht një intensitet më të madh sesa trajta e pashquar. Këtu bëhet fjalë për shprehje të ngurosura të trajtës së pashquar (siç janë në frëngjishte shprehje të tipit: *faire eau* (fut ujë anija), *perdre pied* (çorientohem, e humbas), *tenir tête* (i qëndroj, i rezistoj, i bëj ballë), etj., të cilat (ndryshe nga frëngjishtja) për arsye shprehësie mund të rifitojnë trajtën e shquar të pritur logjiksht. Kështu, këtë e hasim në të njëjtin tekst në gegërishte (Koliqi, *Miku*): *nuk guxojshin me çelë gojë* (e pashquar) “ils n’osaient pas ouvrir la bouche), por pak rreshta më tej, në një monolog, i interesuari flet me një ton të indinjuar: *kam të drejtë me çel gojën* (e shquar) “j’ai bien le droit d’ouvrir la bouche”. Vlen të themi se në fjalinë e fundit shqiptari thotë: *kam të drejtë* (e pashquar), fjalë për fjalë “j’ai droit”. Po kështu, në një tekst në toskërishte (te *Lulja e Kujtimit* e Foqion Postolit) kemi gjetur krahas shumë trajtave thirrore të pashquara fjalinë e mëposhtme: *o sa e bukura që është, sa ëmbël kundërmon* “comme elle est belle, comme elle a une douce odeur”, ku trajta e shquar i jep më shumë fuqi shprehëse fjalisë që ka *që*, e cila ka gjithashtu një vlerë të pastër shprehëse.
7. Këto raste do t’i lidhim me domosdoshmërinë e një shquarsie të dyfishtë, kur bëhet fjalë për një emër, për të cilin është folur më parë: ndërkohë që nga këndvështrimi thjesht formal, për shembull *dardhë* “des poires” i kundërvihet fjalës *dardhët* “les poires”, nga pikëpamja sintaksore *kam dardhë* “j’ai des poires” nuk i kundërvihet *kam dardhët* “j’ai les poires”, por, ashtu si në këtë shembullin e fundit, bëhet fjalë për *dardhë* të mirëpërcaktuara, *i kam dardhët* (fjalë për fjalë “je les ai, les poires”, ku *i*-ja është përemër vetor i vetës së tretë, i rasës kallëzore, shumë, trajtë e theksuar). – Por, kjo trajtë “e mbishquar” mund t’i kundërvihet, si në shembullin e mësipërm, një trajtë të pashquar, por mund gjithashtu t’i kundërvihet një trajtë të shquar të thjeshtë, kështu, mund të marrim shembuj nga S.E. Mann-i nga libri i tij “Short

Albanian Grammar” (“Gramatikë e shkurtër e shqipes”, f. 80: *mbreti formon kabinetin e ri* “le roi forme le nouveau cabinet” (njoftim i thjeshtë i faktit) duke e krahasuar me: *mbreti e formon kabinetin e ri*: le roi forme le nouveau cabinet (për të cilin bëhej fjalë). Kështu, në shqipe kemi alternativën e mëposhtme duke e krahasuar me trajtën “e mbishquar” (sur-déterminée)

Trajtë e pashquar	}	mbishquar
Trajtë e shquar e thjeshtë		

Prej tyre del një çekuilibër, i cili na sjell një farë konfuzioni në nocionin e shquarsisë dhe të pashquarsisë.

8. Ka, ç’është e vërteta, një kundërvënie thjesht formale në rastin kur dy mbiemra ndjekin një emër të shquar në kallëzore: *nyja lidhëse*, e cila i paraprin elementit të parë të grupit, është në trajtën e shquar, ndërsa i dyti paraprihet nga *nyja lidhëse* në trajtën e pashquar, për shembull: *shoh murin e madh të bardhë* “je vois le grand mur blanc”. Kur në vend të mbiemrit të dytë togfjalëshi ka një emër në gjinore, *nyja lidhëse* që i paraprin merr gjithashtu trajtën e pashquar: *në rrugën e re t’Elbasanit* “dans la nouvelle rue d’Elbasan”. – Kështu, sipas vendit që fjala zë në togfjalësh, edhe pse përmbush të njëjtin funksion, ajo mund të marrë dy trajta të ndryshme.

Këtë kundërvënie mund ta hasim në rumanishte kur emri është në gjinore, *le couteau du voisin* (“thika e fqinjit”), për shembull, thuhet *cuçitul vecinului*, por *le grand couteau du voisin* (“thika e madhe e fqinjit”), duhet të përkthehet domosdoshmërisht me: *cuçitul mare al vecinului*, me një nyjë të veçantë, të cilën mund ta krahasojmë me nyjën lidhëse të shqipes.

9. Disa emra të përveçëm mashkullorë me kumbim të huaj dhe që mbarojmë me *-i*, (çka mund të interpretohet si formë e nyjës shquese) kanë vetëm lakim të shquar, edhe kur paraprihen nga një nyjë, e cila, vetë është normalisht e shquar, si: *Kristoforidhi*, emri i albanologut të parë shqiptar. Në një artikull për këtë shkrimtar gjejmë: *ky shkrim i të ndritëshmit Kristoforidhit...* “cet écrit de l’illustre K...” – Kjo formë: *Kristoforidhit* është dyfish befasuese nga pikëpamja e gramatikës tradicionale, meqë prisnim: së pari, një trajtë jo të shquar; së dyti, një emërore, meqë në rastin e togfjalëshit mbiemër i shquar + emër, emri nuk lakohet dhe merr, kur është rasti, shënuesin e shumësit.

Të tilla janë faktet të cilat shënojnë luhatje në ndjenjën e kundërvënies së prerë midis kategorisë së trajtës së shquar dhe asaj të pashquar. Nga sa më sipër, veçojmë këto vërejtje:

1. Këto fakte nuk kanë asgjë të ndarë prerazi dhe tregojnë thjesht mundësi shprehjeje; një studim i thelluar do të mund të nxirrte në pah, me anë statistikash dhe sondazhesh të hollësishme, frekuencën më të madhe apo më të vogël të kësaj apo asaj trajte.

2. Sido që të jetë, megjithëse këto luhatje janë të pranishme në të dyja dialektet, ato janë sigurisht më të shpeshta në pjesën e gegërishtes, ku gjuha është ende larg së pasuri njësimin relativ sesa në toskërishte dhe ku tre grupet e mëdha të dialekteve (Elbasani, Tirana, Shkodra) mbulojnë një numër të madh folësish, të cilët kanë individualitetin e tyre shumë të theksuar. – Duke bërë një krahasim në vija të trasha me një situatë analoge të sllovenishtes, mund të thuhet se gegërishtja nuk e ka pasur fatin të ketë shkrimtarë, autoriteti i të cilëve t'i lejonte këtij apo atij dialekti të konstituohej në një gjuhë letrare të pranuar nga të gjithë.

Këto konstatime na mundësojnë të pranojmë që shqipja dallon shumë lloje kundërvëniesh e shquar ~ e pashquar, jashtë kundërvënies logjike.

Le t'i përmbledhim shkurt:

I. Një kundërvënie thjesht formale:

- a) Rasti i mbiemrit pronor, ku forma e nyjës lidhëse është *e* (teorikisht: e shquar) përpara bashkëtingëllores dhe *të* (teorikisht: e pashquar) përpara zanores;
- b) Sipas vendit të fjalës në fjali, pavarësisht nga funksioni real: *shoh murin e math të bardhë*.

II. Një kundërvënie, edhe kjo formale, midis emrit të veçuar dhe grupit të përbërë:

- a) Me thirroren;
- b) Pas parafjalëve që kërkojnë kallëzoren.

III. Një kundërvënie jokohërente midis njëjësit dhe shumësit:

- a) Për emrat e përveçëm në gjinore shumë: *Shtetet e Ballkanëve* (e pashquar) “les États des Balkans” çka i kundërvihet, për shembull: *shkretëtira e Saharasë* (e shquar) “le désert du Sahara”;
- b) Si rrjedhim i ngatërimit në toskërishte të gjinore-dhanores shumë, trajta e shquar dhe e gjinore-dhanores shumë, trajta e pashquar.

IV. Një kundërvënie jokohërente në lakimin e emrave të njerëzve, qyteteve, etj.

a) Për shkak të ndarjes jologjike të trajtave të shquara dhe të pashquara;

b) Rasti i disa emrave me kumbim të huaj.

V. Një kundërvënie intensiteti: trajta e shquar shfaqet më shprehëse sesa trajta e pashquar.

VI. Një kundërvënie me “mbishquarsi” (gati plotësuese në dy rastet e para):

a) Pas dëftorit;

b) Pas “një”;

c) *Kam dardhë dhe i kam dardhët*, nga njëra anë, *mbreti formon kabinetin e ri dhe mbreti e formon kabinetin e ri*, nga ana tjetër.

Për ta përmbledhur, në qoftë se kundërvënira e qartë që ekziston teorikisht në shqipe midis të shquarës dhe të pashquarës ka prirje të bjerë në hije në disa raste, kjo ndodh për shkak se kundërvendosja logjike konkurrohet nga tipa të tjerë që dalin nga plane të ndryshme. Shqipja na jep në këtë kuptim shembuj interesantë, meqë duke mos u detyruar nga një gjuhë letrare e ngulitur, autorët toskë dhe sidomos gegë, na japin në shkrimet e tyre një imazh besnik transformimesh të cilat janë në zhvillim e sipër në gjuhën e folur dhe që padyshim nuk do të mund të zhvilloheshin, nëse këto prirje të ndryshme do të pengoheshin nga prestigji i një gjuhe të njësuar të organizuar fuqishëm.

Përktheu nga frëngjishtja: **Viktor BAKILLARI**

Titulli i origjinalit: *Formes nominales déterminées et indéterminées en Albanais*, botuar në “Bulletin de la Société de Linguistique de Paris”, Tome Quarante-Sixième (1950), Fascicule 1, Numéro 132, f. 69–81.

Shpëtim ÇUÇKA

## STEFAN PRIFTI DHE PËRKTHIMI I VEPRËS SË BARLETIT “MBI JETËN DHE VEPRAT E SKËNDERBEUT”

Libri i Marin Barletit “Mbi jetën dhe veprat e Skënderbeut”, i përkthyer shqip nga Stefan Prifti, i paraqitet mendjes sonë si krijesë kulturore disaplanëshe, e cila me hijeshinë e saj të gjithanshme në kushtet e sotme të triumfit të banalitetit, na tërheq t’i marrim e t’i parashtrojmë këto rrafshe një e nga një.

E para, përmes vlerave të këtij libri lexuesi njihet me thelbin e lëvizjes kulturore të njohur me emrin “humanizëm”. Për Shqipërinë e sotme vetë domethënia e këtij termi është praktikisht e huaj, e pakuptueshme, pse jo, edhe e papranueshme. Kultura e sotme, më saktë kundërkultura, dallohet për shëmtimin, egërsinë dhe çnjerëzimin në të gjitha fushat duke filluar nga sistemi ekonomik-politik e deri te letërsia dhe artet. Ndërkaq vepra e Barletit në përkthim të Stefan Priftit na shpaloset si një himn për të drejtën dhe të mirën në tërësi, të drejtën dhe të mirën e luftës së shqiptarëve nën udhëheqjen e Skënderbeut përballë valëve të së padrejtës dhe të së keqes të hordhive osmane. Në çdo rresht të këtij libri, në të gjitha bëmat dhe fjalimet e Skënderbeut, vërshon madhështore dhe e fuqishme dashuria për jetën, për të drejtën, për njerëzit. Se fundja ç’është jeta dhe e drejta të marra shkëputur nga masa e madhe e njerëzve që njihet me emrin “popull”? Në përgjigje të këtij mesazhi të madh të veprës së Barletit shqipja e Stefan Priftit është një dëshmi e padiskutueshme e fuqisë shprehëse të gjuhës sonë, të përpunuar dhe të kultivuar pikërisht sipas parimit të humanizmit, të njerëzidashjes,

---

Shpëtim Çuçka, studiues.

të mirësisë dhe bukurisë morale, shkurt, në shërbim të përparimit të vërtetë shoqëror.

E dyta, përkthimi shqip i veprës së Barletit për Skënderbeun i kryer nga Stefan Prifti është një sprovë e shkëlqyer e mjeshtërisë përkthimore, e mjeshtërisë së të sjellit në shqip të një origjinali në gjuhë të huaj. Duke lexuar shqipen e Stefan Priftit lexuesi arrin pa vështirësi të dallojë se deri në ç'shkallë është ngritur gjuha shqipe, në përpjekjen e vetëdijshme dhe profesionale të përkthyesit, për të përballuar latinishten e humanistit Marin Barleti, një latinishte, e cila mëtonte të arrinte po atë lartësi që kishte pasur latinishtja e shek. I p.e.r. në Romë. Periudhat latine – jo të gjata e të mërzitshme, por të gjera dhe të madhërishtme – shpalosen edhe në shqipe me po atë gjerësi e madhështi, me po atë vijimësi e logjikë të hekurt gjuhësore, pra, kuptimore. I gjithë përkthimi është një himn ndaj pjesës themelore të gjuhës sonë, sintaksës, domethënë artit për të lidhur fjalët e për të shprehur mendimin. Rrjedhimisht, ai është dëshmi e prekshme e fuqisë së gjuhës sonë, e zotësive përkthimore e gjuhësore të mjeshtrit të madh të shqipes Stefan Prifti.

Sa qesharake mund të tingëllojë në këtë rast ajo shprehja e paditur, e përsëritur nga njerëz gjithë po aq të paditur: “si një frazë e thatë latine”! Ç’mjerim i shitur si kulturë nga ndonjë shqiptar i letrave si letra dhe jo i letërsisë si kulturë! Stefan Prifti me përkthimin e tij të veprës së Marin Barletit ka dëshmuar se sa i madh, sa i patundur ishte besimi i tij te një shqipe letrare e udhëhequr nga parime shkencore – pra, e ngritur përmbi ngastrat e lokalizmave dhe dialektalizmave – se sa lart mund të ngrihej si mjet kulture në dorën e një mjeshtri dhe qytetari gjuha jonë. Ky përkthim nga latinishtja më sjell ndërmend përkthimin e dymbëdhjetë këngëve të “Odisesë” nga Spiro Çomora, të bërë duke ruajtur metrikisht vargun e origjinalit. Modele të vërteta të shqipes kulturore, modele me të vërtetë monumentale, që e bëjnë këdo që është qytetar shqiptar, të ndihet krenar për gjuhën e vet!

E treta, përkthimi në shqip i veprës së Barletit, i kryer nga Stefan Prifti, përbën një gjedhe estetikisht të rrallë të shqipes së shkruar në tërësi. Leximi i këtij përkthimi ngjall një kënaqësi estetike të pastër, ashtu si çdo krijim i lartë i shpirtit njerëzor. Shqipja e Stefan Priftit në këtë libër është një gur i madh, i latuar mjeshtërisht e me shije të hollë dhe i sjellë me ndërgegje dhe thjeshtësi qytetare në sheshin e punës së madhe e madhështore për krijimin e gjuhës së njësuar letrare shqipe. Sikur edhe vetëm kjo bukuri kumbimi e shqipes, kjo kënaqësi estetike e saj të ishin meritat e këtij përkthimi, do të mjaftonin për ta nderuar përgjithmonë këtë sprovë e për ta bërë pjesë të të gjitha antologjive të letërsisë shqipe për shkollat. Sa shkrimtarë, sa dijetarë ndër ne mund të krenohen se shkruajnë një shqipe kaq të zgjedhur, kaq të mirërenditur,

kaq të lëmuar, kaq të thellë, kaq të bukur, një shqipe, e cila vërteton dhe, pra, meriton vargjet e famshme të Naimit për gjuhën tonë?

Kjo gjë, ky fakt letrar, do të meritonte të qëmtohej me kujdesin dhe nderimin më të madh për të pasuruar kartotekën e shqipes në kuptimin më të gjerë të fjalës "kartotekë": jo vetëm fjalë, jo vetëm togfjalësja, por edhe fjali e periudha të tëra, të cilat mund të shërbejnë si shembuj, si modele se si duhet shkruar shqip.

Gjuhëtarët tanë flasin shpesh për pasurinë gjuhësore të dialekteve. Për mendimin tim, gjuhëtarët me shikimin tek e ardhmja do të duhej të qëmtonin dhe mblidhnin thesare sidomos nga ato dokumente dhe përmendore të larta të shqipes së kulturës, sikurse është edhe përkthimi i veprës së Barletit nga Stefan Prifti, pasi vetëm një shqipe e tillë është garanci e përparimit të kulturës së vendit, e qytetërimit tonë të mëtejshëm.

Si përfundim, do të thosha se përmes përkthimit që Stefan Prifti i ka bërë këtu e pesëdhjetë vjet të shkuara veprës së Marin Barletit për të madhin Skënderbe, kemi në kulturën tonë kombëtare edhe fuqinë e humanizmit kundër çnjerëzimit që na rrethon nga të katër anët e përditë, edhe fuqinë e mjeshtërisë përkthimore të mbështetur te logjika e hekurt e mendimit dhe e sintaksës, edhe fuqinë dhe bukurinë madhështore, në të vërtetë shembullore, të shqipes së shkruar, që është themeli i kulturës së vendit.

Sa nevojë kemi sot për të tilla punë, për të tilla vepra! Sa e thekshme, sa e dhembshme është rrallësia e tyre sot!



**Doriana TUXHARI**

## **VËZHGIME PËR TERMINOLOGJINË E VESHMBATHJEVE DHE TË KOZMETIKËS NË GJUHËN SHQIPE TË SOTME**

Terminologjia e veshmbathjeve dhe e kozmetikës përfshin emërtimet e veshjeve, produkteve kozmetike dhe pjesëve të tyre të përdorura gjerësisht nga bashkësia gjuhësore, si dhe termat specialë që emërtojnë mjete, materiale e procese të prodhimit dhe të tregtimit të tyre të përdorura nga profesionistët. E pasuruar në mënyrë të pandërprerë nga leksiku i përgjithshëm dhe ai profesional, ajo shtrihet në shekuj, duke pasqyruar ndryshimet ekonomike-shoqërore e kulturore të një vendi dhe lidhjet e tij me vendet e tjera.

Në gjuhën shqipe fusha e veshmbathjeve dhe e kozmetikës ka pësuar ndryshime të mëdha sidomos në kohët e reja, pra pas shkëputjes nga Perandoria Osmane (viti 1912) e deri sot. Rruga kryesore e pasurimit të terminologjisë së kësaj fushe ka qenë hyrja e fjalëve nga gjuhë të huaja, me të cilat shqipja ka qenë në kontakt, sipas parimit “me hyrjen e sendit, hyn edhe fjala”. Paraqesin interes termat që janë ende pjesë e shtresës aktive të leksikut, të cilat mund t’i klasifikojmë në:

1. huazime të përshtatura me drejtshkrimin dhe gramatikën e shqipes;
2. fjalë të huaja që shkruhen sipas origjinalit dhe herë lakohen e herë jo;
3. fjalë të njohura që kanë zgjeruar kuptimin.

- 1. Huazimet e përshtatura me drejtshkrimin dhe gramatikën e shqipes** janë bërë pjesë e fondit leksikor të gjuhës shqipe, por jo të gjitha fjalët që janë në aktive në gjuhën e folur dhe në media janë përfshirë në FGjSh. Duke lënë mënjane fjalët me burim nga latinishtja, si *ar*, *argjend*, *gunë* (*zhgun*), *pe*, *teshë* etj., që janë huazime të stërlashta, italianizmat e vjetër, që kanë hyrë para shekullit XX, si: *fjongo* (nëpërmjet greqishtes), *flori*,

---

Doriana Tuxhari, studiuese.

*fu(r)qetë* (ndoshta nëpërmjet greqishtes), *fanellë, kuletë, napë* dhe *vel*<sup>1</sup>, si dhe orientalizmat që kanë hyrë para shekullit XX, si: *astar, basmë, benevrekë, beze, bojë, cohë, çantë, furçë, fustan, ilik, jelek, këna, paftë (pafkë), pambuk, poture, saftjan, serm, sofrabez, tafta* etj., në shtresën aktive të leksikut të veshmbathjeve dhe të kozmetikës gjejmë mjaft huazime të reja, që kanë hyrë gjatë shekullit XX e deri sot, sidomos gjatë periudhave të ndryshimeve të mëdha politike dhe shoqërore. Kështu bien në sy:

a) huazime nga italishtja (italianizma), të cilat mund t'i klasifikojmë sipas periudhave të ndryshme kohore gjatë të cilave kanë hyrë në gjuhën shqipe nga fillimi i shek. XX:

- italianizma të periudhës ndërmjet dy luftërave botërore (1914–1945), të cilat kanë hyrë në shqipe sidomos pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia (1939), si: *beretë, bobinë, borsalinë, brilantinë, damask, disenjator, filigran, gabardinë, gardërobë, gardërobist, gete (geta), kaki, kamosh, kanotierë, kapotë, kapuç, kasketë, kaskë, kombinoj, koral, kostum, kravatë, krem, livandë, llak, mantel, medaljon, model, modelist, modeloj, modern, modernizëm, modernizoj, modë, modist, motiv, onde, palaçeta/paliçeta, pantofël, pantallona, papuçe, parukë, parukier, portofol, pupë, sallon, sandale, seta, sintetike, stampë, stampoj, stof, terital, tirandë, tuta, uniformë, vazelinë, xhaketë, xhelatinë* etj.

Për shkak të afërsisë gjeografike, gjuha shqipe është ndikuar nga italishtja pothuaj në mënyrë të pandërprerë. Marrëdhëniet e shqipes me italishten nuk janë ndërprerë plotësisht as gjatë regjimit komunist në vitet 1945–1990, kur Shqipëria u vetizolua. Studiuesi Genc Lafa<sup>2</sup> klasifikon disa italianizma që kanë hyrë në fondin e gjuhës shqipe në dy periudha të ndryshme kohore: **nga viti 1914 deri më 1939**: *bluzë, borsalinë, dopiopet, gabardinë, gallon, kallcë, kapotë, kapuç, kasketë, kostum, kravatë, mantel, pantofël, peliçe, sandale, spaletë, stof, tirandë, xhaketë*; dhe **nga viti 1945 deri më 1990**: *bigudinë, deodorant, geta, kamosh, kanotiere, , paliçeta, papuçe, rexhipet, xhakavento*.

Disa italianizma, si *deodorant*<sup>3</sup> dhe *detergjent*, që qenë huazuar para viteve '90, por përdorëshin më tepër në gjuhën e folur (nuk shënohen në FGjSSH 1980, por në Fjalorin italisht-shqip të Leka-

<sup>1</sup> Fjalët *fanellë, kuletë, napë* dhe *vel* i gjejmë tek autorët e vjetër.

<sup>2</sup> Lafa, Genc, “Der italienische Einfluß auf das Albanische. Erster Teil - Allgemeine Erörterungen” / “Ndikimi i italishtes mbi shqipen. Pjesa e parë – Shqyrtime të përgjithshme”, *Ponto-Baltica* 8–9/1988–1999, 47–172.

<sup>3</sup> Edhe pse nuk gjendet në FGjSSH 1980, termi *deodorant* është huazuar para viteve '90. Ajo gjendet në “Fjalorin italisht-shqip”, Leka-Simoni, 1986, f. 323.

Simonit, 1986), janë rimarrë në vitet '90 dhe janë pasqyruar edhe në FGjSh 2006. Fillimisht me kuptimin *për të larë rrobat*, termi *detergjent* është huazuar edhe në fushën e kozmetikës, me kuptimin e pastruesve të fytyrës, trupit etj. Krahas termit *detergjent*, përdoret në gjuhën e folur termi *locion* (*locion për fytyrën, flokët, trupin*) prej gjuhëve latine (ital. *lozione*, fr. *lotion*), të cilat janë të dyja të zëvendësueshme me fjalën *lëng larës*. Fjala *detergjent* mund të zëvendësohet nga fjalët *pluhur larës* (shih FGjSh, f. 59). Termi i përgjithshëm *pastrues* është i përshtatshëm kur nuk është nevoja të specifikohet lloji i lëndës: *pastrues fytyre, pastrues lëkure* etj. Ka raste që me kuptimin *pluhur* apo *lëng larës* përdoret edhe termi *produkt* < it. *prodotto*. Ky term i huazuar më herët me kuptime të tjera (në FGjSh dhe FGjSSH) është huazuar edhe në fushën e kozmetikës. Duke pasur një kuptim të gjerë, ai ka shpeshtësi të madhe përdorimi. Kuptimi i tij specializohet në varësi të kontekstit (përdoret zakonisht në togfjalësha: *produkt kozmetik, produkt për flokët, produkt për lëkurën* etj.).

- italianizma të reja, që kanë hyrë në shqipe nga viti '90 deri sot, si: *acid hialuronik, akuamarin, blefaroplastikë* (ndërhyrje kirurgjikale për hapjen e qeskave të syve), *dekoloroj, depiluj, deskuamoj, difuzor, dizenjoj, eksfoliant* (sinonim i anglicizmit *skrab*), *fin, fondatintë, inestetizëm, integrator, kremoze, lavatestë, locion tonik, marsupio, melazmë, mishelar, mokasina, najlon, parfumeri, pasarelë, pjastër, plazmë, sfilatë<sup>4</sup>, silikon, solar, spilë, sprucoj, stilist, strishë* (*depilimi*), *teksturë, ton* (*i syve*), *tonifikoj, tonik* etj.
- b) huazime nga frëngjishtja (francezizma), të cilat kanë hyrë kryesisht në periudhën midis dy luftërave botërore, si: *azhur, atelie, bezhë, bigudi, bluzë, buduar, bukle, butik* (ndoshta nëpërmjet it.), *dantellë, dekolte, demode, detaj, fildikos* (*fil d'Ecosse*), *frak, frizurë, gardërobë, galanteri, galloshe, garniturë, gri, grim* (përdoren me kuptim sinonimik edhe francezizmat *makijazh* dhe *tualet*, italianizmi *truk* dhe anglicizmi i panevojshëm *make-up*), *grimier, karré* (model flokësh), *kilota, komplet, kordon, korse, manekin, manikyr, manto, masazh, makijazh, metrazh, pallto, pandatif, pardesy, papijon, parfum, pedikyr<sup>5</sup>, pelerinë, penjuar, puplin, pudër, robëdëshambër, ruzh, sutiena, shifon, shik, triko, trikotazh, tualet, tyl, violet, zhapone, zhartier, zhile, zhupon*. Në Shqipëri<sup>6</sup> gjuha dhe kultura franceze

<sup>4</sup> Fjala *sfilatë* ka zëvendësuar fjalën *paradë*, që përdoret kryesisht me kuptim ushtarak. Shprehja *paradë mode* para viteve '90 përdorej kryesisht me kuptim negativ.

<sup>5</sup> Fjala *pedikyr* njihet në fushën e kozmetikës nga viti 1900 në Francë, por në Shqipëri është përhapur më tepër pas viteve '90.

<sup>6</sup> Ndikimi i frëngjishtes u ndie veçanërisht në zonën e Korçës, ku gjatë Luftës së Parë Botërore u vendosën trupa franceze. Në vitet 1917–1939 në qytetin e Korçës funksionoi

gëzonte një prestigj të lartë kryesisht midis dy luftërave botërore, por edhe më pas, deri në shtrirjen e ndikimit të anglishtes.

- c) huazime nga anglishtja (anglicizma), pjesa më e madhe e të cilave ka hyrë në shek. XXI, si: *bluxhins, botoks, dizajn, dizajner*<sup>7</sup>, *fard, fashioniste, golf, jogë, kardio, neon* (që po zëvendëson italianizmin *fosforeshent*), *pirsing, pop art, pulovër, rimel, rok, roller, seksi, skrab, spraj, streçe, supermodel, supermodern, swing, shampo, sharm, shifon, tiarë* (që po zëvendëson huazimin neolatin *diademë*), *ti-shërt, topmodel, trend, trendi, xhel, xhinse, xhuboks* etj.

Vala më e madhe e anglicizmave ka filluar pas vitit '90. Me daljen nga vetizolimi, edhe Shqipëria u përfshi nga dukuria e globalizmit, prandaj shqipja u përfshi nga trysnia e anglishtes, që vijon ende. Deri në vitet '80 në gjuhën shqipe kanë hyrë shumë pak anglicizma, megjithëse që në fillim të shekullit XX Shqiptarët kanë pasur lidhje me botën anglosaksone nëpërmjet emigracionit. Si huazim i vjetër nga fusha e veshmbathjes përmendet fjala *ovrolle* (nga anglishtja e Amerikës *overall*), e përdorur në Korçë<sup>8</sup>. Fjalë si: *dok, akrilik, pizhame*, mund të kenë hyrë në gjuhën shqipe nëpërmjet gjuhëve neolatine.

Ndryshimet politike dhe shoqërore që ndodhën pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri dhe rivendosja e lidhjeve me shtete të tjera, sollën një valë të re huazimesh sidomos nga italishtja dhe anglishtja. Në fund të viteve '90 dhe në vitet 2000 Shqipëria njohu një zhvillim të bizneseve të prodhimit dhe të shërbimit në fushën e veshmbathjeve dhe të kozmetikës, d.m.th. të industrisë së fasoneve dhe të qendrave e klinikave estetike. Paralelisht me to u zhvillua edhe media e specializuar e kësaj fushe, me revistat e modës dhe kozmetikës. Termi *fason* (nga lat. *factiō* “bëj”, në fr. *façon* “pamje e jashtme, dukje, model”), që po përdoret dendur tani me kuptimin “prodhim veshmbathjesh” (*industria fasone*), me sa duket është huazim nga

---

liceu francez, ku i gjithë programi mësimor, përveç gjuhës dhe letërsisë shqipe, zhvillohej në gjuhën frënge. Në këtë lice u formuan një pjesë e madhe e elitës intelektuale dhe e elitës politike që do të drejtonte Shqipërinë pas çlirimit.

<sup>7</sup> Shumë profesionistë bëjnë këtë dallim kuptimi nga fjala *stilist* me origjinë nga gjuhët neolatine: *dizajner* quajnë personin që di të bëjë dhe i bën të gjitha proceset e prodhimit të veshjeve: nga ideimi, skicimi e deri te qepja, ndërsa *stilist* quajnë personin që kombinon veshje të gatshme.

<sup>8</sup> E. Lafe vëren se: “me gjithë lidhjet e ngushta të emigracionit shqiptar me vendlindjen, ka gjetur vetëm një fjalë anglishte në gjuhën e folur (sot vetëm në brezin e vjetër e të mesëm) të qytetit e të krahinës së Korçës: *ovrolle-t* angl. *overall* – vetë kjo fjalë dëshmon se shumica dërrmuese e emigrantëve shqiptarë kanë qenë në fillim punëtorë të thjeshtë”. “Rreth fjalëve me burim nga anglishtja në shqipen e sotme” ..., “Gjuha shqipe” (Prishtinë), 2011, nr. 1, f. 55–72 ose në përmbledhjen “Albanologji. Vëllimi II. Punimet nga aktiviteti shkencor “Java e Albanologjisë” i mbajtur më 25–29 tetor, Instituti Albanologjik. Prishtinë, 2011, f. 291–307.

frëngjishtja. Kjo fjalë në anglishten e mesme ka dhënë termin *fashion*, që ka hyrë së fundmi në shqipe si sinonim modern i huazimit më të vjetër nga gjuhët neolatine *modë*. Me të njëjtin kuptim, po përdoren në ndikimin e anglishtes edhe fjala e huaj *trend* dhe mbiemri *trendi* “i modës, i kohës”, ndoshta edhe me ndikim nga përdorimi më i dendur i kësaj fjale në Kosovë.

Një pjesë e huazimeve të përshtatura me drejtshkrimin dhe gramatikën e gjuhës shqipe kanë formuar çerdhe fjalësh me mjete të shqipes: *depilim, depiluj, i depiluar, depilues; dizenjim, dizenjo, i dizenuar, dizenjues* (formimi me prap. shqipe *-ues* ka zëvendësuar huazimin *dizenjator*); *grim, grimim, grimoj, i grimuar; tonifikim, tonifikoj, i tonifikuar, tonifikues* etj.

Si burim për pasqyrimin e terminologjisë së veshmbathjeve dhe të kozmetikës në fjalorët shpjegues mund të shërbejnë fjalorët dygjuhësh (veçanërisht gjuhë e huaj – shqip). Siç kanë vënë re studiuesit E. Lafe, A. Çepani dhe A. Çerpja, fjalorët dygjuhësh të botuar pas çlirimit përmbajnë huazime që sot kanë shpeshtësi të madhe përdorimi<sup>9</sup>. Për shembull, termat *fiston, flakon* (fr. *flacon*), *fosforeshent, kapeleri, peliçe, peliçeri* etj., që gjenden në fjalorin italisht-shqip të Ferdinand Lekës dhe Zef Simonit të vitit 1986, po kështu *frizurë, penjuar* etj., që gjenden në fjalorin frëngjisht-shqip të Vedat Kokonës, mund të përfshihen në fjalorët e sotëm shpjegues.

Përveç huazimeve, terminologjia e veshmbathjeve dhe e kozmetikës përmban edhe fjalë të fondit vendës dhe vijon të pasurohet me fjalë të reja, të formuara me mjete të shqipes, herë-herë prej temash me burim të huaj, p.sh.: *i beztë, dorashka, doreza, fundore* “ana e këmishës së gruas”, *gëzof, i gëzoftë, i kadifenjtë, i kamoshtë, këpucar, kësuljer, krehër, i meshintë, ndërresë, palapetë, palë, petk, pëlhurë, përparëse (përparje), punëdore, qimush, rrobënatë, treçerekëshe, i tyllë, veshje, veshmbathje, fortesë, kashtor(e)* etj.

Përpykja për pastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja gjatë lëvizjes së Rilindjes Kombëtare, e zhvilluar gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX e deri në shpalljen e Pavarësisë dhe fillimi i një modernizimi të jetës së Shqiptarëve pas shkëputjes nga Perandoria Osmane, ndikoi edhe në terminologjinë e veshmbathjeve dhe të kozmetikës me frenimin e fjalëve të huaja nga turqishtja dhe me ndonjë zëvendësim të tyre, p.sh. orientalizmat *elmaz, kalem, karficë* dhe *sedef* janë zëvendësuar përkatësisht me termat me burim nga gjuhët neolatine *diamant, laps,*

<sup>9</sup> Shih: Lafe, Emil; Çepani, Anila; Çerpja, Adelina, Rreth pasqyrimin të fushave terminologjike në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980), në vëllimin *Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë (Konferencë shkencore)*, Tiranë, 3 dhjetor 2004. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë, 2005, 308–314.

*spilë* dhe *perlë*. Tradita e Rilindjes për përdorimin e fjalëve me burim vendës në vend të fjalëve të huaja të panevojshme u pasqyrua edhe në parimet për hartimin e fjalorëve të shqipes pas çlirimit.<sup>10</sup> Duke ndjekur këtë parim<sup>11</sup>, disa huazime të panevojshme të fushës së veshmbathjeve dhe të kozmetikës, si: *borsë, borsetë, bukle, detaj, deterrent, dizenzo, filaturë, floreal, foriserie, grixho, lisho, onde, permanent, tendencë, tirandë, ton, trekuart, violet, voluminoz* mund të zëvendësohen përkatësisht me fjalë të shqipes ose me huazime më të vjetra e më të njohura: *çantë, çantë e vogël, kaçurrel/krelë, hollësi/imtësi/përimtim, larës, skicë/vizatim/motiv, tjerretore, lulor, jashtë serie, gri / i hirtë/ i përhimë / i përhimët, njëngjyrësh, valë* (flokë me onde, flokë valë-valë, të valëzuar), *floktore, pririje, krahoshe, hijezues, treçerekëshe, vjollcë, vëllimor*.

**2. Fjalët e huaja që shkruhen sipas origjinalit dhe herë lakohen e herë jo** janë një shtresë e paqëndrueshme e leksikut të shqipes, që ka hyrë kryesisht prej anglishtes nga vitet '90 e këtej dhe përdoren kryesisht në median e specializuar për fushën e veshmbathjeve dhe të kozmetikës, si: *acroyoga, animal flow, animal print, anti-age, anticelulit, antioksidant, aromatherapy, art work, babydoll, barbie girl, beauty, bikini, blumarin, body, bomber jacket, bon ton, bordo, boyfriend, candy, carnaby chic*<sup>12</sup>, *casual, (syze) cateye, chic*<sup>13</sup>, *classy, clutch, coachella*<sup>14</sup>, *cocktail dress, cowgirl, college girl, colour block, country, court shoes, crème de la crème, depilator, dress code, easy and chic, eyeliner, fashion blogger, fashion designer, fashion week, fashion icon, fotomodel, french*<sup>15</sup>, *gipsy, glam/glamour/glamorous, gold, gomagge, haute couture, hippy, hydrobike, in, infrared, intimo, jacquard, kilt, lifting, limited edition, lip gloss, lipomassage, little black dress, look, make-up, mascara, maxiclutch, meny fashion, mix and match, modeling, must,*

<sup>10</sup> Duke parashtruar parimet e hartimit të një fjalori shpjegues të shqipes, kryeredaktori i FGjSSH Androkli Kostallari është shprehur: “Do të përjashtohen huazimet që tashmë kanë dalë fare nga përdorimi ose huazimet e reja të panevojshme...”, në “Parimet themelore për hartimin e ‘Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe’”, botuar në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II”, Tiranë, 1972, f. 20.

<sup>11</sup> Disa sugjerime të vlefshme për zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë të fondit vendës të shqipes jepen në “Për pastërtinë e gjuhës shqipe”,

<sup>12</sup> Ky term e ka origjinën nga “Charnaby Street”, një rrugë e Londrës, që u bë e famshme në vitet '60 si qendra më e rëndësishme e industrisë së modës.

<sup>13</sup> Kjo fjalë që po përdoret kohët e fundit si në anglishte, ka hyrë në fillim të shek. XX nga frëngjishtja, është përshtatur me drejtshkrimin e shqipes dhe është pasqyruar në fjalorët e shqipes.

<sup>14</sup> Stili Coachella në veshje e ka marrë emrin nga festa e përvitshme që zhvillohet në vendin me të njëjtin emër në Kaliforni, ShBA. Ai përkon me stilin *hippy* të viteve '70, me të cilin vishen të gjithë pjesëmarrësit e festës.

<sup>15</sup> Model thonjsh në manikyr.

*neopren, nude, office style, oversize, pastel, pediluvio* (ital. mbajtja e këmbëve në ujë), *peeling, pilates, pin up, pink, pixie*, (syze) *police, polka dots, pop, primer, print, pumps, punk, retro, sexy, shopping, shorts, skinny, slim-fit, smokey eyes, smoking, spf<sup>16</sup>, suede, superchic, tartan, techno, total black, total white, trendsetter, trendy, t-shirt, ultrachic, unisex, urban-glamour, vintage, vinyl, waterproof, whipped fitness, zumba* etj. Pjesa më e madhe e këtyre fjalëve emërtojnë sende dhe koncepte të reja, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për mbarë botën.

Vitet e fundit është zhvilluar me ritme të shpejta në botë fusha e kozmetikës e bashkë me të edhe terminologjia e saj. Termi *kozmetikë*<sup>17</sup> si “art i të zbukuruarit” është i lidhur me termin *estetikë*<sup>18</sup> – i cili shënon një nga funksionet që kryen kozmetika, pra funksionin e të dukurit mirë, të dukurit bukur, që pasqyrohet në FGjSh si kuptim i dytë: “ana e jashtme artistike, e bukur dhe e rregullt e diçkaje; e bukura”. Përgjithësisht në gjuhën shqipe termi *kozmetikë* ndonjëherë përdoret si sinonim i termit *estetikë*, por në pjesën më të madhe të rasteve bëhet një dallim i qartë mes tyre. Kuptimi i termit *kozmetikë* perceptohet si tërësia e mjeteve dhe e mënyrave të zbukurimit të pamjes së jashtme, ndërsa kuptimit i termit *estetikë* perceptohet si një koncept më i gjerë, që përfshin shumë mjete dhe mënyra zbukurimi, nga ato më të thjeshtat, e deri në ato që e ndryshojnë për një kohë të gjatë ose të përhershme pamjen e njeriut. Një pasqyrim i qartë në fjalor i dallimit të kuptimit të këtyre termave brenda fushës së kozmetikës do të ndihmonte në përcaktimin e terminologjisë themelore të kësaj fushe.

Sot studimi i fushës së kozmetikës kryesisht në Europën perëndimore dhe në ShBA është ngritur në baza të mirëfillta shkencore. Sipas një përkufizimi të përgjithshëm, ndoshta jo përfundimtar në gjuhën shqipe, *kozmetologjia* është shkenca që merret me studimin e mjeteve dhe mënyrave të zbukurimit të njeriut. Bashkë me zhvillimin e objektivave, detyrave dhe metodologjisë së kësaj shkence, po zhvillohet edhe terminologjia e saj. Meqenëse është e lidhur me mjaft shkenca të tjera, si kimia, fizika, mjekësia, kirurgjia plastike etj., terminologjia e kozmetologjisë është pasuruar edhe me terma të këtyre fushave ose i ka përshtatur ato sipas nevojave të veta.

<sup>16</sup> Shkurtim i “Sun Protection Factor”.

<sup>17</sup> Ky term i huazuar nga frëngjishtja në fillim të shekullit XX pasqyrohet në fjalorët e sotëm shpjegues me kuptimin: “përdorimi i mjeteve dhe i mënyrave për të zbukuruar fytyrën ose trupin, duke lyer lëkurën, flokët etj.; mjetet që përdoren për këtë qëllim”, FGjSh, 2006.

<sup>18</sup> Ky italianizëm në fushën e kozmetikës ka hyrë së bashku me termin *estetist* dhe janë përshtatur me drejtshkrimin dhe strukturën gramatikore të shqipes, madje ka zgjeruar çerdhen duke formuar fjalë me prap. Të shqipes *-isht: estetikisht*.

Në gjuhën shqipe terminologjia e kozmetikës po hyn kryesisht nga gjuhët e vendeve nga vijnë risitë, nga anglishtja dhe nga italishtja. Çelja e bizneseve të reja në Shqipëri, si *qendra estetike* dhe *klinika estetike* (gjithashtu termi *kirurgji estetike* përdoret si sinonim i *kirurgjisë kozmetike*), që sollën shërbime për kujdesin e trupit të panjohura më parë në mënyrën e jetesës së Shqiptarëve, sollën një varg fjalësh të huaja nga këto gjuhë.

Bizneset e fushës së veshmbathjeve dhe të kozmetikës u zhvilluan paralelisht me median e specializuar për këtë fushë, sidomos me revistat e modës. Termat e huazuara na japin një pasqyrë të përgjithshme të ndryshimeve që ka pësuar kjo fushë vitet e fundit. Pjesa më e madhe e tyre kanë hyrë drejtpërdrejt nga anglishtja ose nga anglishtja nëpërmjet italishtes.

Disa terma me përdorim më të gjerë që kanë gjegjëse në shqipe përdoren në median e specializuar në gjuhë të huaj ose paralelisht me gjegjësen në shqipe, por në gjuhën e folur përdoren fjalët e gjuhës shqipe, për shembull, *animal print – stampa kafshësh*, *anti-age – kundër rrudhave*, *bikini – rroba banje*, *candy – karamele*, *cat eye – symace*, *classy – me klas*, *dress code – kodi i veshjes*, *fashion icon – ikonë mode*, *fashion week – java e modës*, *fondatintë – krem-pudër*, *lip gloss – shkëlqyes buzësh*, *little black dress – fustani i vogël i zi*, *look – pamje*, *make-up – grim*, *must – i domosdoshëm*, *office style – stil zyrtar*, *oversize – masë e madhe*, *pink – rozë*, *print – stampë*, *spf – filtër mbrojtës*, *shopping – blerje*, *shorts – pantallona të shkurtra*, (*cohë*) *tartan – skoceze/me kuadrate*, *total black – tërësisht e zezë*, *total white – tërësisht e zezë*, *waterproof – rezistent ndaj ujit* etj.

Në kushtet e reja të globalizmit në të cilën gjenden Shqiptarët kudo që banojnë, ruajtja e trashëgimisë leksikore vendëse dhe mënjanimi i fjalës së huaj atje ku është e panevojshme, mbetet detyrë e përhershme e gjuhësisë dhe veçanërisht e leksikografisë shqiptare. Në këtë kuadër, është i domosdoshëm identifikimi i ndërkombëtarizmave, pra i fjalëve-terma të cilat gjenden në anglishte, në gjuhët neolatine, gjermanike dhe sllave. Këto fjalë janë një pjesë e pranueshme në fondin leksikor dhe mund të përfshihen në fjalorët e shqipes.

- 3. Fjalë të njohura që kanë zgjeruar kuptimin, si:** *aksesor, aplikacion, aplikim, avangard, baltë, bordurë, bust/bustier, (bizhuteri) demokratike, detaj, dizenjo, barok, firmë, fortesë, furçë, koleksion, futuriste, gotik, hidratoj, hidratues, kalorësiak, klasike, kontur, korrektor (për flokët dhe për fytyrën), lazer, markë, maskë, neoromantike, penel, perçina, psikedlike, (efekt) riekuilibruet, rokoko, romantike, safari, serum, set (kozmetik), sezon (mode), solucion, sportiv, stampë, stampoj, kalorësiak, mashkullor, minimalist, stil*



*skocez, thekë, ton, transgresiv, (efekt) voluminoz etj.* Pasqyrimi i kuptimeve të fushës së veshmbathjeve dhe të kozmetikës në lemat e këtyre fjalëve gjegjëse në fjalorët e ardhshëm shpjegues mund të bëhet në varësi të tipit të fjalorit e duke ndjekur shembullin e fjalorëve të gjuhëve të tjera. Për shembull, mund të shtohen kuptimet e veshmbathjeve e të kozmetikës (si kuptim i dytë) në lemat *aksesor* dhe *maskë* të fjalësit të FGjSh: “**aksesor,-i** m. sh. **-ë(t)** libr. shtojcë, mb. plotësues. 2. vesh. Një objekt që mbahet zakonisht për të plotësuar veshjen.”; “**maskë,-a** f. sh. **-a(t)** 1. mbulesë prej kartoni, prej rrobe etj., që vihet në fytyrë për të mos u njohur, për t’u mbrojtur etj.: *maskë kundërgazi (skerme, kirurgu); ballo me maska.* 2. një përgatesë kozmetike për lëkurën e fytyrës, që jep një efekt tërheqës kur thahet. 3. fig. diçka që mbulon a që fsheh pamjen reale: *e hoqi maskën doli me fytyrën e vërtetë; ia grisën (ia çorën) maskën.*” etj.

Përfshirja e terminologjisë së veshmbathjeve dhe kozmetikës në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe sipas parimeve të sotme shkencore të hartimit të fjalorëve duhet të përmbushë nevojat e komunikimit të të gjithë Shqiptarëve në të gjithë shtrirjen e trojeve të tyre.

Siç dihet, leksiku i veshmbathjeve dhe i kozmetikës në shqipen e territoreve etnike shqiptare që mbetën jashtë kufijve të shtetit shqiptar paraqet disa veçanti, të ndikuara nga rrethanat e ndryshme historike. Në Kosovë, për shembull, këto veçanti shprehen kryesisht tek huazimet. Pothuaj gjatë gjithë shek. XX Shqiptarët e Kosovës ishin pjesë e ish-Mbretërisë Jugosllave dhe gjuha shqipe nuk përdorej në asnjë veprimtari, përveçse për komunikim familjar. Vetëm pas vitit 1941, kur “gjuha shqipe nisi të shtrihet edhe në sistemin arsimor e në administratë, u ndie shumë i fuqishëm ndikimi i serbokroatishtes”<sup>19</sup>. Mirëpo serbokroatishtja kishte pësuar një ndikim të ndjeshëm nga gjermanishtja. Edhe anglicizmat kanë hyrë nëpërmjet serbishtes. “Vetëm në shekullin e ri mund të flitet për marrëdhënie të drejtpërdrejta ndërmjet anglishtes dhe shqipes në Kosovë”<sup>20</sup>. Në vitet ’90, pas rënies së komunizmit dhe pas shpërbërjes së ish-Mbretërisë Jugosllave, Shqiptarët e Kosovës dhe të Shqipërisë rivendosën komunikimin, i cili është sot gjithmonë e më i afërt.

Në kuadër të përdorimit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të një gjuhe të përbashkët standarde, leksikografët tanë kanë për detyrë të vendosin si do të trajtohen dallimet leksikore krahinore në fjalorët shpjegues të shqipes dhe në fjalorët gjuhë e huaj – shqip e anasjelltas. Siç dihet, në disa fusha ka një numër dallimesh terminologjike ndërmjet

<sup>19</sup> Emil Lafe, “Rreth fjalëve me burim nga anglishtja në shqipen e sotme”, “Gjuha shqipe” (Prishtinë), 2011, nr. 1, f. 57.

<sup>20</sup> Po aty, f. 57.

Shqipërisë dhe Kosovës, duke u krijuar kështu një varg çiftesh sinonimike. Me ndihmën e koleges nga Kosova Sindorela Doli, nga fusha e veshmbathjeve dhe e kozmetikës mund të përmendim si të tilla: *atlete – patika, benevrekë – klina, bollqe, bezhë – drap, bigudi – llokne, bikini – kopaçe, borsalinë – shishir, brekë – klina, dantellë – tentene, gete – hollaope (hollaopke), grim – shmink, grimier – shminker, i kadifenjtë – sumollke (sumollte), kaki – qeremide, kanotierë – maic, korse – allter, krep – mafes, model flokësh – frizurë, mushama – vindjak, parukier – frizer, perlë – biser, pulovër – xhemper, qyrk – bundë, rimel – llabllanuz (maskarë), robëdëshambër – shllafurk, seta (çorape najloni) – dukelenica, tuta – trajnerka, tharëse flokësh – fren, xhinse – farmerka, xhup – setër etj. Në parim mendoj se në çiftet e mësipërme huazimet nga serbishtja a turqishtja mund të mënjanoen krejt ose të cilësohen si të ligjëritimit bisedor, krahinor a fjalë të vjetruara. Dëshiroj të hyj në lidhje bashkëpunimi me kolege nga Kosova e Maqedonia për të përpiluar një listë më të plotë të termave dhe emërtesave të fushës së veshmbathjeve, modës e kozmetikës dhe më tej me një grup pune të hartojmë një material për diskutim në shtypin shkencor me synim që të arrijmë në disa rekomandime të Alb-Shkencës për një rregullim e kodifikim paraprak të leksikut të këtyre fushave. Pas kësaj mund të punojmë edhe për një fjalor të posaçëm të termave të kësaj fushe.*

Në fjalorët e gjuhës shqipe termat e veshmbathjeve dhe të kozmetikës janë paraqitur tradicionalisht pa ndonjë shënim shoqëruar terminologjik. Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980) dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe (2006)” janë shënuar me shkurtimin *etnogr.* (terma të etnografisë) vetëm fjalët që shënojnë veshje tradicionale popullore dhe me *tekst.* (terma të industrisë së tekstileve) disa fjalë që shënojnë kryesisht materiale të prodhimit të veshjeve, si: *atllas, damask, dok, drill, filaturë, terital* dhe një proces pune të prodhimit të tyre: *filaturë, tjerrje*, ndërsa për kozmetikën nuk ka ndonjë term që shoqërohet me shkurtim. Një pasqyrim i fjalëve të veshmbathjeve dhe të kozmetikës si terma me shënimin përkatës terminologjik varet edhe nga tipi i fjalorit. Këtë punë do ta përligjte një fjalor shpjegues i tipit të madh, ku do të bëhej më i qartë specializimi i kuptimeve të një fjale, duke rritur kështu peshën specifike të terminologjisë në leksikun e përgjithshëm, e cila ka përbërë një tipar dallues të rëndësishëm të shqipes letrare, sidomos nga gjysma e dytë e shek. XX e këtej.

**Lista e fjalëve të trajtuara**

<i>acid hialuronik</i>	<i>bordurë</i>	<i>detergjent</i>
<i>acroyoga</i>	<i>borsalinë</i>	<i>detersiv</i>
<i>akrilik</i>	<i>borsë</i>	<i>diademë</i>
<i>aksesor</i>	<i>borsetë</i>	<i>diamant</i>
<i>akuamarin</i>	<i>botoks</i>	<i>difuzor</i>
<i>allter</i>	<i>boyfriend</i>	<i>disenjator</i>
<i>animal flow</i>	<i>brilantinë</i>	<i>dizajn</i>
<i>animal print</i>	<i>buduar</i>	<i>dizajner</i>
<i>anti-age</i>	<i>bukle</i>	<i>dizenjim</i>
<i>antichelulit</i>	<i>bundë</i>	<i>dizenjo</i>
<i>antioksidant</i>	<i>bust/bustier</i>	<i>dizenjoj</i>
<i>aplikacion</i>	<i>butik</i>	<i>dizenjues</i>
<i>aplikim</i>	<i>candy</i>	<i>dok</i>
<i>aromatherapy</i>	<i>çantë</i>	<i>dorashka</i>
<i>art work</i>	<i>çantë e vogël</i>	<i>doreza</i>
<i>atelier</i>	<i>carnaby chic</i>	<i>drap</i>
<i>atlete</i>	<i>casual</i>	<i>dress code</i>
<i>atllas</i>	<i>cateye</i>	<i>drill</i>
<i>avangard</i>	<i>chic</i>	<i>dukelenica</i>
<i>azhur</i>	<i>classy</i>	<i>easy and chic</i>
<i>babydoll</i>	<i>clutch</i>	<i>eksfoliant</i>
<i>baltë</i>	<i>coachella</i>	<i>estetikë</i>
<i>barbie girl</i>	<i>cocktail dress</i>	<i>eyeliner</i>
<i>barok</i>	<i>college girl</i>	<i>fard</i>
<i>beauty</i>	<i>colour block</i>	<i>farmerka</i>
<i>beretë</i>	<i>country</i>	<i>fashion</i>
<i>bezhë</i>	<i>court shoes</i>	<i>fashion blogger</i>
<i>bigudi</i>	<i>cowgirl</i>	<i>fashion designer</i>
<i>bikini</i>	<i>damask</i>	<i>fashion icon</i>
<i>biser</i>	<i>dantellë</i>	<i>fashion week</i>
<i>blefaroplastikë</i>	<i>dekoloroj</i>	<i>fashioniste</i>
<i>blerje</i>	<i>dekolte</i>	<i>fason</i>
<i>blumarin</i>	<i>demode</i>	<i>filaturë</i>
<i>bluxhins</i>	<i>demokratike</i>	<i>fildikos</i>
<i>bluzë</i>	<i>(bizhuteri)</i>	<i>filigran</i>
<i>bobinë</i>	<i>depilator</i>	<i>filtër mbrojtës</i>
<i>body</i>	<i>depilim</i>	<i>fin</i>
<i>bollqe</i>	<i>depiluj</i>	<i>firmë</i>
<i>bomber jacket</i>	<i>depilues</i>	<i>fiston</i>
<i>bon ton</i>	<i>deskuamoj</i>	<i>flakon</i>
<i>bordo</i>	<i>detaj</i>	<i>floktore</i>

<i>floreal</i>	<i>hollaope</i>	<i>këpucar</i>
<i>fondatintë</i>	<i>(hollaopke)</i>	<i>kësuljer</i>
<i>foriserie</i>	<i>hollësi</i>	<i>kilota</i>
<i>fortesë</i>	<i>hydrobike</i>	<i>kilt</i>
<i>fosforeshent</i>	<i>i beztë</i>	<i>klasike</i>
<i>fotomodel</i>	<i>i depiluar</i>	<i>klina</i>
<i>frak</i>	<i>i dizenuar</i>	<i>kodi i veshjes</i>
<i>fren</i>	<i>i domosdoshëm</i>	<i>koleksion</i>
<i>french</i>	<i>i gëzofë</i>	<i>kombinoj</i>
<i>frizer</i>	<i>i grimuar</i>	<i>komplet</i>
<i>frizurë</i>	<i>i hirtë</i>	<i>kontur</i>
<i>frizurë</i>	<i>i kadifenjtë</i>	<i>kopaçe</i>
<i>fundore</i>	<i>i kamoshtë</i>	<i>koral</i>
<i>furçë</i>	<i>i meshintë</i>	<i>kordon</i>
<i>fustani i vogël i zi</i>	<i>i përhimë (i</i>	<i>korrektor</i>
<i>futuriste</i>	<i>përhimtë)</i>	<i>korse</i>
<i>gabardinë</i>	<i>i tonifikuar</i>	<i>kostum</i>
<i>galanteri</i>	<i>i tyltë</i>	<i>krahoshe</i>
<i>galloshe</i>	<i>ikonë mode</i>	<i>kravatë</i>
<i>gardërobë</i>	<i>imtësi</i>	<i>krehër</i>
<i>gardërobist</i>	<i>in</i>	<i>krelë</i>
<i>garniturë</i>	<i>inestetizëm</i>	<i>krem</i>
<i>gete (geta)</i>	<i>infrared</i>	<i>kremoze</i>
<i>gëzof</i>	<i>integrator</i>	<i>krem-pudër</i>
<i>gipsy</i>	<i>intimo</i>	<i>krep</i>
<i>glam</i>	<i>jacquard</i>	<i>kundër rrudhave</i>
<i>glamorous</i>	<i>jashtë serie</i>	<i>kundër ujit</i>
<i>glamour</i>	<i>java e modës</i>	<i>laps</i>
<i>gold</i>	<i>jogë</i>	<i>larës</i>
<i>golf</i>	<i>kaçurrel</i>	<i>lavatestë</i>
<i>gomagge</i>	<i>kaki</i>	<i>lazer</i>
<i>gotik</i>	<i>kalorësiak</i>	<i>lifting</i>
<i>gri</i>	<i>kamosh</i>	<i>limited edition</i>
<i>grim</i>	<i>kanotierë</i>	<i>lip gloss</i>
<i>grimier</i>	<i>kapeleri</i>	<i>lipomassage</i>
<i>grimim</i>	<i>kapotë</i>	<i>lisho</i>
<i>grimoj</i>	<i>kapuç</i>	<i>little black dress</i>
<i>grixho</i>	<i>karamele</i>	<i>livandë</i>
<i>haute couture</i>	<i>kardio</i>	<i>locion tonik</i>
<i>hidratoj</i>	<i>karré</i>	<i>look</i>
<i>hidratues</i>	<i>kashtor(e)</i>	<i>lulor</i>
<i>hijezues</i>	<i>kaskë</i>	<i>llabllanuz</i>
<i>hippy</i>	<i>kasketë</i>	<i>llak</i>

<i>llokne</i>	<i>must</i>	<i>përintim</i>
<i>mafes</i>	<i>najlon</i>	<i>perlë</i>
<i>maic</i>	<i>ndërresë</i>	<i>permanent</i>
<i>make-up</i>	<i>neon</i>	<i>përparëse</i>
<i>make-up</i>	<i>neopren</i>	<i>(përparje)</i>
<i>makijazh</i>	<i>neoromantike</i>	<i>petk</i>
<i>makijazh</i>	<i>nude</i>	<i>pilates</i>
<i>manekin</i>	<i>njëngjyrësh</i>	<i>pin up</i>
<i>manikyr</i>	<i>office style</i>	<i>pink</i>
<i>mantel</i>	<i>onde</i>	<i>pirsing</i>
<i>manto</i>	<i>oversize</i>	<i>pixie</i>
<i>markë</i>	<i>ovrolle</i>	<i>pizhame</i>
<i>marsupio</i>	<i>palaçeta/paliçeta</i>	<i>pjastër</i>
<i>masazh</i>	<i>palapetë</i>	<i>plazmë</i>
<i>mascara</i>	<i>palë</i>	<i>police</i>
<i>masë e madhe</i>	<i>pallto</i>	<i>polka dots</i>
<i>mashkullor</i>	<i>pamje</i>	<i>pop</i>
<i>maskarë</i>	<i>pandatif</i>	<i>pop art</i>
<i>maskë</i>	<i>pantallona</i>	<i>portofol</i>
<i>maxiclutch</i>	<i>pantallona të</i>	<i>primer</i>
<i>me klas</i>	<i>shkurtra</i>	<i>print</i>
<i>me kuadrate</i>	<i>pantofël</i>	<i>prirje</i>
<i>medaljon</i>	<i>papijon</i>	<i>psikedelike</i>
<i>melazmë</i>	<i>papuçe</i>	<i>pudër</i>
<i>meny fashion</i>	<i>paradë</i>	<i>pulovër</i>
<i>metrazh</i>	<i>pardesy</i>	<i>pumps</i>
<i>minimalist</i>	<i>parfum</i>	<i>punëdore</i>
<i>mishelar</i>	<i>parfumeri</i>	<i>punk</i>
<i>mix and match</i>	<i>parukë</i>	<i>pupë</i>
<i>modë</i>	<i>parukier</i>	<i>puplin</i>
<i>model</i>	<i>pasarelë</i>	<i>qeremide</i>
<i>model flokësh</i>	<i>pastel</i>	<i>qimush</i>
<i>modeling</i>	<i>patika</i>	<i>qyrk</i>
<i>modelist</i>	<i>pedikyr</i>	<i>retro</i>
<i>modeloj</i>	<i>pediluvio</i>	<i>riekuilibruet</i>
<i>modern</i>	<i>peeling</i>	<i>rimel</i>
<i>modernizëm</i>	<i>pelerinë</i>	<i>robëdëshambër</i>
<i>modernizoj</i>	<i>pëlhurë</i>	<i>rok</i>
<i>modist</i>	<i>peliçe</i>	<i>rokoko</i>
<i>mokasina</i>	<i>peliçeri</i>	<i>roller</i>
<i>motiv</i>	<i>penel</i>	<i>romantike</i>
<i>motiv</i>	<i>penjuar</i>	<i>rozë</i>
<i>mushama</i>	<i>perçina</i>	<i>rroba banje</i>

<i>rrobënatë</i>	<i>supermodel</i>	<i>trendy</i>
<i>ruzh</i>	<i>supermodern</i>	<i>triko</i>
<i>safari</i>	<i>sutiena</i>	<i>trikotazh</i>
<i>sallon</i>	<i>sving</i>	<i>truk</i>
<i>sandale</i>	<i>symace</i>	<i>t-shirt</i>
<i>seksi</i>	<i>shampo</i>	<i>tualet</i>
<i>serum</i>	<i>sharm</i>	<i>tuta</i>
<i>set (kozmetik)</i>	<i>shifon</i>	<i>tyl</i>
<i>seta</i>	<i>shik</i>	<i>tharëse flokësh</i>
<i>setër</i>	<i>shishir</i>	<i>thekë</i>
<i>sexy</i>	<i>shkëlqyes buzësh</i>	<i>ultrachic</i>
<i>sezon (mode)</i>	<i>shllafurk</i>	<i>uniformë</i>
<i>sfilatë</i>	<i>shmink</i>	<i>unisex</i>
<i>silikon</i>	<i>shminker</i>	<i>urban-glamour</i>
<i>sintetike</i>	<i>shopping</i>	<i>valë-valë</i>
<i>skicë</i>	<i>shorts</i>	<i>vazelinë</i>
<i>skinny</i>	<i>tartan</i>	<i>vëllimor</i>
<i>skoceze</i>	<i>techno</i>	<i>veshje</i>
<i>skrab</i>	<i>teksturë</i>	<i>veshmbathje</i>
<i>slim-fit</i>	<i>tendencë</i>	<i>vindjak</i>
<i>smokey eyes</i>	<i>tentene</i>	<i>vintage</i>
<i>smoking</i>	<i>tërësisht e bardhë</i>	<i>vinyl</i>
<i>solar</i>	<i>tërësisht e zezë</i>	<i>violet</i>
<i>solucion</i>	<i>terital</i>	<i>vizatim</i>
<i>spf</i>	<i>tiarë</i>	<i>vjollcë</i>
<i>spilë</i>	<i>tirandë</i>	<i>voluminoz</i>
<i>sportiv</i>	<i>ti-shërt</i>	<i>waterproof</i>
<i>spraj</i>	<i>tjerrtore</i>	<i>whipped fitness</i>
<i>sprucoj</i>	<i>ton</i>	<i>xhaketë</i>
<i>stampa kafshësh</i>	<i>tonifikim</i>	<i>xhel</i>
<i>stampë</i>	<i>tonifikoj</i>	<i>xhelatinë</i>
<i>stampoj</i>	<i>tonifikues</i>	<i>xhemper</i>
<i>stil skocez</i>	<i>tonik</i>	<i>xhinse</i>
<i>stil zyrtar</i>	<i>topmodel</i>	<i>xhuboks</i>
<i>stilist</i>	<i>total black</i>	<i>xhup</i>
<i>stof</i>	<i>total white</i>	<i>zhapone</i>
<i>streçe</i>	<i>trajnerka</i>	<i>zhartier</i>
<i>strishë</i>	<i>trasgresiv</i>	<i>zhile</i>
<i>suede</i>	<i>treçerekëshe</i>	<i>zhupon</i>
<i>sumollke</i>	<i>trekuart</i>	<i>zumba</i>
<i>(sumollte)</i>	<i>trend</i>	
<i>superchic</i>	<i>trendsetter</i>	

## BIBLIOGRAFI

1. Lafe, Emil; Çepani, Anila; Adelina Çerpja: “Rreth pasqyrimt të fushave terminologjike në ‘Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980)’”, në: *Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005, 308–314.
2. Çabej, Eqrem: “Studime gjuhësore I”, Rilindja, Prishtinë, 1986.
3. Çabej, Eqrem: “Shqiptarët midis perëndimit dhe lindjes”, MÇM, Tiranë, 1994.
4. “Fjalor i gjuhës shqipe”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006.
5. Jorgaqi, Kristina: “Sprovë për identifikimin e huazimeve leksikore italiane në gjuhën shqipe”, në *Studime filologjike* 1992, 1–4, 55–65.
6. Kokona, Vedat: “Fjalor frëngjisht-shqip”, shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1989.
7. Lafe, Emil: “Rreth fjalëve me burim nga anglishtja në shqipen e sotme”, në “*Gjuha shqipe*” (Prishtinë), 2011, nr. 1, f. 55–72 ose *Albanologji. Vëllimi II. Punimet nga aktiviteti shkencor “Java e Albanologjisë” i mbajtur më 25–29 tetor*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2011, f. 291–307.
8. Lafe, Genc: “Der italienische Einfluß auf das Albanische. Erster Teil - Allgemeine Erörterungen. / Ndikimi i italishtes mbi shqipen. Pjesa e parë – Shqyrtime të përgjithshme”/, *Ponto-Baltica* 8–9/1988–1999, 47–172; Zweiter Teil - Wörterbuch der Italianismen im Albanischen. / Pjesa e dytë – Fjalor i italianizmave në gjuhën shqipe”/, *Ponto-Baltica* 10/2000, 31–120.
9. Leka, Ferdinand; Morcka, Sofika: “Zhvillimi dhe pasurimi i terminologjisë pas çlirimit”, *Studime filologjike*, Tiranë, 1969, nr. 4.
10. Mann, E. Stuart: “A Historical Albanian-English Dictionary”, Longmans, Green and Co, London 1948.
11. Pata Kapo, Irena: “Ndikimi i anglishtes në shtypin shqiptar paskomunist” (punim për gradën shkencore “doktor” në gjuhësi), Universiteti i Tiranës, shkurt 2013, 235 f.
12. “Për pastërtinë e gjuhës shqipe”. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1998.
13. : “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II”, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1972.

**Jonida XHYRA-ENTORF**

## **SEMANTIKA E PËRKRYERJES**

**(Sprovë për një interpretim të figurës së Serafina Topisë)**

Në një studim të botuar në vitin 1902, M. Marchianò, ndër studiuesit e parë të De Radës, e cilësonte Serafinën si një krijesë të përkryer.<sup>1</sup> Duke marrë si pikënisje mendimin e mësipërm, sot pas më se një shekulli, në mijëvjeçarin e ri, dëshirojmë të përvijojmë më konkretisht në këtë artikull semantikën e përkryerjes së Serafinës, d.m.th. semantikën e përkryerjes romantike.

Mendimi antropologjik romantik, duke ngërthyer traditën iluministe të konceptimit të njeriut si qenie e arsyeshme, njëkohësisht iu kundërvu kësaj tradite në zhvillimin e një përkatësie të pazgjdhshme të trupit dhe shpirtit. Ky këndvështrim tërësor i njeriut në individualitetin<sup>2</sup> e tij dhe konceptimi ndryshe i femrës i dhanë formë dhe përmbajtje dashurisë romantike, në qerthullin e së cilës, përmes një përjetimi të skajshëm ndjenjash, individi gjen vetveten, zhvillohet, përkryhet. Konceptimi ndryshe i femrës në mendësinë romantike pati si pikënisje idenë e kundërvënies dhe polaritetit të hershëm të gjinive, parashtruar

---

<sup>1</sup> Marchianò, M. (1902) *L'Albania e l'opera di Girolamo de Rada*. Trani, f. 139.

<sup>2</sup> Konceptimi i njeriut si qenie e arsyeshme në lidhjen e pazgjdhshme të trupit e shpirtit (Leib / corpo, Seele / anima) përbën bazën e mendësisë romantike, në qendër të së cilës është njeriu si individ dhe veçantia e tij. Mendësia iluministe dëshmonte në të kundërt një individualizëm sasior. Motoja e Revolucionit Francez *liri, barazi, vëllazëri* i shihte njerëzit të gjithë si të barabartë, pa përfillur veçantinë e individit si të tillë. Shtysën e parë në tronditjen e mendësisë iluministe e dha pietizmi, një lëvizje fetare e shekullit të 17-të dhe të 18-të, e cila e orientonte njeriun drejt përjetimit individual të zotit. Më gjerë për këtë problem shih: Beutin, W. etj. (1994) *Aufklärung*. Në: *Deutsche Literaturgeschichte*. Stuttgart, f. 121–153.

---

Jonida Xhyra-Entorf, studiuese, albanologe.



fillimisht nga Schelling,<sup>3</sup> rimarrë dhe trajtuar më pas edhe nga romantikë të tjerë.<sup>4</sup>

Duke e parë njeriun si qenie të arsyeshme, iluminizmi nuk bënte dallim ndërmjet mashkullit dhe femrës, përveç se në funksionet e tyre trupore. Paraqitja e botës së ndjenjave, për më tepër e asaj bote ndjenjash që përcaktohet nga kufijtë e gjinisë, mbeti gjithsesi brenda caqeve të dualizmit.<sup>5</sup> Shembulli më tipik për këtë mbetet romani *La nouvelle Heloise* i Rousseau-it.<sup>6</sup> Ndjeshmëria si shprehje e jetës shpirtërore të femrës, u pa e ndarë nga sfera e trupit dhe u trajtua kryesisht si triumf i virtytit. Edhe kulti i pasionit tek shkrimtarët e *Sturm und Drang*-ut nuk arriti megjithatë të kapërcejë kufijtë e dualizmit, si mendësi iluministe. Vetë vepra e Goethe-s si dhe jeta e tij mbushur me histori të panumërta dashurie,<sup>7</sup> ofronte dy tipa femrash dhe dy lloje të dashurisë.<sup>8</sup>

Konceptimi ndryshe i femrës dhe i dashurisë romantike u ngjiz në rrjedhën e shekullit të 18-të dhe me daljen në skenë të një sërë figurash të shquara të romantizmit,<sup>9</sup> të cilat me jetën dhe veprën e tyre iu kundërvunë dualizmit iluminist dhe dëshmuan një tërësi dhe njëkohësisht një njësi të trupit e të shpirtit. Ndër këto femra të shquara Caroline<sup>10</sup> mbetet figura më tipike e romantizmit, e ashtuquajtura muza e

<sup>3</sup> Zeltner, H. (1954) *Schelling*. Stuttgart, f. 90–99.

<sup>4</sup> Fichte, J. G. (1962) *Grundlage des Naturrechts. Das System der Sittenlehre*. - në: *Ausgewählte Werke in sechs Bänden*, përgatitur nga Medicus, F. Darmstadt, vëll II, f. 312; Schlegel, F. (1979) *Studien des klassischen Altertums*. - në: *Kritische Friedrich-Schlegel-Ausgabe*, përgatitur nga Behler, E. etj. Paderborn, vëll I, f. 87.

<sup>5</sup> Kluckhohn, P. (1931) *Die Auffassung der Liebe in der Literatur des 18. Jahrhunderts und in der deutschen Romantik*. Halle, f. 94–96.

<sup>6</sup> Rousseau; J.-J. (1947) *La nouvelle Heloise*. Paris.

<sup>7</sup> Shih më gjerë: Bode, W. (1913) *Goethes Liebesleben*. Berlin.

<sup>8</sup> Në romanin e tij *Eduard Allwills Papiere* botuar fillimisht më 1775 / 1776 dhe ripunuar më pas në vitin 1792 nën titullin *Eduard Allwills Briefsammlung*, F. H. Jacobi (1743–1819) mishëron përmes figurës kryesore Eduard Allwills dhe marrëdhënieve të tij dashurore konceptin e dy lloj femrave dhe përkatësisht të dy lloj dashurive, atë trupore, në kuadrin e martesës me gruan e tij, dhe atë shpirtërore jashtë kësaj martese me të dashurën e tij Henriette (Kluckhohn, vepër e cituar, f. 67).

<sup>9</sup> P.sh.: Anna Elisabeth (Bettine) Brentano / Arnim (1785–1859), Sophie Schubart / Mereau / Brentano (1770–1806), Caroline Albertine Dorothea Michaelis / Böhmer / Schlegel / Schelling (1763–1809), Dorothea Mendelssohn / Veit / Schlegel (1763–1839), Rahel Antonie Friederike Levin / Varnhagen von Ense / Robert (1771–1833), Karoline Friederike Louise Maximiliane von Günderode (1780–1806), Anne Louise Germaine Necker / von Staël-Holstein (1766–1817) etj. Shih më gjerë: Söhn, G. (1998) *Frauen der Aufklärung und der Romantik*. Düsseldorf.

<sup>10</sup> Caroline Albertine Dorothea Michaelis (1763–1809) lindi në Göttingen. Babai i saj, J. D. Michaelis, ishte profesor i orientalistikës dhe teologjisë në Universitetin e Göttingen-it. E pajisur me bukuri dhe aftësi të rralla Caroline u rrit në një mjedis tepër intelektual. Në moshën 20 vjeçare ajo martohet me mjekun J. F. W. Böhmer. Në vitin 1792, e mbetur vejushë me dy fëmijë nga kjo martesë dhe pas vdekjes së njëres prej vajzave,

tij. Me individualitetin e saj të pasqor, kjo grua që udhëhiqej nga zemra, mishëroi idealin romantik të femrës në përkryerjen e saj, atë ç'ka Friedrich Schlegel do ta quajë *feminitet të pavarur*. Këtij ideali të frymëzuar nga Caroline ai do t'i kushtojë romanin e tij *Lucinde*, botuar në vitin 1799.<sup>11</sup>

Në këtë roman F. Schlegel përpiqet të tematizojë formën e re të martesës me dashuri dhe për hir të dashurisë, e cila si e tillë ndërthron nevojat individuale, emocionale e shpirtërore si dhe seksualitetin, jo vetëm të mashkullit, por edhe të femrës. Pikërisht në kuadrin e kësaj lloj dashurie, e për rrjedhojë logjike të kësaj martese, individët duke u bërë njësh me njëri-tjetrin zhvillojnë identitetin dhe vërtetësinë e tyre.<sup>12</sup> Pas historisë dashurie nga më të ndryshmet, heroi i romanit Julius takon Lucinde-n, të dashurën e vetme dhe të përjetshme.<sup>13</sup> Lidhja e Lucinde-s dhe Julius mishëron thelbin e dashurisë romantike, e cila parakupton pavarësinë dhe të drejtën e femrës për t'u dashuruar dhe për të dashuruar njëkohësisht. Parashtrimi si njësi dhe tërësi i dashurisë romantike i kundërvihej tërësisht dualizmit të iluminizmit, duke përbërë kështu një hap revolucionar në mendimin e kohës. Në rrjedhën e një dashurie të tillë, njeriu gjen vetveten, zhvillohet dhe vetëm duke u bërë njësh me të dashurin a të dashurën, arrin përkryerjen. Bashkimi trupor dhe shpirtëror i dy qenieve në përkryerjen e tij merr tek romantikët një forcë magjike, mistike e fetare, përtej tokësore, është momenti i lidhjes me përjetësinë,

---

Caroline shkon në Mainz, duke përjetuar së afërmi dështimin e republikës së parë demokratike në Gjermani. Nga një lidhje e shkurtër dashurie me një oficer francez mbetet shtatzënë. Në vitin 1793, e implikuar në ngjarjet e kohës, ajo burgoset për kohësisht bashkë me vajzën. Pas daljes nga burgu, August Wilhelm Schlegel e ndihmon për të lindur fëmijën jashtë martese, e cila vdes pas 17 muajsh. Pas largimit të tij në Hollandë për Caroline-n kujdeset Friedrich Schlegel. Në vitin 1796 Caroline martohet me August Wilhelm Schlegel dhe çifti i sapomartuar vendoset në Jena. Pas ardhjes së Friedrich Schlegel dhe Dorothea Veit në vitin 1799 në këtë qytet, shtëpia e Caroline-s bëhet qendra e romantizmit gjerman të periudhës së parë. Në vitin 1798 në rrethin e Jenës vjen filozofi Friedrich Wilhelm Joseph Schelling. Caroline dashurohet pas tij dhe duke mos gjetur forca për ta përballuar këtë gjendje sëmurë rëndë. Mjekët i këshillojnë një kurë në Bad Bocklet. Pikërisht gjatë qëndrimit atje i vdes papritur dhe vajza e fundit, Auguste Böhmer, në moshën 15 vjeçare. Pas ndarjes me August Wilhelm Schlegel, në vitin 1803 Caroline martohet me filozofin 12 vjet më të ri se veten, F. W. J. Schelling [shih më gjerë: Mauch, U. & Brandes, I. (1986) *Das Geheimnis der Caroline Schlegel-Schelling*, geb. Michaelis. Në: *Der Freiheit entgegen*. Frauen der Romantik. München, f. 61–101].

<sup>11</sup> Krenner, D. (2001) *Romantik*. Stuttgart, f. 130–132.

<sup>12</sup> Schlegel, F. (1962) *Dichtungen*. - në: *Kritische Friedrich-Schlegel-Ausgabe*, përgatitur nga Behler, E. etj. München, vëll 5, f. 54: „Sie waren ganz hingegeben und eins, und doch war jeder ganz er selbst, mehr als sie es noch je gewesen waren.“ (Ata i ishin dhënë tërësisht njëri-tjetrit dhe ishin bërë një, e megjithatë secili kishte mbetur plotësisht ai vetë, më shumë se ç'kishin qenë ndonjëherë.)

<sup>13</sup> Po aty, f. 7.

me zotin.<sup>14</sup> Vuajtja si shtysë drejt kësaj përkryerje dhe përjetimi i saj në kufijtë e skajshëm të ndjeshmërisë përvijon për rrjedhojë ndjesinë e mallit në dashurinë romantike, e një malli përjetësisht të papërmbushur.<sup>15</sup>

Brenda qerthullit të antropologjisë romantike të ravyjësuar më lart Serafina qysh në këngën e parë të poemës ngjizet si një krijesë e plotë. Në shtëpinë e prindërve ajo është rritur si një *vashë gadhiare* (ragazza crebbi leggiadra)<sup>16</sup> e si një *deg e ardhurëz* (come una pianta peregrina).<sup>17</sup> Takimi i parë me Bozdarin në shkretimën e dashurisë i jep jetë dhe ngjyrë bukurisë së saj. Krahasimi që i bën vetes me djalthin që sapo ka mbaruar shkollën<sup>18</sup> na bën me dije se bota e librave nuk është e huaj për të, kurse përskuqja<sup>19</sup> në kohën që i flet Bozdarit përçon tek lexuesi atë çka ndodh në shpirtin e saj të rrëmbyer nga vala e dashurisë. Vetë mënyra e ndërtimit të poemës si ditar<sup>20</sup> i mbajtur nga Serafina e paraqet atë të plotë në njësimin e vrulleve të zemrës dhe aftësisë e kulturës për t'i derdhur ato në letër. Nëse në poemën *Këngët e Milosaos* dy të rinjtë e dashuruar i përkasin shtresave të ndryshme shoqërore, në poemën në fjalë qysh në vargjet e para mësojmë se Serafina dhe Bozdari i përkasin dy familjeve armike.<sup>21</sup> Në të dy rastet semantika e dashurisë romantike i jep mundësi individit përmes ndjeshmërisë së skajshme të vërë në provë identitetin e tij si subjekt modern.

E ngjizur në një përkatësi të pazgjydhshme të trupit, mendjes e shpirtit, Serafina nis të zhvillohet individualisht si një subjekt modern përmes vuajtjes së një dashurie të pamundur e të penguar. Në vijim të poemës De Rada i kthehet hera-herës bukurisë së Serafinës,<sup>22</sup> por gjithsesi, në mënyrë të përkorë në krahasim me Rinën. Autori e cilëson atë të pashoqe në krejt botën evropiane<sup>23</sup> dhe përpos për hijeshinë na bën me dije se në mjedisin ku jeton ajo çmohet dhe si një individ i ditur e i

<sup>14</sup> Kluckhohn, vepër e cituar, f. 482–486.

<sup>15</sup> Bobsin, J. (1994) Von der Werther-Krise zur Lucinde-Liebe. Studien zur Liebessemantik in der deutschen Erzählliteratur 1770–1800. Tübingen, f. 167–184.

<sup>16</sup> Libri i parë / Kënga e Serafinës / 1. Shembujt janë cituar nga: De Rada, J. (1987) Serafina Topia (Një pasqyrë jete njerëzore). Në: Vepra letrare I. Tiranë, f. 227–398.

<sup>17</sup> Libri i parë / Kënga e Serafinës / 3.

<sup>18</sup> Po aty / 20.

<sup>19</sup> Po aty / 74.

<sup>20</sup> Resuli, N. (1941) De Rada (1814–1903). - në: *Shkrimtarët shqiptarë. Pjesa I (1462–1878). Mbledhë e punue nën kujdesin e Ernest Koliqit*. Botim i Ministris s' Arsimit. Tiranë, f. 257.

<sup>21</sup> Libri i parë / Kënga e Serafinës / 44, 76.

<sup>22</sup> Libri i parë / Këngë e Bozdarit me shokë Serafinës / 15–16: Gërshetat korb, mollzat hir nga ata dy sy. / Me to ti linde, të mundje zemrat edhe t'i shëroje; Libri i parë / Kënga e dytë / 4: mollëzaskuqur; Libri i parë / Këngë e Nik Dukagjinit vashës së Topiajve / 3: një të hirshme zanë; Libri i parë / Kënga e katërt / 25–26: faqet, / aq të kthjellta sa dhe dita.

<sup>23</sup> Libri i dytë / Kënga e parë / 84.

kulturuar.<sup>24</sup> Përsiatjet e saj nuk janë vetëm të një shpirti që vuan thellë, por edhe ato të një individi të kulturuar, i cili pas leximeve të shumta<sup>25</sup> tashmë *s'mund të lë pa parë / ç'është hapur para syve*.<sup>26</sup> Përsiatjet e Serafinës marrin shpesh ngjyrimë filozofike lidhur me jetën pas vdekjes,<sup>27</sup> me kapjen e momentit se gjithçka ikën e s'vjen më,<sup>28</sup> për t'u kthyer në kapërthime të vërteta filozofike në dhiatën që Serafina u lë dy djemve të saj në fund të poemës.<sup>29</sup> Jo vetëm kaq, por Serafina është poete.<sup>30</sup> Në një nga këngët e poemës i vjehri Pal Dukagjini i lutet asaj të lexojë diçka nga ato që ka shkruar.<sup>31</sup> Rreth tij, pranë vatrës, formohet një rreth dëgjuesish,<sup>32</sup> një publik, i cili të sjell ndër mend rrëzëllimin e zbehtë të një salloni. Të mos harrojmë se edhe gjatë romantizmit salloni mbeti gjithsesi një vend në të cilin zinte fill sfera e ndikimit shoqëror dhe e veprimtarisë artistike e politike të një femre.<sup>33</sup> Poema<sup>34</sup> që lexon Serafina është një histori dashurie fatkeqe e me fund të hidhur, në qerthullin e së cilës dy të dashuruarit, Radavani dhe Parayllja, përvijohen tërësisht si individë romantikë me pasione të fuqishme dhe me një ndjeshmëri të skajshme.

Por mbi të gjitha Serafina, vetë krijuesja e kësaj poeme, nuk mund të konceptohet jashtë kësaj ndjeshmërie. Ndjenjat janë produkte të ndryshueshme historike të një normimi dhe kodimi kulturor.<sup>35</sup> Normimi dhe kodimi kulturor i tyre në mjedisin romantik italian të shekullit të 19-të, mjedis në të cilin u formua De Rada, u bë në kuadrin e lëvizjes për

<sup>24</sup> Libri i parë / Kënga e parë / 42–43: Po më shumë se martesë / gjithë e thonë, na vlen vasha.

<sup>25</sup> Libri i parë / Kënga e dytë / 21–23: Pse më mësove të lexoj? / Të shoh te pasqyra e kohës / shesh andrallash njerëzore; Libri i parë / Kënga e tretë / 77–78: Gjithnjë lexon, bija ime / mbyllur si një murgë andaj.

<sup>26</sup> Libri i parë / Kënga e dytë / 38–39.

<sup>27</sup> Libri i parë / Kënga e tretë / 13–14: Vallë atëherë kur të vdes, / a do të zgjohem përsëri.

<sup>28</sup> Libri i parë / Kënga e katërt / 142–143: Hajd, Bozdar le të gëzojmë / këtë çast që po na ikën.

<sup>29</sup> Libri i katërt / Kënga e pestë / 109–161.

<sup>30</sup> Libri i tretë / Kënga e katërt / 152–154: Mesha niste e Serafina / pështjell letrat ku kish shkruar / poemën që u lëçiti.

<sup>31</sup> Libri i tretë / Kënga e parë / 227–233: Ti, të paktën / ime re, këndonë sonte / ndonjë përrallë a të ngjarë / t'arbëreshe, që mban shkruar / n'arkën tënde. Se, si vashë, / ndër shtëpi, ti, e vetmuar, / gjithnjë shkruaje e këndoje.

<sup>32</sup> Libri i tretë / Kënga e parë / 223–225: Edhe gratë pas zakonit / rreth tij vihen. Me to bashkë / dhe gjitonë, bujq, barinj.

<sup>33</sup> Sohn, vepër e cituar, f. 15.

<sup>34</sup> Libri i tretë / Kënga e dytë, e tretë dhe e katërt.

<sup>35</sup> Titzmann, M. (1990) „Empfindung' und ‚Leidenschaft“: Strukturen, Kontexte, Transformationen der Affektivität / Emotionalität in der deutschen Literatur in der zweiten Hälfte des 18. Jahrhunderts. - në: Hansen, P. K. *Empfindsamkeiten*. Passau, f. 137–165.

bashkimin e Italisë, duke ngërthyer kësisoj qysh në fillim brenda vetes ndjenjën e vuajtjes dhe të sakrificës për atdheun, si një ndër ndjenjat më të fuqishme të shpirtit njerëzor. Në këto kushte, kur orientimi programatik i letërsisë ndaj problemeve politike të kohës ishte një domosdoshmëri, artisti u pa si përmbushës i misionit historik në luftën për bashkimin e Italisë. Nëse pikënisja e romantizmit italian lidhet me emrin e një figure të shquar, tërësisht romantike në përkryerjen e saj, me Madame de Staël (Anne Louise Germaine Necker / von Staël-Holstein 1766–1817)<sup>36</sup>, kulmin ai e arrin me kompozitorin Giuseppe Verdi (1813–1901)<sup>37</sup>, në operat e të cilit thyhet pretendimi absolut i individëve romantikë ndaj autoritetit të padiskutueshëm të atdheut. Duke u bërë simbol i lëvizjes për bashkimin e Italisë<sup>38</sup> Verdi arriti të shprehë në muzikë njëkohësisht patriotizmin dhe kultin e ndjenjës së kohës së tij.

Qëllimin e romantizmit në hapësirën shqiptare të shekullit të 19-të Çabej e formulon si vijon: *të përtërihet gjithësia e nacionit, duke filluar që nga alfabeti e gjer te mburjtja e një gjuhe letrare dhe te formimi i një literature të vet, në lëmë politike krijimi i një shteti*.<sup>39</sup> Është një fakt i padiskutueshëm që këtë qëllim De Rada me veprimtarinë e gjithanshme gati një shekullorë e ktheu në detyrë të jetës së tij. Por, a e mishëruan figurat e krijuara prej tij qëllimin e autorit në atë masë që synoi ai? Kujtoj që sot, në harkun kohor të gati dy shekujve, në kushtet e një vlerësimi e rivlerësimi të traditës brenda shembjeve që kanë ndodhur në realitetin shqiptar, pyetja e shtruar më lart është më se e ligjshme. Për më tepër, figurat e krijuara nga një autor jo rrallë dëshmojnë në rrjedhën e viteve një jetë të pavarur, e cila pasqyron më së miri jo vetëm vetëdijen, por dhe nënvetëdijen e krijuesit të tyre, e bashkë me të edhe të kohës që e lindi atë.

Le të ndjekim nën këtë perspektivë zhvillimin e mëtejshëm të Serafinës. Takimi i parë i saj me Bozdarin ka ndezur tek të dy shkëndijën e dashurisë, e një dashurie të penguar, për arsye se dy familjet nga vijnë ata janë në armiqësi me njëra-tjetrën. Pa u përpjekur ta shtjellojë këtë pengesë De Rada i bën me dije lexuesit, menjëherë pas takimit të parë të

<sup>36</sup> Në vitin 1816 ajo boton në numrin e parë të revistës mujore *Biblioteca Italiana* artikullin me titull *Sulla maniera e l'utilità delle traduzioni*. Polemika e shkaktuar nga ky artikull, në të cilin autorja u bënte thirrje bashkëkohësve për zgjerimin e horizontit letrar, shënon lindjen e romantizmit si shkollë letrare në mjedisin italian. Përmes librit të saj *De l'Allemagne*, që kishte botuar në vitin 1810 M. de Staël ishte bërë ndërkohë ndërmjetësja kryesore e ideve të romantizmit gjerman në Itali (Felten, H. etj. (1994) *Italianische Literaturgeschichte*. Stuttgart, f. 260v).

<sup>37</sup> Carsaniga, G. (1970) *Geschichte der italienischen Literatur*. Stuttgart, f. 156.

<sup>38</sup> Verdi quhej nga bashkëkohësit *Vittorio Emanuele Re D'Italia*.

<sup>39</sup> Çabej, E. (1994) Romantizmi në Europë lindore e juglindore dhe në literaturën shqiptare. - në: *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*. Tiranë, f. 97.

dy të dashuruarve, se bashkimi i tyre pengohet dhe nga një arsye madhore: Serafina duhet të martohet me një fisnik tjetër, në mënyrë që shqiptarët të forcohen në luftën kundër turqve për të mbrojtur vendin e tyre.

Pas takimit të parë, ndonëse realisht Serafina dhe Bozdari takohen vetëm tri herë të tjera,<sup>40</sup> ata e bartin njëri-tjetrin me vete në gjithë poemën brenda brengës së tyre, madje edhe përtej tokësore.<sup>41</sup> Bozdari ndjen për Serafinën një pasion të fuqishëm, ai e dashuron dhe e çmon atë, por në të njëjtën kohë edhe e dëshiron.<sup>42</sup> Me ndjeshmërinë e tij të skajshme<sup>43</sup>, me pasionin e tij aktiv, me jetën dhe me vdekjen e tij, Bozdari është ndoshta heroi romantik *par excellence* i De Radës. Kjo vërejtje formësohet nëse bëjmë një krahasim të tij me Nik Dukagjinin. Ky i fundit është thjesht kalorës, një kalorës i mesjetës, brenda së cilës ai nuk ka asnjë mundësi të zhvillohet si individ. Ajo çka e mban në këmbë këtë figurë është vetëm ideja e bashkimit të shqiptarëve, që De Rada dëshiron të përçojë përmes tij. Përkrah tij Serafina mbetet përjetësisht bartëse e vuajtjes së saj. Zbehtësia<sup>44</sup> që i bën hije në fytyrë gjatë gjithë poemës, është gjurma fisnike e kësaj vuajtjeje<sup>45</sup>, në shtjellën e së cilës

<sup>40</sup> Libri i parë / Kënga e katërt; Libri i dytë / Kënga e katërt; Libri i katërt / Kënga e parë.

<sup>41</sup> Libri i katërt / Kënga e katërt / 165–168: Zonjë mos dil kësaj ane / se mos hije e trimit mjerë / n'atë dashuri shtrëngatë / t'i rrëmben të gjitha hiret.

<sup>42</sup> Libri i parë / Këngë e Bozdarit me shokë Serafinës / 8–9: Sa herë e luta, q'ajo, mermer i bardhë / të vinte e duart të m'i hidh në qafë; Libri i parë / Këngë e Bozdarit me shokë Serafinës / 10–11: Përloshëm të më thosh: "Kët'orë pata, / s'kam kujt t'i jap për qafje, veçse ty!"; Libri i parë / Këngë e Bozdarit me shokë Serafinës / 17–18: O gji me ëndje të paprekura, o duar, / edhe ti shtat, që kur më shfaqe, ngazllon dheu!; Libri i parë / Kënga e katërt / 106–110: Por s'do të vijë ajo ditë / kur në hije të ksaj peme, / do të më jepet e gjithë / vasha që desha e s'iu ndashë / që mëngjesin kur e pashë?

<sup>43</sup> Libri i parë / Këngë e Bozdarit me shokë Serafinës / 6–7: Prej syve unë ia vodha zemrën / e s'di në lumë u bëra apo i mjerë; Libri i dytë / Kënga e pestë / 120: brengat e Bozdarit; Libri i dytë / Kënga e gjashtë / 32–34: Shkoi përpara e ushta-urë / brenda i ndizej dhe ia grinte / zemrën tym-e-zjarzburitës; Libri i katërt / Kënga e tretë / 7–8: Dhe sërishmi ai përmblihet / në vetvete dallgë e brengë; Libri i parë / Këngë lamtumire / 23–26: Me shëndet më mbeç! Në hasç në të keqe / jetllën e gërshetit m'ia lidh një lumbadhe / ma nis që nga dera, e si të më zej' hera, / te këmbët e tua, o vashë, kam për t'ardhë.

<sup>44</sup> Libri i parë / Këngë e Nik Dukagjinit vashës së Topiajve / 16: Të zbehtat faqe; Libri i parë / Kënga e gjashtë / 131: buzëzbehtë; Libri i parë / Kënga e gjashtë / 163–165: Edhe ndënë faqet jeta / nisi t'i tretet si dylli / kur rreze dielli i shkrijnë; Libri i dytë / Kënga e katërt / 59: U duk e zbehtë; Libri i dytë / Kënga e shtatë / 93: E bardhë e fytyrëprerë. Libri i parë / Këngë e Bozdarit me shokë Serafinës / 1–2: E zbehtë si asnjëherë e mendjelodhët.

<sup>45</sup> Libri i parë / Kënga e tretë / 80–83: E vasha, vetëm, / ra përmbys shpejt përmbi shtrat / se iu shkreh një vaj me dënësë; Libri i parë / Kënga e dytë / 43: Me buzëqeshje helmi; Libri i parë / Kënga e parë / 98–99: Asnjë ende nuk e di / si shërohen këto ethe; Libri i parë / Kënga e dytë / 18–19: Apo mbase nuk ma thua / brengën që të trazon zemrën?; Libri i parë / Kënga e dytë / 46: Ç'brengë kishte në gji vasha; Libri i parë / Kënga e tretë

ajo shpaloset si individ. E menduar, e trishtuar, e brengosur, bashkë me zemrën<sup>46</sup> ajo i ka falur Bozdarit njëkohësisht fantazinë e saj<sup>47</sup>, s'ka çast që Serafina të mos mendojë për të. Në takimin e tyre të fundit në pallatin e Kastriotëve, pasi Serafina ndërkohë është martuar dhe ka lindur djalë, ajo ndjehet po aq e dashuruar sa në takimin e tyre të parë.<sup>48</sup> Vetëm pas vdekjes së Bozdarit, ajo e quan dashurinë e saj për të: *bota e parë* që *shkoi e vate*.<sup>49</sup> Pikërisht ky moment i fal figurës së Serafinës dhe sakrificës së saj përmasën simbolike në mjedisin arbëror ku jeton,<sup>50</sup> por bashkë me të ajo humb njëkohësisht dhe vrullin e fuqishëm romantik. Pa këtë vrull përkryerja e saj kurrsesi nuk do të kishte marrë udhë. Kjo përkryerje tashmë është ajo e një madone, siç do ta quajë Marchianò.<sup>51</sup> Në të gjitha përthyerjet e përkryerjes së saj, Serafina i fal letërsisë shqipe për herë të parë një përmasë qoftë edhe fare të druajtur të një kulture femërore. Qysh nga viti 1839, kur botohet varianti i parë i Serafinës, emra të tillë si Dora D'Istria, motrat Qiriazzi, Tefta Tashko Koço e Musine Kokalari, po ashtu druajtur do t'i japin frymë dhe shpirt kësaj përmasë.

---

/ 35–36: E ç'më duhen mua vjetët / e një jete kaq të shkretë; Libri i parë / Kënga e tretë / 100: e vetmuar, e brengosur; Libri i parë / Kënga e tretë / 110–112: Vonë vasha fjeti e çkrehur; / n'ëndërr pa veten n'humnerë / të përzier me të vdekur / që pat njohur; Libri i parë / Kënga e katërt / 188: Vasha e ngrysur ndenji te zalli; Libri i parë / Kënga e katërt / 189: brengën; Libri i parë / Kënga e katërt / 193–194: Dukej si mermer i sjellur / në prag jete, por pa shpirt; Libri i parë / Kënga e katërt / 198–199: Shkoi u mbyll fare / n'odë gjumi; Libri i parë / Kënga e katërt / 199–200: Dhe vajtoi / vashërinë e saj të pastër; Libri i parë / Këngë lamtumire / 22: T'i ngushllohet zemra dhe murgës së shkretë; Libri i parë / Kënga e gjashtë / 107: zemrën e zhuritur; Libri i dytë / Kënga e parë / 75–76: Vasha rëndë e plagosur / na u ngrit me tru të zbrazur / dhe me zemrën pa një shpresë; Libri i dytë / Kënga e shtatë / 204–205: E më s'tha, se e mundi dnesa / vaji ia errësoi botën; Libri i dytë / Kënga e tretë / 6: N'heshtje, e vetme; Libri i dytë / kënga e shtatë / 112–113: Në kurm akull dhe në shpirt / ajo dukej engjëll qiejsh.

<sup>46</sup> Libri i parë / Këngë lamtumire / 9–10: Se zemra ime tretet, vjen me ty / të të gjejë zgjuar dhe në gjumë.

<sup>47</sup> Barthes, R. (1984) *Fragmente einer Sprache der Liebe*. Përkthyer nga H.-H. Henschen. (Titulli i origjinalit: *Fragments d'un discours amoureux*, Paris, 1977) Frankfurt am Main, f. 104.

<sup>48</sup> Libri i katërt / Kënga e parë / 84–85: Ashtu rreth e rreth ushtonte / shtroll' i zemrave të tyre.

<sup>49</sup> Libri i katërt / Kënga e katërt / 29.

<sup>50</sup> Libri i parë / Kënga e katërt / 174–175: Ylli ynë i pashojtur / në shtrëngatat që pllakosin!; Libri i parë / Kënga e katërt / 139–14: Zemra jonë nuk tronditet / mjaft që të na japsh flamurin / me brezin tënd t'artë lidhur!; Libri i parë / Kënga e pestë / 19–20: Serafina prijse e mbrëmjes; Libri i parë / Kënga e gjashtë / 167: Nga gjithë e nderuar; Libri i dytë / Kënga e parë / 7: Vasha plot lavd nga Topiajt; Libri i dytë / Kënga e dytë / 84: Vasha, mburja e të gjithë Arbrit; Libri i dytë / Kënga e shtatë / 25: Thesarin e Arbrit; Libri i dytë / Kënga e shtatë / 136–137: Ajo sot nd'Arbreshtë e saj / është hiri i qiejve.

<sup>51</sup> Marchianò, M. (1902), f. 139.

Vasil KRISTO

## EDUKIMI KOMBËTAR GJEOGRAFIK NËPËRMJET TEKSTEVE SHKOLLORE (1912–1939)

Gjatë periudhës 1912–1939 gjeografia e Shqipërisë si lëndë mësimore zhvillohej kryesisht në klasën e tretë të shkollës fillore dhe në klasën e dytë të shkollës së mesme, por njohuri gjeografike për Shqipërinë nxënësit merrnin dhe në klasat e tjera. Deri në vitin 1920 për gjeografinë e Shqipërisë janë përdorur tekstet “*Shcypnija*” botuar më 1902 (pa autor) dhe “*Dheshkroje për Msojtore Popullore e Gjytetnore*” e Gaspër Mikelit (botuar më 1912 dhe ribotuar më 1916). Në periudhën 1920–1939 u botuan edhe 14 tekste shkollore (shih listën në fund). Nga të 15 tekstet e botuar gjatë viteve 1912–1939, 10 ishin për shkollat fillore dhe pesë për shkollat e mesme. Në këto tekste jepen njohuri për gjeografinë e përgjithshme dhe atë botërore sipas të dhënave shkencore të kohës.

Gati të gjitha tekstet e botuara janë pajisur me ilustrime (figura, skica, tabela, grafikë e fotografi për dukuri e objekte gjeografike të ndryshme). Më të pasur e më të kompletuar janë tekstet e prof. Ahmet Gashit dhe te Ismail Anamalit. Në disa prej këtyre teksteve, në fund të çdo mësimi ose teme, jepet dhe një përmbledhje e shkurtër e mësimi si dhe pyetje të ndryshme rreth mësimi. Dallohen për këtë tekstet e Ismail Anamalit. Të gjitha tekstet e botuara gjatë kësaj periudhe dallohen për nivel të lartë shkencor e metodik dhe i përshtaten moshës së nxënësve për të cilët janë hartuar.

Në 11 prej këtyre teksteve, krahas njohurive për gjeografinë e përgjithshme e atë botërore, behet fjalë dhe për gjeografinë e Shqipërisë. Më gjerësisht për gjeografinë e vendit tonë flitet në tekstet: “*Gjeografia për shkollat fillore*” e Dhori Kottit (1920), “*Njoftime Gjeografijet II, për*

---

Vasil Kristo, studiues, gjeograf.



*klasët fillore*” (pa autor), botuar më 1926; *“Atdheu e bota për klasën e katërt”* e autorit Ismail Anamali (1929); *“Dheshkroje..”* e Gasper Mikelit dhe *“Gjeografia e Shqipnis për shkollat normale e të mesme”* e prof. Ahmet Gashit (botuar më 1933 dhe ribotuar më 1937). Ky është i vetmi tekst që i kushtohet tërësisht gjeografisë së vendit tonë.

Po paraqesim shkurtimisht njohuritë gjeografike të teksteve të mësipërme. Teksti *“Gjeografia”* i Dhori Kotit është i pari botim gjeografik pas shpalljes së Pavarësisë, ku gjeografia e Shqipërisë trajtohet gjerësisht. Në fillim të tekstit përmenden kufijtë e Shqipërisë dhe shprehet keqardhja se konferenca e Ambasadorëve në Londër më 1913 e copëtoi Shqipërinë dhe pjesa më e madhe e territorit të saj mbeti jashtë kufirit politik. Mandej përshkruhen pjesët përbërëse të Shqipërisë: *Gegëria ose Shqipëria Veriore* (krahinat e Hasit, Hotit, Grudës, Shkrelit etj.), dhe *Toskëria ose Shqipëria Jugore* (krahina e Dangëllisë, Dëshnicës, Oparit, Mallakastrës etj.). Si kufi midis tyre shërben lumi Shkumbin; jepen të dhëna për detet e gjiret (gjiri i Sarandës, i Vlorës, i Durrësit e i Drinit), malet, lumenjtë e liqenet. Ndër malet përmenden Alpet, Kërraba, malet e Martaneshit, të Oparit, Tomori, Nemërçka, Morava etj., dhe ku shtrihen ata; përshkruhen lumenjtë më të mëdhenj të vendit (Buna, Drini, Mati, Semani e Vjosa), nga burojnë, degët që marrin e ku derdhen; po ashtu të gjitha liqenet e mëdha dhe lagunat bregdetare, duke dhënë veçoritë e tyre gjeografike. Për liqenin e Ohrit shkruhet: *“ka ujën të kulluar fare, nxierr një peshk të mirë që i thonë koran, lekna dhe belushka”*; kurse për liqenin e Shkodrës shkruhet: *“është një liqen mjaft i madh që punojnë vaporet dhe me anën e Bujanës (lumi Buna) udhëtojnë e tregëtojnë me detnë Adriatik. Ka shumë lloje peshk shumë të mirë.”* (fq. 24)

Krahas pjesës fizike përshkruhen të gjitha qytetet (numri i popullsisë dhe veçoritë më karakteristike) dhe një numër fshatrash, jepen të dhëna për popullsinë dhe ekonominë e vendit. Për qytetin e Shkodrës shkruhet: *“Shkodra, m’i madhi i qyteteve të Shqipërisë, me ndërtesa të mira, i bukur dhe fort i motshmë. Ndodhet më anët të kënetës së tij, në krye të Bujanës ku çiket me Drinë. Del duhan i bukur fort dhe me famë. Punohet mëndafshi, armët, argjendi; me 25 mijë ndenjës”* (fq. 24–25); kurse për Beratën shkruhet: *“Qytet i motshmë afër Tomorit mbi lumin që mban emërin e tij. Bën vaj me emër dhe ullinj të mirë; me 14 mijë ndenjës”* (fq. 26).

Më pas jepet numri i popullsisë së Shqipërisë prej 1.100.000 banorë, flitet për gjuhën shqipe që përdoret, duke theksuar se ajo është e pasur, por e papërpunuar, *“është mëma e gjuhëve latine dhe e gërgishtes”*. Fjalët e saj janë rrënjët e gjithë fjalëve europiane. Përmenden të dy fetë kryesore (feja myslimane dhe ajo e krishtere) e numri i tyre, ku më të shumtit janë myslimanët prej 700.000 të ndarë në

synitë dhe bektashinj dhe të krishterët prej 400.000 të ndarë në ortodoksë dhe katolikë. Po këtu, përmendet klima dhe pasuritë e vendit. Flitet me admirim për pasuritë natyrore: “*Vënt i Shqipërisë është i tëri pjellor. Tërë drithërat bëhen më gjithë anët e Shqipërisë me shumicë. Malet e tërë janë veshur me dru e bimë. Që nga Shkodra në Sarandë janë male të tërë të veshur me ullinj.....Malet e Shqipërisë me drurët e gjelbërinë e tyre, na japin shumë qereste dhe ushqim për bagëtinë. Nëpër këto male ndodhen dhe shumë kafshë të egëra për gja*”. (fq. 29).

Për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë flitet shkurt. Autori shpreh keqardhjen se Shqipëria ishte shumë e prapambetur dhe gjendja politike e pastabilizuar (1920). Duke folur për tregtinë, shprehet: “*Shqipëria nuk bën tregëti të madhe. Ndalohet nga puna e rrugëve që nuk janë të bëra. As udhë qerreje, as udhë të hekurta nuk ka, po punohet me kuaj*”, urse për mjeshtëritë (industrinë e artizanatin) shkruhet: “*Mjeshtëria është pothuajse e vdekur fare. As një fabrikë nuk ndodhet që të punohet mjeshtëria, ca të pakëta abrika janë për të blojtur grurë dhe ullinj. Argjëndi punohet në Shkodër... Më të madhen e mjeshtërisë e punon Korça, ku punohet sheqeri fort mirë, lëkurët e këpucë të mira fare*”. (fq. 29–30). Pavarësisht nga gjendja e dobët ekonomike, autori vlerëson zgjuarsinë dhe talentin e Shqiptarëve.

Në tekstin pa emër autori “*Njoftime gjeografijet*” II, në fillim jepen të dhëna për pozitën gjeografike të Shqipërisë në gadishullin e Ballkanit dhe çfarë përfaqësojnë Shqipëria fizike, etnografike (...*asht ajo trevë, banorët e të cilës flasin gjuhën shqype*) dhe politike (... *asht ajo trevë, banorët e të cilës janë nënshtetas të një shtetit të vetun, d.m.th. të republikës shqiptare*”) (fq. 6). Trajtohen me shumë hollësi kushtet fiziko-gjeografike të Shqipërisë brigjet detare, gjiret e kepat më kryesorë të Adriatikut e Jonit, lagunat e Karavastasë dhe Nartës; përshtohen vargjet kryesore malore (shtrirja e pjesët përbërëse). Autori dallon katër vargje malorë. -*Bjeshkët e Shqipërisë së Epër; të gjithë në jug të Prizrenit* (Alpet dhe mali i Pashtrikut në jug të qafës së Morinës). - *Malet e Sharrit* (Koritniku, Gjalica e Lumës, Korabi, Deshati). - *Malet e Gegëve* (nga Drini i bashkuar deri në liqenin e Ohrit; Mali i Shejt, Oroshi, Valamara, Deja e Macukullit, Allamani, Jabllanica). Tregohet se prej tij degëzohen drejt detit shumë male. - *Vargu i Madh që ndan anën perëndimore të gadishullit Ballkanik* (Gramozi, Nemërçka), ku degëzohen disa vargje.

Në këtë kapitull flitet edhe për fushat nga Shkodra deri në Vjosë dhe më pas përshtohen lumenjtë (Buna, Drini, Mati, Erzeni, Ishmi, Shkumbini, Osumi e Devolli dhe Vjosa), nga burojnë, vendet ku kalojnë, degët që marrin e ku derdhen; liqenet (përmasat), vendndodhja (sipërfaqja e liqenit të Shkodrës jepet 350 km<sup>2</sup> dhe e Ohrit 270 km<sup>2</sup>) dhe kënetat e moçalet.

Mbas pjesës fizike jepen të dhëna për numrin dhe dendësinë e popullsisë (sipas tekstit në vitin 1924 popullsia e Shqipërisë ishte 817.468 banorë dhe dendësia e saj 29 banorë/km<sup>2</sup>), për gjuhën shqipe, për besimet fetare (katolike, ortodokse e muhamedane), numrin e përqendrimit më të madh të tyre (në vitin 1924 kishte 560.348 muhamedanë, 172.610 ortodoksë dhe 84.420 katolikë, nga të cilët 68.000 jetonin në prefekturën e Shkodrës). Në fund bëhet fjalë për ndarjen administrative. Përmenden me radhë të 10 prefekturat (jepen të dhëna për shtrirjen hapësinore, pjesët përbërëse (nënprefekturat), numrin e popullsisë etj.). Autori për aq sa e lejonte teksti e mosha e nxënësve, ka dhënë informacionet më të rëndësishme dhe më të nevojshme që nxënësit ta njihnin sa më mirë gjeografinë e Atdheut të tyre.

Në numrin e teksteve për shkollat fillore është dhe *“Atdheu e Bota” i Ismail Anamalit* me mjaft të dhëna për gjeografinë e Shqipërisë. Si edhe në tekstet e mësipërme, në fillim jepet pozita gjeografike, kufijtë, madhësia dhe vazhdohet me kushtet natyrore (relievin, klimën, lumenjtë, liqenet etj.). Kushtet natyrore trajtohen me hollësi. Fillohet me relievin (malet, vargjet malore, rrafshnaltat, kodrat dhe fushat), duke dhënë vendndodhjen, lartësinë mbidetare etj. Autori dallon katër vargje malore: *Bjeshkët e Shqipërisë së Veriut; Vargun që shtrihet në verilindje të Shqipërisë; Malet e Gegëve; Vargun që shtrihet në anën lindore të liqenit të Ohrit*. Shtrirja e këtyre vargjeve gati përputhet me tekstin *“Njoftime Gjeografijet” II*. Në vijim përshkruhen veçoritë e brigjeve detare të Jonit dhe Adriatikut (pamja e brigjeve, gjiret, kepet dhe portet etj.). Në të shkruhet: *“Bregdeti Jon asht shkamb e thik edhe i drejtë. Në këtë breg nuk ka as gjë me randsi as limane të sigurtë. Ktu gjindet vetëm Saranda, qi asht sqela e Gjirokastrës”* (fq. 6). Gjithashtu, trajtohen veçoritë e klimës dhe të hidrografisë (lumenjtë e liqenet). Për klimën analizohen veçoritë e saj dhe faktorët që e kushtëzojnë. Në të shkruhet: *“Shqipnija përgjithësisht klimën e ka të butë, d.m.th., as nuk ka të nxehtë të madh, as të ftohtë të tepërtë, pse gjindet në zonën e butë... Shqipnija asht larg si nga polet qi kanë të ftohtë të math e të gjithmonshëm, ashtu edhe prej Ekuatorit qi ban të ngrohtë të tepërt. Pastaj Shqipnija në njenën anë asht e qarkueme me dete”* (fq. 6),

Duke përshkruar veçoritë e lumenjve, jep vendet nga burojnë, drejtimin, degët, territoret që përshkojnë, ku derdhen, pasojat etj. Për ta shkruhet : *“në Shqipni nuk ka lumenj të gjatë..., shumica burojnë nga malet, kanë lugina të thella e rrjedhje të shpejtë..., nuk lundrohen, dhe në stinët e shirave prej ujit të tepërt nganjëherë gufojnë dhe mbulojnë arat e fushat edhe shkaktajnë dam të madh”* (fq. 7). Përmenden liqeni i Shkodrës (është më i madhi), i Ohrit (është më i bukuri në Ballkan), i Prespës dhe kënetat e Maliqit, Durrësit dhe Tërbufit.

Më pas përshkruhen krahinat e Shqipërisë: Veriore, Lindore, Qendrore dhe Jugore. Për secilën krahinë jepen me fjalë të thjeshta njohuri për karakteristikat e relievit e të klimës, për popullsinë, qytetet dhe ekonominë. Për të parën shkruhet: *“Klima ma e egër e Shqipnis asht klima e ksaj zone... E shumta e banorëve të saj janë malcorë, të cilët merren me bujqësi e me blegtori... Shkodra me 25 mijë banorë, qendra e prefekturës së Shkodrës, asht qyteti ma i madh i Shqipnisë. Në kohna të vjetra Shkodra ka qenë kryeqyteti i Ilirve”*. (fq. 14–15)

Në pjesën e fundit të librit flitet për ekonominë e Shqipërisë (bujqësinë, prodhimet bujqësore, kafshët e pyjet, metalet, industrinë, komunikacionin, tregtinë, eksportin, importin etj.). Autori është përpjekur të japë gjendjen reale të degëve të ekonomisë së vendit në atë periudhë. Për bujqësinë shkruhet: *“Pasunija ma e madhe e Shqipnisë asht bujqësija... Mandej vazhdohet “Bujqësija ma e parë në Shqipni asht kollomboqi (misri) e gruni... Ndër rrethinat e Shkodrës dhe Elbasanit bahet duhan i mirë, i cili pëlqehet shumë në tregjet e huej”* (fq. 19–20).

Duke folur për pasuritë e nëntokës dhe industrinë autori thekson se Shqipëria është e pasur me minerale, por përfitimi prej tyre është i vogël. Në pasuritë nëntokësore përmenden dhe ujërat termominerale (Ilixhat) të Elbasanit. Gjatë trajtimit të industrisë shkruhet se në disa qytete si në Shkodër, Tiranë, Durrës etj., ka filluar jeta industriale dhe punojnë fabrika të pakta (të makaronave, sapunit, miellit, fabrika e çimentos në Shkodër, e tullave në Tiranë etj.). Theksohet se mungon industria e madhe. Në të njëjtën mënyrë trajtohen e analizohen dhe komunikacioni, tregtia e degët e tjera të ekonomisë.

Në prag të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë botohet teksti me titull *“Dheshshkroje për Msojtore Popullore e Gjytetnore”* i Gasper Mikelit. Teksti ishte për shkollat e mesme, ndoshta për Normalen e Elbasanit. Në fillim trajtohen kushtet natyrore, e më gjerësisht brigjet detare, malet e fushat (e Myzeqesë, e Shkodrës, e Kosovës e Korçës), të gjithë lumenjtë (me gjerësisht Drini, Mati, Shkumbini e Vjosa), liqenet dhe klima. Gjatë trajtimit të klimës dhe relievit bëhet dhe rajonizimi klimatik i vendit me dy zona (lindore dhe perëndimore). Te relievi janë dalluar katër vargje malore: *Bjeshkët e Shqipërisë së Sipërme* (ose të Epër), *që fillon nga liqeni i Shkodrës deri në fushën e Kosovës; vargu i Madh i Sharit (Dibra e Poshtme – Kaçanik); malet e Gegëve (në të majtë të Drinit të Zi – liqeni i Ohrit); vargu Malor në lindje të liqenit të Ohrit deri në Pind*.

Në pjesën administrative trajtohen në të gjitha aspektet njësitë administrative (numri i popullsisë, qytetet e historia e tyre, shkollat e objektet e kultit, mjeshtëritë e prodhimet, fiset në to etj.). Jepet çfarë është më karakteristike për secilën njësi e qytet. Për Shkodrën shkruhet: *“Ky gjytet asht i gjanë, i hapët e bukur, i hijshëm, por mjerisht i kputun e*

*i vetnuem prejë krejt Shqypniës, pse s'kaa kurrnji udhë a rrugë qi t'a bashkojnë e t'a perpjekun me tjera gjytete” (fq. 139)*

Në pjesën për ekonominë trajtohen të gjitha degët e saj: kulturat bujqësore, blegtorja, punishtet e fabrikat e pakta e të vogla, prodhimet e tyre, karakteri i tregtisë, gjendja e transportit etj. Autori jep gjendjen reale të ekonomisë së vendit dhe shkaqet e prapambetjes.

Në vitin 1933 botohet teksti “*Gjeografija e Shqipnisë*” me autor prof. A. Gashin. Është i pari tekst që trajton vetëm gjeografinë e Shqipërisë në mënyrë tërësore, më të plotë, më komplekse dhe më me hollësi. Fillimisht jep kufijtë, shtrirjen, madhësinë, duke shprehur brengën dhe keqardhjen për copëtimin e vendit tonë në vitin 1913. Teksti ndahet në tri pjesë: studimi fizik, politik dhe ekonomik.

Në pjesën e parë “studimi fizik“ autori trajton kushtet natyrore. Fillon me malet e vargjet malore, të cilët i grupon në pesë njësi: 1) *Alpet e Shqipërisë së Veriut* (mbi Drinin e Bashkuar: Jezerca (lartësinë më të madhe të Alpeve 2700 m), Radohima, Biga e Gimajt, Kollata, Veletiku etj.). Autori përshkruan dhe fiset (popullsinë) që jetojnë në çdo varg malor. 2) *Vargu Lindor*, që përfshin vargjet në lindje të Drinit të Zi (Koritniku, Gjalica e Lumës, Korabi, Deshati, Mali i Thatë) 3) *Grumbulli Qendror*, i cili shtrihet paralel me vargun lindor nga malësia e Dukagjinit e deri te kënetat e Maliqit. Në qendër ka malësinë e Çermenikës. Përbëhet nga disa vargje: mali Skënderbeut, i Munellës, Bjeshkët e Kushnës – Tërbunit etj., vargu Shebenik – Jabllanicë – Belicë, etj; malësia e Mokrës – malet e Kamje – Llëngës etj. Pjesa perëndimore e tij përfshin trevën Çermenikë – Kolonjë (Çermenikë, Polis, Shpat, Ostrovicë, Moravë, Gramoz etj.). 4) *Vargjet Detare ose Perëndimorë*: Renc – Kakarriq – Krujë – Dajt – kodrat e Kërrabës – Dumre – Mallakastër dhe kodrat e Pojanit. 5) *Vargjet e Shqipërisë së Naltë Jugore*, ku përfshihen: malësia midis Leskovikut e Beratit (Qarishta, Kokojka, Melesini, Tomori etj.); Trebeshinë – Dhëmbel – Nemërçkë; Shëndelli – Lunxheri – Bureto; Mali i Gjerë – Stugarë; mali i Gribës – Kurvelesh; Malet Detare të Delvinës (Kostar – Saraqin – Mile etj.); malësia e Labërisë së Sipërme (Çikë – Lungarë – Karaburun etj.). Përshkruhet dhe pasuria bimë dhe ku përdoret. P.sh. për Vargun Lindor shkruhet: “*Këta male janë të veshun, ma tepër në faqet perëndimore me pyje dushku, ahue dhe pishe; sidomos në Gjalicën e Lumës brezi pyjues shkon deri mbë 2100 m naltësi. Këto përmbajnë edhe kullota të gjana fort, ku janë ngrefun stanet verore të blegtorëve të Lumës e të Dibrës”.* (fq. 7)

Në vijim trajtohen fushat e luginat kryesore të vendit. Ato i klasifikon në këto grupe: *fushat e Shqipnisë së Ulët ose Detike* (rreth Shkodrës, Lezhës, Tiranës e Durrësit; fushat e Elbasanit dhe ato të Myzeqesë); *fushat e luginat e Shqipnisë së Naltë Jugore* (luginat e

Vjosës së Sipërme, Zagorisë, Pogonit, Dropullit e fusha e Delvinës); *fushat dhe luginat e Shqipërisë së Naltë ose të Brendshme* (të Korçës, Devollit të Sipërm, Starovës, Domosdovës, lugina e Drinit të Zi, luginat e Malësisë së Gjakovës dhe rrjedhjes së Sipërme të Matit). Fushat dhe pjesët përbërëse të tyre trajtohen me hollësi: origjina, tiparet morfologjike, hidrografia, moçalet, mushkonjat e malaria, vlerat, kulturat që mbillen e ku përdoren. Për fushën e Lezhës shkruan se është vepër e lumenjve Drin, Mat dhe Ishëm (delta, moçale), kurse për atë të Tiranës shkruan se është fushë e bukur me tokë lymore pjellore, por është e thatë në verë, i mungon humusi. Për Myzeqenë shkruan se është më e madhja në vend (nga Semani në veri të Shkumbinit: fusha e Kavajës) dhe me kënetat më të mëdha (Karavastaja, Tërbufi etj.), që prishin klimën. e saj, Për fushën e Devollit të Sipërm shkruan se është lymore e pjellore, me klimë të shëndetshme dhe ka katunde të pasura e të ndërtuara mirë. Trajtohen dhe lumenjtë, liqenet e kënetat më të mëdha në to. Për lumenjtë jepen: burimi, vendi ku derdhet, degët, territoret nëpër të cilat kalon, prurja e lëngët, vërshimet e pasojat e përmybtjes, erozioni etj. Për liqenet jepen veçoritë më origjinale të tyre. Për liqenin e Pogradecit shkruan: *“Ky liqen merr ujnën e tij të Prespës që asht 130 m ma i naltë; këta ujna rrjedhin ndën dhe e dalin pranë Shën Naumit e Tushemishtit me shumë burime..., asht ndër ma të kthjellëtit e botës, në vende të fella ma se 20 m mund të shifen lehtë peshqit..., zihen ma me shumicë lekna, kresnica, korani, pllasica..., por ma i shijëshmi asht peshku i bardhë që quhet belushkë.”* (fq. 29)

Për klimën përshkruan faktorët që ndikojnë: pozitën gjeografike, detet dhe relievin. Analizon elementet klimatike (temperaturat mujore e vjetore sipas krahinave, maksimalet e minimalet, llojet e sasinë e reshjeve, vranësirën e erërat, rolin e pasojat negative). Autori bën klasifikimin klimatik të Shqipërisë: mesdhetare detare dhe mesdhetare kontinentale e jep dhe karakteristikat e tyre. Flet për botën bimore, dëmtimin e mbrojtjen e saj.

Në pjesën e dytë “Studimi politik i Shqipërisë” flet për racën shqiptare (ilire), veshjet popullore e doket e popullsisë së Shqipërisë, të Gegëve e Toskëve; numri dhe shpërndarja e popullsisë në Shqipëri e jashtë saj; vendbanimet (fshatrat e qytetet: më 1933 kishte 2578 fshatra dhe 28 qytete); banesa dhe familja e bujkut është e madhe; përshkruan pazarin e qyteteve, dyqanet e farkëtarëve, këpucarëve, rrobaqepësve etj. Me hollësi jepet ndarja administrative (10 prefekturat, nënprefekturat e komunat: historia, objektet e kultit, muzetë, rrugët, punishtet e fabrikat, ngjarjet historike, njerëzit e shquar, shkollat e hapura etj.).

Në pjesën e tretë “Studimi ekonomik i Shqipërisë” analizohet gjendja ekonomike e vendit dhe degët e saj në të gjitha aspektet. Kështu analizohen me radhë kulturat bujqësore që mbillen, sipërfaqet që zënë,

prodhimi vjetor, përhapja gjeografike e tyre, etj. Sipas A. Gashit në Myzeqe e fushën e Korçës kultivohen gruri e misri. Agrumet mbillen në Rivierë e Elbasan, ullinj të në Vlorë, Berat etj. Një pjesë e madhe e fushës së Tiranës përdoret për kullota e livadhe, se s'ka kanale. Analizohet blegtoaria (llojet, numri, përhapja gjeografike, prodhimi etj.), peshkimi dhe pyjet, duke shënuar se janë të prapambetura. Më pas trajtohen pasuritë minerare, industria, transporti, tregtia, kultura etj., duke shënuar se janë të vogla e të pakta; rrugët midis qyteteve, urat, pazaret, eksportet etj.

Për pasuritë minerare përmenden sera në Selenicë, qymyrguri në Drenovë e Kërrabë, kromi, bakri, hekuri etj. dhe llixhat e Elbasanit. Gjithashtu jep gjendjen e arsimit në Shqipëri. Në 1932 kishte 540 shkolla fillore (mbi 40 mijë nxënës) dhe 10 të mesme (4 mijë nxënës).

Në të gjitha tekstet e sipërpërmendura vihet re dëshira e madhe e autorëve për të dhënë sa më tepër njohuri për gjeografinë e vendit, duke pasur parasysh ciklin shkollor. Një nga qëllimet kryesore ishte që nxënësit ta njihnin sa më mirë Atdheun, pasuritë e bukuritë natyrore të tij, ta donin atë. Koha tregoi se përkushtimi i tyre u vlejti shumë të gjithë brezave që mësuan me këto tekste. Tradita vazhdoi dhe vazhdon, por zhvillimet e reja kanë kërkuar që edhe tekstet e Gjeografisë të pësojnë ndryshime, duke iu përshtatur atyre. Të gjithë brezat që kanë mësuar me ato tekste dhe ne të tjerët, kemi respekt e mirënjohje për përkushtimin e veprën e madhe të autorëve të tyre në dobi të edukimit kombëtar nëpërmjet teksteve të gjeografisë shkollore.

### **Lista e librave gjeografikë të botuar në periudhën 1912–1939**

1. Mikeli, Gaspër: "Dheshkroje për msojtoje popullore e gjytetnore", Shkodër, 1912. 191 fq.
2. Koti, Dhori: "Gjeografi për shkollat fillore", Korçë, 1920, 64 fq.
3. "Njoftime gjeografijet për klasët fillore" I. Shkodër, 1926, 27 fq.
4. "Njoftime gjeografijet për klasët fillore" II. Shkodër, 1926, 38 fq.
5. "Njoftime gjeografijet për klasët fillore" III. Shkodër, 1926, 39 fq.
6. Ikonomi, Perikli: "Atdheshkronja praktike për klasët e ulëta të shkollave fillore". Tiranë, 1926, 36 fq.
7. Paluca, Ndue: "Gjeografi për shkolla të mjesme", Pjesa e I, Tiranë, 1927, fq. 84.
8. Pejani, Sadi: "Gjeografi e punueme për klasë te nalta të fillores". Tiranë, 1929, 43 fq.
9. Anamali, Ismail: "Atdheu e bota". Për klasët e treta të shkollës fillore, Tiranë, 1929, 46 fq.
10. Anamali Ismail: "Atdheu e bota". Për klasët e katërta të shkollës fillore, Tiranë, 1929, 36 fq.
11. Paluca Ndue: "Gjeografi për shkolla të mjesme", Pjesa e III. Tiranë, 1930, 91 fq.
- 12: Ikonomi Perikli: "Atdheshkronja e plotë". Për të III-tën dhe të IV-tën klasë të shkollave fillore, Korçë, 1932, 92 fq.
13. Gashi Ahmet: "Gjeografija e Shqipnis" Për shkollat normale e të mesme. Tiranë, 1933, 112 fq.
14. Gashi Ahmet. "Gjeografija e Përgjithshme." Për rendin e parë të shkollave qytetse edhe të mesme. Tiranë, 1935, 167 fq.
15. Çomo Emin: "Gjeografi për klasën e pestë të shkollave fillore", Vlorë, 1937, 116 fq.



**Merita KOKA-KARAGUNI**

## **MIGRIMI DHE TIPARET E TIJ NË QYTETIN E TIRANËS (1945–2002)**

Rritja e madhe e popullsisë që ka pësuar qyteti i Tiranës dhe ritmet shumë të larta me të cilat kjo popullsi ka ndryshuar dhe po ndryshon, të shtyjnë të gjykosh për rëndësinë që kanë studimi i elementeve dhe i faktorëve kryesorë të këtij ndryshimi. Ndër ta do të veçojmë: rritjen natyrore të popullsisë dhe popullsinë migruese që rezulton nga diferenca midis ardhjeve e largimeve në Tiranë. Pavarësisht nga ndryshimi i të dhënave të regjistrimit zyrtar të popullsisë të INSTAT, nga të dhënat e zyrës së gjendjes civile të Bashkisë së Tiranës, rezulton se rritja është e dukshme.

Për të gjykuar për këtë rritje dhe për elementet kryesore të saj, vetëm të dhënat e siguruara nga Bashkia krijojnë mundësi për krahasime dhe analizë të ecurisë së ndryshimit të numrit të popullsisë në njësitë administrative të Tiranës. Ato janë, vit pas viti, ndryshe nga të dhënat që ofrohen nga regjistrimi i popullsisë të INSTAT, të cilat tregojnë momentin e regjistrimit. Nga studimet e deritanishme (2) ka rezultuar se peshën më të madhe në këtë ndryshim të numrit të popullsisë, e ka rritja migratore (popullsia e ardhur). Rritja e numrit të popullsisë është më fort pasojë e lëvizjes migruese sesa e shtesës natyrore të saj. Por këto studime arrijnë deri në vitin 1997, madje janë të pakta.

Objekt i këtij artikulli është analiza e rritjes së popullsisë së qytetit të Tiranës në vitet 1996–2002. Kjo kushtëzohet nga mundësia e këndvështrimit krahasues midis njërive administrative të krijuara rishtazi në fillim të viteve '90. Kësaj i duhet shtuar edhe fakti që në këtë periudhë popullsia e Tiranës është shtuar ndjeshëm, krahasuar me

---

Merita Koka-Karaguni, studiuese, pedagoge në Departamentin e Gjeografisë të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

periudhat pararendëse (4). Për të kryer këtë analizë na është dashur të bëjmë përpunimin e statistikave të gjendjes civile të Bashkisë së Tiranës, muaj pas muaji për vitet 1996–2000.

### **Migrimi në vitet 1945–1990**

Në përgjithësi, ndryshimi i numrit të popullsisë së rrethit të Tiranës mund të kategorizohet në disa etapa (3). Nga viti i parë i regjistrimit (1923) deri në vitin e parë të pasqirimit (1945) (22 vjet) popullsia u rrit rreth 3 herë në shkallë rrethi, 5,5 herë në qytet dhe rreth 2 herë në fshat. Ritmi mesatar vjetor i rritjes së popullsisë së rrethit në periudhën 1923–1938 ishte 3,25%, ndërsa ai i qytetit 5,7%. Gjatë periudhës vijuese (1938–1945) popullsia qytetare rritet mesatarisht 13,2% në vit. Kjo rritjesh shpjegohet me faktin se Tirana është kryeqytet i vendit, gjë që ndikoi edhe në zhvillimin e saj ekonomik-administrativ-demografik krahasuar me rrethet e tjera.

Në periudhën 1945–1950, kohë kur vendi ishte në fazën e rindërtimit e të zhdukjes së pasojave të luftës, ritmi mesatar vjetor i rritjes së popullsisë për qytetin e Tiranës ishte 1,5%. Rolin kryesor e luante shtesa natyrore (3). Në periudhën 1951–1985 intensiteti i shtimit të popullsisë rritet, dhe në këtë mes ndikimin më të madh e ka kryesisht lëvizja mekanike e popullsisë (të ardhurit) në qytetin e Tiranës (3). Në vitet 1951–1955 ritmi mesatar i rritjes së popullsisë në qytet arriti në 11,0% në vit (nga 1,5% në vitet 1945–1950). Sa i përket strukturës së popullsisë si rreth, popullsia qytetare zinte rreth 70%. Në shtesën e përgjithshme të popullsisë (viti 1955) në shkallë rrethi lëvizja migratore e ndikonte me 55%, ndërsa për qytetin 81%.

Shtesa e lartë natyrore e popullsisë së rrethit pati rol të madh në plotësimin e nevojave me fuqi punëtore, duke ndikuar në një ulje relative të imigrimit (3) krahas rritjes së nivelit të mekanizimit të punëve në degët e ekonomisë së rrethit, por edhe përpjekjet për zhdukjen e dallimeve fshat–qytet në fushën social-kulturore, kontrolli mbi lëvizjen mekanike të popullsisë etj. Nga viti 1955 e më tej ritmi mesatar i rritjes vjetore të popullsisë së qytetit do të ulet deri në vlerën 0,7%, por rritet në 2,2% në vitet 1981–1985. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ndikimin e shtesës migruese me ulje deri 14% të asaj vjetore në vitin 1979. Në vitet 1981–1985 rifillon rritja graduale 22–25%. Në qytet migrimi ndaj shtesës vjetore shënoi pikën më të ulët në vitin 1979 me 20%, por u rrit në vitet 1981–1985 me 39–46% (3).

## Migrimi gjatë periudhës së tranzicionit


Deri në vitin 1987 ritmi i rritjes së popullsisë së qytetit të Tiranës luhatej rreth 2% dhe mbizotëroi shtimi natyror ndaj saldos migruese. Më pas, sidomos në vitet 1988–1999 (2), ritmi i rritjes arrin rreth 4%. Rolin kryesor e pati saldoja migruese, e cila ndryshoi nga 0,8–1,1% (1981–1987) në rreth 3% (1987–1989).

Tabloja e ndryshimit të ritmeve të rritjes së popullsisë urbane paraqitet krejt e ndryshme pas vitit 1992, kur ritmet janë të larta (2). Kjo duket në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 1. Koeficientet e rritjes së popullsisë 1993–1997 (2)**

Viti	Koeficienti i rritjes	Koeficienti i shtimit natyror	Koeficienti i saldos migruese
1993	4,6	0,9	3,7
1994	20,3	0,9	19,4
1995	3,5	0,8	2,7
1996	15,8	0,7	15,1
1997	3,9	0,7	3,2

Studimet pas vitit 1990 tregojnë se është saldoja migruese ajo ka luajtur rolin kryesor në rritjen e popullsisë deri në vitin 1997. Në vitet 1996–1997 ajo ka përbërë 92,9% të shtesës së përgjithshme të popullsisë (2). Për periudhën 1996–2002 ky tregues ka këto karakteristika: në të gjitha njësitë, rritja migratore mbizotëron ndaj shtimit natyror; kufijtë e skajshëm të saj luhaten nga 68,5% në njësinë administrative nr. 1, në 95,2% në njësinë administrative nr. 5; shtimi natyror në këto njësi përbën edhe kufijtë e skajshëm të shpërndarjes së tij sipas njësive, duke arritur nivelin më të lartë në njësinë nr. 1 dhe më të ulët në atë nr. 5. Kjo gjë shprehet në grafikun e mëposhtëm.



Për të treguar rritjen migratore ndaj asaj të përgjithshme në njësitë administrative, i drejtohem i dhënave të tabelës në vijim.

**Tabela 2. Klasifikimi i njësive sipas përpjesës që zë rritja migratore në rritjen e përgjithshme**

Rritja migratore (%)	Njësiti administrative (Tiranë)
0–40%	–
40–80%	XI, VIII, III, I
>80%	V, X, II, VII, IV, IX, VI

Ardhjet më të shumta në numër i kanë njësitet nr. 4 e 11, përkatësisht 16.521 banorë dhe 16.162 banorë, të ndjekura nga njësitet nr. 6, 5, 2, 7, 1. Të ardhurit janë vendosur kryesisht në pjesët periferike të qytetit. Largimet më të shumta në numër absolut u përkasin njësive nr. 1, 4, 3 e 11 (nga 4042 deri në 6775 banorë). Tri njësitet e para me numër të konsiderueshëm të larguarish ndodhen në pjesën lindore të qytetit, ndërkohë njësitet më pëlqyera janë kryesisht në atë perëndimore. Ndryshueshmëria e koeficienteve të emigrimit e imigrimit midis njësive administrative krijon mundësi krahasimi dhe evidentimi të njësive administrative ku fenomeni që përfaqëson koeficienti përkatës, është më i shprehur.


**Tabela 3. Imigrimi, emigrimi dhe rritja migratore 1997–2002 (në<sup>0</sup>/00)**

	Imigrimi	Emigrimi	Rritja migratore
Njësia 1	29,2	16,9	12,3
Njësia 2	68,5	13,2	55,3
Njësia 3	40,7	25,5	15,2
Njësia 4	54,3	14,9	39,4
Njësia 5	45,4	9,5	35,9
Njësia 6	63,4	12,1	51,3
Njësia 7	51,4	10,4	41,0
Njësia 8	33,2	14,7	18,5
Njësia 9	43,9	9,5	34,4
Njësia 10	24,1	12,6	11,5
Njësia 11	60,5	15,1	45,4

Sipas të dhënave në tabelë arrijmë në përfundimin se:

Njësitë II, IV, VI, VII dhe XI kanë pasur koeficientet më të larta të imigrimit, po kështu dhe të larguarit. Niveli më i ulët i rritjes migratore i përket njësisë nr. 10.

Duke analizuar, statistikat e bashkisë për strukturën e të ardhurve sipas vendbanimit, vihet re se në qytetin e Tiranës, në përgjithësi, të ardhurit nga zonat rurale përbëjnë 32,5% të numrit të të ardhurve, ndërsa 67,5% vijnë nga qytete të tjera. Pesha specifike i kalon 50% në njësitë VI dhe XI. Grafiku i mëposhtëm tregon këtë tregues në çdo njësi.



Të ardhurit nga qytetet kanë synuar njësitë X, V, II, III (më pranë qendrës), ndërsa ata nga zonat rurale njësitë VI, XI: ish-Kombinati, Laprakë e Kodër-Kamzë, ku mjedisi fizik është më pranë atij rural, i ngjashëm me vendin e origjinës. Faktorë të tjerë mund të jenë: vlera më ulët e çmimit të tokës, e qirave të banesave apo mundësia për të ndërtuar në mënyrë ilegale në hapësira përkohësisht “të lira”. Ardhjet nga jashtë rrethit, gati mbizotërojnë në çdo njësi ndaj atyre nga brenda rrethit. Për Tiranën përbëjnë 68,4% të totalit të të ardhurve. Për shifrën më të lartë dallojnë njësia nr. 11 (82,1%), ndërsa për më të ulët ajo nr. 2 (46,5%). Ardhjet nga brenda rrethit Tiranë janë më të larta në njësitë 2, 3, 11 e pjesërisht në ato që shtrihen dukshëm pranë qendrës: njësitë 1, 7, 9. Në fakt, në statistikat nuk ka regjistrime për të ardhurit nga brenda qytetit, se janë përfshirë në regjistrimin e të ardhurve nga brenda rrethit. Është provuar (2) se pjesa më e madhe e kësaj kategorie vijnë nga njësitë brendapërbrenda qytetit. Ndër të ardhurit nga fshatrat mbizotërojnë ata nga jashtë rrethit, ku njësia nr. 2 është ajo që ka përqindjen më të ulët (60,8%) dhe njësia nr. 5 më të lartën (86,4%). E njëjta gjë vërehet edhe në ardhjet nga qytetet, ku mbizotërojnë qytetet jashtë rrethit (51,7% në njësinë nr. 10 dhe 79,2% njësia nr. 11). Bëjnë përjashtim njësitë nr. 2 e 3, ku mbizotëron popullsia e ardhur nga qytetet brenda rrethit: Vorë, Kërrabë dhe Kamzë (3).

Në strukturën gjinore të të ardhurve ka një mbizotërim të lehtë të femrave ndaj totalit në të gjitha njësitë (51,8% njësia 6 deri në 56,8%

njësia 10), ndërsa femrat e ardhura nga qytetet mbizotërojnë në njësitë më pranë qendrës. Kjo ndodh, ndoshta se femrat qytetare janë më të pavarura e migrojnë edhe të vetme në kërkim të punësimit më fitimprurës, për prestigj social më të lartë etj. Klasifikimi i njësive administrative, sipas këtij treguesi shprehet në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 4. Përpjesa e femrave të ardhura nga qytetet, sipas njësive, 1996–2002**

Përpjesa (%)	Njësitë administrative
< 50 %	11, 6
50–60%	–
60–70%	4
70–80%	1,2,3,7,8,9
80–90%	5, 10

Meshkujt e ardhur nga qytetet përbëjnë mbi 50% të totalit të atyre të ardhur, përveç njësive 6 e 11, ku mbizotërojnë meshkujt e ardhur nga fshatrat. (Shiko tabelën e mëposhtme).

**Tabela 5. Përpjesa e meshkujve të ardhur nga qytetet, sipas njësive, 1996–2002**

Përpjesa (%)	Njësitë administrative
< 50 %	11, 6
50–60%	–
60–70%	1, 4
70–80%	2, 3, 7, 8, 9
80–90%	5, 10

Sic shihet, prirja e migrantëve (meshkuj e femra) të ardhur nga qytetet drejt njësive më pranë qendrës është e dukshme, përveç njësive nr. 1, më e preferuar nga meshkujt. Ndoshta kjo lidhet me migrimin e tyre edhe të vetëm në këtë zonë, me largësinë prej periferisë ose me strukturën gjinore të familjeve të ardhura (familje me shumë meshkuj). Në totalin e ardhjeve femrat e zonave rurale zënë përqindjen më të madhe në njësitë 6 e 11 (28,7% e 28,5%), ndërsa ato të zonave urbane pëlqejnë më shumë në njësitë nr. 10 (49,4%), nr. 5 (46,4%), nr. 3 (43,4%), nr. 9 (41,4%), nr. 2 e nr. 7 (41,1%). Në totalin e ardhjeve, meshkujt e ardhur nga qytetet janë më të shumtë në njësitë nr. 5 (38,3%), 10 (36,9%), nr. 2 (35,1%), nr. 7 (35%), nr. 9 (34,5%). I dukshëm është mbizotërimi i femrave qytetare

të ardhura në të gjitha njësitë dhe në qytetin e Tiranës në tërësi (37%). Vetëm njësitë administrative 6 e 11 kanë baraspeshë femra – meshkuj të ardhur nga zonat rurale dhe ato urbane.

Natyrisht, në rritjen migratore ndikojnë edhe largimet, por përqendrimi tek ardhjet e popullsisë është i justifikueshëm, sepse ato i kanë dhënë kahun pozitiv lëvizjes migruese. Nga të dhënat e Bashkisë së Tiranës rezulton se të larguarit, më shpesh, synojnë vendosjen brenda rrethit (89,2%) dhe mbi 90% pëlqejnë njësitë administrative 1, 2, 3, 5 dhe 10. Në raport me totalin e të larguarve 10,2% e përbëjnë ata që shkojnë drejt fshatrave. Nga të dhënat ka rezultuar se femrat përbëjnë 59,4% më shumë në njësitë administrative 5, 6, 7, 8, 9, 10. Zgjerimi i informacionit statistikor mbi lëvizjet e popullsisë në Bashkinë e Tiranës, do të ndihmonte më shumë në evidentimin e lëvizjes brenda Tiranës dhe drejt qyteteve të tjera (brenda apo jashtë rrethit të Tiranës).

Nga analiza e mësipërme rezulton se: në të gjitha njësitë administrative të qytetit të Tiranës, rritja migratore mbizotëron mbi atë natyrore, por vlera ndryshon nga njëra njësi në tjetrën; të ardhurit nga zonat urbane pëlqejnë më shumë njësitë 10, 5, 2, 3, ndërsa ata nga zonat rurale njësitë 6, 11; struktura gjinore e të ardhurve, mbizotërohet lehtë nga femrat; shumica e të larguarve shkojnë drejt qyteteve.


## Literatura

Dumani, Bukuri, “Profili demografik i Tiranës dhe lëvizja migruese”, *Ekonomia e tranzicioni* (Tiranë), 1998, f. 63–68.

Karaguni, Merita & Dumani, Bukuri, *Tirana: Reliev demo-ekonomik e social*. ILAR, Tiranë, 2005, f. 38–60

Yzeiri, E. & Pustina L., *Migrimi i popullsisë në rrethin e Tiranës dhe probleme të përputhjes së tij me zhvillimin ekonomik-shoqëror të rrethit* (Raport). Tiranë, 1985, 15 f.

Të dhëna nga zyra e gjendjes civile në Bashkinë e Tiranës (1997–2002).



# IRANOLOGJI





**Muhammad Xhafer JAHAKI**

## **KULMI DHE EKUILIBRI NË LETËRSINË PERSE<sup>1</sup>**

### **Koha dhe vendi**

Në këtë kohë kemi të bëjmë me dy ngjarje të mëdha historike, me kryqëzatat në Azinë e Vogël dhe me mësymjen e përgjithshme tartare mbi tokat perse, që nisi aty rreth vitit 618 hixhri kamari (1221). Këta faktorë historikë ndikuan në përhapjen e gjuhës dhe të kulturës perse jashtë kufijve të vendit. Për këtë arsye periudha e Saadiut quhet ndryshe edhe periudha e zgjerimit dhe e përhapjes së gjuhës dhe kulturës perse.

Periudha e Saadiut përkon edhe me periudhën e rënies së perandorive, madje edhe me shkatërrimin e fuqisë shpirtërore të kalifatit arab të Bagdadit.

Në këtë periudhë zgjerimi i gjuhës perse jashtë kufijve gjeografikë vendas arriti kulmin. Në qoftë se më përpara gjuha perse zhvillohej vetëm përbrenda Persisë në këtë periudhë jo vetëm që kemi të bëjmë me një zhvillim të brendshëm të gjuhës perse, por arrijmë të gjejmë edhe qendra të tjera (qytete), që lëvronin gjuhën perse, si për shembull, Konia dhe Dahali që janë jashtë kufijve persianë.

Periudha e Saadiut ka të bëjë me kohën e mungesës relative të tregut të kasideve dhe ringjalljes së vlerave të gazaleve. Në qoftë se në periudhën e Enverit<sup>2</sup> kasidetë mbizotëronin në numër krahasuar me

---

<sup>1</sup> Marrë nga libri “Historia e letërsisë iraniane”, botim i Fondacionit Kulturor “Saadi Shirazi”, Tiranë, 2012.

<sup>2</sup> Enveri “Anvari” [1126-1189], Avhad al-Din Muhammad ibn Muhammed Anvari, ose (Alī ibn Muhammed Anvari) i njohur me pseudonimin “Enveri i Abivardit” ka lindur në Abivard, (Turkmenistani i sotëm) në vitin 1126 dhe vdiq në vitin 1189, (në Balkh të

gazalet, tashmë ndodh e kundërta se janë gazalet ato që mbizotërojnë rrethet intelektuale vendase. Po ashtu në këtë periudhë kemi të bëjmë me prezantimin e emrit të poetit ose të mbiemrit të tij zakonisht në dy vargjet e fundit të gazaleve, gjë që nuk bëhej më përpara. Pra, me pak fjalë, gjithçka në lidhje me identitetin e poetit dhe të poezisë së tij regjistrohej në gazalet e kësaj periudhe. Bile poetët e kësaj periudhë arritën deri aty sa të tregonin që poezia e vërtetë ishte gazal.

Në poezinë e periudhës së Saadiut procesi i ringjalljes së kasideve ndalet, por ato nuk vdesin, por përkundrazi kemi të bëjmë me një transformim të tyre, pra ato vetëm sa ndryshojnë drejtim. Në këtë periudhë nuk ndeshemi as me thatësirën dhe as me plogështinë e gjuhës dhe të fjalës në poezinë e fillimit të Kharasanit, ku kemi parasysht periudhën e Ferdusit dhe të Naser Khosros, dhe as me futjen e fjalëve arabe të periudhës së Enverit.

Në periudhën e Saadiut poezia dhe kultura perse e të folurit mbështetet mbi të njëjtat baza folklorike, të cilat Ferdusi i ngjizi në periudhën e vet me anë të epopesë kombëtare. Dituria e periudhës së Saadiut mbështetet në përvojën, rregulloren shoqërore si dhe në ndjenjat mbarëpopullore të asaj kohe. Një pjesë e saj ka të bëjë me njohjen e shoqërisë dhe me mjedisin e jashtëm, ndërsa pjesa tjetër ka të bëjë me njohjen e brendshme të njeriut si dhe me rinjohjen e përmasave shpirtërore të poetit. Përballë pjesës së parë të diturisë, që përmendëm më lart, mund të vendosim *Bostanin* nga poezitë e Saadiut, kurse për sa i përket pjesës së dytë të kësaj diturie janë gazalet e ndjeshme *nagz* ato që mund t'i vëmë përkrah, ku më të shquarat prej tyre në këtë periudhë mund t'i gjejmë te *Përmbledhja e Saadiut*. A mundet ta konsiderojmë *Bostanin*, i cili është libri më mësimdhënës dhe njerinjohës i periudhës së Saadiut, si një “epope shoqërore”? Në poezinë dhe në letërsinë e kësaj periudhe pa dyshim që Saadiu është në kulmin e madhësisë dhe të ekuilibrit dhe kushdo tjetër përveç tij është më poshtë se ai. Në këtë periudhë do të trajtojmë gjithashtu edhe dy poetë të tjerë të letërsisë perse.

### **Zahir Farabi dhe lloji i gazaleve**

Farabi është një nga fshatrat e Xhuzxonit në përfundim të Xhejhunit dhe që ishte larg Balkhit gjashtë kilometra. Zahir Aladini, që

---

Khorasanit [rajon që ndodhet sot në Afganistan]). Enveri në Iran konsiderohet si mjeshtri i kasideve dhe si një prej panegjiristëve më të mëdhenj të letërsisë persiane. Ai përveçse ishte i njohur si poet, muzikant dhe kaligrafist, ishte i aftë edhe në fusha të tjera si gjeometri, astronomi dhe astrologji.

më vonë u quajt “Farabi” lindi pikërisht në këtë fshat aty nga mesi i shekullit të gjashtë hixhri kamari (shekulli XII).

Periudhën e rinisë poeti e kaloi në fshatin e lindjes dhe në Nejshabur duke mësuar shkencat e kohës. Këtu vlen për t’u theksuar se shpirti i tij poetik filloi nga ky qytet. Zahiri, përveç njohurive të mira që kishte në lidhje me artin, shkencën dhe letërsinë merrej gjithashtu edhe me astronomi. Në vitin 572 hixhri kamari (1177) Zahiri largohet nga Nejshaburi ku fillimisht shkon në Esfehan dhe pas dy vjetësh udhëton për në Mazandaran dhe me pas për në Azerbajxhan.

### Saadiu prijësi i zotëruesve të fjalës

Në qoftë se do të pranojmë se hapësira e gjuhës perse ka vetëm një prijës të përkryer oratorie, ose një mjeshtër të vetëm fjale, ky është pa dyshim sheiku Maslah Aladin Saadi Shirazi. Themi fjala perse dhe jo poezia perse, për arsye se Saadiut nuk u dallua vetëm në poezi, por ai me kryeveprën e tij, *Gjylstani* edhe në prozë mbetet ende pa konkurrent. Pikërisht për këtë arsye shkrimtari-poet dhe poeti-shkrimtar Saadi quhet ndryshe edhe prijësi i gjuhës perse.

Ky prijës i përsosur çfarë bëri që arriti në një shkallë dhe në një përsosmëri të tillë? Fama dhe rëndësia e këtyre prijësve të mëdhenj, që në të vërtetë, është pjesë e historisë kombëtare, madje edhe më gjerë, është e vështirë për t’u treguar drejt, sepse është një rrezatim i fuqishëm njerëzor. Në qoftë se do të donim t’u tregonim të tjerëve për jetën e Saadiut, duhet të shpreheshim kështu:

Emri i tij i vërtetë është Maslah, mbiemri Mashruf Aladin, kurse autorësia që mbajnë poezitë e tij është Saadi. Normalisht mendohet se emri Saadi rrjedh nga emri Saad Ben Abu Bekr, gjysh Salgri në kohën e vet. Disa kërkues të tjerë dëshmojnë se ka të ngjarë që ky emër rrjedh nga stërgjyshërit e tij të hershëm, që mendohet se janë nga fisi Bani Saad në kohën e profetit të islamit, dhe që atëherë ky emër ka shërbyer si mbiemër për brezat e ardhshëm.

Maslahi lindi aty rreth vitit 606 hixhri kamari (1210) në qytetin e gëzueshëm të Shirazit në një familje, siç pohon edhe ai vetë “të mbushur me dijetarë fetarë”. Në këtë periudhë shkatërruesit mongolë ende nuk kishin mësyrë në tokat perse, ku mbretëronte qetësia dhe lulëzimi. Por disa vite më vonë sulmi mongol, që ishte parashikuar plotësisht, e bën djalin e vogël të humbasë qetësinë dhe të mbetet jetim nga i ati. Po ashtu tek ai mbeten kujtimet e një Shirazi magjepsës, ai kujton më së miri madhështinë dhe bukurinë e këtij qyteti dhe gjithmonë e ruan të freskët në kujtesën e tij. Fatkeqësisht ai nuk u ndikua dot nga mendimet e të atit,

i cili ishte në atë kohë një nga mendimtarët më të mëdhenj të shekullit të shtatë hixhri kamari (shekulli XIII), në mënyrë që të mbushte zbrazëtinë natyrore të fëmijërisë së tij. Në këto kushte Saadiu ndërmerr një udhëtim të gjatë e të mbushur plot ndodhira mësimdhënëse dhe përvoja. Ai mësimet e para i kishte marrë në vendlindje, por gjithsesi në këto kushte detyrohet aty rreth vitit 620 hixhri kamari (1223), që i bie dy, ose tre vjet pas sulmit shkatërrues mongol mbi zonën lindore të Iranit, të zgjedhë Bagdadin si vendqëndrim për vazhdimin e studimeve të tij. Ai në atë kohë botën e konsideronte, siç na thotë edhe vetë, si një fije floku të shprishur.

Saadiu jetoi përkohësisht në Bagdad sepse befas i lindi dëshira për të përfituar me tepër përvojë njerëzore me anë të udhëtimeve, që në atë kohe ishte e vetmja mënyrë për t'u njohur me traditat dhe zakonet e fiseve dhe të popujve të ndryshëm. Kështu që shpejt e lë Bagdadin dhe ndërmerr edhe një udhëtim tjetër mbi tokat e pamasa arabe.

Plot 35 vjetët shpenzoi Saadiu për udhëtimet e tija përvojës-jellëse, por këto nuk ishin të gjitha në tokat arabe. Mendohet se ai duhet të këtë qenë në Romë si edhe në vendet lindore islamike. Edhe në qoftë se këto udhëtime nuk do të jenë të vërteta, dhe disa prej tyre t'i konsiderojmë si fantazi krijuese e poetike të tij, përsëri nuk mund ta mohojmë se ai ka shpenzuar një pjesë të madhe të kohës në udhëtime të ndryshme. Në fillimet e tij ai lë Shirazin, me qëllim që të gjejë një vend të qetë për të banuar. Por sado që kërkon, nuk e gjen dot vendin e dëshiruar dhe kështu pas 35 vjetëve, i lodhur, me plaçkat e shtëpisë mbi shpatulla, vendos të rikthehet në Shirazin e zemrës. Tashmë ai ishte rreth të pesëdhjetave.

Shirazi në kohën kur u kthye Saadiu administrohej nga Atabak Abubekriu, djali i Saad Zangut, për të cilin dhe për familjen e tij emri dhe fama e Saadiut ishin të njohur. Këta Atabakët kishin arritur që me anë të politikave, ryshfeteve dhe manovrave të tjera të ngjashme, ta shpëtonin deri diku Shirazin nga sulmi i zjarhtë i tartarëve. Në këtë kontekst ata kishin krijuar një ishull të sigurt për poetët dhe për këdo që lëvronte në fushën e letrave.

Vitet e fundit prodhimtare Saadiu i kaloi në Shiraz, ku përfundimisht mbylli sytë në vitin 690 hixhri kamari (1291), ose një vit më pas. Trupi i tij, që deri në fund mbajti dashurinë njerëzore, u varros në një vend të quajtur "Saadie", që edhe sot e kësaj dite është një vend pelegrinazhi për letrarë dhe për poetë të ndryshëm. Pohojmë pa frikë se emri i Saadiut sapo ka filluar përjetësinë e tij.

## Veprat e Saadiut

1. *Bostani*, ose *Saadiname*, që në të vërtetë është vepra e parë e Saadiut, u përfundua në vitin 655 hixhri kamari (1257). Thuhet se Saadiu e shkroi këtë libër gjatë udhëtimit të tij dhe e zgjodhi si dhuratë për miqtë e tij në kohën e hyrjes së tij në vendlindje. Tematikat e prekura në këtë libër, që është shprehësi i kulmit të forcës poetike të Saadiut si dhe një nga kryeveprat e papërsëritshme të poezisë perse, ndahen në dhjetë pjesë: drejtësia, bamirësia, dashuria, thjeshtësia, dëshira, përmendja, edukimi, falënderimi, pendimi, predikimi si dhe mbyllja e librit. Saadiu këtë libër, i cili përmban rreth katër mijë vargje, në shenjë nderimi për udhëheqësin Atabak të asaj periudhe, e prezantoi nën emrin e Atabak Abubekr Ben Saad Zangi.
2. *Gjylistani* është një kryevepër e fjalës perse, që është shkruar në vitin 656 hixhri kamari (1258) dhe për këtë arsye ne e kemi klasifikuar dhe paraqitur si një ndër veprat e periudhës së Abu Almaolit.
3. *Kasidetë arabe* përbëhen nga rreth shtatëqind vargje. Kanë tematikë më tepër lavdëruese për njerëz të ndryshëm në pushtet, por dhe pas vdekjes së tyre.
4. *Kasidetë perse* kanë kryesisht tematikë lavdërimin për Zotin, por dhe vargje lavdëruese për mbretër dhe njerëz të shquar.
5. *Marosi* përmban disa kaside të gjata elegji për vdekjen e Mustasam Beallahut, kalifi i fundit Abasit, i cili u vra me urdhër të Halokut. Gjithashtu në të ndodhen edhe disa elegji të tjera për Atabakët persë dhe për qeveritarë të tjerë të asaj kohe.
6. *Malmelat va muslasat va tarxhiat* shquhet për refrenin e tij të zgjedhur dhe tashmë të njohur për bukurinë dhe popullaritetin e fituar.
7. *Gazalet* në vetvete ndahen në katër grupe (libra): *Taibat*, *Badaia*, *Khatim* dhe *Gazalet e vjetra*.
8. *Maxholes panxhgane* është shkruar në prozë dhe përmban fjalimet e Saadiut. Megjithëse tematika e tyre është harmonia dhe gëzimi, përsëri nuk janë në një nivel artistik me Gjylistanin.

9. *Nasiat-ul-muluk* përmban proza me tematikë shoqërore, ku edukimi dhe sjellja e njeriut përbën shumicën e tyre.
10. *Sahebie* është një përmbledhje tregimesh në persisht dhe arabisht, ku shumica e tyre ngre lart figurën e Shams Aladinit, ministrit dijedashës të periudhës Atabake, dhe për këtë arsye u quajt edhe *Dy nga miqtë*.
11. *Habithat* është një përmbledhje me poezi humoristike. Përmbledhja nuk spikat për gjuhë të përpunuar, por përkundrazi në këto poezi spikat gjuha me zhargonin e rrugës, ndër disa gazale dhe rubai shquhen për sensin e thellë humoristik.

Bashkësia e të gjitha këtyre veprave quhet ndryshe edhe si përmbledhja e Saadiut; fillimisht vetë Saadiu i përmbloodhi në këtë formë. Disa vite pas vdekjes së tij, një njeri i ri, i quajtur Ebubekr Bistuni, i grumbulloi në një përmbledhje të vetme, ashtu siç kish vepruar vetë Saadiu, dhe tashmë botohen herë pas here në Iran. Përmbledhja më e mirë dhe më e re e Saadiut është përgatitur për shtyp nga i ndjeri doktor Golamhusein Jusefi, i cili arriti të nxjerrë në dritë veç e veç dhe në mënyrë të pavarur, në Teheran, botimin e *Bostanit*, *Gjylystanit* dhe *Gazalet*. Fatkeqësisht me vdekjen e tij nisma mbeti e papërfunduar, por megjithatë para disa vitesh Muhamed Ali Furughi ia del mbanë dhe boton në Teheran përmbledhjen më të plotë të Saadiut.

### **Bota poetike dhe mendimet e Saadiut**

Përmbledhja e Saadiut është një paraqitje shumëgjyreshe ku gjenden të gjitha llojet e poezive dhe stilet e prozës. Po ashtu ai cek pothuajse të gjitha tematikat, duke filluar këtu nga temat edukative, shoqërore, dashurore, lavdëruese, mistike, politike, kombëtare e të tjera. Pra në çdo moshë, me çfarëdo preference dhe kapaciteti vetjak që do të ketë individi, ai sapo të fillonte të lexonte përmbledhjen e Saadiut, do ta humbiste veten në artin dhe mendimet e shprehura aty. Lexuesi do të gjente vetveten dhe do të dilte i habitur nga forca shprehëse e këtij mjeshtri të madh. Vetëm ata që shesin besimin, tradhtarët e vetvetes, që nuk shohin dot larg, gënjeshtarët e rëndomtë, pretekstgjëtësit dhe mohuesit njerëzorë nuk janë në gjendje ta përthithin dot filozofinë e Saadiut, sepse ajo u duket një paradoks, diçka qesharake, një kundërshti natyrore, një botë false. Por në të vërtetë Saadiu shpreh atë që ndien, atë që ndodh për ditë, realitetin njerëzor, filozofinë e jetës.

Në përmbledhjen e Saadiut gjithçka është në vendin e vet. Në qoftë se te *Gjylystani* do ta shohim botën reale dhe fatet e njerëzve së bashku me gëzimet dhe hidhërimet, te *Bostani*, përkrah saj, na shfaqet një botë e

pastër, e dëshiruar dhe tejpertej e qartë, ku të gjithë pa përjashtim në këtë botë janë dijetarë. Në përmbledhjen e Saadiut, si kulmi i botës njerëzore, ashtu dhe fundi apo llumi i saj, pasqyrohen në vendin e duhur.

Në qoftë se do të kemi parasysh të gjitha llojet e vargjeve të përdorura deri në atë kohë në gjuhën perse, ato gjenden pa përjashtim te përmbledhja e Saadiut. Po ashtu edhe tematikat apo polemikat poetike të njohura deri në atë kohë, pra gjithçka që lidhet me njeriun gjenden në renditjet e vargjeve në këtë përmbledhje. Shumëllojshmëria këtu nuk është me kuptimin se Saadiu konkurronte ndonjë shkrimtar tjetër dhe ishte pikërisht kjo konkurrencë, le të themi e papërfillshme përpara personalitetit gjenial artistik të tij, ajo që e detyroi atë të përdorte të gjithë bagazhin që kishte për të arritur në këtë garë të gjerë problemesh, ndjenjash, stilesh letrare, të cilën që e pasqyroi me shumëngjyrshmëri vargu. Nga të gjitha sa thamë më lart, kuptojmë se kemi të bëjmë me një poet dhe shkrimtar tejet të kompletuar dhe të ekuilibruar të letërsisë perse. Me fjalë të tjera, në qoftë se do të donim që në tërësinë e letërsisë njëmijënjëqindvjeçare perse të kishte një poet të balancuar, ku të gjitha drejtimet artistike dhe teknike, gjithashtu dhe ato mendore e imagjinare, individuale dhe shoqërore, ndjesore dhe logjike të zhvilloheshin në mënyrë paralele dhe të shkonin deri në përsosmërinë letrare në poezinë e vet, ky nuk mund të jetë tjetër, përveçse sheiku nga Shirazi.

### **Amir Khosro, papagalli gjuhëformues indian**

Themelet e gjuhës dhe të kulturës perse depërtuan në tokën indiane për afërsisht në kohën e Mahmud Gaznavisë. Ai, me pretekstin e përhapjes së islamit, u vendos në krahinat indiane, por qëllimi i tij i vërtetë ishin pasuritë e mbretërve të ndryshëm provincialë. Për këtë qëllim ai shpesh shkonte pas ushtrive (urdu) të ndryshme në ekspeditat e tyre në tokat indiane. Më pas ata flisnin një gjuhë të përzier, që quhet ndryshe “gjuha urdu”. Në bazë kjo gjuhë ka gjuhën perse të përzier me dialektet vendase. Mendohet së kjo gjuhë rrjedh pikërisht nga këto “urdu-të e gëzueshme” të Mahmudit, ku kuptimi i vërtetë i fjalës *urdu* do të thotë “udhëtim”. Në më pak se një shekull më vonë mbretërit vendas indianë, ndoshta duke ndjekur dhe kopjuar sistematikisht Mahmud Gaznavinë, formuan rrethet e tyre letrare duke ftuar në oborret e tyre poetë dhe shkrimtarë të ndryshëm si Abu Alfaraxh Runi dhe Masud Saadin, për të cilin kemi folur në këtë libër. Në këtë mënyrë këta mbretër mbështetën fuqishëm, si materialisht edhe moralisht, letërsinë dhe kulturën perse, duke i dhuruar persishtes në tërësi thesare të reja.

Një emër i njohur i poezisë perse të kësaj periudhe në tokat indiane është edhe Amir Khosro Dehlavi, i lindur në vitin 651 hixhri kamari (1253) në qytetin e Dehli. Ai që në fëmijërinë e tij mbetet jetim nga i



ati. Në këto kushte vendoset në shërbim të Nezam Aladin Ulia-së, njërit prej dijetarëve më të shquar të Delhit në atë periudhë, duke iu futur kështu rrugës së misticizmit. Pas disa kohësh edhe ai, si shumë poetë të tjerë të asaj kohe, filloi të merrej me poezi lavdëruese. Ishte pikërisht në shërbimin e njërit prej mbretërve vendas, me poezitë e tij lavdëruese, në kohën kur zhvillohet beteja me njërin nga komandantët mongolë në vitin 683 hixhri kamari (1284). Amir Khosro bie rob dhe jeton për dy vjet në burgjet e Balkhit.

Pasi lirohet shkon serish në Indi dhe vihet në shërbimin (me poezitë e veta lavdëruese) e Xhelaludin Halxhit, udhëheqësit të Delhit në atë kohë. Në këtë periudhë ai bëhet i njohur me emrin Amir Khosro. Ai vdiq në vitin 725 hixhri kamari (1325) i vetëm dhe në harresë të plotë. Me pas pranë varrit të tij u varros edhe Nezam Aladin Ulia. Nga Amir Khosro njohim vetëm një djalë me emrin Malek Ahmad, i cili kishte talent në fushën e poezisë.

### **Veprat dhe poezitë e Amir Khosros**

Amir Khosro nuk ishte vetëm poet, por dhe prozator, dhe historian. Ai ishte mjeshër në prozën vetjake. Libri i tij në prozë, i titulluar *Exhaz Khosravi*, shpalos më së miri dhuntitë e tij letrarë-artistike. Ai krijonte vargje edhe në gjuhën indiane ashtu si në persisht dhe në të dyja gjuhët duken qartë disa shprehje të njëjta arabe. Veprat e tij në persisht renditen si më poshtë:

1. *Divani*, i cili ndahet në pesë pjesë të pavarura dhe çdo pjesë përmban vargje nga jeta e tij poetike.
2. *Khamose*, që është një kopje e librit *Pesë thesaret* e Nezamit. Siç e kemi përmendur edhe më parë, në këtë libër, kur kemi folur për *Pesë thesaret*, kemi thënë së ky libër është marrë si bazë dhe është kopjuar nga shumë autorë të tjerë. Në vazhdim mund të themi se *Khamose* e Amir Khosrot-it është më e suksesshme nga këto kopje. *Khamose* ndahet në pesë libra si më poshtë:
  - *Matlah Alnavar*, që është marrë mbi bazën e *Muhazen Alesrar-it*.
  - *Shirin va Khosr*, që është kopjuar nga *Khosro va Shirin*.
  - *Maxhnun va Leili*, që bazohet te *Leili va Maxhnun*.
  - *Oine-je Eskander*, që ka si origjinal *Eskandername*.
  - *Hasht Behesht*, që bazohet te *Haft Peikar*.
3. *Masnavi Khazarkhan va Davalrani*, që përmban histori dashurie të Khazarkhanit, djalit të Aloadinit me Davalranin, vajzën e Amir Gaxhratit.

### **Mendimet dhe poezia e Amir Khosros**

Khosro në përgjithësi ndoqi rrugën e paraardhësve të vetë dhe shprehet se në *Divanin* e tij nuk ka ndonjë gjë të re. Po ashtu edhe *Khamose-ja* e tij, siç e pamë edhe më lart, është një kopje e librit *Pesë thesaret* të Nezamiut, ku ndryshimet e tij janë në nivelin e ndryshimeve të emrave brenda librit, megjithëse forca treguese dhe bukuria e fjalës së tij nuk duhet anashkaluar.

Duke u mbështetur në vetë fjalët e Amir Khosro-s, ne mund të themi se ai jo vetëm që nuk hapi ndonjë rrugë të re poetike apo letrare, por edhe nuk u shqua për ndonjë cilësi të veçantë letraro-artistike. Por ai duhet vlerësuar për forcën e tij shprehëse, forcë që ishte e nivelit natyror-mjeshtëror. Kjo vlerë e vetme na mjafton për ta klasifikuar Amir Khosron si poetin më të madh të Gadishullit Indian në mesin e persishtshkruesve, duke përjashtuar këtu poetët persishtfolës.

Ahmed TAMIMDARI

## STILET E PROZËS PERSIANE<sup>1</sup>

### 1. Stili i prozës persiane në periudhën e parë (300/912 -450/1058): Proza e thjeshtë dhe proza e lulëzuar.

Periudha e parë e prozës persiane ndahet në dy faza:

- a. Fillimi i shkrimit të prozës deri në fund të gjysmës së shek. V/XI.
- b. Fundi i gjysmës së shek. 5/11 deri fillim të shek. VI/XII<sup>2</sup>.

Për pjesën e dytë të këtij klasifikimi do të flasim në periudhën e dytë të stilit të prozës persiane. Veprat më të vjetra që janë shkruar në gjuhën persiane, më tepër përmbajnë tema fetare, teologjike, epike, historike, shkencore, filozofike dhe mistike. Po përmendim disa prej tyre: *Resale-i der Akajidi Hanefijan*, e autorit Hakim Ebul Kasem Semerkandi (v. 343/954), *Mukaddeme-i Shahname Ebu Mensuri*, e përgatitur nga një grup transmetuesish të epikës kombëtare të Iranit dhe ky libër ka mbetur vetëm hyrja e saj, *Tarihi Bel'ami*, që është një përktim i *Tarihi Er Rusul ve El Muluk* të autorit Taberi, *Terxhume-i Tefsiri Taberi*, *Resale-i Istihraxh ve Resale-i Shish Fasl* të autorit Muhamed Bin Ehub Taberi, *Hududul Alem*, *Axhajibi El Beldan* nga Ebu Muejjid Belhi, *El Ebnije an Hakajikul Edvije* nga Ebu Mensur Mufak Bin Ali Herevi, veprat, të shkruara në persisht, të Ibni Sinasë, si:

---

<sup>1</sup> Marrë nga libri “Historia e letërsisë perse”, botim i Fondacionit Kulturor “Saadi Shirazi”, Tiranë, 2008.

<sup>2</sup> Hatibi, Fenni Nesr der Edebi Parsi, fq. 121.

*Daneshname-i Alaji dhe Resale-i Reg Shenasi, Et Tefhim nga Biruni, Tarihi Sistan, Zejn El Ehbari Gerdizi, veprat e Naser Hosros dhe Kashful Mahxhub nga Ebu Ja'kub Segezi*<sup>3</sup>.

Stili i veprave të lartpërmendura është i thjeshtë dhe i lulëzuar. Veçoritë gjuhësore të këtij stili janë: përdorimi mbizotërues i fjalëve persiane përballë fjalëve të gjuhëve të tjera, sidomos të gjuhës arabe; më të dukshme janë sidomos në veprën Mukaddeme-i Shahname Ebu Mensuri, ku vërehen 1 ose 2 % fjalë arabe<sup>4</sup>. Edhe proza e Shahnamesë, e cila është një nga shembujt e rrallë të letërsisë epike, qëndron larg nga fjalët e gjuhëve të huaja, e sidomos nga ato arabe. Ndërsa librat e përkthyer nga gjuha arabe, siç është *Tefsiri Taberi* kanë shumë fjalë arabe.

Sidoqoftë karakteristikat gjuhësore të stilit të lulëzuar mund t'i numërojmë si më poshtë: ky stil është i pastër nga fjalët arabe, përveçse në raste të caktuara kur kemi të bëjmë me fjalët fetare, që nuk kanë ekzistuar në persishtë; nuk ka pasur teknika retorike dhe spirituale; nuk janë përdorur ajete dhe hadithe për të stolisur fjalinë; në përkthimet e veprave ka ndikim të vogël stili i fjalive të gjuhës arabe; ka përdorim të vogël të poezive në gjuhën persiane dhe arabe, me fjali të shkurtër; ka përsëritje të foljeve në fjali; përdoren terma shkencorë në gjuhën persiane përballë gjuhës arabe, shfrytëzohen disa struktura morfologjike dhe sintaksore që i përkasin vetëm kësaj periudhe, si p.sh.: parafjalët e veçanta në folje, harmonizimi i emrit dhe i mbiemrit dhe po ashtu përdorimi i shumësit të një fjale arabe në shumësin e persishtes, etj.<sup>5</sup>

Edhe veprat me tematikë mistike, në këtë periudhë, janë shkruar me një gjuhë të thjeshtë dhe në to janë përdorur shumë fjalë të gjuhës persiane, të cilat më vonë u harruan, si në veprën *Keshful Mahxhub* të Huxhvirut. Megjithatë, veprat që përfaqësojnë stilin e thjeshtë dhe në lulëzim të prozës persiane janë *Tarihi Bel'ami* dhe *Hududul Alem*.

## **2. Stili i prozës persiane në periudhën e dytë (450/1058 – 550/1155): Periudha e gaznevitëve dhe selxhukëve të parë**

Në këtë periudhë dalëngadalë stili i prozës persiane fillon të anojë kah stili teknik dhe rrënjët e këtij ndryshimi duhet t'i kërkojmë në elemente të ndryshme politiko-sociale. Në këtë periudhë ndodh evoluimi i natyrshëm i prozës, nga e thjeshtë ajo bëhet e ndërlikuar, ka ndikim prej poezisë. Natyrisht, proza në këtë periudhë ka një stil të ndërmjetëm, por animi i saj kah stili teknik është më i dukshëm. Edhe veprat e kësaj

<sup>3</sup> Behar, Sebk Shenasi, vëll. 2, fq. 1.

<sup>4</sup> Po aty, fq. 7.

<sup>5</sup> Hatibi, Fenni Nesr der Edebi Parsi, fq. 127-130, dhe, Behar, Sebk Shenasi, vëll. 2, fq. 54-61.

periudhe më tepër janë fetare, filozofike, historike dhe moralizuese, ndërsa proza mistike gjen një shtrirje të jashtëzakonshme. Modelet, që përfaqësojnë karakteristikat e këtij stili janë shkrimet e Bu Nasr Moshkanit dhe të nxënësit të tij Ebul Fazl Bejhakiut. Bejhakiu është autor i veprës së madhe për historinë e gaznevitëve. Sipas Beharit, në stilin e tij prozaik, ai ka imituar Bu Nasr Moshkanin<sup>6</sup>. Por ky nuk ishte një imitim në aspektin morfologjik; fuqia e tij krijuese bëri që veprat e tij nga imitimi të shkojnë në drejtim të një stili të përsosur të prozës së atëhershme persiane.

Proza persiane në këtë periudhë, në dallim nga periudha e mëparshme, filloi të stërzgjetet, zotëron kombinime fjalësh dhe fjalish më të gjata dhe ky fenomen vërehet shumë qartë në shkrimet e Bu Nasrit dhe të Bejhakiut. Kjo stërzgjetje bëhet me qëllim që të zgjojë interesim të madh për përshkrimet dhe pa ngurrim mund të themi se proza e Bejhakiut është prozë përshkruese. Behari shkruan: “Stili i Bu Nasrit dhe Bejhakiut është stili më real i prozës”<sup>7</sup>. Në prozën e kësaj periudhe alegoria në ajetet dhe në hadithet ka një shtrirje të dukshme, por gjithashtu është ruajtur njëfarë balance dhe nuk është ashtu si në prozën e mëvonshme. Proza persiane në këtë periudhë, është ndikuar në tri dimensione nga proza arabe:

- a. Depërtimi i fjalëve të reja arabe, që nuk ishin përdorur në kohën e Samanidëve,
- b. shfrytëzimi i fjalëve arabe me tenvin<sup>8</sup>, dhe
- c. përdorimi i fjalive arabe në hyrje të veprës, pa ndonjë qëllim të caktuar letrar<sup>9</sup>.

Këto veçori hasen shumë qartë në veprën e Bejhakiut, ndërsa më vonë patën një shtrirje shumë më të madhe.

Nga veprat e tjera të kësaj periudhe mund të përmendim edhe *Sijasetnamen* ose *Sejru'l Muluk* të autorit Haxhe Nizamul Muluk. Lloji i prozës së kësaj vepre duket që është didaktik dhe moralizues, por në të janë sjellë edhe shumë tregime historike. Kjo vepër ka dy karakteristika stilistike: struktura morfologjike dhe sintaksore e saj është sikurse proza e Bel'amiut dhe në dukje është e thjeshtë, ndërsa për nga struktura letrare dhe subjektive zotëron disa koncepte të reja dhe ka pak ngjashmëri me stilin e Bejhakiut. Fjalët arabe në të janë rreth 10 %<sup>10</sup>. Gjatë studimit të kësaj vepre vërejmë se autori në përdorimin e gjuhës ka

<sup>6</sup> Behar, vep. e cit. vël. 2, fq. 67.

<sup>7</sup> Po aty, fq. 69.

<sup>8</sup> Zanoret e,u,i në gjuhën arabe mund të dyfishohen. Ky dyfishim quhet tenvin dhe vjen vetëm në fund të fjalës.

<sup>9</sup> Po aty, fq. 71.

<sup>10</sup> Po aty, fq. 96.

pasur parasysh edhe pozitën e lexuesit. Stili i veprës *Kabusname* është si i *Sijasetnames*, por autori i *Kabusanemes* ka sjellë edhe vargje poetike dhe kjo dëshmon se ai ka qenë edhe poet. Për nga lloji letrar, *Kabusname* i përket letërsisë didaktike dhe në të është përdorur metoda e teozofisë teorike. Edhe veprat e Naser Hosros kanë rëndësi të madhe për këtë periudhë. *Sefername*-ja e Hosros i takon letërsisë realiste, ndërsa *Zadul Musafirin* është shkruar në stilin e prozës së periudhës së parë. Ai në librin *Zadul Musafirin* ka sjellë shprehje të shumta dhe fjalët e kësaj vepre më shumë shprehin botëkuptime filozofike, fetare dhe teologjike. *Sefername*-ja e tij ka më pak fjalë arabe dhe në të zotërojnë fjalë më të vjetra në krahasim me veprat që janë shkruar në kohën e tij. Por fuqia përshkruese e Naser Hosros është e lartë dhe realiste dhe një gjë të këtillë mund ta hasim edhe në veprën *Tarihi Bejhaki*.

Ndër veprat e misticizmit të kësaj periudhe mund të përmendim *Kimjaji Saadet* të Imam Muhamed Gazaliut. Këtë vepër ai e ka shkruar në stilin e prozës së sufinjve dhe si duket ka qenë nën ndikimin e Keshful Mahxhub të Huxhviriut, dhe po kjo është bërë shkak që proza e kësaj vepre të jetë e thjeshtë dhe në lulëzim. Imam Muhamed Gazaliu në këtë libër ka respektuar lexuesin; veprën e ka shkruar në fund të viteve të jetës së tij me kërkesë të popullit të Horosanit. Shkrimi i veprave mistike në prozë filloi me Keshful Mahxhub të Huxhviriut (v. 464/1072). Stili i kësaj vepre është i afërt me stilin e veprave të periudhës samanide, por për sa i përket strukturës muzikore ajo është më e fortë. Edhe veprat *Esrarul Tevhid* dhe *Tezkiretul Evlija* janë më afër stilit të periudhës samanide sesa me stilin e prozës së periudhës kur janë shkruar. Në *Tezkiretul Evlija* të Atarit në mënyrë të dukshme është imituar Keshful Mahxhub dhe ngjashmëria e tyre shihet edhe në strukturën letrare dhe në atë retorike<sup>11</sup>. Në po këtë shekull, Haxhe Abdullah Ensari (v. 481/1088) sjell në letërsinë persiane prozën e rimuar. Veprat më kryesore të tij, janë: *Zadul Arifin*, *Kenzul Salikin*, *Munaxhatname* dhe *Sed Mejdani*. Stili i prozës së Haxhe Abdullahut nuk u mirëprit në shek. 5/11, por në shekujt e mëvonshëm.

### 3. Stili i prozës persiane në periudhën e tretë. Periudha e Selçukëve dhe Harezmsahëve të parë (550/1155-600/1203)

Edhe shkrimtarët e kësaj periudhe, ashtu sikurse edhe poetët, me tepër ishin të prirë që në krijimtarinë e tyre të shfrytëzonin strukturat muzikore dhe stereotipat gjuhësorë. Në veprat e tyre hasim shumë arabizma. Në aspektin subjektiv shohim sinonime me kuptime të përbashkëta, me anë të të cilave një koncept e shpjegonin në mënyra të

<sup>11</sup> Po aty, fq. 207.

ndryshme. Ajetet dhe hadithet në prozën e kësaj periudhe kanë përdorim argumentues dhe në përgjithësi proza e kësaj periudhe ka qenë e ndikuar më shumë nga proza arabe. Në rrafshin kuptimor shohim një ndërlikim, që buron nga përdorimi i figurave letrare dhe prej teknikave poetike, andaj dhe kjo është arsyeja pse Behari prozën e kësaj periudhe e quan “proza teknike”<sup>12</sup>.

Vepra që përfaqëson këtë stil është *Kelile ve Dimne*, e përkthyer nga Ebul Meali Nasrullah Menshi. Në këtë vepër hasim veçori të shumta stilistike, por në të gjithashtu janë përdorur edhe fjalë e shprehje të reja që nuk ishin përdorur në periudhat e mëparshme<sup>13</sup>. Në *Kelile ve Dimne* janë përdorur edhe kombinime të fjalëve arabe me fjalët persiane dhe në krahasim me veprat e shek. 5/11, në të janë shfrytëzuar më shumë fjalë arabe. Nga figurat e balancuara, proza e rimuar është përdorur më shumë me synimin e krijimit të konceptit muzikor, ndërsa në rrafshin e interpretimit janë shfrytëzuar gjithashtu figurat poetike si krahasimi, metafora etj. Në interpretimin e tregimeve është shfrytëzuar metoda nga tregimi në tregim ose *Labirent*. Tregimet e kësaj vepre janë alegorike dhe didaktike, kështu që këto tregime më tepër janë përdorur për të bindur lexuesin. P.sh. në hyrje të kreut të tetë thuhet: “Raji tha... tani... më thuaj prapë se dushmani ka ikur, kjo nuk do të ndodhë përsëri ...”<sup>14</sup>. Por narracioni është ajo që *Kelile ve Dimnen* e bënë të bukur dhe artistike duke i dhënë një përmasë të re letrare. Interpretimi i veprave dhe i sjelljeve të heronjve me anë të gjuhës së shtazëve dhe roli i tyre gjatë gjithë tregimeve, ka krijuar një gjini letrare të veçantë, e cila në letërsinë europiane quhet *Fabul*. Stazët në këto tregime identifikohen me njerëzit e asaj kohe. Për Mansulla Menshn edhe *Kelile ve Dimne* solli një lloj të letërsisë alegorike.

Një libër tjetër që i përket kësaj periudhe, ishte edhe *Çehar Makale* e Nizami Aruziut. Kjo vepër, në krahasim me veprat e tjera të kësaj kohe, ishte shkruar me një gjuhë më të vjetër dhe ngjan me veprat e shek. V/XI, ndërsa stili i saj është shumë afër me atë të *Kabusnames* dhe të *Sijasetnames*. Çdonjëri nga këta katër artikuj të kësaj vepre (*Çehar Makale* ka kuptimin e katër artikujve, *shën. i përkth.*). Secili artikull është shkruar me një gjuhë të veçantë sepse tematika e artikujve është e ndryshme: rreth mjekësisë, rreth poezisë, rreth astronomisë dhe rreth mbarështimit. Gjithashtu autori është munduar që ta ruajë origjinalitetin e gjuhës së vet edhe tek tregimet historike. Megjithatë mund të themi se vepra *Çehar Makale* qëndron diku rreth stilit të prozës të ndërmjetme ose të stilit të lulëzuar dhe të stilit të prozës teknike.

<sup>12</sup>Po aty, fq. 255.

<sup>13</sup>Po aty, fq. 263-267.

<sup>14</sup>Nasrullah Menshi, *Kelile ve Dimne*, fq. 191.

Në prozën e shek. VI/XII u përhap kultura e shkrimit të mekameve. *Mekami* ose *Mekamat* quhen fjalë që folësit i kanë thënë për të këshilluar, udhëzuar dhe për të predikuar te të tjerët, por që janë me kuptim të thellë, dhe shprehja e “Fjalimit në Mexhlis” rrjedh nga kjo fjalë. Këto janë gjithashtu edhe gojëdhëna e legjenda që janë tubuar nga një person dhe shpjegohen në formën e prozës së rimuar<sup>15</sup>. Mekamet në gjuhën persiane janë imitime të mekameve të gjuhës arabe, kështu që sipas Hariut, në hyrje të veprës së tij *Makamat*, ndër arabët i pari që ka krijuar në këtë stil të prozës ka qenë Bediuzzaman Hamedani. Kurse disa studiues të tjerë janë të mendimit se autori i parë i mekamateve në gjuhën arabe ka qenë Ahmed Bin Farsi (v. 395/1004)<sup>16</sup>. Në gjuhën persiane ngjashmëri të mekameve shohim në veprat e Haxhe Abdullah Ensariut, por mjeshtërit kryesorë të mekameve janë Kazi Hamiduddin Ebu Bekr Belhi (v. 559/1163) në shek. e 6/12 dhe Shejh Muslihuddin Saadi në shek. 7/13. Stili i mekamateve të Kazi Hamiduddinut ose të *Mekamati Hamidit* janë imitim i pastër i mekamateve të Harirut dhe Hamedanit në gjuhën arabe. Natyrisht që në mekamet e Hamidiut shfaqen tipare të dukshme që kësaj vepre i falin një pamje të veçantë. Në një shumicë, që përbëhet prej 24 mekameve, stili mbizotërues është stili letrar, d.m.th. autori ka shfrytëzuar strukturën letrare dhe gjuhësore. Mekamet që janë shkruar rreth xhinëve, rreth rregullave të udhëtimit dhe rreth tesavufit kanë një stil mistik dhe filozofik. Gjithashtu në këto mekamate janë përdorur edhe ajete dhe hadithe, janë sjellë shumë fjalë arabe dhe anekdota e poezi në gjuhën arabe.

*Tarihi Bejhaki* është vepra tjetër e shek. VI/XII që ka stil të veçantë. Data e shkrimit të saj është rreth vitit 563/1167. Proza historike e kësaj vepre ka një gjuhë të përzier me stilin e shek. V/XI dhe VI/XII. Siç duket, është më afër veprës *Çehar Mekale*. Por gjithashtu në këtë vepër hasim edhe poezi në gjuhën arabe. Figurat stilistike në të janë përdorur me mjeshtëri të jashtëzakonshme. Veprat e tjera të shkruara në prozë në shek. VI/XII janë *Atabat El Kutbe*, *Resaili Behauddin Bagdadi*, *El Tevessul Ila Et Tersul* dhe *Tarihi Jemeni*. Këto vepra më shumë janë shkruar nën ndikimin e *Kelile ve Dimnes*. Në këtë shekull janë shkruar edhe vepra shkencore si *Tefsiri Rovzetul Xhenan*, nga autori Ebul Futuh Razi, e cila është më afër stilit të prozës së shek. V/XI dhe më afër stilit të ndërmjetëm dhe veprat e Habish Bin Ibrahim Teflisiut, Imam Fahr Raziut dhe Reshiduddin Vetvatit në shkencën e retorikës; këto quhen *Hadaikus Seher fi Dakajikush Shir*.

<sup>15</sup> Behar, Sebki Shenasi, vëll. 2, fq. 325.

<sup>16</sup> Hatibi, Fenni Nesr der Edebi Parsi, vëll. 1, fq. 552.



#### 4. Stili i prozës persiane në periudhën e katërt (600/1203 – 1200/1785). Stili irakian dhe proza artificiale

Në këtë periudhë sundonin mongolët dhe për shkak të interesimit të tyre për shkrimin e historisë, filloi të zgjerohet kultura e të shkruarit në prozë historike. Si pasojë u shkruan shumë vepra me tematikë historike. Vepra më e rëndësishme historike në shek. VII/XIII është *Tarihi Xhihan Goshaj* e Xhurvejniut, e hartuar në vitin 658/1259. Nga historitë e tjera të kësaj periudhe mund të përmendim *Xhamiu Tevarih* (shkruar në vitin 710/1310) e autorit Reshiduddin Fazlullah, *Texhzijetul Emsar ve Texhzijetul Easar* e njohur edhe si *Tarhi Vesaf* (sh. 738/1337) nga Abdullah Bin Fazl Shirazi, *Tarihi Gozidei* (sh. 730/1329) nga Hamdullah Mostafavi dhe *Nizamul Tevarih* (sh. 674/1275) nga autori Kazi Bejzavi. Stili i këtyre veprave, përveç *Tarihi Xhihan Goshaj* dhe *Tarihi Vesaf*, është i thjeshtë dhe i lulëzuar dhe ka ngjashmëri të madhe me veprat e shekujve të mëparshëm. Në këtë shekull ndër shkrimtarët që imitonin stilet e shekujve të mëparshëm, janë: Muhammed Nesevi, autori i veprave *Nefethetul Mesdur* dhe *Sire-i Xhelaleddin*, veprat e të cilit ndjekin stilin e *Kelile ve Dimnes* dhe Seadeddin Veravini, përkthyes i *Merzbanames*, gjatë përkthimit të së cilës ka shfrytëzuar plotësisht veprën *Kelile ve Dimne*. *Mirsadul Ibad*, vepra e autorit Nexhmuddin Raziut është shkruar nën ndikimin e *Kelile ve Dimnes*, por është më e rrejshme se ajo. Nga veprat shkencore të kësaj periudhe mund të përmendim: *El Muaxhem Fi Meajiri Eshari Axhem* nga Shems Kejs Razi dhe veprat e Mahmud Avfi, të quajtura *Lebabul Elbab* dhe veprën e tij letrare *Xhevamiul Hikajat*. Vepër që shquhet për stil artificial në këtë shekull, është *Tarihi Xhihan Goshaj* e Xhurvejniut e cila në vetvete përmban të gjitha veçoritë e stilit artificial. Xhurvejniu në veprën e tij gjithashtu ka sjellë edhe poezi nga gjuha perse prej *Shahnamesë* së Ferdsiut dhe atë e ka harmonizuar me temën për të cilën ka folur. Vlera kryesore e kësaj vepre qëndron në antropologji dhe në sociologji, sepse në të përshkruhen fiset e mongolëve si dhe traditat e zakonet e tyre, prandaj dhe shumë studiues këtë vepër e shfrytëzojnë edhe si referencë shkencore për kohën kur është shkruar. Ky është autori i vetëm që ka vizituar edhe Mongolinë dhe krahinat e Azisë Lindore dhe gjithçka që ka parë, i ka përshkruar në këtë vepër.

Proza persiane në shek. VII/XIII, me ardhjen e Saadiut arriti kulmin e saj. Saadiu në veprat e tij prozaike ka përdorur tri stile të veçanta:

1. Stilin e *Kelile ve Dimnes*, *Merzbannames* dhe të *Tarihi Xhihan Goshaj*,
2. stilin e *Mekamatit* të Haxhe Abdullah Ensariut, dhe
3. stilin e veçantë të Saadiut.

Përveç *Golestanit*, (Gjylistanit) veprat e tjera të tij i kanë të tria llojet e këtyre stileve. Saadiu në veprën *Mexhalis ve Resalat* për nga subjekti shfrytëzon stilin mistik, ndërsa në rrafshin gjuhësor ka qenë i ndikuar nga Haxhe Abdullah Ensariu, i cili ka krijuar prozë të rimuar dhe kjo vërehet gjatë gjithë veprës së Saadiut. Natyrisht, në përgjithësi në veprat e shkruara në prozë nga Saadiu, vërehet edhe stili i humorit në formën e Samarkandit dhe lirisht mund të themi se ky stil i takon vetëm atij. Stili i veprës *Golestan* është në formën e mekameve dhe si duket Saadiu ka qenë nën ndikimin e Haxhe Abdullah Ensariut dhe këtë mund ta quajmë edhe një mekame të mrekullueshme. Në *Golestan*, autori e ka shfrytëzuar gjuhën deri në fund dhe po ashtu ka respektuar pozitën dhe nivelin e lexuesit. Saadiu në këtë vepër, gjithashtu, në një masë të duhur ka shfrytëzuar edhe figurat poetike. Në *Golestan* edhe pse mund t'i hasim gati të gjitha figurat letrare dhe gjuhësore, më së shumti të bie në sy personifikimi. Zgjedhja e temave nga ana e autorit, botëkuptimet e stilit i bën më të larmishme. Tetë krerët e *Golestanit* kanë tematikë të ndryshme nga njëri-tjetri. Në kreun e parë flitet për biografinë e mbretërve dhe në të është shfrytëzuar me tepër fjalori politik. Në kreun e pestë fjalët janë më tepër erotike dhe të gazelit, kurse tematika e këtij kreu është dashuria dhe rinia. Ndërsa në kreun e shtatë flitet për ndikimin e edukatës dhe të moralit. Këtu ne përballemi me fjalë dhe shprehje psikologjike, si: arsimi, edukata, i mençuri, i marri, këshilla, arti, edukatori, mësuesi, shkenca etj., të cilat janë përdorur me një mjeshtri të madhe. Por në kreun e tetë, në të cilin flitet me rregullat e bisedës, të fjalimit, ne shohim kulmin e artit të Saadiut në shfrytëzimin e strukturës morfologjike dhe kuptimore të gjuhës si dhe rolin e përdorimit të saj. Fjalitë e shkurtra dhe fjalët dërstilare janë disa nga veçoritë e këtij kreu dhe kjo harmoni dhe bashkërendim nuk mund të shihet në asnjë vepër të letërsisë persiane. Stili i Saadiut në kohën e tij mbahet si risi në prozën persiane; ai mund të quhet edhe si “Stili i prozës së rimuar ose prozës poetike”. Stili i *Golestanit* ka pasur ndikim jashtëzakonisht të madh në letërsinë persiane dhe shumë shkrimtarë e kanë imituar këtë stil, por asnjëri nga ata nuk arriti ta kalojë Saadiun. Shkrimtarët që krijuan në këtë stil janë Xhovvejni në veprën *Nigeristan*, Xhami në veprën *Beharistan* dhe Ka’ani në veprën *Perishan*.

Në shek. VIII/XIV shohim një rënie të letërsisë persiane dhe vërejmë hapat e parë të shkatërrimit të prozës së saj<sup>17</sup>. Madje në këtë shekull edhe veprat historike humbën ndikimin e tyre dhe nuk kishte interesim për vepra të tilla. Kjo rrjedhë vazhdoi edhe në shek. IX/XV dhe e vetmja vepër që u shkrua në këtë shekull është *Tezkiretush Shuara*, e Devletshah Semarkandit, e cila ka gabime të shumta dhe përmban

<sup>17</sup> Behar, vep. e cit. vël. 3, fq. 179.

informacione të gabuara. Kjo quhet edhe si kronologjia më e njohur e poezisë dhe poetëve persianë. Në këtë shekull, shkrimtarët e tjerë jo edhe aq të rëndësishëm janë: Sherefuddin Ali Jezdi, autor i veprës *Zafername-i Timuri*, ku imiton Tarihi Xhihan Goshaj, por sipas Beharit, proza e këtij shekulli qëndron diku në mes të periudhës së ndërmjetme, të stilit të thjeshtë dhe teknik. Në shek. VIII/XIV në veprat e Abid Zekanit hasim humor dhe sarkazëm, që autori i përdor për të shprehur pikëpamjet e tij për shoqërinë e kohës. *Ahlakul Eshraf* dhe *Resale-i Delgasha* janë ndër veprat e rëndësishme të kësaj periudhe.

Proza persiane në kohën e sundimit të Safevitëve njihet si prozë e angazhuar dhe teknike dhe po ashtu është e ndërlikuar dhe e mbushur me figura të panevojshme poetike. Duket sikur shkrimtari, në këtë periudhë, më tepër ka dashur t'i thurë lavde vetes sesa të shprehë fuqinë e tij krijuese dhe artistike. Kemi edhe vepra të shkruara me një stil të thjeshtë, siç janë: *Alemi Arai Shah Ismail* dhe *Eskendername*<sup>18</sup>. Veprat e Shejh Behaji dhe Al'lame Mexhlisiut kanë tematikë shkencore dhe fetare. Shumica e veprave të kësaj periudhe janë artificiale dhe të angazhuara. Zakonisht këto vepra i ngjajnë kasideve të Azerbajxhanit që u krijuan në shek. VI/XII. Shkrimtari në fillim sjell një hyrje me detaje ose një ligjëratë artificiale, ku hasim disa ndërlikime poetike. Vepra *Nevab Giti*, mund të jetë shembull i kësaj proze.

## 5. Proza persiane në periudhën e pestë: Periudha e kthimit letrar (1200/1785 – 1300/1883)

Pas shpërbërjes së Safevitëve, në gjysmën e parë të shek. XII/XVIII jemi dëshmitarë të tri lloj prozave:

- 1) proza e thjeshtë, siç është vepra *Tezkire-i Hazejn* e Azer Bigdeliut,
- 2) proza artificiale dhe e angazhuar siç janë veprat e Mirza Mehdi Hanit, sekretari i mbretit Nadir, *Dorre-i Nadire* dhe *Xhihan Goshaji Nadiri*, si dhe veprat e Mirza Sadek Namiut, dhe
- 3) proza mesatare, ku bëjnë pjesë veprat e Ebul Hasan Golistane si *Mexhmel Et Tevarih*.

Gjatë studimeve të stilistikës së kësaj periudhe arrijmë në përfundim se shkrimtarët e kësaj kohe nuk ndjekin ndonjë stil të caktuar. Në veprat e tyre vërehen mangësi stilistike. Gjithashtu në këtë periudhë hasim edhe shumë gabime në drejtshkrimin gjuhësor. Shkrimtarët si Abdurrezak Denbeli dhe Abdulvehab Neshat shkruan në stilin artificial të shekujve XII/XVIII dhe XIII/XIX.

<sup>18</sup> Po aty, fq. 259.

## 6. Stili i prozës persiane në periudhën e gjashtë: Periudha moderne (nga 1300/1883 e më pas)

Proza persiane në periudhën e sundimit të Kaxharëve përjetoi ndryshime, kështu që përhapja e gazetave dhe e revistave u bë shkak që proza persiane të thjeshtëzohet, me qëllim që lexuesit të kishin mundësi t'i kuptonin më lehtë këto gazeta. Në këto shkrime më tepër vihej në dukje qëllimi dhe thjeshtësia e shkrimit, ndërsa shkrimet tradicionale, të shkruara me gjuhë të vështirë, filluan të quheshin si shkrime të kota dhe pa ndikim te masa e gjerë. Në kohën e Kaxharëve stili i prozës ishte artificial, por Kaim Mekami ishte personi i parë që filloi të shkruajë me një gjuhë të thjeshtë dhe përhapri këtë kulturë të shkrimit. Ai shkruante edhe nën ndikimin e Saadiut edhe pse stili i tij ishte imitues, por ai solli mjaft risi në shkrimin e prozës. Megjithatë përhapjen e shkrimit të thjeshtë duhet ta kërkojmë në zhvillimin e publicistikës, në industrinë e botimit, në arsimimin e gjerë të popullit, në lidhjet me Europën, te hapja e shkollave të larta dhe te përhapja e kulturës së përkthimit. Në stilin e thjeshtë shkruan Fet'h Ali Ahundzade dhe Mirza Agahan Kermani dhe pas tyre kjo metodë e shkrimit vazhdohet në veprat si *Haxhi Baba Isfehani*, përkthyer nga Mirza Ibrahim Beg, *Mesalikul Muhsinejn*, nga Abdurrahim Tebrizi Talibof, *Sejihatname Mirza Ibrahim Beg* nga Haxhi Zejnul Abidin Moragasi. Shtrirja e tregimit dhe e romanit ndihmoi rrjedhën e shkrimit të thjeshtë dhe kjo mënyrë të shkruari kulmin e arriti në veprat e Hedajetit, Dehhodas, Xhemalzades dhe Çubekut. Kjo thjeshtësi vazhdoi të ruhej me anë të përdorimit të gjuhës popullore në prozë dhe nga përhapja e prozave të veprave të përkthyer. Ali Ekber Dehhoda në përmbledhjen e tij *Çeren ve Perend*, që është një vepër humoristike, Xhemelazade në romanin e tij *Jeki Bud Jeki Nebud* dhe Sadik Hidajeti në shumicën e romaneve të tij përdorën gjuhën e popullit. Stili erotik ose i gazelit vërehet në veprat e Muhammed Hixhaziut, si *Ziba*, *Periçehr* dhe *Homa*.

**Akiro MATSUMOTO**

## **MBI FILOZOFINË GJUHËSORE TË RUMIUT**

### **Përmbledhje**

Në këtë shkrim do të trajtojmë natyrën gjuhësore në veprat e Mevlana Xhelaleddin Rumiut. Ky shkrim përbëhet nga dy pjesë: Gjuha dhe realiteti në veprat e Rumiut; *Pikëpamja komplekse e gjuhës në Fihî ma Fihî (diskurset e Rumiut)*; dhe *Poezia dhe misticizmi i Rumiut*.

Në këtë shkrim trajtohen tri tema kryesore: Qëndrimi i dyzuar i Rumiut ndaj gjuhës, i cili shihet si në kuptimin e përçimit të së vërtetës, ashtu edhe të udhëzimit, dhe prapëseprapë është përfundimisht e papërshtatshme për të shpjeguar realitetet hyjnore; natyra e dehjes mistike në poezinë e Rumiut dhe mënyrat e ndryshme me të cilat shprehet ajo në veprën “Divan-e Shams” dhe “Mesnevi”; dhe lidhja intime në mes imagjinare dhe shprehja e të vërtetave mistike në shkrimet e Rumiut. Në fund, në këtë shkrim do të tregojmë se si ndërlihen këto tri tema me njëra tjetrën duke na dhënë një pasqyrë të plotë të gjuhës në veprat e Rumiut

Fjalë çelës: *Rumiu, gjuha (sokhan), dehja mistike, Fihî ma Fihî, Divan-i Shams, Mesnevia.*

### **1. Gjuha dhe Realiteti tek Rumi**

Në veprat e Rumiut ne gjejmë një numër të madh thëniesh në lidhje me gjuhën. Në këtë rast me fjalën “gjuhë” nënkuptojmë “gjuhën” në kuptimin modern gjuhësor. Kur Rumi diskuton mbi gjuhën në kuptimin gjuhësor, ai zakonisht përdor fjalën perse “sokhan”, e cila shenjon “të folurit” ose “fjalën”. Megjithatë “sokhan” sipas Rumiut shpesh nënkupton “gjuhën në përgjithësi” në gjuhësinë moderne, më

---

Akiro Matsumoto, studiues, profesor në Universitetin Shën Tomas në Osaka (Japoni).

shumë sesa “të folurit” apo “fjalën” në kuptim të zakonshëm. Mund të themi se thëniet e Rumiut në lidhje me “Sokhan-in” përfshijnë tema të ndryshme të gjuhësisë moderne.

Gjuha shpjegohet në mënyrë të përgjithshme në gjuhësinë moderne si një sistem simbolesh ose sistem shenjash për t’u shprehur dhe për të komunikuar. Një shpjegim i tillë i gjuhës mund të ilustron shumë mirë aspektin funksional të gjuhës, i cili është objekt i shqetësimit akademik për gjuhëtarët modernë. Megjithatë, ky shpjegim i gjuhës për gjuhëtarët modernë jo domosdoshmërisht është një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj pyetjes thelbësore për lidhjen e gjuhës me realitetin sikurse edhe për lidhjen e gjuhës me ndërgjegjen. Në thëniet e Rumiut në lidhje me “sokhan”, pikëpamja e tij mbi lidhjet e gjuhës me realitetin dhe ndërgjegjen shprehen sipas mënyrës së tij.

Vetë Rumiut nuk është filozof që mendon sistematikisht, por ai është një poet me depërtim mistik në realitetin e botës. Prandaj, pikëpamja e tij mbi gjuhën mund të bazohet më shumë në depërtimin e tij poetik dhe intuitën mistike, sesa në një analizë logjike dhe konkluzione prej saj. Për më tepër, këndvështrimet e tij mbi “gjuhën” shprehen dhe propozohen fragmentarisht në veprat e tij. Si pasojë, për ne është e domosdoshme që të rregullojmë komentet e tij mbi “gjuhën”. Komentet e tij të mëposhtme mbi “sokhan” mund të na japin një gjurmë për të kuptuar këndvështrimin e tij mbi gjuhën.

Njeru i urtë e shikon të folurit si një e folur hyjnore që vjen nga qielli; kjo nuk është një gjë e vogël.

Kur ti nuk flet fjalë të mira, ato nuk janë një mijë, ato janë një; por kur ti flet mirë, një fjalë është sa një mijë. Fjala rrjedh nga prapa së keqes – atëherë ju do të shihni se kjo ishte një atribut i Zotit, Krijuesit. (D 9896–98)<sup>1</sup>

Fjala, edhe pse rrjedh nga shpirti, është një mbulesë e shpirtit; Gjuha është një mbulesë për margaritarët dhe bregun e detit. (D921)

Fjala është një anije, dhe të kuptuarit është deti, futu shpejt, që unë të mund të drejtoj anijen!<sup>2</sup> (D1518)

Sipas teologjisë islame, Zoti e krijoi universin me fjalën e tij “*Bëhu!*”, pra sipas dëshmisë kur’anore. Kështu që “gjuha” besohet se ka ekzistuar përpara krijimit të universit, dhe kjo “gjuhë” që i paraprin krijimit, llogaritet si një gjuhë me attribute hyjnore. Gjuha në këtë kuptim është gjuhë e qenieve të përjetshme dhe është në të njëjtën kohë edhe

<sup>1</sup> Shih ‘*Rruga Sufiste e Dashurisë*’. *Mësimdhënia shpirtërore e Rumiut’nga Uilliam C Chittink*, 1983, SUNY, f. 270.

<sup>2</sup> Shih ‘*Fjala është një anije në detin e kuptimit*’: *dise aspekte formale në poezinë lirike të Rumiut nga J. Kristof Burgel në: Poezia dhe misticizmi në Islam*, Trashëgimia e Rumiut, 1987, Kembrixh U.P. f. 46.

shkaku i ekzistencës së të gjitha qenieve. Këtë pikëpamje ka Rumi, siç edhe e pamë në citimet e mësipërme. Gjuha e përjetshme është njëri nga atributet e Zotit. Zoti i Pastër është vetë i mirë. Të gjitha fjalët e përdorura në këtë botë eksperimentale kanë një lidhje ontologjike me gjuhën si një nga atributet hyjnore. Prandaj “gjuha” e jetës sonë të përditshme në mënyrë jo të drejtpërdrejtë lidhet me gjuhën hyjnore. Nëse një fjalë ose një frazë në jetën tonë të përditshme shqiptohet me qëllim ruajtjen e lidhjes me gjuhën hyjnore, ajo do të ketë vlera universale dhe të përjetshme, ashtu sikurse ka gjuha hyjnore. Ajo do të citohet dhe do të përsëritet nga mijëra njerëz. Ky mund të jetë kuptimi i vërtetë i vargut të dytë të citimit të parë, “Kur ti nuk flet fjalë të mira, ato nuk janë një mijë, ato janë një; por kur ti flet mirë, një fjalë është sa një mijë.”

Për dallim, Rumi thotë në vargun D921 se “fjala”(sohkan), edhe pse rrjedh nga shpirti, është një mbulesë për shpirtin / Gjuha është një mbulesë për margaritarët dhe bregdetin”. Pjesa e parë e këtij vargu ilustron hipokrizinë e gjuhës. Gjuha vjen nga shpirti njerëzor për të përshkruar përvojat e tij. Megjithatë gjuha nuk i përshkruan dot ato ashtu siç janë. Gjuha është gjithmonë e kufizuar në aftësitë e saj për të shprehur realitetin. Ajo gjithmonë përshkruan dhe shpreh objektin e saj në mënyrë jo të përsosur. Prandaj, gjuha nuk i përçon shpirtit njerëzor natyrën e vërtetë të gjërave ashtu siç janë ato realisht. Në këtë kuptim, gjuha është një barrierë për shpirtin njerëzor, duke fshehur natyrën e vërtetë të gjërave ashtu siç janë ato. Kjo mund të jetë arsyeja pse Rumi përpiloi pjesën e parë të vargut të mësipërm. Për më tepër, Rumi shpreh pikëpamjen e tij në lidhje me raportet e gjuhës me të kuptuarit siç shihet më sipër në citimet e tretë. Gjuha lidhet me anijet në detin e të kuptuarit. Kjo do të thotë se sipas pikëpamjes së Rumiut, gjuha asnjëherë nuk e arrin atë që shtrihet nën sipërfaqen e detit të të kuptuarit. Ai thotë:

Të shprehurit zakonisht dështon të arrijë tek të kuptuarit;

Prandaj Profeti ka thënë: (Kush e njeh Zotin) gjuha e tij lëkundet.

Gjuha është (sikur) një astrolab për llogarinë e saj; Sa di ajo në lidhje me qiellin dhe diellin? (M.Vol II. 3013–3014)<sup>3</sup>

Në këtë citim, fjala originale perse për fjalën “shprehje” në rreshtin e parë është “lafz” dhe jo “sokhan”. Fjala “lafz” këtu ka pothuajse të njëjtin kuptim me fjalën gjuhë (sokhan). Rumi me të drejtë shqetësohet për të metat e gjuhës në funksion të përçimit të kuptimit të së nënkuptuarës. Në këtë citim, pamjaftueshmëria e gjuhës për të përfshirë kuptimin është e shprehur qartë. Raporti i gjuhës me kuptimin (ma’ni) është një nga shqetësimet kryesore në lidhje me gjuhën. Ai thotë:

<sup>3</sup> Shih *Mesnevi Ma’nevi Rumi, Përktim i volumit të parë*, botuar dhe përkthyer nga Reynold A. Nikolson. Ribotuar më 1977, Kembrixh. f. 377.

Letrat janë ena; kështu që të kuptuarit është (në përmbajtje) si uji (por) deti i kuptimit është (me Zotin) “*me Atë në Umm al-kitab*”.

Në këtë botë deti i hidhur dhe deti i ëmbël (janë të ndarë) ndërmjet tyre ka një barrierë, të cilën ata nuk përpiqen ta kapërcejnë.

Ta dini se të dy këto rrjedhin nga e njëjta origjinë. Kalojini ata të dy (dhe gjithmonë) shkoni drejt origjinës së tyre (M. Vol.1. 295–298)<sup>4</sup>.

Në këtë cilësim, Rumi përdor fjalën “germa” (harf) në vend të “gjuhë” (sokhan). Megjithatë, nga këndvështrimi i këtij kuptimi, është e qartë se ai me fjalën “germë” nënkupton pothuajse të njëjtën fjalë, pra “gjuhë”. “Gjuha” këtu përngjasohet prej tij me enën për mbajtjen e ujit. Por, uji në enë është vetëm një pjesë e “detit të kuptimit” (bahr-i ma’ni) i cili është paskajshmërisht i gjerë, sepse ai ruhet në librin origjinal, të ruajtur në botën e përjetshme, hyjnore. Prandaj është e qartë se Rumi beson se “gjuha” është e pamjaftueshme për të shprehur tërësinë e kuptimit. Sërisht, në tregimin e famshëm mbi elefantin në shtëpinë e errët, Rumi thotë:

Kjo mënyrë e të shprehurit, gjithashtu, është jo e përsosur dhe e gjymtuar; Fjala e përsosur gjendet vetëm atje matanë.

Nëse ai (i shenjt) flet nga ai (burim), këmbët tuaja do të pengohen. Dhe nëse ai nuk flet fare, oh, mjerë për ju!

Dhe nëse ai flet në formë të padëshiruar (materiale), ju do t’i bindeni asaj forme, o rini! (M 1277–79)<sup>5</sup>

Sipas Rumiut, “fjala që s’ka të meta” (*an sokhan ki nist naqis*), është gjuha e përsosur dhe ekziston vetëm në botën hyjnore. Vetëm profetët e zgjedhur të Zotit mund ta sjellin atë nga bota hyjnore në botën njerëzore. Për aq kohë sa gjuha njerëzore është e krijuar, gjithmonë do të jetë e papërsosur dhe e papërshtatshme për të përshkruar realitetin në mënyrë të përsosur. Sa i përket rolit të gjuhës, Rumi me të drejtë thekson:

Fjalët (sokhan) janë thjesht “hije” të realitetit (Sayah-yi haqiqat). Ato janë ashtu siç kanë qenë, një degë e realitetit. Nëse hijet mund të joshin, aq më shumë mund të joshë realiteti!

Fjalët janë thjesht pretekst. Është elementi i simpatisë ai që e josh një njeri ndaj një tjetri, jo fjalët.”(Fihi ma fihi, kapitulli i dytë)<sup>6</sup>.

Prandaj, mund të themi se Rumi, njëri nga artistët më të shquar të botës, nuk kishte shumë besim tek gjuha. Apo, duhet thënë se Rumi ishte poet aq eminent me pikëpamje të thella ndaj gjuhës, sa që ai e dinte

<sup>4</sup> Ibid., f. 19.

<sup>5</sup> Ibid., f. 72.

<sup>6</sup> Citimet në gjuhën angleze në këtë shkrim janë marrë nga *Shenjat e të Paparës, Diskurset e Xhelaludin Rumiut*, U. M. Thackson. Nju-Jork, 1993.



mjaft mirë kufirin e rrezes efektive të veprimit të gjuhës. Gjuha është thjesht një hije e realitetit.

## 2. Pikëpamja komplekse të gjuhës në *Fihi ma Fihi* (diskurset e Rumiut)

Pikëpamjet e Rumiut mbi gjuhën në bazë të efektit të saj, gjithashtu përmenden shpesh në veprën e tij *Fihi ma Fihi* (Diskurset e Rumiut). Ai e krahason gjuhën me gjëra të ndryshme në veprën e tij, dukë përfshirë ujin, diellin, anijen e kështu me radhë. Në një vend ai e vlerëson lart rolin e gjuhës, siç shihet në thënien e tij; “Fjala është si dielli. Të gjithë burrat marrin ngrohtësi dhe jetë nga ai. Dielli gjithmonë ekziston dhe është i pranishëm gjithmonë, dhe gjithsecili merr ngrohtësi nga ai” (*Fihi ma Fihi*, Kapitulli 52). Ai thotë në një vend tjetër se “gjuha” (notq) ekziston përjetësisht” (ibid., Kapitulli 53).

Por në një vend tjetër, ai thotë: “fjalët janë të përkohshme, zërat janë të përkohshëm, buzët dhe goja janë të përkohshme (ibid., Kreu 4) ose “këto fjalë nuk janë kaq të mëdha. Ato nuk janë aq të forta. E si mund të jenë ato të mëdha? Mbi të gjitha ato janë thjesht fjalë.” (ibid).

Në citimet e mësipërme Rumi thekson opinionet e tij negative rreth vlerës së gjuhës, paralelisht me pikëpamjet pozitive. Ai duket sikur luhetet në mes një pikëpamje negative dhe pozitive në lidhje me gjuhën. Nganjëherë thotë se gjuha është një gjë e përkohshme, por, nga ana tjetër, thotë se gjuha është një gjë e përhershme. Kjo kontradiktë në thëniet e tij në lidhje me gjuhën mund të pasqyrojë të kuptuarit e marrëdhënies së gjuhës me ndërgjegjen njerëzore. Si një mysliman i devotshëm Rumi asnjëherë nuk beson se njerëzit mund të bëhen bërës (agjentë) të vërtetë të veprimtarive të tyre. Të gjitha veprimtaritë njerëzore, përfshirë edhe të folurit, janë krijuar nga Zoti, i Plotfuqishëm, i cili i krijoi të gjitha veprimtaritë njerëzore. Ai thotë në vijim;

***“All-llahu i cili i ka dhënë aftësi për të folur çdo sendi, edhe neve na ka bërë që të flasim. (41:21).*** Ai bën që unë të flas, ashtu siç bën gjithkënd të flasë, ashtu siç i bën muret dhe dyert, gurët dhe grumbujt e baltës të flasin. Krijuesi, i cili mund të pajisë çdo gjë me të folur, po ashtu ka mundësi t’i japë gjuhës fuqinë e të folurit. Gjuha juaj është një copë mishi, e kështu është edhe fjala. A është gjuha e mençur? Nga shumë gjëra të cilat ju i keni parë, nuk duket edhe aq e pamundur që ajo të jetë. Përndryshe, gjuha është thjesht një pretekst i Zotit. Kur ai e urdhëron atë të flasë, ajo do të flasë, dhe ajo thotë çdo gjë që Ai e urdhëron të thotë.

Gjuha është në përpjesëtim me aftësinë e njeriut. Fjalët tona janë si uji, kur e lëshon ujatori<sup>7</sup>. (ibid., Kreu 25)

Njerëzit janë veprimtarë (agjentë) të Zotit dhe gjuha e tyre është dhënë nga vetë Zoti.

Kjo pikëpamje nuk mbështetet vetëm nga Rumi, por edhe nga myslimanët në përgjithësi. Sipas këtij këndvështrimi, njerëzit në vetvete nuk janë të aftë për të qenë krijues të gjuhës së tyre. Gjuha është një gjë e huazuar nga Zoti. Por, siç pamë më sipër, gjuha është po ashtu “hija” e realitetit. Nuk është asnjëherë në gjendje që ta shprehë vetë realitetin. Prandaj Rumi gjithmonë ka qenë i frustruar nga aftësia e gjuhës. Ndoshta ishte ky frustrim rreth gjuhës ajo që e bëri Rumiun të thotë konstatime kaq kundërthënëse në lidhje me vlerën e saj.

Nga ana tjetër, Rumi ka kozmologjinë e tij gjuhësore për të ilustruar pozitën e gjuhës, por sipas këndvështrimit të tij. Sipas kozmologjisë së tij gjuhësore, gjuha, e cila përbëhet nga gjëra të përfaqësuara (musauarat-o mahsusat) kuptohet si një manifestim i ndjeshëm i imazheve mendore të cilat ekzistojnë në botën e imazheve mendore (‘alam al-hajal). Si pasojë, kjo botë e imazheve mendore është vendlindja e gjuhës, ekzistenca e të cilës është një shkallë më lart sesa ekzistenca e gjërave të ndjeshme. Kjo botë e imazheve mjekësore është e gjerë dhe e madhe. Në fakt është një botë tjetër e madhe ajo që është bota e Krijuesit, thotë Rumi.

Në krahasim me botën e koncepteve dhe të ndjesive, bota e imazheve mendore (‘alam al-hajal) është më e gjerë, sepse të gjitha konceptet janë të lindura nga imazhet mendore; por bota e imazheve mendore është e ngushtë në krahasim me botën ku krijohen imazhet mendore. Kjo më së miri kuptohet nga fjalët, por realiteti i substancës është i pamundur të kuptohet nëpërmjet shprehjeve verbale.

Për çfarë shërben atëherë të shprehurit verbal? Mund të pyesë dikush.

Dobia e fjalëve është për të bërë që ju të kërkoni dhe për t’ju eksituar, por objekti i kërkimit tuaj nuk mund të arrihet nëpërmjet fjalëve. Po të mos ishte kështu, nuk do të kishte nevojë për grindje dhe vetasgjësim. Fjalët janë si të shikosh diçka që lëvizë në distancë: ti ecën në drejtim të saj për ta parë atë nga afër, dhe jo për ta parë atë se si lëviz. E folura rationale e njeriut është pothuajse e njëjta gjë. Ajo ju eksiton për të kërkuar konceptin, edhe pse ju nuk mund ta shihni atë në aktualitet. (ibid., Kreu 52).

Nga ky paragraf bëhet e qartë se në kozmologjinë e Rumiut universi ndahet në tri sfera, të cilat janë: sfera e gjuhës, sfera e imazheve mendore, dhe sfera e Zotit. Sfera e gjuhës është bota eksperimentale,

---

<sup>7</sup> Ai që rregullon lëshimin e ujit në një ujësjellës.

ndërsa sfera e imazheve mendore shkon përtej perceptimit njerëzor. Për më tepër, bota e Krijuesit që është sfera e realitetit, ekziston mbi sferën e imazheve mendore. Gjuha është e paaftë të përfshijë sferën e imazheve mendore, ashtu sikur edhe sferën e Krijuesit.

Në këtë kozmologji, sfera e imazheve mendore ka një vend shumë të rëndësishëm. Sfera e imazheve mendore është një përmasë ontologjike po aq sa edhe transcendentale dhe kjo është një botë e ndërmjetme midis sferës hyjnore dhe sferës së gjuhës. Imazhet mendore, të cilat ekzistojnë në këtë botë ndërmjetësuese, prodhojnë fjalë dhe fraza, që do të thotë gjuhë. Prandaj, sfera e imazheve mendore mund të krahasohet me botën e imazheve fillestare (‘alam al-mithal) në kozmologjinë e shkollës së unitetit të qenies. Ashtu sikur imazhet fillestare janë shkaqe formuese të qenieve në botën shqisore, por ato nuk janë plotësisht të njëjta me qeniet e ndjeshme, imazhet mendore janë shkaqe formuese të fjalëve, por ato shtrihen shumë përtej përmbledhjes së aftësisë së fjalëve.

Bazuar në këtë dituri mbi kufizimet e gjuhës, roli i gjuhës është i kufizuar nga Rumi sipas rolit të nxitjes së njerëzve për të kërkuar realitetin. Vetë gjuha nuk është realitet, por është një shenjë udhëzuese për të arritur tek realiteti. Prandaj, sapo të mësohet/përfitohet realiteti, gjuha nuk ka më dobi dhe nuk ka vlerë. Vlera e gjuhës, sipas Rumiut, është e kufizuar dhe kalimtare. Megjithatë, ai është i vetëdijshëm për rëndësinë e gjuhës sipas raporteve të saj me veprimin. Ai thotë:

“Baza e çdo gjëje është e folura dhe fjala (asl-i çiz-ha hame goft-ast). Tani ju nuk dini asgjë rreth “të folurit” dhe “fjalës”. Ju e përçmoni atë; dhe prapëseprapë e folura është fryti i pemës së veprimit (‘amal), sepse fjala rrjedh nga veprimi. Zoti e krijoi botën nëpërmjet fjalës duke thënë **BËHU!** Dhe ajo bëhet (36 : 82). Besimi ekziston në zemra, e nëse nuk e shpreh me zë, ajo nuk ka kuptim. Lutja, e cila është një grup veprimesh, nuk është korrekte pa recitimin e Kur’anit. Tani kur ju thoni se fjalët e kësaj kohe nuk janë të besueshme, si ka mundësi që ne ju dëgjojmë ju, duke thënë se fjalët tuaja nuk janë të besueshme? Edhe këtë ju e thoni nëpërmjet fjalëve (ibid., Kreu 16).

Në këtë paragraf Rumi thotë se fjala ose gjuha është bazë e gjërave dhe fjala rrjedh nga veprimi. Për derisa krijimi i Kozmosit është i rëndësishëm, kozmosi është krijuar nga fjala hyjnore **BËHU!** ashtu siç përmendet në Kur’an. Në këtë kuptim, gjuha, pa dyshim është baza e gjithçkaje. Fjala “*Bëhu*” nuk është thjesht një fjalë, por veprimi i krijimit. Prandaj gjuha konsiderohet si një veprim në këtë rast. Me fjalë të tjera, gjuha shprehimisht është identike me veprimin. Kjo nënkupton se gjuha me aktualitetin e saj është vetë veprimi. Përpara aktit të të shprehurit, gjuha është e heshtur, që do të thotë gjuhë me rezerva. Si pasojë, gjuha me rezerva nuk është veprim dhe nuk njihet. Ajo mbetet në

detin e kuptimit si një gjuhë e pafolur. Nëse duam që gjuha të jetë efikase, ajo duhet të bashkohet me veprimin e shprehjes.

Gjuha në mundësi (potencialitet) është ligjërim përpara të shprehurit dhe nuk është veprim, por kuptim përpara artikulimit. Fjala me rezerva mbetet në botën e kuptimit. Nëpërmjet aktit të të folurit, gjuha në gjendjen e rezervës është e kuptueshme dhe bëhet efikase. Frazja “e folura është fryt i pemës së besimit, ngase fjala rrjedh nga veprimi” në citimin e mëhershëm, do të thotë se fjala nuk është rezultat i veprimit, por fjala gjithmonë shoqërohet me veprim, kur ka ndikim.

Megjithatë, Rumi po ashtu është i ndërgjegjshëm ndaj gjuhës së pa shprehur. Gjuha e heshtur përpara të shprehurit cilësohet nga ai si racionalitet (notk), e cila njihet si një lloj gjuhe që është e pashmangshme tek njerëzit, siç shihet më poshtë;

“Njeriu është një kafshë rationale”. Njeriu është një përzierje mes kafshërisë (hajvani) dhe racionalitetit (notk), dhe kafshëria e tij është pjesë e pandashme e tij, ashtu sikur racionaliteti. Edhe nëse ai nuk flet me zë, ai flet me vete: ai gjithnjë flet. Ai është sikur një përrua i përzier me baltë. Uji i pastër është fjala e tij rationale, dhe balta është kafshëria. Balta është thjesht rastësore. A nuk e shikoni se kur balta dhe format që ajo merr të largohen apo të zhduken, mbetet vetëm fuqia e të shprehurit në mënyrë rationale për mirë apo për keq? (Ibid., Kreu 16).

Sipas Rumiut, kafshë rationale është ajo që gjithmonë flet me veten. Edhe nëse njeriu nuk shpreh asnjë fjalë, ai/ajo gjithnjë cilësohet si një qenie e cila flet me vete, sepse njerëzit kanë racionalitet (notk), i cili është shkaktar i të shprehurit me zë, sikur edhe i të folurit me vete. Fjala “racionalitet” këtu mund të krahasohet me “gjuhën – I (interne) (gjuhën e brendshme) në gjuhësinë moderne.

Tani, ne tashmë kemi parë kozmologjinë gjuhësore të Rumiut, i cili e përshkruan kozmosin si të trefishtë, që përbëhet nga sfera e gjuhës së ndjeshme, sfera e imazheve mendore dhe sfera e esencës dhe attributeve hyjnore. Pastaj, racionaliteti si “gjuhë e shprehur” duhet t’i përkasë botës së imazheve mendore sikurse edhe formave të tyre rationale.

Nëpërmjet studimit të shkrimeve të Rumiut mbi gjuhën në kreun e parë dhe të dytë, tani ne kemi një skicë të pikëpamjeve të Rumiut mbi gjuhën. Në veprat e Rumiut, gjuha cilësohet si e kufizuar në aftësitë e saj për të paraqitur realitetin, por ajo vepron me efikasitet si simbol apo shenjë për t’i drejtuar njerëzit drejt realitetit. Prandaj, gjuha është efikase dhe e vlefshme për njerëzit përpara se ata të arrijnë te realiteti. Nga ana tjetër, gjuha konsiderohet si një gjë e krijuar nga Zoti dhe njerëzit nuk janë të aftë të jenë krijues të gjuhës. Rumi beson se gjuha e ka origjinën tek imazhet mendore, të cilat janë më të gjera sesa sfera e gjuhës. Për shkak të një kufizimi të tillë, gjuha është në gjendje të përshkruajë një

pjesë të imazheve mendore, të cilat janë racionaliteti dhe të kuptuarit. Prandaj, gjuha krahasohet me anijen në oqeanin e kuptimit.

Megjithatë, Rumi u mbi të gjitha është një poet. Megjithëse ai shqetësohet vërtet për natyrën e vërtetë të gjuhës dhe kufizimet e saj, ai neve na ka lënë shumë poema. Unë do të trajtoj strukturën filozofike të poezisë së tij në vijim.

### 3. Poezia dhe misticizmi i Rumiut

Rumi u na ka lënë dy përmbledhje të mëdha poemash që janë “Divan-i Shams-i Tabrizi” dhe “Mesnevi Ma’nevi”. Të dyja këto janë përmbledhje poemash mistike. Bazuar në opinionin e profesorit Izutsu, unë do të trajtoj poezinë e Rumiut dhe lidhjet e saj me gjuhën. Sipas kuptimit që jep prof. Izutsu ka një dallim në mes “Divan-i Shams-i Tabrizi” dhe “Mesnevisë” për sa i përket misticizmit dhe gjuhës. Profesor Izutsu në lidhje me natyrën e vërtetë të poezisë së Rumiut dhe misticizmit të tij në “Divan-i Shams-i Tabrizi” thotë se: “Imazhet e bukura dalin nga mesi i thellësisë së përvojës mistike, tek e cila njerëzit e rëndomtë nuk depërtojnë dot. Këto imazhe ndeshen dhe gërshetohen me njëri-tjetrin dhe kështu ato kthehen në fjalë me një dallgëzim të veçantë ritmik. Thuhet se në Persi ka shumë poetë gjenialë, të cilët mund t’i shprehin përvojat e tyre mistike në nivele dhe përmasa të ndryshme me imazhe të bukura poetike. Por gjithashtu, thuhet se ritmi poetik i Rumiut është një ritëm i pakrahasueshëm dhe nuk mund ta imitojë askush. Kur një virtuoz i recitimit poetik reciton poemat e tij, dëgjuesit gjithmonë thellohen në një ndjenjë qetësie, në të cilën bota e mrekullueshme e dehjes që rrethon ndërgjegjen njerëzore, bëhet një manifest i gjendjes së meditimit të thellë.

Në veprën e tij *Fihi Ma Fihi*, vetë Rumi thotë se fjalët e tij të thëna në një gjendje të tillë nuk janë më fjalë të tijat. Fjalët dalin nga diku dhe rrjedhin drejt diçkaje. Rrjedhja e fjalëve ka një ritëm dhe dallgëzim të papërshkrueshëm, i cili është identik me ritmin dhe dallgëzimin e ndërgjegjes së mistikës në gjendjen e meditimit. Në këtë mënyrë, poezia dhe misticizmi janë bashkuar tek Rumi. Sa u përket poemave të Rumiut, nuk është e përshtatshme të themi se ai shprehte përvojat e tij mistike në poemat e tij. Por, duhet të themi se përvoja e tij poetike është e barabartë me përvojën e tij mistike. Në rastin e tij, vetë fjalët e tij janë në gjendjen e dehjes mistike. Kjo dehje jo vetëm që ekziston në kuptimin e shprehjes, por po ashtu edhe në kuptimin e rrjedhjes së fjalëve veçmas nga kuptimi i tyre. Prandaj vetë fjalët janë

dehje mistike.<sup>8</sup> (përkthim i parafrazuar i poshtëshënimit nga përkthimi i veprës së tij *Fihi ma Fihi* në gjuhën japoneze).

Kjo është natyra e vërtetë e poezisë së Rumiut në veprën “Divan-i Shams-i Tabrizi”. Me fjalë të tjera, vetë fjalët poetike janë të lyera mirë me dehjen mistike.

Megjithatë sipas Prof. Izutsus kjo ilustron një nga dy aspektet e poezisë së Rumiut. Aspekti i dytë i poezisë së Rumiut gjendet në veprën “Mesnevi Ma’nevi”. Është një vepër vërtetë mistike. Kjo bëhet e qartë nga vetë titulli “*Mesnevi Ma’nevi*”, sepse fjala perse apo arabe “Mesnevi” ka kuptimin “Bazuar në depërtime mistike” apo “të devijuarit nga aspekti i vërtetë i realitetit të shfaqur në përvojën mistike”. Në fakt, filozofia themelore e trajtësuar në 26.000 dyvargëshat e 6 vëllimeve, përplot me imazhe poetike, ashtu sikurse edhe një numër të jashtëzakonshëm përvojash, është filozofia e sufizmit apo misticizmi mbi të gjitha. Është një libër i rrëfimit të përvojës së një sufisti. Në këtë kuptim “*Mesnevi Ma’nevi*” nuk është e ndryshme nga “*Divan-i Shams-i Tabrizi*”.

Megjithatë është gjetur një dallim rrënjësor në mes këtyre dy veprave, sepse “*Mesnevi Ma’nevi*” është një përmbledhje poemash të prodhuara me vetekzaminimin e Rumiut dhe reflektimin e ndërjegjes, ndërsa “*Divan-i Shams-i Tabrizi*” është prodhuar me dehje mistike.<sup>9</sup>

Sipas prof. Izutsu, në “*Divan-i Shams-i Tabrizi*”, njeriu gjen dehjen e ndërjegjes. Izutsu thotë:

Në veprën “*Divan-i Shams-i Tabrizi*” ndërjegjja e dehur e Rumiut shpreh drejtpërdrejt fjalët e dehjes mistike. Nga ana tjetër, ndërjegjja e Rumiut tek “*Mesnevi Ma’nevi*” është më e shtëllë. Tek *kjo e fundit*, përvoja mistike e realitetit të Rumiut nuk është artikuluar në mënyrë të drejtpërdrejtë, por ndërjegjja e tij e kthjellët reflektuese ekzaminon përvojën mistike të realitetit dhe pas këtij ekzaminimi ndërjegjja e tij reflektuese shpreh fjalët në lidhje me përvojat e thella të realitetit.

Për këtë arsye “*Mesnevi Ma’nevi*” është një vepër skajshmërisht filozofike sipas përmbajtjes së saj. Në këtë vepër një mistik shndërrohet në një metafizik. Kjo do të thotë se përvoja mistike e realitetit është transformuar nëpërmjet ndërjegjes reflektive në një pikëpamje metafizike të botës. Megjithatë, ndryshe nga Ibn Arabiu dhe Sadr al-Din Kunjaviu, një nga nxënësit e Ibn Arabiut dhe mik i Rumiut, të cilët që të dy i shprehnin mendimet e tyre në formë filozofike, Rumiut në veprën “*Mesnevi*” nuk e shpreh pikëpamjen e tij mbi botën metafizike në

<sup>8</sup> Shih Rumi Goroku, Përkthim në japonisht i prof. Izutsu i veprës *Fihi ma Fihi*, *Iuanami Shoten*. 1978. f. 417.

<sup>9</sup> *Ibid.*, f. 420.

mënyrë filozofike, por e ka shprehur atë në formën e një serie të gjatë imazhesh të bukura poetike. Prandaj, përveç faktit se “*Mesnevi*” është një vepër në thelb filozofike, dimensionin e saj filozofik bëhet i dukshëm vetëm pas shqyrtimit të imazheve poetike, të cilat duket se nuk kanë lidhje me filozofinë.<sup>10</sup>

Prandaj, megjithëse edhe *Mesnevi* edhe *Divan-i Shams-i Tabrizi*, janë poezi mistike, *Mesnevia* është më filozofike sesa *Divan-i Shams-i Tabrizi*. Për më tepër, *Mesnevi* ka strukturë më të komplikuar sesa *Divan-i Shams-i Tabrizi*, për shkak të natyrës së veçantë të fjalëve me dehje mistike në të. Edhe pse fjalët tek *Mesnevi* nuk janë shprehje direkte të dehjes mistike, ato shprehen pas një vetëshqyrtimi të përvojës së dehjes mistike. Ato përshkruhen në gjendje të kthjellët pas vetëshqyrtimit dhe pas një rindërtimi të dehjes mistike. Megjithatë, në dallojmë ngjyrën e dehjes mistike në shprehjet poetike në *Mesnevisë* të shkruar me ndërgjegje të kthjellët. Ritmi frazues tek *Mesnevi* e ruan akoma aromën e dehjes mistike sikur edhe ekstazën dhe ndërgjegjja e lexuesit të *saj* është e detyruar që ta përjetojë gjendjen e dehjes mistike. Megjithatë, kjo aromë e dehjes mistike nuk vjen drejtpërdrejtë nga dehja mistike, sepse, siç thamë më herët, *Mesnevi* është një produkt i ndërgjegjes së kthjellët, ashtu sikur që është fryt i vetëshqyrtimit të dehjes mistike të vetë Rumiut. Aroma e dehjes mistike, e cila rrjedh nga *Mesnevia*, duhet të kuptohet si rezultat i reflektimit gjuhësor të dehjes imagjinare në dimensionin e përvojës së imazheve. Ky do të ishte çelësi për të kuptuar strukturën e brendshme të ekzistencës së Rumiut.

Rumi ishte një njeri i imazheve. Tek ai, gjithçka kapet pas imazheve. Çdo përvojë, përfshirë edhe vetëshqyrtimin filozofik, merr imazhet e tij dhe shfaqet nëpërmjet dimensionit të imazheve. Të gjitha llojet e përvojave në nivelin e ndërgjegjes dhe jondërgjegjes shfaqen me imazhe. Prandaj, mënyra e të menduarit të Rumiut është parimisht imagjinare. Kjo nënkupton që përvoja e Rumiut ndaj realitetit është tërësisht imagjinare. Edhe në përvojën e tij të realitetit maksimal, me fjalë të tjera, edhe përvoja e tij e *asgjë-së* (fena) është një përvojë imagjinare për arsye se *Asgjë-ja* është përtej të gjitha llojeve të imazheve si dhe përshkrimeve.<sup>11</sup>

Të gjitha llojet e përvojave tek Rumi stimulojnë sferën e imazheve në ndërgjegjen e tij, kështu që imazhet e tij të sakta krijohen në mendjen e tij. Me fjalë të tjera, ai i ripërjeton përvojat përtej imazheve dhe përshkrimeve në sferën e imazheve të ndërgjegjes së tij. Kjo sferë e imazheve quhet bota e imazheve fillestare (‘alam al-mithal) në filozofinë sufiste, të cilën Rumi e quan sfera e imazheve mendore. Kjo botë e

<sup>10</sup> Ibid., f. 420.

<sup>11</sup> Ibid., f. 420.

imazheve fillestare është një botë e pavarur jomateriale, në të cilën edhe konceptet e pastra shfaqen nëpërmjet imazheve dhe qenieve materiale në format dhe imazhet e tyre jomateriale. Në momentin e tranzicionit nga gjendja e qetësisë absolute në gjendjen e aktivitetit në ndërgjegje, imazhe të panumërta rrjedhin nga gëzimi eksitues i arritjes në ekzistencë mendore të ndërgjegjes së tij, dhe secili nga këto imazhe zgjedh fjalën e tij për të fituar shprehjen e drejtpërdrejtë gjuhësore.

Ngaqë fjalët dhe frazat e Rumiut marrin shprehje gjuhësore me anë të një procesi të tillë, fjalët e tij janë të lyera me ekstazë të këndshme të imazheve. Në këtë gjendje, ai shpreh fjalët e tij, të cilat nuk janë nën kontrollin e tij. Për këtë arsye ai shprehet si vijon;

“Unë nuk i kam nën kontroll fjalët e mia, dhe kjo më dhemb, sepse unë dua që t’i këshilloj miqtë e mi; por fjalët nuk do të udhëhiqen nga unë. Për këtë arsye unë jam i befasuar; por duke pasur parasysh faktin se fjalët e mia janë më të larta se unë dhe se unë jam subjekt i tyre, jam krenar sepse kurdo që të vijnë fjalët e folura nga Zoti, ato japin jetë dhe kanë ndikim të thellë.<sup>12</sup>

Nga studimi i mësipërm, mund të themi se shpirti i Rumiut ishte i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me sferën e imazheve mendore, ose ndërgjegjja e tij ishte vetë bota e imazheve fillestare. Megjithatë, kur këto imazhe shndërrohen në fjalë, format origjinale të këtyre imazheve nuk shfaqen në mënyrë të përsosur në gjuhë për shkak të kufizimeve të gjuhës. Pastaj, imazhet mendore drejtohen drejt fjalëve të tjera për të kënaqur dëshirën për t’u shprehur. Ky proces përsëritet pa ndërprerë. Për këtë arsye ai thotë: “Unë nuk i kam nën kontroll fjalët e mia dhe kjo më dhemb”, siç e pamë më lart. Si rezultat, deti i fjalëve vjen në jetë. Mbase ky det i fjalëve është poezia e Rumiut.

---

<sup>12</sup> *Shenjat e së panjohurës, Diskursi i Xhalaludin Rumiut*, U. M. Thackson. Nju-Jork 1993, f. 222 .



Suela XHYHERI

## HISTORIA E PANJOHUR E LETRËS SË PROFETIT MUHAMED DREJTUAR MBRETIT TË PERSISË KHUSRAW II<sup>1</sup>

Në fund të vitit të 6-të e në fillim të vitit të 7-të mbas Hixhrit, mbas kthimit të tij nga Hudaibiyah, Profeti Muhamed vendosi t'u dërgojë nga një letër mbretërve të vendeve përtej Gadishullit Arabik, duke i ftuar të përqafojnë islamin. Duke dashur që të vërtetojë kredencialet e të dërguarve të tij, ai vendosi në secilën letër nga një vulë prej argjendi, ku ishin gdhendur fjalët “Muhamedi i dërguari i Allahut”<sup>2</sup>.

Letrën për mbretin e Persisë ai ia kishte besuar Abdullah bin Huzâfa al-Sahmî-t<sup>3</sup>. Në fund të pergamenës Profeti kishte vendosur

---

<sup>1</sup> Khosrow II (i njohur në burimet klasike si Chosroes II; në persishten mesjetare si Husrō(y), i mbiqajtur “Aparvëz” (“Fitimtari”), i njohur edhe si Khusraw Parvëz (në persishten e re: خسرو پرويز), ishte mbreti i fundit i madh i Perandorisë Sasanide, mbretëroi nga viti 590 deri në vitin 628.

<sup>2</sup> Sahih Al-Bukhari 2, 872, 873.

<sup>3</sup> Vetë emri i këtij lajmëtarit tregon se edhe ky ishte një i konvertuar rishtas në fenë islame, pasi *Abdullah* do të thotë “biri i Allahut” dhe ishte një emër që vihej, madje vihet edhe sot për të gjithë meshkujt e sapokonvertuar në fenë islame.

Lajmëtarët me letrat e tjera ishin:

*Amr bin Umayyah al-Damri*, i dërguari tek mbreti i Etiopisë (Abisinia e atëhershme) të quajtur *Ashhama ibn Abjar*.

*Dihyah bin Khalifa Kelbi*, i dërguari tek perandori i Bizantit Herakliu.

*Hatib bin Ebi Baltaeh*, i dërguari tek mbreti i Egjiptit i quajtur *Muqawqis*.

*Allabn al-Hazermi*, i dërguari tek mbreti i Bahreinit i quajtur *Munzir ibn Sawa Al Tamimi*.

*Amr ibn al-As*, i dërguari tek mbreti i Omanit i quajtur *Abd Al-Jalandi*.

*Salit bin Amri*, i dërguari tek mbreti i Yamama i quajtur *Hawza bin Ali*. *Yamāma* (në arabisht: اليمامة *Yam-al, āma*, përkth. “pëllumb”) është një rajon në Arabinë antike, i cili

vulën e tij, mbi të cilën ishte mbivendosur ky shënim: “Profeti i Allahut Muhamed”<sup>4</sup>. Historianët bashkëkohës e kanë regjistruar përmbajtjen e letrës si më poshtë, duke bërë vetëm ndryshime të vogla shkronjash:

“Në emër të Allahut, Mirëbërësit, Më të Mëshirshmit.

Nga Muhamedi, i Dërguari i Allahut, drejtuar Khusraw-it II, mbretit të Persisë.

Paqja qoftë mbi atë, i cili ndjek udhën e vërtetë, beson në Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe dëshmon se nuk ka zot tjetër përveç Allahut të Vetëm dhe të pashoq dhe se Muhamedi është Skllavi dhe i Dërguari i Tij. Unë ju ftoj ju për të pranuar fenë e Allahut. Unë jam i Dërguari i Allahut i dërguar për të gjithë njerëzit, në mënyrë që unë mund të mbush me frikën e Allahut çdo person që jeton dhe që dënimi të bëhet kundër të gjithë atyre jobsimtarë, të cilët mohojnë të Vërtetën. Pranoni Islamin si fenë tuaj, në mënyrë që ju të mund të jetoni në siguri, përndryshe, ju do të jeni përgjegjës për të gjitha mëkatet e Magianëve”.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ مِنْ مُحَمَّدٍ عَبْدَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ إِلَى كَسْرَى عَظِيمِ فَارِسَ سَلَامٍ  
عَلَى مَنْ اتَّبَعَ الْهُدَى وَأَمَّنَ بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ وَشَهِدَ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ  
وَإِنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ . ادْعُوكُمْ بِدَعَايَةِ اللَّهِ فَإِنِّي أَنَا رَسُولُ اللَّهِ إِلَى النَّاسِ كَافَّةً لِأَنْزَلُ  
مَنْ كَانَ حَيًّا وَيُحِقُّ الْقَوْلَ عَلَى الْكَافِرِينَ سَلَّمَ تَسْلَمَ . فَإِنَّ آيَاتِي فَأَمَّا عَلَيْكَ أَيُّهَا الْمَجُوسُ .

**Figura 1.** Teksti i pergamenës origjinale të profetit Muhamed drejtuar mbretit të Persisë, Khusraw II i kthyer në gjuhën moderne arabe (sipas Aboussouan 1974).

---

shtrihet në pjesën lindore të Rrafshnaltës Najd, dhe ndodhet në territorin e sotëm të Arabisë Saudite.

*Shiya bin Wahab*, i dërguari tek mbreti i Damaskut i quajtur *Harith bin Ebi Shamir Al-Ghassani*.

Një dërguar u sulmua nga banditët.

*Dhiyah bin Halife el-Kelbi*, i dërguari tek mbreti i Basorës (Basra), i cili nga ana e tij ia dërgoi atë Perandorit të Bizantit Herakliut.

(Akbar Shāh K̲h̲ān Najtbābādī, *History of Islam*, vëll. 1)

<sup>4</sup> C. Aboussouan, Letter from the Prophet Muhammad to Khusraw, King of Persia, (nën kujdesin e C. Aboussouan) *Art Islamique dans les collections privées libanaises*, Beyrouth 1974.



**Figura 2.** Pergamena origjinale e profetit Muhamed, në të cilën duken qartë grisjet që janë bërë nga mbreti i Persisë, *Khusraw II*. Kjo letër e shkruar në pergamenë është një ndër shfaqet më të rëndësishme të kaligrafisë arabe, në të cilën është parashikuar e ardhmja kohore dhe shpirtërore e islamit (sipas Aboussouan 1974).

Sipas asaj çka thotë legjenda, letra u paraqit dhe u përkthye përpara mbretit *Khusraw II* (arabisht: كسرى), i cili, krenar siç ishte, pasi dëgjoi vetëm fjalët e para dhe vuri re që emri i profetit Muhamed ishte i vendosur mbi emrin e tij, e grisi atë dhe e ndau në dy pjesë. *Khusraw-i II* pasi e grisi letren e Muhamedit, urdhëroi *Badhan-in*, sundimtarin vasal të tij të Jemenit, që të dërgonte dy burra trima për të identifikuar dhe kapur njeriun nga Medina (Muhamedin) dhe për ta sjellë më pas tek ai.

Ndërkohë, i kthyer përsëri në Medinë, Abdullahu i tregoi Muhamedit se si *Khusraw*-i e kishte grisur letrën e tij. Me të dëgjuar këto fjalë Muhamedi premtoi shkatërrimin e mbretit *Khusraw II*.

### **Historia e Letrës dhe ngjarjet që lidhen me lënien e saj në harresë**

Legjenda tregon se pasi Abdullahu u zgjodh për të dërguar letrën, ai bëri gati për rrugë devenë e tij dhe i dha lamtumirën së shoqes dhe të birit. Ai morri rrugën, i vetëm dhe kaloi male e lugina, derisa mbërriti në tokën e persëve. Ai kërkoi leje për të hyrë te mbreti, duke i informuar rojet për letrën që kishte me vete. Pas kësaj *Khusraw Parvez* urdhëroi që të bëhej gati dhoma e tij e pritjes dhe thirri të mblidheshin këshilltarët e tij më të shquar. Pasi ata ishin mbledhur, ai i dha leje Abdullahut të hynte.

Abdullahu hyri dhe pa sovranin persian të veshur me rroba të çmuara, të hijshme e të derdhura dhe në kokë kishte një çallmë madhështore të vendosur me kujdes. Abdullahu ishte i veshur thjesht me rrobat e ashpra të një beduini, por krenaria e islamit digjte e fortë në kraharorin e tij dhe fuqia e besimit rrihte në zemrën e tij.

Menjëherë pasi *Khusraw Parvez* e pa atë të afrohej, i dha urdhër njërit prej njerëzve të tij për t'i marrë letrën nga duart.

“Jo” tha Abdullahu. – “Profeti më ka urdhëruar mua për t’jua dorëzuar Juve në dorë këtë letër dhe unë nuk shkoj kundër urdhrave të së Dërguarit të Zotit”.

“Lejojeni të më afrohet” – u tha *Khusraw* rojeve, dhe Abdullahu shkoi përpara dhe ia dorëzoi letrën. *Khusraw*-i pastaj thirri një nëpunës arab, i cili e kishte prejardhjen nga Hira dhe e urdhëroi për të hapur letrën në prani të tij dhe ta lexonte përmbajtjen e saj. Ai filloi leximin: “Në emër të Allahut, Mëshiruesit Mëshirëbërësit. Nga Muhamedi, i Dërguar i Zotit, për tek *Khusraw* udhëheqësi i Persisë. Paqe mbi këdo që ndjek rrugën e drejtë...”.

*Khusraw*-i dëgjoi vetëm këtë nga letra, kur zjarri i zemërimit shpërtheu brenda tij. Fytyra iu bë e kuqe dhe filloi të djersitej rreth qafës, rrëmbeu letrën nga duart e nëpunësit dhe filloi me vrull ta griste atë copa-copa dhe pa e ditur se çfarë tjetër përmbante bërtiti: “Si guxon ai të më shkruajë mua në këtë mënyrë, ai që nuk është gjë tjetër veçse një skllav imi”. Ai ishte i zemëruar se Profeti nuk i kishte dhënë përparësi në letrën e tij. Ai pastaj urdhëroi që Abdullahu të dëbohej nga kuvendi i tij.

Abdullahu u dëbua pa ditur se çfarë do të ndodhte me të. A do të vdiste apo do ta linin të lirë? Por ai nuk donte të priste për ta gjetur. Ai tha: “Në emër të Zotit, mua nuk më intereson se çfarë ndodh me mua pasi letra e Profetit u trajtua aq keq.” Ai arriti të marrë devenë e tij dhe u largua. Kur *Khusraw*-i u qetësua dhe i ra zemërimi, urdhëroi që ta sillnin

përsëri Abdullahun para tij. Por, Abdullah nuk gjendej asgjëkund. Ata e kërkuar atë përgjatë gjithë rrugës deri në Gadishullin Arabik, por morën vesh se ai kishte shkuar përpara.

Kur u kthye në Medinë, Abdullahu i tha Profetit se si *Khusraw*-i e kishte grisur copa-copa letrën e tij; përgjigjja e vetme e Profetit ishte “E copëtoftë Perëndia mbretërinë e tij!”.

Ndërkohë, *Khusraw*-i i shkroi *Badhan*-it, zëvendësit të tij në Jemen, për të dërguar dy burra të fortë për tek “ai burri që është shfaqur në Hixhaz” me urdhrin për ta sjellë atë në Persi. *Badhan*-i dërgoi për tek Profeti dy nga njerëzit e tij më të fortë dhe u dha atyre një letër në të cilën kishte urdhëruar që Profeti të shkonte, pa u vonuar, me të dy burrat, për të përmbushur urdhrin e *Khusraw*-it. *Badhani* gjithashtu kërkoi nga dy burrat që të mblidhnin çfarëdo informacioni që kishte mbi Profetin dhe të studionin nga afër mesazhin që ai përcillte.

Burrat që u dërguan, lëvizën shumë shpejt. Në Taif ata u takuan me disa tregtarë kurejshë (*Quraysh*) dhe i pyetën për Muhamedin. “Ai është në Jethrib”, – thanë ata, – dhe vazhduan jashtëzakonisht të lumtur drejt Mekës. Ky ishte një lajm i mirë për ata dhe vazhduan duke u thënë kurejshëve të tjerë se: “Ju do të jeni shumë të kënaqur. *Khusraw*-i është duke kërkuar për të marrë Muhamedin dhe ju së shpejti do të shpëtoni nga e keqja që sjell ai”. Të dy burrat, ndërkohë shkuan drejt për Medinë dhe u takuan me Profetin, i dorëzuan atij letrën e *Badhan*-it dhe i thanë se:

“Mbreti i mbretërve, *Khusraw*, i ka shkruar sundimtarit tonë *Badhan* që të dërgojë njerëzit e tij për të marrë ty. Ne kemi ardhur për t’ju marrë, që të vini me ne. Nëse ju vini me dëshirë, *Khusraw*-i ka thënë se do të tregohet i mirë për ju dhe do t’ju kursejë çdo ndëshkim. Nëse ju refuzoni, ju do të njiheni me fuqinë e ndëshkimit të tij. Ai ka fuqinë për të shkatërruar ju dhe popullin tuaj”.

Profeti buzëqeshi dhe u tha atyre: “Kthehuni sot në malet tuaja dhe ejani përsëri nesër”. Të nesërmen, ata erdhën tek Profeti dhe i thanë: “A jeni i përgatitur për të ardhur me ne për të takuar *Khusraw*-in?”

“Askush nuk do të takohet sot me *Khusraw*-in”, - u përgjigj Profeti. “Perëndia e ka vlarë atë dhe tashmë vendin e tij e ka marrë i biri i tij, po në këtë natë të këtij muaji”.

Të dy burrat vështronin fytyrën e Profetit. Ata ishin krejt të shtangur.

“A e dini se çfarë po thoni?” – pyetën ata. “A duhet t’i shkruajmë *Badhan*-it në lidhje me këtë?”


“Po,” – u përgjigj Profeti, – “dhe i thuaj atij se feja ime më ka njoftuar për atë që i ka ndodhur Mbretërisë së *Khusraw*-it dhe në qoftë se ai bëhet mysliman, unë do ta caktoj atë qeveritar të atij territori që sot ai vetëm e kontrollon”.

Të dy burrat u kthyen në Jemen dhe i thanë *Badhan*-it se çfarë kishte ndodhur. *Badhan*-i tha, “Nëse ajo që ka thënë Muhamedi është e vërtetë, atëherë ai është Profet. Nëse jo atëherë ne do të shohim se çfarë do të ndodhë me të”.

Jo shumë kohë më pas *Badhan*-i mori një letër nga *Shirwaih*-u, në të cilën ai shkruante: “Unë kam vrarë *Khusraw*-in për shkak të tiranisë së tij kundër popullit tonë. Ai e konsideronte si të ligjshme vrasjen e liderëve, kapjen e grave të tyre dhe shpronësimin e pasurisë së tyre. Kur kjo letër të arrijë tek ju, të merrni së bashku me të edhe aleancën time”.

Sapo *Badhan*-i lexoi letrën e *Shirwaih*-ut, e hodhi atë mënjanë dhe lajmëroi hyrjen e tij në islam edhe persët në Jemen që ishin me të gjithashtu u bënë myslimanë.

Kjo është historia e takimit të Abdullah ibn Hudhafahut me mbretin e Persisë.



**Figura 3.** Hartë e fqinjëve dhe e lëvizjeve në kohën e Muhamedit dhe e vendeve fqinje tek të cilat u dërgua letra dhe u shpërnda feja islame (sipas Wikimaps).

## Gjetja e letrës dhe rishfaqja e historisë së saj

Se çfarë u bë më pas me letrën, mbeti e panjohur, deri kur në vitin 1962 Henry Pharaon dërgoi në Muzeun *Nicolas Ibrahim Sursock* një mbishkrim në një pergamenë të vjetër, e cila kishte një të grisur në mes dhe një vulë të qartë në fund. Duke mos pasur një paleograf, muzeu ia dërgoi për studim pergamenën Dr. Salahuddine al-Munajjd, i cili ishte një autoritet i padiskutueshëm në këtë fushë. Pas një studimi që zgjati disa muaj ai arriti në përfundimin se ishte pikërisht kjo letra që Profeti Muhamed i kishte dërguar mbretit *Khusraw*.

Studimi paleografik i kryer nga S. Al-Munajjd mbeti për shumë kohë i pabotuar, por ai botoi një përmbledhje të tij në revistën *Al-Hayat* (dt. 22.05.1963); në gazetën *Le Jour* (23.05.1963) dhe në librin e tij *Studies of Arabic Paleography*, botuar në Bejrut në vitin 1972. Më vonë, një studim rreth këtij zbulimi të kryer nga Al-Munajjd ka botuar dhe prof. M. Hamidullah<sup>5</sup>.

## Kush ishte mbreti *Khusraw* dhe cila ishte arsyeja pse ai refuzoi ?



**Figura 4.** Monedhë e mbretit *Khusraw II* me imazhin e mbretit (marrë nga *Classical Numismatic Group, Inc.*).

Historia e ngjitjes dhe e rënies nga pushteti të perandorit *Khusraw* është e lidhur ngushtë si me fenë e krishterë, ashtu dhe me besimin e ri mysliman që u përhap gjatë mbretërimit të tij nga shkretëtira arabike.

*Khusraw-i II* (persisht پرویز خسرو), Mbret i Madh (Shah) i Persisë, i mbiquajtur edhe *Parvëz* (Fitimtari), ishte i fesë së Zoroastrizmit.

<sup>5</sup> M. Hamidullah, Original de la lettre du Prophète à Kisra, *Rivista degli Studi Orientali*, vëll. XL, 1, Romë 1965, f. 57–70.

*Khusraw-i II* ishte mbreti i fundit i Perandorisë Sasaniane, i cili mbretëroi nga viti 590 deri 628.

Ai ishte i biri i *Hormiz-it IV* (i cili mbretëroi nga viti 579–590) dhe nipi i *Khusraw-it I* (mbretëroi 531–579), ndërsa e ëma ishte e ardhur nga *Ispahbudhan* në Parti. *Khusraw-i* gjithashtu kishte dy kushërinj nga familja *Ispahbudhan*, të cilët quheshin *Mah-Adhur Gushnasp* dhe *Narsi*. Ai kishte një kunat të quajtur *Hormuzan*, një fisnik sasanid, anëtar i njërit nga shtatë klanet parthe, i cili më vonë luftoi kundër arabëve gjatë pushtimit mysliman të Persisë. *Khusraw-i*, përveç *Shirin-it* kishte edhe dy gra të tjera: *Maria*, njëra nga bijat e perandorit bizantin *Mauric*, dhe tjetra në *Gordiya*, e motra e *Bahram Chobin*.

Ai ishte mbreti i fundit i Persisë që pati një mbretërim të gjatë para pushtimit mysliman të Iranit, i cili filloi pesë vjet pas vdekjes së tij me anë të vrasjes.

Në veprat e letërsisë persiane si *Shahnameh* dhe *Khusraw-i dhe Shirin-i* (*persisht شیرین و خسرو*), një romancë e famshme tragjike nga *Nizami Ganjavi* (1141–1209), një variant shumë i përpunuar dhe imagjinar i jetës së *Khusraw-it*, e bëri atë një nga heronjtë më të mëdhenj të kulturës perse. *Khusraw-i dhe Shirin-i* tregon historinë e dashurisë së tij për princeshën siriane *Shirin*, e cila bëhet mbretëresha e tij pas një periudhe të gjatë të mbushur me vështirësi dhe aksidente.

*Khusraw-i* hipi në fron me ndihmën e dy xhaxhallarëve të tij *Vistahm* dhe *Vinduyih*, të cilët ishin udhëheqësit e një grushti shteti të organizuar brenda pallatit, që rrëzoi, verboi dhe më pas vrau *Hormizd-in IV*. Megjithatë, në të njëjtën kohë, spahiu *Mihranid*<sup>6</sup> *Bahram Chobin*, ishte duke marshuar drejt kryeqytetit sasanid *Ctesiphon*. Menjëherë, pranë qytetit zhvillohet një betejë, që përfundon me humbjen e *Khusraw-it* dhe largimin e tij së bashku me dy xhaxhallarët drejt territorit bizantin.

Në mënyrë që të tërhiqte vëmendjen e perandorit bizantin *Mauric*<sup>7</sup>. Ai i dërgoi një mesazh perandorit dhe i kërkoi ndihmë për të rimarrë fronin sasanid, kërkesë, të cilën perandori *Mauric* e pranoi. Me anë të kësaj aleance fillon edhe ajo e vetë *Khusraw-it* me fenë e krishterë.

*Khusraw-i* së bashku me komandantin bizantin të territoreve të jugut, *Comentiolus*<sup>8</sup>, sulmuan Mesopotaminë dhe pushtuan

---

<sup>6</sup> *Mihranidët* ishin një familje iraniane me origjinë nga Partia, të cilët zotëronin rajone të ndryshme të Kaukazit nga viti 330–821.

<sup>7</sup> *Maurice* (latinisht: *Flavius Mauricius Tiberius Augustus*; greqisht: Φλάβιος Μαυρίκιος Τιβέριος Αύγουστος) (539 – 27 nëntor 602) ishte perandor i Perandorisë Romake të Lindjes nga viti 582 deri në vitin 602.

<sup>8</sup> *Comentiolus* (greqisht: Κομηντίολος, *Komentiolos*; vdiq në vitin 602). Ka qenë një gjeneral i shquar i perandorisë Romake të Lindjes (Bizantine) në fund të shek. VI gjatë mbretërimit të perandorit *Mauric*. Ai luajti një rol të rëndësishëm gjatë fushatave ballkanike të perandorit *Mauric*, i cili edhe luftoi në Lindje kundër persëve sasanidë.



Azerbajxhanin verior, duke vazhduar më tej në jug të rajonit. Pas këtyre fushatave u mbyll zyrtarisht paqja me bizantinët. Për këtë ndihmë të tij, perandori Mauric mori një pjesë të madhe të Armenisë persiane dhe të Gjeorgjisë perëndimore si dhe iu hoqën subvencionet që u kishte paguar më parë sasanidëve.

*Khusraw II* u martua me një të krishterë të quajtur Shirin; të birin që pati me të, Mardanshah, donte që ta linte si pasuesin e tij në fron. Marrëdhënia e *Khusraw-it* me krishterimin ishte e komplikuar: gruaja e tij Shirin ishte e krishterë, po kështu dhe Yazdini, ministri i tij i financave<sup>9</sup>. Gjatë mbretërimit të tij ka pasur konflikt të vazhdueshëm ndërmjet të krishterëve monofizitë dhe atyre nestorianë. *Khusraw-i* favorizonte monofizitët dhe urdhëroi që të gjithë subjektet e tij t'i përmbaheshin monofizimit, ndoshta nën ndikimin e *Shirin-it* dhe mjekut të tij mbretëror Gabrielit nga Sinjari, të cilët të dy mbështesnin këtë besim.

*Khusraw-i* gjithashtu u shpërndau para ose dhurata faltoreve të krishtera<sup>10</sup>. Toleranca e madhe që tregoi *Khusraw-i* ndaj krishterimit dhe miqësia e tij me të krishterët bizantinë bënë që disa shkrimtarë armenë të mendonin se *Khusraw* ishte një i krishterë<sup>11</sup>. Politika e tij përkrahëse ndaj të krishterëve, e cila ishte ndoshta e motivuar politikisht, e armiqësoi atë me priftërinjtë zoroastrianë, por gjithashtu bëri që krishterimi të përhapej në masë të madhe në Perandorinë Sasanide<sup>12</sup>. Ishte, pikërisht kjo lidhje që shpjegon edhe reagimin që pati *Khusraw-i* përpara letrës së dërguar nga profeti Muhamet dhe përpara alternativës së një besimi të ri që e vinte ajo.

Megjithatë, *Khusraw-i* u kushtoi gjithashtu, vëmendje të zoroastrianëve dhe ndërtoi tempuj të ndryshëm kushtuar zjarrit. Por kjo nuk e ndihmoi zoroastrizmin, i cili ishte një besim në rënie të madhe gjatë mbretërimit të *Khusraw-it*, dhe që, sipas fjalëve të Richard N. Frye, ishte një besim “më i njohur për përkushtimin ndaj luksit sesa për ndaj mendimit”<sup>13</sup>.

Që në fillim të mbretërimit të tij, *Khusraw-i II* kishte marrëdhënie të mira me bizantinët. Megjithatë, kur në vitin 602 perandori *Mauric* u

*Comentiolus* u ekzekutua në vitin 602 mbasi ushtria bizantine u rebelua kundër *Mauric-it* dhe perandori Foka (mbretëroi nga viti 602 deri në vitin 610) uzurpoi fronin.

<sup>9</sup> P. Brown, *The Rise of Western Christendom*, vëll. 2, Erweiterte Auflage, Oxford 2003, S. 283.

<sup>10</sup> R. N. Frye, The political history of Iran under the Sasanians, *The Cambridge History of Iran*, vëll. 3, 1, Cambridge University Press, 1983.

<sup>11</sup> Frye 1983, f. 166.

<sup>12</sup> Frye 1983, f. 171.

<sup>13</sup> *Vep. cit.*, f. 183.

vra nga gjenerali i tij Foka (602–610), *Khusraw-i* filloi një mësymje kundër Kostandinopojës për t'u hakmarrë për vdekjen e *Mauric-it*.

Në vitin 610, Herakliu<sup>14</sup>, një armen, u ngrit në revoltë kundër perandorit Fokas (602–610) dhe e vrau, duke e kurorëzuar veten si perandor të Perandorisë Bizantine. Herakliu u përpoq për të arritur një marrëveshje për paqe me *Khusraw-in II*, madje edhe duke dërguar diplomatë në oborrin e tij.

Megjithatë, *Khusraw-i* e refuzoi ofertën e tyre dhe tha: “Kjo mbretëri më takon mua dhe unë do të vë në fron si perandor djalin e *Mauric-it*, Teodosin...”<sup>15</sup>. Pas kësaj, *Khusraw-i* i ekzekutoi diplomatët, duke u dhënë në këtë mënyrë një përgjigje përfundimtare të gjitha tentativave për paqe.

Në vitet 613 dhe 614, gjenerali Shahrbaraz rrethoi dhe më pas pushtoi Damaskun dhe Jerusalemin, në këtë mënyrë Kryqi i Vërtetë (thuhej se ishte ky objekt kryqi i vërtetë, në të cilin ishte kryqëzuar Jezu Krishti) u mor si plaçkë lufte. Menjëherë pas kësaj, Shahini<sup>16</sup> marshoi drejt Anatólisë, duke mundur disa herë bizantinët dhe më në fund në vitin 618 pushtoi Egjiptin.

Në vitin 622 perandori bizantin Herakliu kishte arritur të mblidhte një ushtri të fuqishme për të rifilluar betejat. Pas pushtimit të Khazarëve të Transkaukazisë në vitin 627, perandori bizantin mundi ushtrinë perse në betejën e Ninevesë, duke marshuar kështu drejt *Ctesifon-it*<sup>17</sup>. *Khusraw-i II* iku nga banesa e tij në Dastagir, pranë *Ctesifon-it*, pa hasur asnjë rezistencë.

Pas pushtimit të Dastagirit, i biri i *Khusraw-it*, *Kavadh II*, e shpalli veten perandor të Perandorisë Sasanide dhe urdhëroi ekzekutimin e të atit dhe të gjithë vëllezërve dhe gjysmë vëllezërve të tij. *Kavadh-i*, më pas, nënshkroi paqe me perandorin bizantin Herakliu, me anë të së cilës bizantinët rifituan të gjithë territoret që kishin humbur, të gjithë ushtarët që ishin zënë rob, një dëmshpërblim për luftën, së bashku me Kryqin e

---

<sup>14</sup> *Heraclius* (latinisht: *Flavius Heraclius Augustus*, greqisht: Φλάβιος Ἡράκλειος, në gjuhën armene: Հերակղև Փլավղիս, viti 575 – 11 shkurt 641) ishte Perandor i Bizantit nga viti 610 deri në 641.

<sup>15</sup> SEBEOS, kap. 24.

<sup>16</sup> Shahin (në persishten e mesme: *Šāhēn Vahūmanzādag*, në burimet antike greke: Σαήν; vdiq rreth vitit 626) ai ishte një gjeneral i rangut të lartë (*spahbed*) gjatë periudhës së mbretërimit të *Khusraw-it* (590–628). Shahini përmendet për herë të parë në vitin 602, menjëherë mbas fillimit të luftës midis bizantinëve dhe sasanidëve (602–628), ku ai kishte komandën e forcave, të cilat pushtuan territoret bizantine në Transkaukazi 607/8.

<sup>17</sup> *Ktesiphon* ka qenë kryeqyteti i perandorisë së Partëve (247–224 p.e.r.) dhe të perandorisë Sasanide (224–651). Ishte një ndër qytetet më të mëdha të Mesopotamisë së Lashtë (në anën e majtë të lumit Tigër, rreth 35 km në JL të Bagdadit). Emri në latinisht ishte *Ctesiphon* dhe e ka prejardhjen nga greqishtja e lashtë *Ktēsiphōn*.

Vërtetë dhe relikte të tjera që i kishin humbur që nga pushtimi i Jerusalemit në vitin 614<sup>18</sup>.



Një engjëll Kerubin (latinisht: nj. *cherub*, shum. *cherubin*, *cherubim*) dhe perandori Herakliu duke u dorëzuar përpara perandorit *Khusraw II*; pllakë nga një kryq (smalt punuar sipas teknikës *Champlevé* mbi bakër të praruar, viti 1160–1170, Muzeu i Luvrit në Paris).

Beteja midis perandorit Herakli dhe *Khusraw*-it është paraqitur në një afresk të famshëm të fillimit të periudhës së Rilindjes nga Piero della Francesca, si pjesë e ciklit që lidhet me Historinë e Kryqit të Vërtetë në kishën e Shën Françeskut në Areco (Arezzo).



**Figura 5.** Legjenda e Kryqit të Vërtetë, afresk i Piero della Francesca, Basilika e Shën Françeskut në Areco, pikturuar në vitin 1466.

<sup>18</sup> OMAN 1893, f. 212; KAEGI, 2003, f. 178, 189–190.

## Bibliografi tematike

GEORGIAN CHRONICLES: *Rewriting Caucasian History: The Medieval Armenian Adaptation of the Georgian Chronicles: The Original Georgian texts and the Armenian adaptation*, përkth. dhe koment. nga R. W. THOMSON, Oxford, 1996.

KHUZISTAN CHRONICLE: përkth. TH. NÖLDEKE, "Die von Guidi herausgegebene syrische Chronik übersetzt und commentiert", *Sitzungsberichte der kais. Ak. Wiss., Phil.-Hist. Classe 128.9*, Vienna, 1893.

MIRACULA S. DEMETRII: *Les plus anciens recueils des miracles de Saint Démétrius*, I, Text II, Commentary, (nën kujdesin e) P. LEMERLE, Paris, 1979–1981.

MOVSĒS DASKHURANTS'I: *The History of the Caucasian Albanians by Movsēs Daxuranc'i*, përkth. C. J. F. DOWSETT, London, 1961.

SEBEOS: *The Armenian History Attributed to Sebeos I, Translation and Notes, II Historical Commentary*, përkth. R. W. THOMSON, J. HOWARD-JOHNSTON, T. GREENWOOD, *Translated Texts for Historians 31*, Liverpool, 1999.

SEERT CHRONICLE: *Histoire nestorienne (Chronique de Séert)*, Seconde partie (nën kujdesin dhe përkthyer nga) A. SCHER, P.O. 13.4, Paris, 1919.

SIMOCATTA: *The History of Theophylact Simocatta*, përkth. M. WHITBY, M. WHITBY, Oxford, 1986.

THEOPHANES: *The Chronicle of Theophanes Confessor: Byzantine and Near Eastern History AD 284–813*, përkth. C. MANGO, R. SCOTT, Oxford, 1997.

AL TABARI, *The last years of the Prophet* (përkthyer nga ISMA'IL QURBAN HUSAYN), State University of New York Press, 25 Sep. 1990, f. 100 (online).

ALTHEIM-STIEHL R., "The Sasanians in Egypt - Some Evidence of Historical Interest", *Bulletin de la société d'archéologie copte 31*, 1992, pp. 87–96.

BROCK S. P., "Christians in the Sasanian Empire: A Case of Divided Loyalties", *Studies in Church History 18*, 1982, f. 1–19.

CHRISTENSEN A., *L'Iran sous les Sassanides*, Copenhagen, 1944.

GARSOÏAN N., "L'église arménienne et le grand schisme d'orient", *CSCO 574*, Subsidia 100, Louvain, 1999.

GÖBL R., *Sasanian Numismatics*, Brunswick, 1971.

GREATREX G., "Khusro II and the Christians of His Empire", *Journal of the Canadian Society for Syriac Studies 3*, 2003, f. 78–88.

GYSELEN R., "Un trésor de monnaies sassanides tardives", *Revue Numismatique*, sér.6, 32, 1990, f. 212–31.

CRAWFORD P., *The war of the three gods: Romans, Persians and the rise of Islam*, Pen and Sword (2013).

DARYAEE T., *Sasanian Iran: the Portrait of a Late Antique Empire*, Costa Mesa: Mazda Publishers, 2008.

FLUSIN B., *Saint Anastase le Perse et l'histoire de la Palestine au début du VIIe siècle*, I, Texts textes, II, Commentary, Paris, 1992.

FRYE R. N., "The political history of Iran under the Sasanians", *The Cambridge History of Iran*, kap. IV, Cambridge University Press 3 (1), 1983.

GREATREX G., SAMUEL N. C., *The roman eastern frontier and the persian wars* (Part II, 363–630 AD), New York, New York and London, United Kingdom: Routledge (Taylor & Francis), 2002.

HANSEN O., "Die mittelpersischen Papyri der Papyrussammlung der Staatlichen Museen zu Berlin", *Abhandlungen der Preuss. Ak. Wiss.*, 1937, Nr.9, Berlin, 1938.

- HAWAREY M., *The Journey of Prophecy, Days of Peace and War* (Arabic), Islamic Book Trust 2010, English translation available (on line).
- HIGGINS M. J., *The Persian War of the Emperor Maurice (582–602) I: The Chronology, with a Brief History of the Persian Calendar*, Washington, D.C., 1939.
- HOWARD-JOHNSTON J., “Heraclius’ Persian Campaigns and the Revival of the East Roman Empire”, 622–630, *War in History* 6, 1999, f. 1–44.
- HOWARD-JOHNSTON J., *Armenian Historians of Heraclius: An Examination of the Aims, Sources and Working-Methods of Sebeos and Moses Daskhurantsi* (nën kujdesin e) G. J. REININK, B. H. STOLTE, *The Reign of Heraclius (610–641): Crisis and Confrontation*, Leuven, 2002, f. 41–62.
- HOWARD-JOHNSTON J., *East Rome, Sasanian Persia and the End of Antiquity: Historiographical and Historical Studies*, Aldershot, U.K., 2006.
- JARIR ṬABARI M., *Ketāb ta’riḳ al-rosol wa’l-muluk*, përkthyer si: *The History of al-Ṭabarī, General ed. Ehsan Yar-Shater, V, The Sāsānids, the Byzantines, the Lakmids, and Yemen*, përkth. C. E. BOSWORTH, Albany, N.Y., 1999.
- KAEGI W. E., *Heraclius, Emperor of Byzantium*, Cambridge, 2003.
- LUSCHEY H., Bisutun: “Geschichte und Forschungsgeschichte”, *Archäologischer Anzeiger* 89 1974/75, f. 114–49.
- MONTGOMERY W. W., *Muhammad at Medina*, Oxford University Press, 1956, f. 108.
- MUBARAKPURI, SAIFUR RAHMAN AL, *The Sealed Nectar*, Darussalam Publications, 2005, (online).
- POURSHARIATI P., *Decline and fall of the Sasanian Empire: The Sasanian–Parthian Confederacy and the Arab Conquest of Iran*, I. B. Tauris, London/New York, 2008.
- SHAPUR SHAHBAZI A., “Sasanian Dynasty”, *Encyclopaedia Iranica*, 2005, në Online Edition. Retrieved 30 March 2014.
- RUBIN Z., Ibn al-Muqaffa’ and the Account of Sasanian History in the Arabic Codex Sprenger 30, *Jerusalem Studies in Arabic and Islam* 30, 2005, f. 52–93.
- RUBIN Z., “Musa ibn ‘Isa al-Kisrāwī and the Other Authors on Sasanian History Known to Hamza al-Isfahānī”, *Jerusalem Studies in Arabic and Islam* 34, 2009.
- SALZMANN W., “Die Felsarbeitung und Terrasse des Farhad’ in Bisutun: Ein spätsasanidisches Monument”, *Archäologischer Anzeiger* 91, 1976, f. 110–134.
- Sarre F., Herzfeld E., *Archäologische Reise im Euphrat- und Tigris-Gebiet*, II, Berlin, 1920.
- THOMSON R. W., The Defence of Armenian Orthodoxy in Sebeos, (nën kujdesin e) I. ŠEVČENKO, I. HUTTER, *AETOS: Studies in Honour of Cyril Mango*, Stuttgart/Leipzig, 1998, f. 329–341.
- TOUMANOFF C., *Studies in Christian Caucasian History*, Georgetown, 1963.
- TYLER-SMITH S., Calendars and Coronations: The Literary and Numismatic Evidence for the Accession of Khusrau II, *Byzantine and Modern Greek Studies* 28, 2004, f. 33–65.
- VON GALL H., “Entwicklung und Gestalt des Thrones im vorislamischen Iran”, *Archäologische Mitteilungen aus Iran* 4, 1971, f. 207–235.
- WEBER D., Ostraca, “Papyri und Pergamente”, *Corpus inscriptionum Iranicarum*, III.4–5, London, 1992.
- WHITBY M., *The Emperor Maurice and His Historian*, Oxford, 1988.
- WHITBY M., “A New Image for a New Age: George of Pisidia on the Emperor Heraclius” (nën kujdesin e) E. Dabrowa, *The Roman and Byzantine Army in the East*, Cracow, 1994, f. 197–225.



# PËRKUJTME



## **STEFAN PRIFTI, PROFESORI, FILOLOGU DHE PËRKTHYESI I SHQUAR (1910–1975)**

Stefan Prifti lindi në Arrëz të Kolonjës më 2 janar 1910 dhe ndërroi jetë në Tiranë më 27 tetor 1975. Kreu liceun “Zosimea” të Janinës dhe u diplomua për filologji, me rezultate shumë të larta, në Universitetin e Athinës. Më 1938 u emërua mësues në Normalen e Elbasanit, ku filloi karrierën e tij të gjatë arsimore më se tridhjetëvjeçare. Në vitet 1942–1947 shërbeu si mësues dhe drejtor në Liceun e Korçës; në vitet 1947–1948 kryetar i Degës së programeve dhe teksteve në Ministrinë e Arsimit; më pas drejtor i gjimnazit “Qemal Stafa” në Tiranë (1948–1955) dhe pedagog i jashtëm në Institutin e Lartë Pedagogjik 2-vjeçar të Tiranës. Nga viti 1955 e deri sa doli në pension qe pedagog, në fillim në Institutin e Lartë Pedagogjik 2-vjeçar të Tiranës, – për ca kohë qe drejtor i tij, – dhe më pas, në Institutin e Lartë Pedagogjik Katërvjeçar. Me krijimin e Universitetit të Tiranës u emërua kryetar i Degës mësimore në Rektoratin e këtij Universiteti. Ka qenë pedagog titullar i sintaksës së gjuhës shqipe, i latinishtes dhe i greqishtes së vjetër në degën e gjuhëve të huaja të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë. Në vitet 1965–1968 ka qenë përgjegjës i katedrës së gjuhëve klasike e perëndimore të këtij Fakulteti. Punoi për rreth 20 vjet në arsimin e lartë.

Profesor Mahir Domi ka shprehur këtë vlerësim për kolegun e tij të vyer: “Kudo që punoi, u tregua i aftë, i përpiktë, i rregullt, sistematik dhe i palodhur, duke u dalluar për zell, seriozitet dhe ndërgjegje të lartë në detyrë. Nuk i kurseu asnjëherë fuqitë e veta për t’iu përgjigjur kërkesave të ngutshme të zhvillimit të vrullshëm të arsimit tonë. I thjeshtë e i papërtuar, gëzoi simpatinë e nderimin e studentëve të tij”.

Stefan Prifti u shqua dhe dha ndihmesa të vyera në disa fusha të dijes filologjike. Për punë të palodhshme pedagogjike e shkencore është dekoruar me Urdhrin e Punës të klasës së parë, dhe, më 1992, me titullin “Mësues i Popullit” (pas vdekjes) me motivacionin “Pionier i shkencës shqiptare, edukator i shquar, frymëzues për punë të mirëfilltë shkencore.



Autor veprash e studimesh shkencore me ide përparimtare dhe demokratike”. Ka qenë delegat në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (nëntor 1972), ku mbajti edhe një kumtesë të rëndësishme për problemet që paraqet shkrimi i fjalëve me burim nga greqishtja e vjetër dhe e reja, duke dhënë disa orientime me vlerë për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Profesor S. Prifti do të kujtohet edhe si një latinist i shkëlqyer që solli në gjuhën shqipe veprën monumentale të Marin Barletit “Historia e Skënderbeut”, shoqëruar me analizën shkencore, letrare dhe gjuhësore të kësaj vepre (Tiranë, 1964, me disa ribotime). Më parë ai kishte përkthyer po nga latinishtja veprën polemike të Frang Bardhit “Apologjia e Skënderbeut” (Tiranë, 1956, me disa ribotime). Mjafton të shohim qindra e qindra shënime e shpjegime plotësuese në këto dy vepra, për të gjykuar jo vetëm për njohjen e thellë të latinishtes, por edhe për fushën e gjerë të dijeve kulturore e historike që zotëronte ky filolog.

Profesor Stefan Prifti është edhe njëherazi e mbi të gjitha sintaksolog i shquar. Ai ka hartuar tekstin universitar “Sintaksë e gjuhës shqipe” (dispensë për Institutin Pedagogjik 2-vjeçar), në dy pjesë (I, 1959; II 1962); është një ndër bashkautorët e vëll. II (“Sintaksa”) të veprës “Gramatikë e gjuhës shqipe”, botim i Akademisë së Shkencave (Tiranë, 1976, me ribotime). Ka botuar në revistën “Studime filologjike” disa artikuj studimorë për çështje të rëndësishme të sintaksës së gjuhës shqipe, si p.sh., “Rreth disa çështjeve të fjalisë kohore” (1966); “Elipsa në sintaksën e fjalisë” (1966); “Klasifikimi i fjalive të varura” (1972); “Mendime për tri çështje të sintaksës” (1965) etj. Megjithëse i përqendruar në hetimin e dukurive sintaksore, shkroi disa artikuj edhe për ndërtimin e saj morfologjik të shqipes: “Mendime për disa çështje të rasave në gjuhën shqipe” (1975); “Emërzimi (substantivizimi)” (1976). Për studentët e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë hartoi dhe një tekst të morfologjisë së shqipes së sotme.

Vepra e tij më e rëndësishme, teksti universitar “Sintaksa e gjuhës shqipe”, është cilësuar si me frymë logjiciste, por, nga ana tjetër, aty më shumë se në të gjitha gramatikat e shqipes, bëhen analiza të elipsës, të figurave sintaksore dhe të rregullave të kalimit nga ligjëratat e drejtë në të zhdrejtë, analiza këto që i hapin rrugën edhe në gjuhën shqipe gjuhësisë ligjërimore, që u vullësua në Europë nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar pas ideve programatike të Roman Jakobsonit dhe të Emil Benvenistit. Sintaksa e Stefan Priftit ka qenë dhe mbetet një nga kulmet shkencore të gjuhësisë shqiptare në përshkrimin e strukturës sintaksore të shqipes, hartuar prej një autori të vetëm, me të cilën kanë mësuar breza të tërë studentësh dhe studiuesish. Ky tekst u ribotua si libër dhe u miratua si tekst bazë i sintaksës nga Universiteti i Prishtinës (1971), ku u përdor vite me radhë dhe mbetet një nga veprat më të cituara në studimet sintaksore.

Në vitet '60 të shekullit të kaluar, kur drejtimet dhe përmbajtja e shkollës shqiptare iu nënshtruan një diskutimi të gjerë, Stefan Prifti ka qenë një ndër specialistët më aktivë që shtronte mendimet e veta të vyera, sidomos rreth disa çështjeve të teksteve të gjuhës shqipe me synim

përsosjen e tyre në vazhden e traditës sonë, por edhe me risi pedagogjike e shkencore që kërkonin zhvillimet e reja kulturore tek ne, si në letërsi, publicistikë e stile të tjera që po përvijoheshin dukshëm.

Profesor Stefan Prifti ishte i bindur se gjuhësia e re shqiptare, albanologjia përgjithësisht, kishte nevojë të madhe për literaturë këshillimi me autorë e shkolla të vendeve të ndryshme, në mënyrë të veçantë për çështje teorike, që nuk i takonin vetëm shqipes, por mbarë gjuhësisë së përgjithshme a teorisë gjuhësore për probleme të caktuara, prandaj dhe në studimet e tij gjejmë një mbështetje të gjerë tek autorë dhe vepra në gjuhë të huaja, të cilat ai i zotëronte dhe i shfrytëzonte, lidhur me dukuri të shqipes, me nocionet e reja apo trajtesat për kategori të ndryshme sintaksore që nga togjet e fjalëve (siç e përdorte ai) deri në njësitë kumtuuese të fjalisë e frazës (periudhës). Kështu, nga 31 autorë që përmban bibliografia shkencore e punimit monografik për elipsën, 28 prej tyre janë përfaqësues të gjuhësisë evropiane, bashkëkohorë, por edhe të historisë së zhvillimit të sintaksës në shekuj.

Punimet shkencore dhe tekstet mësimore që botoi në fushën e gjuhësisë, veprimtaria e gjatë arsimore dhe përkthimet mjeshtërore i japin prof. Stefan Priftit një vend të nderuar krahas studiuesve të tjerë të gjuhës shqipe dhe mësuesve të përkushtuar të shumë brezave.

**Remzi PËRNASKA, Tefë TOPALLI**





## **PASQYRA E LIBRAVE**



**“AKTET E KONGRESIT NDERKOMBËTAR TË  
ARKEOLOGJISË SHQIPTARE - PROCEEDINGS OF  
THE INTERNATIONAL CONGRESS OF ALBANIAN  
ARCHEOLOGICAL STUDIES”. TIRANË, 2014, 654  
FQ.**

Kongresi Ndërkombëtar i Studimeve Arkeologjike Shqiptare, që zhvilloi punimet më 21–22 nëntor 2013 në Tiranë, me rastin e 65-vjetorit të arkeologjisë shqiptare, bëri një bilanc të punës në fushën e arkeologjisë gjatë kësaj periudhe. Ky Kongres solli në qendër të vëmendjes përvojën e shkollës arkeologjike shqiptare dhe rrugën e saj të integritimit në arkeologjinë europiane.

Centre for Albanian Studies  
Institute of Archaeology

INTERNATIONAL CONGRESS  
OF ALBANIAN ARCHAEOLOGICAL STUDIES




Në kongres u mbajtën 70 kumtesa, 25 nga kolegë të huaj, 10 nga pjesëmarrësit nga Maqedonia dhe Kosova dhe pjesa tjetër i përket Institutit të Arkeologjisë të Shqipërisë. Në Kongres u paraqitën zbulimet me të veçanta të mijëvjeçarit të ri në territorin e Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë.

Vetëm një vit më pas, falë një pune sistematike të stafit të Institutit Arkeologjik, u arrit botohen Aktet e Kongresit. Ky botim është kontribut i 72 autorëve dhe bashkautorë të fushave të arkeologjisë, historisë antike, antropologjisë, numizmatikës etj. Në këtë botim të tërheqin vëmendjen rezultatet e reja të 41 projekteve kërkimore të realizuara gjatë 15 viteve të fundit në gjithë Shqipërinë.


Na duken me mjaft interes rezultatet e paraqitura në këtë botim të kërkimeve në fushën e Prehistorisë, që kanë kontribuar si për zbulimin e siteve të reja në zona më pak të eksploruara e të studiuara, ashtu edhe për zbatimin e mjeteve e të metodave moderne të kërkimit shkencor, dhe kanë synuar shtrirjen e tyre edhe për periudha të pastuduara më parë ose të studiuara pak, siç ishin ato për Epokën e Gurit (Paleolitit e Mezolitit), të cilat zbuluan një numër të madh qendrash me gjetje mjaft interesante. Këto zbulime u pasqyruan në botimin e tyre në Aktet e Kongresit nga prof. Ilir Gjipali, prof. Jurgen Richter, Rudenc Ruka etj., duke ndryshuar plotësisht hartën arkeologjike për Prehistorinë e thellë të Shqipërisë, duke u shtrirë në të gjithë Ultësirën Bregdetare, nga veriu në jug. Kjo u arrit dhe si rezultat i një bashkëpunimi të ngushtë me universitete të SHBA dhe Europës. Për periudhat e tjera të Prehistorisë nga Neoliti në periudhën e Hekurit, kujdes është treguar për thellimin e kërkimeve dhe për zgjerimin e të dhënave, duke u mbështetur në zbatimin e shkencave ndihmëse si gjeoarkeologjia, arkeozoologjia, arkeobotanika, paleontologjia, palinologjia etj.

### Paleoliti dhe Mezoliti




Kërkimet për periudhën e fundit të Epokës së Gurit (Neolitit), të realizuara nga dr. Susan Alen dhe prof. Ilir Gjipali, të paraqitura në këtë botim, kanë për objekt studimi procesin e neolitizimit të territoreve të Shqipërisë. Ato sjellin ndihmesa të reja për rolin e komponenteve kulturore në procesin e neolitizimit në tërësi, por edhe për kryerjen e datimeve absolute dhe renditjen kronologjike të Neolitit të hershëm në Shqipëri.

Gërmimet në rajonin e Korçës, nga prof. Petrika Lera, prof. Gilles Touchais dhe dr. Cecile Oberweiler, paraqesin një kontribut me rëndësi për mijëvjeçarin VII, Bronzin e hershëm (fundi i mijëvjeçarit III) deri në fillimin e periudhës së Hekurit (rreth 700 para e.r.).



Problematika që lidhen me epokën e Bronzit dhe të Hekurit janë trajtuar tashmë në një sfond të ri, kjo falë hulumtimeve të reja të viteve të fundit nga prof. Adem Bunguri, për Shqipërinë dhe Kosovën, si dhe kontributin e prof. as. Muhamet Belaj për rajonin e pellgut të Drinave.




Një pasqyrë e aktivitetit kërkimor të përbashkët Tiranë–Prishtinë për përpilimin e Hartës Arkeologjike të Kosovës, vjen me kontributin e dr. Kemajl Lucit, ku shënohet evidentimi i 264 qendrave arkeologjike, shumica prej të cilave janë zbulime të reja me përkatësi kohore të ndryshme. Po



ashtu me interes shkencor vlerësojmë kontributin e paraqitur nga prof. Petrika Lera dhe dr. Oikonomis, për gërmimet arkeologjike në ishullin e Maligradit.

Periudha e Antikitetit zë vëllimin më të madh të Akteve të Kongresit dhe përfshin studime dhe kërkime arkeologjike për shumicën e qyteteve antike, si Scodra (nga prof. as. Saimir Shpuza dhe prof. Pjoter Dychec), Lissos (prof. Gëzim Hoxha dhe dr. Andrea Oetell), Dimal (prof. as. Belisa Muka dhe prof. Michael Heinzerman), Antigone (prof. Dhimitër Çondi), Foinike (prof. Shpresa Gjongecaj dhe prof. Sandro de Maria), Hadrianopol (prof. Dhimitër Çondi dhe prof. Roberto Perna), Apoloni (prof. Faik Drini dhe prof. Jean Luc Lambole), Butrint (prof. Dhimitër Çondi dhe dr. David Hernandez, Durres (dr. Edi Shehi dhe dr. Catherine Abatie Reynal), Orikum (prof. as. Saimir Shpuza dhe prof. Jean Paul Descoedres).



Tematika e kërkimeve në këto qendra është orientuar tek problemet e urbanistikës, komplekset arkitekturore që lidhen me qendrën e qytetit antik (teatro, portikë), tempujt, varrezat etj. Ekspeditat shumëvjeçare kanë zbuluar me dhjetëra monumente të reja dhe një material arkeologjik të shumëllojshëm për ndriçimin sa më të mirë të historisë së tyre. Studimet epigrafi (prof. Faik Dini dhe prof. Pierre Cabanes) dhe numizmatike (prof. Oliver Picard dhe dr. Albana Meta) kanë pasuruar gjithashtu të dhënat historike, duke kontribuar ndjeshëm për studimin e jetës ekonomike, politike e administrative të qytetit në Iliri. Kjo veprimtari është shtrirë në çështje me tematika të ndryshme, në një hark kohor që nis me themelimin e ngulimeve të para koloniale në brigjet lindore të Adriatikut, si Apolonia dhe Epidamn-Dyrrhachioni, rreth shek. VII para e.r., deri në fillimin e shek. IV të e.r., që shënon fillimin e periudhës së Antikitetit të vonë.




Një vend me rëndësi në Aktet e Kongresit zë studimi dhe kërkimi i realizuar në fushën e Antikitetit të vonë dhe të Mesjetës, i cili ka pasur për objekt jo vetëm qendrat kryesore mesjetare tradicionale, por është shtrirë në një territor të gjerë që lidhet me studimin e jetës së qyteteve, duke përfshirë aspektet urbane, monumentet kryesore, fortifikimet, objektet e kultit dhe nekropolet.



**Trikonka**


Studime të hollësishme që përfshihen në këtë botim vijnë nga specialistë të njohur siç është prof. Guntram Kohn, i cili me mjeshtëri publikon gjetje të rralla të paanalizuara më parë, siç janë sarkofagët e periudhës së perandorisë romake; apo prof. Marie-Patricia Raynaud, e cila i ka përqendruar kërkimet dhe studimet e saj mbi korpusin e mozaikëve.

Shqipëria numëron 20 qytete të periudhës së Antikitetit të vonë, që gjenden të shpërndara nga veriu në jug. Kërkimet e viteve të fundit mbi këtë tematike, jo vetëm kanë afirmuar arritjet e kërkimeve shkencore të mëparshme, por ato po ndihmojnë në sqarimin e çështjeve të origjinës, transformimit, urbanizimit dhe administrimit të qytetit të shekujve IV–VI në Illyricum.



**Diaporit**

Zgjerimi i kërkimeve dhe studimeve për qytetet e kësaj periudhe është pasqyruar tashmë nga prof. Gëzim Hoxha i cili analizon procesin e transformimit të qytetit të Lissusit në periudhën e antikitetit të vonë; nga dr. Elio Hobdarit dhe prof. as. Ylli Cerova - qyteti i Scampisit në antikitetin e vonë; nga prof. Afrim Hoti dhe prof. Sara Santorio - studimi mbi transformimin e Dyrrahut nga periudha antike deri në mesjetë; dr. Oliver Gilkes, me studimin e tij të zbulimeve të reja në prapatokën e Butrintit, i cili i shton historisë së zhvillimit të kësaj qendre të dhëna të reja për periudhën e vonë romake dhe bizantine' si dhe nga një grup autorësh, si prof. as. Kosta Lako, prof. Skënder Muçaj, Skënder Bushi dhe Suela Xhyheri të cilët analizojnë zhvillimin kulturor dhe religjioz të qytetit të Onhezmit gjatë shek 5–7 të e.r.



Një drejtim tjetër i rëndësishëm i përfshirë në aktet e Kongresit është studimi i prof. Neritan Cekës, që pasqyron ecurinë, kohën dhe vendin e formimit të shqiptarëve në mesjetë; studimi i prof. Luc Buchet i cili për herë të parë na sjell në fushën e antropologjisë evolucionin e popullsisë shqiptare në Veri gjatë periudhës së fundit të antikitetit dhe epokës osmane; si dhe studimin e dr. Elvana Metallës “Të dhënat e qeramikës mbi tregtinë e Durrësit në shek IX–XIV”.

Po ashtu, në fushën e Antikitetit të vonë dhe të Mesjetës, janë realizuar studime me rëndësi mbi fortifikime të shek. IV–VI në rrugët strategjike që lidhnin bregdetin Adriatik me Ballkanin Qendror, të pasqyruara nga Fitni Dalipi, i cili sqaron funksionin e kështjellave gjatë antikitetit në liqenin e Ohrit (Maqedoni).



## Lezhë




## Koman



Luan PËRZHITA

## PESËDHJETË VJET PUBLIKIME ARKIVISTIKE NË KOSOVË



### Hyrje

Pas largimit të Perandorisë Osmane nga Kosova e deri në Luftën e Dytë Botërore, e madje edhe vitet e para pas saj, kushtet nuk ishin shumë të favorshme për popullin shqiptar të këtyre anëve, e rrjedhimisht edhe dokumentacioni arkivor shkatërrohej. Veprimtaria arkivore në Kosovë, asokohe mbeti në kuadrin e *sekretari-arkivave* pranë organeve shtetërore, si pasojë edhe dokumentet mbetën të shpërndara, të pasistemuara dhe të painventarizuara. Arritjet më të dukshme u shënuan në punën e sekretarisë, elemente të veçanta të së cilës kanë ndihmuar shumë për drejtime të caktuara të klasifikimit shkencor që iu bënë më vonë dokumenteve të kësaj periudhe në Arkivin e Kosovës. Organizimi i mirëfilltë i shërbimit të sotëm arkivor në Kosovë daton nga viti 1948, kur në kuadër Drejtoratit Krahinor për Arsim dhe Kulturë të asokohe, formohet Qendra Arkivore, e cila kujdesej për mbrojtjen dhe evidencimin e lëndës arkivore. Kjo qendër

arkivore i parapriu themelimit të Arkivit të Kosovës dhe realisht edhe rrjetit arkivor në Kosovë. Më 20 mars 1951 në bazë të Ligjit mbi arkivat shtetërore dhe me vendimin e ish-Këshillit Popullor Krahinor të Kosovës, formohet Arkivi Shtetëror i Krahinës, më vonë Arkivi i Kosovës në Prishtinë. Që nga fillimi e deri në vitin 1968, përkatësisht deri më 1970, kur u krijua edhe rrjeti arkivor në baza ndërkomunale dhe komunale, Arkivi kreu funksionin e vet në tërë Kosovën. Arkivi i Kosovës deri më 1968 e vazhdoi punën si i vetmi institucion arkivor në Kosovë. Më 26 nëntor 1990 pushteti serb vuri në veprim masat e dhunshme në Arkivin e Kosovës. Pas vitit 1999 në Kosovë u krijuan rrethana të reja dhe më të favorshme edhe për rrjetin arkivor. Në vitin 2008 rrjeti arkivor në Kosovë kaloi në vartësi të drejtpërdrejtë të Zyrës së Kryeministrit dhe mori emrin Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK), siç quhet edhe sot. ASHAK-u sot ka në përbërje: Arkivin Shtetëror të Kosovës, arkivat rajonale dhe komunale.

Një prej detyrave kryesore të ASHAK-ut, krahas ruajtjes, sistemimit dhe rregullimit të dokumenteve është edhe botimi i tyre. Kështu ASHAK-u ka edhe organin e vet shkencor profesional që nga viti 1965, revistën “*Vjetari*”, ku botohen artikuj dhe studime në fushën e arkivistikës e të historiografisë, pasuri arkivore dhe recensione të botimeve të ndryshme nga arkivat dhe për arkivat. Revista del një herë në vit dhe artikujt kryesor shoqërohen me një përmbledhje të shkurtër në gjuhën angleze e më herët dhe në gjuhën frënge dhe në gjuhë të tjera. Deri sot janë botuar 50 numra të revistës “*Vjetari*”.

### **Revista “*Vjetari*” themel i periodikut dhe publicistikës arkivore në gjuhën shqipe në Kosovë**

Revista “*Vjetari*”, me traditën e saj 50-vjeçare, ka luajtur rol të rëndësishëm në rrjedhat dhe në proceset e arkivistikës në Kosovë, duke u hapur rrugët dhe horizontet ideve dhe të arriturave më të reja të arkivistikës dhe duke pasur ndikime të rëndësishme në vetëdijen e njerëzve për rëndësinë e dokumenteve, për ruajtjen dhe për botimin e tyre. Revista “*Vjetari*”, në mos për gjë tjetër, është e rëndësishme sepse i ka orientuar studiuesit drejt burimeve arkivore, ose edhe sepse me të kanë bashkëpunuar disa autorë, të cilët, më vonë kanë qenë mjaft produktivë dhe kanë lënë vepra të mëdha.

Revista “*Vjetari*” fillimisht botohej si e përvitshme, në dy gjuhë, shqip dhe serbisht. Në numrin e parë doli me emrin “*Buletini/Godišnjak*”, kurse më vonë, mori emrin “*Vjetari/ Godišnjak*”. Nga viti 2001 vetëm “*Vjetari*”. Midis viteve 1988–2001, për shkak të rrethanave të krijuara në Kosovë dhe për shkak të masave të dhunshme të instaluar në Arkivin e Kosovës, revista “*Vjetari*” nuk u botua. Numrat e “*Vjetarit*” në ballinë shquhen për dizajnin e njëjtë, duke pasur të ndryshme vetëm ngjyrën dhe, sikurse kuptohet, përmbajtjen.

Nuk do ta tepronim aspak nëse themi se me fillimin e botimit të “*Vjetarit*” iu vunë themelet periodikut dhe publicistikës arkivore në gjuhën shqipe në Kosovë, e cila do të zhvillohej në vitet në vijim. Është e madhe, prandaj, rëndësia kulturore arsimore dhe sidomos ajo arkivore e kësaj reviste, natyrisht në qoftë se ajo vështrohet në kontekstin e rrethanave të kohës, kur, krahas mbarëvajtjes së institucioneve të tjera, qe marrë vendimi për botimin e kësaj reviste. Kjo është arsyeja pse një meritë e madhe u takon pikërisht nismëtarëve të botimit të saj, të cilët, në rrethana tejet të vështira, morën vendimin për të botuar “*Vjetar-in*”.

Kryeredaktori i parë i kësaj reviste ishte Ismet Dërmaku (1965–1984), më pastaj Hakif Bajrami (1985), Emin Pllana (1986–1988), Hakif Bajrami (2001–2005), Jusuf Osmani (2006–2010), Ramë Manaj (2011–2014). Anëtarë të redaksisë nga numri iparë, varësisht sipas viteve dhe numrave vijues të revistës, kanë qenë: Stjepan Antoljak, Ali Hadri, Zekeria Cana, Jovica Ivančević, Rexhep Zogaj, Ismet Dërmaku, Hasan Kaleshi, Skënder Rizaj, Branko Bošković, Shefqet Pllana, Bogdan Ivanović, Gjyltekin Shehu, Branko Bošković, Bogdan Ivanović, Bogumil Hrabak, Milivoje Dukić, Ilijaz Rexha, Dušanka Resulić, Petar Glogovac, Radmila Popović, Hakif Bajrami, Millovan Obradović, Jusuf Osmani, Drita Bakia-Gunga, Edi Shukriu, Jahja Drançolli, Liman Rushiti, Shaban Sinani, Ismail Rexhepi, Neville Nika, Sadik Mehmeti, Frashër Demaj, Lulzim Lajçi e Ramë Manaj.

Në revistë janë të pranishëm me punimet e tyre autorë të hapësirave shqiptare, si: Ismet Dërmaku, Zekeria Cana, Skënder Rizaj, Jashar Rexhepagiqi, Ali Hadri, Ahmed Kelmendi, Rexhep Zogaj, Emin Pllana, Hasan Kaleshi, Zaim Maqedonci, Abdulla Bektashi, Ilijaz Rexha, Shukri Rahimi, Xhafer Vllasolli, Neki Shehu, Masar Kodra, Gjyltekin Shehu, Jusuf Osmani, Nimetullah Hafiz, Drita Shehu, Sherafedin Hoxha, Hashim Islami, Muhamet Pirraku, Thoma Kacori, Hakif Bajrami, Sabit Uka, Muhamet Shatri, Haki Kosumi, Feti Mehdiu, Shaban Hashani, Xhafer Nushi, Gazmend Berisha, Habibe Hasani, Muhamet Maloku, Fehmi Pushkolli, Fehmi Rexhepi, Sabri Rexha, Ramiz Abdyli, Ismail Rexhepi, Abdullah Mulaku, Abaz Rexhepagiqi, Jahja Drançolli, Fejaz Drançolli, Marjan Prenkaj, Faruk Salihu, Nuriye Hoxha, Faik Mehmeti, Masar Rizvanolli, Sulltane Kojçini-Ukaj, Seit Lipa, Avdi Abdyli, Hazbije Nimani, Xheladin Shala, Islam Dobra, Sylë Dreshaj, Hysen Azemi, Tefik Geci, Argjentina Duli, Shaban Sinani, Sadik Mehmeti, Qemajl Morina, Ramadan Shkodra, Bedri Muhadri, Hysni Halilaj, Liman Rushiti, Lush Culaj, Agim Zogaj, Muhamed Havolli, Qazim Namani, Nail Halimi, Nexhat Ibrahim, Aliriza Selmani, Ibrahim Gashi, Ismail Ismaili, Refike Sülçevsi, Marenglen Verli, Zeliye Shala, Idriz Kosova, Thoma Murzaku, Nehat Krasniqi, Bujar Dugolli, Etleva Lala, Emine Arifi-Bakalli, Sylë Ukshini Hamit Kaba, Frashër Demaj, Amer Shurdhani, Halim Purellku, Lavdosh Ahmetaj, Teki Kurti, Mira Popoci, Sabile Keçmezi-Basha, Nuridin Ahmeti, Fikrije Berisha, Lush Culaj, Hatixhe Ahmedi, Jani Sota, Alban Dobruna, Ramë Manaj, Ruzhdi Panxha, Selim Bezeraj, Esilda Luku, Diana Dushullovc etj.



Gjithashtu ka edhe nga autorët e huaj, të cilët punimet e tyre, qoftë të përkthyer qoftë në ndonjë gjuhë tjetër, i kanë botuar në “Vjetar”, si Andrija Lainović, Kliment Džambazovski, Živko Avramovski, Vasilija Kolaković, Radmila Simić, Stevan Jovičić, Radovan Turković, Bogdan Ivanović, Jovan Vlahović, Bogumil Hrabak, Vladeta Vuković, Radmila Popović, Slavko Mijušković, Stjepan Antoljak, Đorđe Mikić, Vasilije Lukić, Stjepan Antoljak, Andreja Lainović, Živko Avramovski, Slobodanka Obradović, Nicolae Ciachir, Zorica Bučić, Martin Modrushan, Momir Jović, Goiko Medenica, Leonid Boicu, Chorghe Platon, Milovan Sekulić, Radomir Bogdanović, Branislav Milutinović, Katica Josifov, Đorđe Stavretović, Naire Ajvazi, Milić Petrović, Moma Marković, Milutin Folić, Milić Petrović, Dragi Maliković, Sreten Martinović, Hasan Duman, Arzu T. Terzi, Vladimir Zhumer, Mirjana Hurem, Davorin Erzhishnik, Azem Kozar, Peter Pavel Klasinc, Zivana Hedbeli, Mustafa Küçük, Vlatka Lemiq, Darko Rubçiq, Izet Shabotiq, Miroslav Novak, Oliver Jens Schmitt, Stefan Troebst, Fevzi Demir etj.

### **Kronikë e nivelit kulturor-arsimor të punonjësve arkivorë dhe tribunë e përhapjes së arritjeve të arkivistikës**

Revista “*Vjetari*”, që nga numri i parë e deri më sot, përveçse ishte një kronikë e vërtetë e ngritjes së nivelit kulturor-arsimor të punonjësve arkivorë dhe jo vetëm të atyre, ishte njëkohësisht edhe një tribunë e vërtetë e përhapjes së arritjeve të arkivistikës në Kosovë në përgjithësi. Në rrjedhën e viteve, me hapin e kohës, sidomos me zgjerimin e rrjetit arkivor në Kosovë dhe në veçanti me ndërtimin e godinës së re të Arkivit të Kosovës (1978), edhe nevojat u shtuan, sikundër që edhe revista “*Vjetari*” ndryshoi nga përmasat e vëllimi dhe solli bashkëpunëtorë fushash të ndryshme nga brenda dhe jashtë vendit. Nuk është tepër të konstatojmë po ashtu se revista “*Vjetari*” paraqet një histori të gjallë të arkivistikës në këto pesë dekada. Asnjë studiues që merret sidomos me fushat e historisë dhe shkencat e saj ndihmëse, në radhë të parë të arkivistikës, nuk mund të shpresojë se do të mund të shkruajë për to, pa i shfletuar me kujdes shkencor faqet e të gjithë numrave të “*Vjetar-it*”. Gjatë gjithë kësaj kohe, – që nga numri i parë e deri në numrin e pesëdhjetë, – revista “*Vjetari*” shërbeu si nxitëse e frymëzuese dhe tribunë e fjalës me peshë në këto fusha. Në faqet e saj vend meritore kanë zënë dhe janë trajtuar aktualitete arkivore, sikundër edhe tema të ndryshme në fushën e historisë dhe shkencave ndihmëse të saj.

Rubrikat kryesore të “*Vjetarit*” në rrjedh të viteve janë: *Arkivistikë, Studime, Vlerësime, Materiale, Artikuj, Kontribute, Hulumtime, Dokumente, Informata, Ekspozita, Aktivitete, Kronologji, Raporte, Nga puna e Arkivit, Bibliografi, Kritika, Recensione, In memoriam*.

Në faqet e “*Vjetar-it*” kanë gjetur hapësirë shumë autorë, që nga ata të brezit më të vjetër e deri te më të rinjtë dhe ky fakt dëshmon se revista ka qenë e hapur për të gjithë ata që kanë dëshiruar të japin kontributet e tyre

dhe të pasurojnë dijen në këto fusha. Aty janë ndriçuar e pasqyruar shumë ngjarje e personalitete. Në mënyrë sistematike në revistë janë botuar edhe shkrime të autorëve të shquar nga rajoni dhe më gjerë. Pothuajse në çdo numër të *“Vjetar-it”*, sidomos vitet e fundit, botohen shkrime të shkencëtarëve dhe të punonjësve arkivorë nga Shqipëria, gjë që ndihmon, përveç tjerash, edhe për njohjen dhe njësimin e praktikave dhe të terminologjisë së arkivistikës shqiptare.

Duke shënuar përvjetorin e 50-të të revistës *“Vjetari”*, ne shënojmë përvjetorin e një reviste tashmë tradicionale, e cila gjendet në shumë biblioteka të institucioneve dhe të studiuesve të lexuesve jo vetëm shqiptarë.

Si përfundim, mund të themi se revista *“Vjetari”*, padyshim është një pasqyrë e kronikës së zhvillimit të arkivistikës në Kosovë, përkatësisht të veprimtarive të saj jetike. Ajo mbetet prore sensibilizuese e opinionit shkencor për vlerat që ruhen në arkivat e Kosovës. Të gjitha ata që kontribuuan në vazhdimësinë e kësaj reviste, kanë meritat e tyre.

Duke ditur se në çfarë rrethanash kaloi vendi ynë, s’do mend se edhe këtë revistë e ka shoqëruar po ai fat. *“Vjetari”*, si një organ profesional e shkencor i Arkivit të Kosovës, përkatësisht Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, është një veprim i çmueshëm dhe mendojmë se kjo revistë ka përmbushur dhe vijon të përmbushë misionin e saj në fushën e vet profesionale dhe shkencore.

**Sadik MEHMETI, Nuridin AHMETI**

## **“GODISHEN ZBORNIK (VJETAR)” I FAKULTETIT TË FILOLOGJISË TË UNIVERSITETIT TË SHKUPIT**

*“Shën Kirili dhe metodi” kushtuar prof. Remzi Nesimit me rastin e 80-vjetorit të lindjes. Kniga 39–40, shkup 2013–2014, 747 f.*

Përmbledhja vjetore e punimeve të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Shkupit (nr. 39–40, 2013–2024) i kushtohet tërësisht prof. Remzi Nesimit, një nga figurat e mirënjohura dhe emblematiche të arsimit të lartë në gjuhën shqipe dhe të shkencave filologjike në Maqedoni. Lënda e pasur e këtij vëllimi hapet me rubrikën *Shkrime kushtuar prof. Remzi Nesimit*; më tej vijojnë rubrikat *Gjuhë dhe didaktikë, Letërsi dhe kulturë, Punime doktorate dhe master, Kronika*. Artikujt kushtuar prof. Remzi Nesimit zënë 113 faqe; pjesa më e madhe janë në gjuhën shqipe, por disa në gjuhën maqedonase. Vëllimi hapet me shkrimin e Agim Lekës “Me devotshmëri për jubileun e madh të profesorit të paharrueshëm”, që zë vendin e parathënies. Autori këtu shpalos figurën, veprën dhe kontributin e gjatë të prof. R. Nesimit jo vetëm për Katedrën e gjuhës shqipe të Universitetit të Shkupit, po në edhe në shkencën filologjike shqiptare në tërësi. Ai është ndalur edhe te vlerësimet e kolegëve për vlerat shkencore të studimeve të prof. R. Nesimit, i cili spikat si një shembull për t’u ndjekur nga të gjithë ata që kanë hyrë rrugën e ndritur të shkencave filologjike dhe të arsimit në gjuhën shqipe. A. Leka ka nxjerrë në pah rolin e R. Nesimit si mësimdhënës dhe si autor tekstesh mësimore për shqiptarët në Maqedoni. Në mënyrë të veçantë ka theksuar meritat e tij për miratimin e dhe zbatimin e shqipes standarde në Maqedoni, rolin e tij për organizimin dhe mbarëvajtjen e Kongresit të Drejtshkrimit (Tiranë, 1972) si një ndër delegatët nga Maqedonia.

Prof. Asllan Hamiti në artikullin “Profili shkencor-arsimor i prof. Remzi Nesimit” parashtrohet rrugën e jetës së tij si pedagog dhe studiues, me një kontribut domethënës jo vetëm për albanologjinë, por edhe për ndërgjegjësimin kulturor dhe emancipimin e popullsisë shqiptare në përgjithësi. Më tej ai ndalet në angazhimin e prof. R. Nesimit rreth përgatitjes dhe organizimit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, si dhe të Konferencës kushtuar 20-vjetorit të Kongresit (Tiranë, 1992). Prof. A. Hamiti thekson punën e vijueshme të R. Nesimit për përhapjen dhe zbatimin e shqipes letrare, por studimet e tij nga fusha të tjera si dialektologjia, historia e gjuhës, shqipja në kontekstin ballkanik,

marrëdhëniet e shqipes me maqedonishten etj. Në fund të artikullit jepet edhe një bibliografi e përzgjedhur e punimeve të prof. R. Nesimit.

Në shkrimin në vijim “Personaliteti shkencor i prof. Remzi Nesimit “ kolegu i tij nga Tirana, prof. Emil Lafe, flet për njohjen dhe bashkëpunimin e tyre shumëvjeçar. Ai jep një paraqitje të përmbledhur të drejtimeve e të arritjeve të punës shkencore të prof. R. Nesimit dhe e cilëson si një personalitet të shquar të botës intelektuale shqiptare, si një dijetar që dallohet jo vetëm për argumentimin bindës dhe gjykimet objektive rreth dukurive e proceseve që ka studiuar, por edhe për shprehjen e qartë e të rrjedhshme me një stil të përpunuar letrar, si një mjeshtër i madh i gjuhës shqipe dhe i shkollës shqipe.

Artikulli “Kontributi i Remzi Nesimit në hartimin e teksteve shkollore” i shkruar nga Avzi Mustafa paraqet kontributin shumëvjeçar të R. Nesimit për hartimin e teksteve shkollore të gjuhës shqipe në Maqedoni, duke theksuar rolin e tyre për mësimin e shqipes letrare. Autori ka vënë në dukje se prof. R. Nesimi çdo herë mban parasysh karakteristikat psikologjike-didaktike për mësim aktiv, synon që të zhvillojë te nxënësit shprehitë dhe aftësitë e zotërimit të kulturës së të shprehurit qartë dhe sipas rregullave të gjuhës letrare. Pedagogia e letërsisë Mirlinda Krifca-Beqiri ndalet te “Kontributi i prof. Remzi Nesimit në studimin e veçantive gjuhësore të krijuesve nga letërsia shqipe” si Naim e Sami Frashëri, Josif Bageri, Rexhep Voka, Haki Stërmilli, Murat Isaku. Veçoritë gjuhësore të këtyre autorëve dhe rëndësinë e veprave të tyre për zhvillimin e shqipes letrare prof. R. Nesimi i ka trajtuar në një disa artikuj studimorë, në të cilët ka shqyrtuar gjuhën e tyre në tërësi, me veçoritë fonetike e drejtshkrimore, trajtat morfologjike, sintaksën e fjalisë e të periudhës dhe veçori të fjalorit.

Artikulli i Hamit Xhaferit “Remzi Nesimi studiues në zë i gjuhës shqipe” parashtron arritjet studimore të jubilarit dhe vlerëson meritat e tij për zhvillimin e filologjisë shqipe dhe të arsimit në gjuhën shqipe në Maqedoni. Ndër të tjera autori shkruan se “në studimet gjuhësore shqiptare në Maqedoni dhe më gjerë, kontributi i R. Nesimit do të ketë peshën e vet. Duke hetuar në mënyrë të qartë thellësitë e gjuhës së folur dhe asaj të shkruar të arealit shqipfolës të shqiptarëve në Maqedoni, ai ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm lidhur me qëndrimin ndaj standardit të shqipes dhe afirmimin e tij në praktikë.” Mirushe Hoxha në artikullin “Gjuhëtari profesor Remzi Nesimi” bën fjalë për një punim magjistrature me këtë temë (90 faqe) të kandidatës Florije Shahini, që është edhe punimi parë tërësor rreth veprimtarisë shkencore e mësimore të R. Nesimit. Kjo temë magjistrature vlerësohet si arritje me vlerë jo vetëm për origjinalitetin e saj, por edhe sepse në mënyrë të ndërsjellë janë përmbledhur vështrimet biobibliografike me analizat shkencore të punimeve të R. Nesimit. Vetë Florije Shahini në artikullin “Prof. Remzi Nesimi personalitet i shquar i shqiptarëve të Maqedonisë dhe më gjerë” ka dhënë një përmbledhje të punimit të saj të lartpërmendur. Ajo e cilëson R. Nesimin si “njeri i fjalës së dhënë, i besës dhe i ndershmërisë. Ndonëse modest tej mase, Nesimi jo pa krenari i ka shërbyer një

qëllimi, çështjes së pastërtisë së gjuhës shqipe dhe zbatimit praktik të normës letrare, e cila bëhet preokupimi i tij thuhet gjatë gjithë veprimtarisë kërkimore në fushë të shqipes, gjë që duket edhe nga vetë titujt e punimeve.” Artikulli i Qani Mehmetit “Kontributi i prof. Remzi Nesimit për gjuhën shqipe” vlerëson sidomos punimet e jubilarit për çështje të normës së sotme letrare dhe të mënjanimin të ndikimeve të dëmshme nga gjuhët e huaja, veçanërisht të ndikimeve të maqedonishtes e të serbishtes në Maqedoni. Autori ndalet edhe në ndihmesat e tjera të R. Nesimit, si p.sh. në dialektologji, në ballkanologji etj.

Artikulli i Ismet Osmanit “Kontributi i Remzi Nesimit për shqipen standarde” i shkruar maqedonisht synon të njohë filologët maqedonas etj. me historikun e sanksionimit të shqipes standarde në Kongresin e Drejtshkrimit (1972), me problemet e pranimit e të zbatimit të shqipes standarde në Maqedoni dhe me kontributin e prof. R. Nesimit në këtë fushë para, gjatë dhe pas këtij kongresi. Aجتen Qamili, e cila gjatë viteve të studimeve në Universitetin e ka marrë një intervistë prof. Remzi Nesimit (botuar te revista mujore “Rrezja” nr. 3, 1998) i rikthehet kësaj interviste në shkrimin e saj “Një intervistë me prof. Remzi Nesimin para 16 vitesh”, duke u bërë një vlerësim të ri mendimeve të shfaqura atëherë nga profesori i saj. Zarije Nuredini në shkrimin “Prijet e Remzi Nesimit në dialektologjinë shqiptare” ndalet kryesisht te monografia e tij “E folmja e Dervenit” (500 fq.), që përfaqëson një studim të plotë e të kësaj së folmeje, me një material të pasur gjuhësor të mbledhur me kujdes nga autori. Në artikullin e Bertoni Sulejmanit “Studimet për sintaksën e gjuhës shqipe të prof. Remzi Nesimit” vihet në dukje se sintaksa ka qenë një fushë kryesore e studimeve dhe e veprimtarisë mësimore të R. Nesimit. Ai është autor tekstesh shkollorë dhe studimesh për çështje të ndryshme të sintaksës së fjalisë e të periudhës. Me rëndësi janë edhe vërejtjet e tij për mënjanimin e ndikimeve të gjuhëve sllave në sintaksë, që vërehen sidomos në gjuhën e shtypit, po edhe në gjuhën e folur të shqiptarëve në Maqedoni.

Botimi për nder të prof. Remzi Nesimit i një numri të vjetarit të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Shkupit me nismën e kolegëve dhe ish-studentëve të tij përbën një ngjarje me rëndësi për shkencat filologjike dhe për arsimin e lartë të shqiptarëve në Maqedoni. Vjetari kushtuar prof. Remzi Nesimit dëshmon edhe për prestigjin në rritje të Katedrës së gjuhës e të letërsisë shqipe në Universitetin e Shkupit dhe të studimeve albanologjike në përgjithësi në atë universitet. Dhe kjo i detyrohet edhe punës së prof. R. Nesimit. Veprimtaria mësimore e shkencore 40-vjeçare e ka bërë atë që të vështrohet si një prej aktorëve kryesorë në zhvillimin arsimor-shkencor gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX në Republikën e Maqedonisë, ku krahas punës së gjatë në këtë fushë, ai ka merita edhe për vlerat njerëzore dhe morale që mbart.



# **KRONIKA KULTURORE**



## KONFERENCA SHKENCORE “FJALORËT LATINISHT – SHQIP DHE LATINISHTJA NË SHKOLLAT SHQIPTARE”

Më 15 janar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës u zhvillua konferenca shkencore me temë “**Fjalorët latinisht–shqip dhe latinishtja në shkollat shqiptare**”. Me këtë veprimtari organizuesit e saj, Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, hapin një program më të gjerë konferencash shkencore me temën kuadër “**Leksikografia shqipe dygjuhëshe: gjendja, problemet, perspektivat**”. Në konferencë morën pjesë anëtarë të Shoqatës, pedagogë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja si dhe dekania e këtij Fakulteti, prof. Klodeta Dibra.

Fjalën e hapjes e mbajti kryetari i Shoqatës së Gjuhësisë Shqiptare, prof. Emil Lafe, i cili ndër të tjera tha: “Konferenca jonë e sotme, duke nderuar veprën dhe figurën e shquar të humanistit dhe atdhetarit Frang Bardhi, dëshiron ta drejtojë vëmendjen e gjuhësisë sonë në një fushë shumë të rëndësishme, por të mbetur thuajse vetëm në nivel empirik. Kuptohet se është fjala për leksikografinë dygjuhëshe të shqipes dhe për problematikat e saj të shumta. Gjuhësia shqiptare ka nisur pikërisht me një fjalor dygjuhësh, të mirënjohurin *Dictionarium latino-epiroticum* të botuar 380 vjet më parë (1635).”

Më tej ai vuri në dukje se botimi i fjalorëve dygjuhësh (gjuhë e huaj – shqip e anasjelltas), duke përfshirë këtu edhe fjalorët frazeologjikë si dhe fjalorët specialë dygjuhësh, ka një rritje të vullshme në tre dhjetëvjeçarët e fundit. Këta fjalorë dygjuhësh, që përdoren me dobi e përfitim sidomos në Universitet, është e nevojshme edhe të studiohen me qëllim që, nga njëra anë, të përpunohen teorikisht problemet e leksikografisë dygjuhëshe të shqipes, dhe, nga ana tjetër, të ndreqen të metat e të plotësohen mungesat e tyre. Leksikografia dygjuhëshe përbën sigurisht edhe më tej një fushë tërheqëse e të frytshme studimesh, sidomos për departamentet e gjuhëve të huaja.



Në vijim mbajtën mbajtën fjalë përshëndetëse prof. Raul Lilo, zv.dekan i Fakultetit, dhe prof. Zeqirja Neziri (Universiteti i Shkupit), prof. dr. Rami Memushaj, kryetari i degës së Tiranës të Shoqatës së Gjuhësisë Shqiptare. Programi i konferencës përmbante një varg kumtesash nga pedagogë dhe studiues, si: Xhevat Lloshi (Akademia Shqiptare e Arteve dhe e Shkencave), “Fjalori latinisht-shqip i Frang Bardhit si vepër leksikografike dhe si përmendore e gjuhës shqipe”; Zeqirja Neziri (Universiteti i Shkupit), “Personaliteti i Frang Bardhit”; Nermin Basha (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë), “Fjalorët latinisht–shqip nga Frang Bardhi deri në ditët tona: vështrim i përgjithshëm dhe detyra të reja”; Evalda Paci (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë), “Botimet dhe studimet për fjalorin e Frang Bardhit”; Albert Riska (Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”), “Fjalë shqipe të gjalla dhe fjalë të bjerra nga fjalori i Frang Bardhit”; Mustafa Ibrahim (Universiteti i Europës Juglindore, Tetovë), “Frazologjia dhe fjalët e urta në Fjalorin e Frang Bardhit”; Daniela Stoica - Anila Maxhe (Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë), “Mësimi i latinishtes në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë”; Eliana Paço (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë), “Fjalori i madh latinisht–shqip (dorëshkrim) i Henrik Lacajt dhe mundësitë e përgatitjes së tij për botim”; Elona Gjata, “Zanorja *ë* e patheksuar në *Fjalorin latinisht-shqip* të F. Bardhit”. Në konferencë u paraqit i përkthyer shqip për herë të parë edhe një artikull i latinistit të njohur Henrik Lacaj (1910–1991) “Mësimi i latinishtes në Shqipëri dhe latinistët shqiptarë”, i botuar së pari gjermanisht në një revistë gjermane (1961).

Kumtesat dhe diskutimet e konferencës sollën vëzhgime, analiza e të dhëna të reja për punën e Frang Bardhit, për vlerat dhe veçoritë e fjalorit të tij latinisht-shqip, për rëndësinë e tij si dëshmi e gjuhës shqipe të shek. XVII, për ribotimet dhe studimet rreth këtij fjalori, për personalitetin e Frang Bardhit si veprimtar i paepur për liri, për ndjenjat e krenarisë kombëtare të tij, për meritat si historian, mbledhës i folklorit dhe i të dhënave etnografike. U sollën, gjithashtu, të dhëna me interes për mësimin e latinishtes në Shqipëri, për fjalorët latinisht-shqip të hartuar deri tani, duke përfshirë fjalorët e mbetur dorëshkrim; dhe u theksua nevoja e shkollave të larta dhe e institucioneve shkencore për më shumë specialistë të cilësuar të gjuhëve klasike.

Me interes u ndoq ligjërata e prof. Xhevat Lloshit “Fjalori latinisht-shqip i Frang Bardhit si vepër leksikografike dhe si përmendore e gjuhës shqipe”. Kumtuesi e vështroi veprimtarinë e autorëve tanë të vjetër në një kontekst më të gjerë historik dhe u shpreh se vërshimi i pushtimeve osmane mbi Ballkan dhe në veçanti mbi trevat shqiptare ishte si një thyerje tektonike, sepse e ndërpreu evoluimin e Shqipërisë nga Mesjeta drejt Rilindjes si gjithë Europa, domethënë pati një kthim prapa dhe me një trajtë thellësisht të ndryshme nga rrjedha e pritshme europiane. Zgjerimet ngadhënjimtare osmane në shek. XVII-XVIII arritën të rrezikonin thelbin e identitetit etnik në Ballkan, por anasjelltas, në një mënyrë që mund të

tingëllojë paradoksale, popujt e goditur ende i ushqenin të gjalla shpresat për ta rifituar lirinë. Shqiptarët ende jetonin me kujtimin e Skënderbeut, prandaj te Frang Bardhi ai del si "Kuçedra e Arbërit".

Nga ana tjetër, gjuha shqipe gjatë shekujve XV-XVII përrjetoj edhe valën e një trysnie të re të huaj pas asaj të sllavishtes, dhe nga periudha e shqipes së mesme hyri në shek. XVIII në etapën e shqipes së re. Përmbledhtazi, Frang Bardhi jetoi e shkroi gjatë viteve kur ende nuk ishin shuar shpresat për rimëkëmbje etnike dhe gjuhësore. Kjo ndjenjë e përshkon dhe e shpjegon punën e tij si historian, si folklorist e etnograf, si leksikograf dhe si klerik – tha më tej prof. Xh. Lloshi.

Në konferencë u vu në dukje roli i fjalorëve dygjuhësh për saktësinë e shprehjes në përkthimet, për zhvillimin e interkulturalitetit, për pasurimin e gjuhës shqipe dhe për të penguar hyrjen në përdorim të fjalëve të huaja të panevojshme. U shtrua si detyrë që gjuhësia shqiptare ta drejtojë vëmendjen në një fushë shumë të rëndësishme, por të mbetur thuajse vetëm në nivel empirik, siç është leksikografia dygjuhëshe, e lëvruar kryesisht nga individë të pasionuar. Studimet dhe përgjithësimet teorike në këtë fushë do të ndihmojnë që të rritet cilësia e fjalorëve dhe të shtohet llojshmëria e tyre, në mënyrë që ata të përmbushin më mirë kërkesat në rritje të shkollës dhe të publikut të interesuar në gjithë hapësirën shqiptare. Për këtë Shoqata dhe Fakulteti kanë marrë përsipër të organizojnë një projekt studimor afatmesëm me pjesëmarrjen edhe të departamenteve të gjuhëve të huaja në universitetet e tjera shqiptare dhe gjithashtu të organizmave dhe specialistëve të tjerë të interesuar.

**Kujtim KAPLLANI**

## JAVA E KULTURËS IRANIANE NË SHQIPËRI



Nga 12–18 shkurt 2016 u organizua “Java e kulturës iraniane në Shqipëri”. Kjo veprimtari, e cila përmbante katër ekspozita artistike, të hapura në hollin e Muzeut Historik Kombëtar, ku merrnin pjesë artistë iranianë, ishte e treta në llojin e saj dhe ngjalli një interesim mjaft të gjerë.

Në ceremoninë e hapjes merrnin pjesë drejtori i Muzeut Historik Kombëtar z. Melsi Labi, ambasadori i Republikës Islamike të Iranit, z. Abdolmajid Mozafari, drejtori i Fondacionit Kulturor “Saadi Shirazi”, z. Abas Azizi, këshilltari i kryeministrit për kulturën z. Fate Velaj, përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, diplomatë, akademikë, artistë dhe shumë dashamirë të kulturës dhe artit iranian.

Në fjalën përshëndetëse drejtori i Muzeut Historik Kombëtar z. Melsi Labi vlerësoi lart artin pers dhe mirëpriti 3 artistët iranianë që kishin ardhur në Shqipëri për të ekspozuar dhe paraqitur publikut shqiptar artin autentik pers.

Nga ana e tij ambasadori i Republikës Islamike të Iranit, z. Mozafari, pasi uroi ditët festive të fitores së Revolucionit Islamik të Iranit, theksoi rëndësinë që ka arti dhe kultura iraniane në botë si një vlerë e hershme dhe ndikimin e madh të saj tek kulturat botërore. Ai gjithashtu hodhi dritë mbi të përbashkëtat kulturore dhe artistike që ekzistojnë midis dy vendeve dhe popujve dhe theksoi rëndësinë dhe ndikimin e madh që ka pasur arti dhe qytetërimi pers në atë shqiptar, duke përmendur kostumet popullore, teknikat e gdhendjes së metalit apo fjalët e huazuara perse në leksikon shqiptar.



Kryeredaktori i revistës kulturore shkencore “Perla” prof. Emil Lafe, i pranishëm në këtë veprimtari, do të deklaronte për gazetën “Telegraf:

*“Irani është i njohur në botën e sotme përgjithësisht për pasuritë e mëdha të naftës, e cila luan një rol të dorës së parë në ekonominë e atij vendi dhe është ndoshta malli kryesor i eksportit iranian. Në Shqipëri, dhe kjo mund të duket pak e çuditshme në vështrim të parë, artikulli kryesor i eksportit iranian ka qenë dhe është kultura! Vlera e naftës, siç jemi dëshmitarë të gjithë, ka pësuar mjaft luhatje në tregjet ndërkombëtare dhe sot ka arritur një pikë të ulët. Arti dhe kultura e iraniane, nga ana tjetër, kanë pasur dhe kanë një vlerë të qëndrueshme e të lartë në “bursën ndërkombëtare të kulturës”. Kjo vlerë e pacenueshme e tyre buron, së pari, nga lashtësia mbi 700-vjeçare që kanë mjeshtëritë artistike në truallin e popullit iranian dhe nga trashëgimia e pandërprerë brez pas brezi. Së dyti, mendoj se vlera e lartë e artit dhe kulturës iraniane buron nga shpirti krijues i popullit të Iranit, nga ndjenjat e tij delikate dhe nga pasuria e botës së brendshme dhe imagjinata artistike e pashoqe. Bukuria e harmonia e natyrës, bukuria e jashtme dhe e brendshme e njeriut si krijime të të Gjithëfuqishmit kanë frymëzuar në shekuj mjeshtrit e mëdhenj të arteve dhe të letërsisë iraniane.*

*Shqipëria jonë, e vogël në krahasim me Iranin, mund të mburret megjithatë për traditat e saj në këtë fushë. Fati historik i hodhi paraardhësit tanë në një hapësirë ku lulëzuan dy superfuqitë kulturore të lashtësisë: bota e kulturës greke dhe Perandoria Romake e në vijim Perandoria Bizantine. Është një mrekulli e vërtetë që në këtë hapësirë mundi të ruhet dhe të mbijetojë një etni, një gjuhë e një kulturë që zë fill nga kohët e mjegullta paragreke e pararomake të këtij trualli dhe që na përfaqëson e na individualizon ne shqiptarëve në botën e sotme.*

*Shqipëria dhe Irani kanë përqaftuar dhe përqaftojnë zhvillimet pozitive të kulturës dhe artit botëror dhe veçanërisht në kohët moderne, kur bota po bëhet gjithnjë e më shumë, siç thuhet, një fshat i madh! Por të dyja vendet tona dhe të dy popujt tanë janë krenarë dhe xhelozë për traditat dhe thesaret kulturore që kanë*

*trashëguar nga lashtësia, sepse në to shprehet origjinaliteti, identiteti dhe bota jonë e brendshme shpirtërore, që na bën ta ndiejmë veten këta që jemi. Prandaj ne përpiqemi t'i ruajmë, t'i mbrojmë e t'i zhvillojmë këto dhe t'ua lëmë trashëgim brezave të ardhshëm që edhe ata të bëjnë të njëjtën gjë. Kjo ekspozitë e artit iranian “Nga Teherani në Tiranë”, që çel dhe javën e kulturës iraniane, është një dëshmi konkrete për këtë politikë kulturore të ngjashme. Gjithashtu ky Muze Historik, që ka strehuar me dashuri gjithë këto vepra të shkëlqyera të mjeshtërve duarartë iranianë, është një thesar vlerash të kulturës ilire-arbërore-shqiptare.*


*Ambasada iraniane në Tiranë dhe Fondacioni Kulturor “Saadi Shirazi” kanë një meritë të madhe për organizimin e ekspozitave të njëpasnjëshme të artit dhe kulturës së Iranit në Shqipëri dhe me një varg botimesh të përkryera nga këto fusha. Të gjithë dashamirët dhe miqtë e veprimtarive kulturore, të gjitha ata që i shikojnë këto veprimtari si ura miqësie, si dritare për të parë një botë të largët, u shprehin falënderime të sinqerta. Ne sot mund të shohim nga afër jo vetëm objektet e mrekullueshme artistike që janë paraqitur këtu me hijeshi, por të njohim edhe mjeshtrit e tyre, t'i shohim në procesin e kësaj pune fisnike që bashkon në një talentin artistik, mendimin e lartë dhe shpirtin e butë, të ndjeshëm e paqësor.*

*Ekspozita e sivjetshme vjen në një kohë kur roli i Iranit në arenën ndërkombëtare si fuqi me peshë në paqen dhe sigurinë globale është në ngritje. I urojmë nga zemra popullit të Iranit lumturi dhe përparime të mëtejshme!”*



Në “Javën e kulturës iraniane në Shqipëri” u hapën katër ekspozita në fotografi, në pikturën postmoderne dhe miniaturë, Punimet (gdhendjen) e metalit (argjend dhe bakër) dhe shkrimi me anë të gdhendjes në dru dhe ishin të ftuar tre artistë iranianë.

Gjatë ditëve të organizimit të “Javës së kulturës iraniane në Shqipëri” pati një interesim të gjerë si nga publiku artdashës ashtu edhe nga studentët e Universitetit të Arteve.



# NEKROLOGJI



## **KRISTO FRASHËRI (4 DHJETOR 1920 – 31 JANAR 2016)**



Më 31 janar 2016 mbylli sytë përgjithmonë në moshën e nderuar 95 vjeç e dy muaj historiani i mirënjohur, akademiku Kristo Frashëri. Gjatë jetës së tij qe pjesëmarrës aktiv dhe dëshmitar në ngjarje nga më të rëndësishmet të historisë sonë, si pushtimi fashist dhe Lufta ANÇ, vendosja e sistemit socialist, përkulja dhe rënia e tij, vendosja e pluralizmit politik dhe zigzaget e rrugës së Shqipërisë drejt ndërtimit të rendit demokratik të qëndrueshëm. Ngritjet dhe rëniet e kësaj rruge historike ai i ka përjetuar thellë, me entuziazëm dhe me brengosje, por kurrë nuk ligështoj. Në çastet e duhura ka ngritur zërin e tij të fortë si historian kompetent dhe me autoritet për të ndriçuar të vërtetën, për të treguar udhën e drejtë që duhet ndjekur.

Nuk është jeta e gjatë ajo që e bën të mirënjohur e të nderuar njeriun. Është rruga e jetës, mënyra si e ka jetuar jetën, vepra që ka arritur të nxjerrë në dritë dhe kujtimet që ka lënë tek ata me të cilët ka pasur lidhje e marrëdhënie. Kristo Frashëri e ka jetuar me dinjitet jetën e vet, u ka ndenjtur besnik ideve të mëdha që e kanë çuar përpara njerëzimin dhe



popullin shqiptar si pjesë të tij. Atdhedashës e liridashës, luftëtar i vërtetë për lirinë kombëtare e shoqërore dhe për të vërtetën; i palodhur e i pamposhtur në vendosmërinë e tij për t'i shërbyer shkencës e kombit shqiptar. Vdekja e tij është një humbje e madhe për botën intelektuale shqiptare veçanërisht për historiografinë tonë.

Kristo Frashëri fitoi një përvojë të madhe jetësore dhe u përpoq të shpjegonte si historian proceset e ngjarjet bashkëkohore dhe të së shkuarës. Historinë e Shqipërisë e vështroi gjithnjë si pjesë të historisë së rajonit e të Europës dhe me kushtëzimet e lidhjet e saj me zhvillimet botërore. Interesimi i tij shkencor, i gjallë dhe i pandërprerë, nis që nga periudhat e mjegullta të etnogjenezë shqiptare, përshkon lashtësinë, mesjetën, Rilindjen dhe arrin deri në ngjarjet e historisë bashkëkohore. Ai ishte një enciklopedi e gjallë, një historian me horizont të hapët, një univers historie. Të duket e çuditshme si kishte mundur të grumbullonte në një jetë njeriu, sado të gjatë, atë thesar njohurish që kishte mendja e tij.

Ai pati meritën e veçantë të atyre që kanë ditur të punojnë duke qenë sistematikë gjatë gjithë jetës, duke mbledhur e klasifikuar materiale historike, duke vlerësuar çdo të dhënë, fakt e dokument dhe u përpjekur të zbulojë lidhjet e tyre të brendshme. Në këtë mes e vërteta historike, objektiviteti shkencor, metodologjia e punës dhe interesat kombëtarë kanë qenë udhëheqës të përhershëm në veprën e tij të gjerë shkencore.

Këta 15 vjet të shekullit të ri ishin veçanërisht të frytshëm për historianin tonë të mirënjohur. Ishte periudha kur ai, si të thuash voli frytet e pemëve që kishte rritur me kujdes. Përveç pjesëve të rëndësishme të hartuara e të redaktuara prej tij në veprën kolektive "Historia e popullit shqiptar", vëll. I e II, botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave (2002), si dhe një numër artikujsh, referatesh e kumtesash, po ashtu dhe një varg zërash në "Fjalorin enciklopedik shqiptar" në tre vëllime (2008–2009), në këta 15 vjet ai ka botuar edhe 26 libra studimorë të veçantë me rreth 8000 faqe shtypi. Vetëm gjatë vitit të kaluar dolën nga shtypi tri vepra të reja të tij: *Historia e Çamërisë (Vështrim historik)*. UET Press, 329 faqe; e cila pati jehonë të gjerë edhe në media, sepse vjen në një kohë kur "çështja çame", siç quhet në diskutimet e përditshme, ka nevojë për një ndriçim të gjithanshëm, të dokumentuar e të argumentuar. Dy librat e tjerë, të botuar nga Akademia e Shkencave trajtojnë në mënyrë të plotë e të dokumentuar dy ngjarje të mëdha historike të viteve '40 me rrjedhime të rëndësishme për ecurinë e mëtejshme të historisë së vendit tonë: *Kongresi i Përmetit (24–28 maj 1944)*. *Vështrim historik dhe burime dokumentare* (123 f.) dhe *Shqipëria në Konferencën e Paqes në Paris 1946*. *Vështrim historik*. (255 f.).

Gjithë kjo bibliotekë historike është fryt i erudicionit, i përvojës së tij të gjatë dhe i dokumenteve e materialeve të grumbulluara e të sistemuara

me kujdes e me durim vite e vite me radhë. Ai gjithashtu ndiqte me vëmendje edhe botimet e ndryshme historike e dokumentare brenda e jashtë vendit. Në vitet kur për arsye shëndetësore qëndroi i mbyllur në shtëpi, priste gjithnjë me gëzim të dëgjonte për ndonjë botim të ri historik. Lajme të tilla ishin gëzimi i tij.



Kristo Frashëri ka qenë një nga bashkëpunëtorët më të shquar të revistës “Perla”. Këtu ai

botoi në disa numra studimin “Letërsia shqipe me alfabetë orientale” (2009, nr. 4, f. 9–20; 2010, nr. 1, f. 28–35; nr. 2–4, f. 7–15; 2011, nr. 1, f. 5–14; nr. 3–4, f. 5–10; në vijim artikullin “Trashëgimia letrare shqipe në shekullin XVII” (2012, nr. 1, f. 5–10) dhe më pas “Sulejman Naibi dhe vendi që ai zë në letërsinë shqipe të shek. XVIII” (2012, nr. 2, f. 5–13), “Sulejman Naibi, vjersha” (2013, nr. 1, f. 5–10), ndërsa në vitin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë botoi artikullin “Kuvendi Kombëtar i Vlorës dhe parimet e tij europiane” (2012, nr. 3–4, f. 16–19). Edhe në vitin e fundit të jetës, kur ishte 95 vjeç, ai e vijoi bashkëpunimin me “Perlën” duke na sjellë një studim interesant e të pasur me të dhëna e analiza për një libër gjeografie të Shqipërisë të fillimit të shekullit XIX: “Qirjako Kutra dhe vizioni i tij gjeografik mbi Shqipërinë (1832)” (2015, nr. 2, f. 17–32; nr. 3–4, f. 56–65).

Tërë vepra shkencore e prof. Kristo Frashërit përshkohet nga ndjenja e dinjitetit të lartë kombëtar dhe nga besimi te aftësitë e popullit të vet për të qenë i barabartë ndërmjet të barabartëve në botën e sotme. Në veprën shkencore të Kristo Frashërit shpaloset një vijë e pamposhtur qëndrese dhe mbijetese e etnosit shqiptar, një synim i pandalshëm drejt konvergimit kombëtar dhe bashkimit të fuqive intelektuale e të burimeve njerëzore e ekonomike. Në studimet e tij shpalosen ndeshje të mëdha të forcave dhe energjive pozitive të popullit shqiptar dhe njerëzve vizionarë të historisë së

tij me forcat e huaja dhe me rrymat e brendshme që janë renditur në anën e gabuar. Prandaj vepra e tij është edhe një shkollë edukimi atdhetar. Si e tillë, ajo dhe kujtimi i tij do të jenë të pavdekshëm.

**Emil Lafe, Kastriot Bezati**

### ضمیمه

استفان پریفتی، استاد، زبان شناس و مترجم برجسته (۱۹۱۰-۱۹۷۵)

۱۱۹ \_ رمضی پرناسکا / تفه توپالی

### کتاب شناسی

۱۲۵ سخنرانی های کنگره بین المللی باستان شناسی آلبانیایی \_ لوان پرژیتا

۱۳۳ نشریات آرشیو کوزوو در طول پنجاه سال \_ صادق محمدی / نورالدین احمدی

"گودیشن زبورنیک (سالنامه)" دانشکده علم زبان در دانشگاه اسکوپیه

۱۳۸ \_ امیل لافه / والتینا نستور

### گزارش فرهنگی

۱۴۳ کنفرانس علمی لغتنامه لاتین - انگلیسی و زبان لاتین در مدارس آلبانی \_ کویتیم کاپلانی

۱۴۶ برگزاری هفته فرهنگی ایران در آلبانی \_ التون لی لا

### یادگاری

۱۵۱ شخصیت برجسته کریستو فراشری (۱۹۲۰-۲۰۱۶) \_ کاستریوت بغزاد / امیل لافه

۱۵۵ فهرست فارسی

## “PERLA” مروراید

فصلنامه علمی - فرهنگی، سال بیست و یکم

شماره اول سال ۲۰۱۶ میلادی - شماره مسلسل ۷۴

### فهرست مطالب

#### روابط فرهنگی

- ۵ نگرش انتقادی سامی فراشری به شعر فارسی \_ عبدالله رجبی

#### آلبانی شناسی

- ۱۷ اسم مفعول و غیر مفعول در زبان آلبانی \_ هنری بواسین
- ۲۹ شخصیت استفان پریفیتی و ترجمه آثار بارلتی در باره زندگی اسکندربگ \_ شپتیم چوچکا
- نگاهی بر اصطلاحات لباس و لوازم آرایشی و بهداشتی در زبان آلبانیایی امروز
- ۳۲ \_ دوریانا توجاری
- ۴۷ معناشناسی کمال \_ یونیدا جورا - انتورف
- ۵۵ آموزش ملی علم جغرافیا از طریق کتاب های درسی (۱۹۱۲-۱۹۳۹) \_ واسیل کریستو
- ۶۴ مهاجرت و ویژگی های آن در تیرانا (۱۹۴۵-۲۰۰۲) \_ مریتا کوکا-کاراگونی

#### ایران شناسی

- ۷۳ اوج و تعادل در ادبیات فارسی \_ محمد جعفر یاحقی
- ۸۲ سبک نثر فارسی \_ احمد تعمیم داری
- ۹۲ در باره فلسفه زبانی مولانا \_ آکیرو ماتسوموتو
- داستان ناشناخته نامه حضرت محمد (ص) خطاب به پادشاه ایران خسرو دوم
- ۱۰۴ \_ سوالات جوهری



**Fondacioni Kulturor Iranian  
SAADI SHIRAZI**

**ADRESA: Rruga Ismail Qemali, Nr. 12, Ap: 3/2; 3/3, Tiranë.**

**Tel: +355 4 2238301**

**<http://www.iranalbania.ir/> E-mail: [iranalbania@gmail.com](mailto:iranalbania@gmail.com)**